



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 23 E 24 KORRIK DHE 7 GUSHT E 17 SHTATOR 2020**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. I 24. JULA I 7. AVGUSTA I 17. SEPTEMBRA 2020. GOD.**

**KORRIK/GUSHT/SHTATOR - JUL/AVGUST/SEPTEMBAR
2020**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Debat parlamentar për situatën financiare të Telekomit të Kosovës, pas lejimit të përmbarimit të vendimit përfundimtar OEN nr. 20990/MHM, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Paris,
4. Debat parlamentar për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Parlamentarna rasprava o finansijskoj situaciji u Telekomu Kosova, nakon dozvole za izvršenje konačne odluke OEN-a br. 20990 /MHM, Međunarodnog arbitražnog suda pri Trgovačko-industrijskoj komori Pariza,
4. Parlamentarna rasprava o pravima penzionera platiša doprinosa.

Mbledhjen e drejtoi kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë menjëherë me seancën e radhës, me rendin e ditës, i cili u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

I hap punimet e kësaj seance, e cila e ka rendin e ditës në marrëveshje me Kryesinë dhe grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 15 korrik 2020.

Për procedurë zoti Arben Gashi, urdhëro!

ARBEN GASHI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Propozoj që në rend të ditës të futet edhe plotësimi i komisioneve, për çka e kam dërguar letrën, për shkak se komisionet ad hoc kanë mbetur pa anëtarë nga radhët e LDK-së, Komisioni ad hoc për Bordin e Radiotelevizionit të Kosovës dhe Komisioni ad hoc për media. Letra zyrtare ju ka ardhur, sepse kemi mbetur baras me vota në komision dhe duhet ndryshuar derisa sa të gjendet një zgjidhje edhe Nismën, nëse mund të formojë komision. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Kjo ka të bëjë me disa plotësime në komisionet parlamentare. A pajtoheni që të futet si pikë e fundit të rendit të ditës. Kemi pra propozime nga AAK-ja, nga LDK-ja i kemi dy propozime. Ka të bëjë me plotësimet e emrave në komisionet parlamentare.

Kush është për që të plotësohet rendi i ditës me këto ndryshime. Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka.

Abstenime? Nuk ka.

Atëherë, konstatoj që pika e fundit e rendit të ditës të kësaj seance do të jetë plotësimi i komisioneve parlamentare me propozimet e reja që vijnë nga grupet parlamentare.

Vazhdojmë me pikën e parë:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimi në emër të grupit siç e dini zgjat pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën, në mënyrë që të caktohet minutazhi. Në emër të Grupit të VV-së, fjalën e ka deputeti Hajrullah Çeku, pesë minuta.

HAJRULLA ÇEKU: Deklarim në emër të Grupit Parlamentar.

Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës,

Para ca kohësh, data 27 qershor kishte fituar një rëndësi historike në Kosovë, kështu e cilësonin një pjesë e mirë e protagonistëve të klubit të stërvjetëruar politik, e patën çuar aq lart sa e krahasonin edhe më 17 shkurtin, edhe më 12 qershorin. Prisni se do të shihni, na patën thënë në atë kohë, e një lidhje të veçantë më 27 qershor ka edhe zoti Avdullah Hoti dhe kjo qeveri. Ai në mesin e muajit qershor pati thënë që si kryeministër në shenjë të vullnetit të mirë heq dorë nga aplikimi për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, pati thënë që këtë po e bën për ta penguar sabotimin e dialogut nga Serbia. Në shkëmbim pati premtuar që Serbia do ta ndalë fushatën për çnjohje dhe afati që kishte caktuar ishte 27 qershori, vetëm deri në këtë datë do të vlejë pezullimi i politikës sonë të jashtme, këto janë fjalët e zotit Hoti.

Por, edhe pse po bëhet një muaj tashmë asnjë fjalë, asnjë veprim nga kjo qeveri. Kosova vazhdon të mos aplikojë për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, e për më keq, nuk kemi as angazhim e as lobim për njohje të reja të shtetësisë. Kjo qeveri ka pushuar aktivitetin diplomatik, as anëtarësim, as njohje, krejt kjo në dëm të subjektivitetit tonë ndërkombëtar. Diplomacia jonë ekziston vetëm në Tweeter, dhe akuzon komisionerë e BE-së për librat që gjenden në zyrën e Serbisë në Bruksel. Zoti Hoti dhe qeveri, afati që keni dhënë ka qenë 27 qershori dhe ky afat ka skaduar, Serbia nuk e ka ndaluar angazhimin për çnjohje, pse Kosova nuk është duke aplikuar për anëtarësim në organizata ndërkombëtare? Nëse e keni shtyrë afatin, na tregoni ose nëse qëndron e kundërta, na informoni. Për shembull, do të mund të nisni duke na treguar se për cilat aplikime jeni duke punuar aktualisht. Shkurt, na tregoni të vërtetën, kjo zemërgjerësi juaja karshi Serbisë a vazhdon ende apo jo, sepse ata nuk po ndalen. Çdo hap yni prapa në raport me shtetësinë tonë është hapësirë për Serbinë që të bëjë edhe një hap përpara për të cenuar shtetësinë tonë dhe ju e dini shumë mirë këtë gjë.

Besoj ju kujtohet deklarimi i Presidentit Thaçi menjëherë pas dështimit të anëtarësimit në Interpol, në nëntor 2018, pa dialog me Serbinë, s'ka anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Kështu pati deklaruar zoti Thaçi, ju po e vazhdoni këtë mendësi sabotuese ndaj shtetësisë së Kosovës, ai mbase nuk është pjesë e dialogut, kështu fizikisht, me prezencë, personalisht, por qasja nuk ka ndryshuar, gabimin e tij po e përsëritni edhe ju, e kjo është e pafalshme, përveç që është edhe e rrezikshme.

Qytetarë të nderuar të Kosovës, ne sot nuk kemi politikë të jashtme. Kjo Qeveri as nuk angazhohet për afirmim të subjektivitetit tonë ndërkombëtar, as nuk bën përpjekje për të penguar ofensivën e Serbisë për të cenuar Republikën tonë. Ndërsa, paradoksalisht të gjitha shpresat për konsolidim të shtetësisë i ka te Serbia. Sa më gjatë që qëndron kjo qeveri, aq më e thellë bëhet pabarazia mes Kosovës dhe Serbisë, sa më gjatë që politika jonë e jashtme qëndron në hibernim, aq më e cënueshme do të bëhet shtetësia jonë. Heqja dorë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare është nënshtrim. Derisa Kosova vazhdon të bëjë lëshime karshi Serbisë, kjo e

fundit nuk ka ndryshuar as kërkesat, as veprimet në raport me Kosovën. Hyrja në dialog në kushte të pabarabarta nuk mund ta nxjerrë Kosovën si palë të barabartë dhe me njohje reciproke në fund. Pra, supozimi juaj që njohjet e anëtarësimet do të vijnë vetëm nëse do të kemi marrëveshje me Serbinë është i ndërtuar mbi premisa të gabuara. Asnjë qytetar i Republikës së Kosovës nuk ua ka borxh këtë qasje, e as juve, as Presidentit, në lojën e të cilit jeni futur me shumë zell. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, po e shoh deputeti Ilir Tasholli e ka kërkuar fjalën, nuk ka të tjerë të paraqitur. Në rregull! Atëherë, ju e keni fjalën si deputet, do të thotë 3 minuta! Faleminderit, vazhdoni! Mikrofonin edhe një herë deputetit, ju lutem!

Deputet, si duket ka probleme teknike me mikrofonin tuaj, ju lus ta përdorni foltoren!

ILIR TASHOLLI: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje edhe një herë, kryetare e Kuvendit!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Zëvendëskryeministra,

Ministra,

Të nderuar kolegë deputetë të Parlamentit,

Sot kërkoj vëmendjen tuaj që nga ky Kuvend të adresoj një shqetësim dhe në të njëjtën kohë edhe kërkesën e një komuniteti të biznesit që është në gjendje të rëndë dhe është sektori i gastronomisë apo i hotelerisë.

Duke qenë të vetëdijshëm për gjendjen në të cilën jemi tash si Kosovë, pra këtë të pandemisë, por edhe në të njëjtën kohë krizën ekonomike, e cila sapo vjen dhe po thellohet, vlerësoj se është e domosdoshme që për zbutjen e krizës sadopak duhet të rishikohen masat kufizuese për disa sektorë të ekonomisë, me theks të veçantë, sektorin e gastronomisë që inkorporon brenda edhe sektorin e turizmit dhe që është një sektor që numëron dhjetëra-mijëra të punësuar gjithandej në Kosovë, pra me numrin më të madh të të punësuarve në sektorin privat. Me masat aktuale kufizuese në fuqi këtij sektori i lejohet të punojë deri në orën 21:00, e që në fakt është e pamjaftueshme për të zhvilluar sadopak veprimtarinë e tyre dhe, rrjedhimisht me këtë orar hoteleria është duke përjetuar humbje të mëdha, punëtorët janë duke u zvogëluar në numër dhe kjo po shkakton vështirësi të shtuar dhe në të njëjtën kohë po e rrit numrin e të papunëve dhe, për më shumë, nëse edhe për pak kohë vazhdon ky trend, atëherë ky sektor do të vihet para kolapsit total ose drejt falimentimit të paevitueshëm.

Duke pasur parasysh ato që thashë më lart, u bëjmë thirrje të gjitha institucioneve që në një afat sa më të shpejtë orari i punës për këtë sektorë të vazhdohet nga ora 21:00 që është aktualisht, deri në orarin normal që është ora 23:00. Pra, të bëhet shtesë për dy orë dhe t'u mundësohen edhe

lehtësi të tjera që do të ndikojnë në veprimtarinë apo afarizmin e këtij sektori, pra të hotelerisë dhe të turizmit. Zgjatja e orarit të punës për vetëm dy orë në asnjë mënyrë nuk do të cenonte punën rreth menaxhimit të pandemisë, e sigurisht me një mbikëqyrje më të mirë të këtyre bizneseve dhe me zbatimin e protokolleve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera relevante.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I bindur thellë se edhe shumë nga ju jeni përballur me këto kërkesa të njëjta që janë shumë të arsyeshme, kërkoj që të jepni edhe ju kontributin tuaj, për shkak se kjo kërkesë është e natyrës urgjente. Andaj, në një afat sa më të shpejtë të zgjatet orari i punës për objektet hoteliere nga ora 21:00 deri në orën 23:00 me qëllim të shmangies së thellimit të krizës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, kush flet në emër të grupit? Në emër të grupit nuk ka për momentin, si deputete Blerta Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Do të paraqes sot shqetësimin tim, i cili shpreh brengën lidhur me vizitën e pazakontë të raportueses për Kosovën në Parlamentin Evropian, zonjës Von Cramon, në Dhomat e Specializuara në Hagë, vetëm një ditë pas intervistimit të Presidentit Thaçi.

Vizita, por edhe deklarimi i zonjës Cramon për punën e Gjykatës Speciale konsideroj se është ndërhyrje në këtë gjykatë dhe një veprim si ky nuk do të duhej që asnjëherë t'i takojë asnjë zyrtari evropian, i cili është i ngarkuar me përgjegjësi politike. Veprime të tilla bien ndesh me frazën e njohur e të ripërsëritur nga Bashkimi Evropian që drejtësia do të duhej të jetë e pavarur nga politika.

Të nderuar deputetë,

Ne e dimë mirëfilli se vizitat në organet e drejtësisë dhe deklaramet politike rreth proceseve të tyre e dëmtojnë esencialisht besueshmërinë e ndaj këtyre proceseve dhe fare lehtë mund të perceptohen si ndërhyrje e qëllimshme politike për favore të caktuara. Në anën tjetër, më habit thellësisht fakti se institucionet e Republikës së Kosovës, po edhe ato të Bashkimit Evropian, e kaluan fare në heshtje këtë veprim të pajustificueshëm dhe pa precedent të saj, duke qenë të vetëdijshëm për trysnin e ushtruar ndaj çdo veprimi shumë më minor të ndonjë politikani kosovar në raport me Gjykatën në Hagë, apo çfarëdo procesi gjyqësor. Fakti se Von Cramon është një deputete evropiane, nuk e zhvesh atë asnjëherë nga detyrimi për t'u qëndruar larg

këtyre proceseve gjyqësore. Në realitet, si raportuese zonja Cramon, por edhe si grua do duhej të bëhej e zëshme për vënien e drejtësisë për 20 mijë gratë dhe vajzat e dhunuara nga forcat e rregullta të ushtrisë e policisë së Serbisë, për vrasjen makabre të 1 mijë e 230 fëmijëve, përfshirë këtu fëmijë të porsalindur dhe qindra masakra, të cilat shkaktuan natyrisht vrasjen e mbi 14 mijë shqiptarëve nga shteti i Serbisë. Zonja Cramon do të duhej që energjinë e saj ta përqendrojë në liberalizimin e lëvizjes së lirë për qytetarët më të rinj të Evropës, pas përmbushjes së të gjitha kriterëve nga institucionet e Kosovës.

Bashkimi Evropian duhet ta kuptojë dhe ta respektojë këtë shqetësim tonin mbi tejkalimin e rolit nga ana e raportueses së tij për Kosovën dhe t'i përgjigjet një herë e mirë nevojës sonë për sigurim të raportimit korrekt dhe pa konotacione partiake mbi zhvillimet në Kosovë. Por, edhe ne si përfaqësues politikë e të zgjedhur të popullit nuk do të duhej të qëndrojmë indiferentë dhe të kërkojmë që Kosova të prezantohet drejtësisht e denjësisht në institucionet e Bashkimit Evropian dhe jo të shfrytëzohet si vegël për kalkulime e manipulime të caktuara politike brenda dhe jashtë saj.

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, fjalën e ka kërkuar deputeti Arbër Tolaj.

ARBËR TOLAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Bazuar në analizat e ekspertëve të ekonomisë, si pasojë e Covid 19, aktualisht mijëra biznese në vend janë në gjendje të rëndë, e ndër veprimtaritë biznesore pothuajse më të atakuara nga efektet e pandemisë pa dyshim mbetet gastronomia. Prandaj, si pasojë e gjendjes së krijuar në Kosovë rrezikojmë falimentimin e shumë veprimtarive biznesore, për aq sa pritet edhe humbja e mijëra vendeve të punës në këtë sektor.

Duke iu referuar situatës së krijuar, konsideroj se vendimi për kufizimin e orarit të punës për sektorin e gastronomisë duhet të rishqyrtohet nga Qeveria e Kosovës, ngase reduktimi i orarit deri në orën 21:00 vërtet duket i pakuptimtë. Çfarë do të thotë 3 orë më pak lëvizje, kur respektohen masat e tjera të vendosura nga Qeveria? Këto orë lëvizjeje nuk kanë ndonjë efekt të madh në uljen e numrit të rasteve nëse respektohen të gjitha masat e parashtruara dhe të kërkuara. Përderisa 3 orë më pak punë, do të thonë shumë për profitin e secilit restorant dhe kafene në vend. Andaj, në këtë rast vlerësoj se do të ishte e udhës që orari i gastronomisë të zgjatej të paktën deri në orën 24:00, kuptohet duke respektuar masat e distancës sociale, zhvillimin e aktivitetit në hapësira të hapura, mbajtjen e maskave nga punonjësit dhe klientët, dezinfektimet e rregullta të hapësirave, higjienën e punonjësve, si dhe masa të tjera të nevojshme që parandalojnë rritjen e numrit të rasteve me COVID.

Ndërsa, masat sanksionuese do të vlenin vetëm për veprimtaritë gastronomike, të cilat nuk respektojnë rregullat dhe masat e kërkuara nga autoritetet shtetërore, siç janë: Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike. Prandaj, presim nga Qeveria e vendit që të angazhohet në rimëkëmbjen ekonomike, si dhe nevojën financiare për të paguar punëtorët, obligimet e qeverisë për ndihmë prej 170 euro për bizneset, për të gjithë punëtorët në kuadër të gastronomisë, sepse ky sektor vërtet nëse nuk ndërmerren masa konkrete të tjera, është në prag të falimentimit, ndërsa Kosova nuk ka kapacitete të mjaftueshme ta përballojë këtë situatë.

KRYETARJA: Faleminderit! Deputeti Artan Abrashi e ka fjalën.

ARTAN ABRASHI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Dje u bënë 10 vjet nga mendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, i cili konstatoi që Serbia nuk kishte të drejtë në pretendimin e saj se shpallja e pavarësisë së Kosovës kishte shkelur të drejtën ndërkombëtare. Kësisoj, Gjykata Ndërkombëtare konstatoi se shpallja e pavarësisë së Kosovës ishte e ligjshme në pikëpamjen e të drejtës ndërkombëtare.

Por, atë që e bëri Gjykata Ndërkombëtare, nuk e bëri asnjëherë Qeveria e atëherëshme e Kosovës, nuk po e bën as kjo e sotmja. Madje, si atëherë, edhe tani qeveritarët e Kosovës ishin vënë sikur për ta relativizuar këtë vendim të rëndësishëm të drejtësisë ndërkombëtare. Dështimi i Serbisë në GJND nuk u shfrytëzua nga Kosova, GJND na ka pajisur me një instrument të rëndësishëm, por ai nuk u përdor në të kaluarën dhe nuk po përdoret as sot. Po bëhen thujtëse 10 vjet prej kur Kosova ndodhet në tavolinën e dialogut me Serbinë, një herë teknik, e pastaj politik. Por, gjithnjë për çështjet e saj të brendshme. Pikërisht në vitin 2011 ky proces i stërmunduar u nis gabimisht dhe në dëm të Kosovës. Kësaj i thonë 10 vjet koncesione të dhimbshme e prapaskena politike që qëllim kishin forcimin e pranisë fizike dhe faktike të politikës serbe brenda territorit e institucioneve të Kosovës.

Pikërisht këtë dhe për ato pak çështje të mbetura të brendshme e rikthyen në skenë Skënder Hysenin, i cili sot po shkon në Bruksel. Si për ironi, por në fakt si mohim, sot në 10-vjetorin e mendimit të GJND-së do të udhëtojë apo ka udhëtuar zoti Skënder Hyseni për në Bruksel në takim me Gjuriqin. Përsëri për çështje të brendshme të Kosovës, sërish pa platformë, pa parime, e i papërgatitur. Për çka do të negociojë ai? Kë e përfaqëson? Ku bazon qëndrimin e shtetit të Kosovës dhe mbi të gjitha, kush po negocion, Skënder Hyseni. A nuk mjafton vetëm kaq për të kuptuar se çfarë po ndodh, kush ka pritshmëri se do të mbrohet interesi i Kosovës nga një përbërje e tillë, apo se kjo qeveri qëllimshëm po futet në një proces dialogu pa platformë, pa parime, të papërgatitur dhe me persona të tillë, për të cilët e pakta që mund të thuhet është se janë joadekuatë. Nga fjalimet për njohje reciproke në vijat e kuqe, në pak ditë pamë heqje të reciprocitetit, heqje dorë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare e përfundam në një

kryenegociator si zoti Hyseni. A nuk mjafton të mos duash vendin që të bësh emërime të tilla, duhet ta urresh vendin e popullin tënd që ta vendosësh Skënder Hysenin për të negociuar gjoja marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Kundër përbërjes së këtij ekipi negociator ka reaguuar edhe Nisrete Kumnova, kryetare e Shoqatës “Thirrjet e nënave”. Ajo ka deklaruar me të drejtë se gjatë gjithë kohës...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Vazhdoja edhe 30 sekonda, të lutem!

ARTAN ABRASHI: Zonja Nisrete Kumnova, kryetare e Shoqatës “Thirrjet e Nënave”, ka deklaruar se gjatë gjithë kohës keni kërkuar të përfshihemi në delegacionin e bisedimeve me Serbinë për faktin se ne jemi kategoria më e prekur dhe më e anashkaluar gjatë gjithë procesit të zbardhjes së fatit të të pagjeturve. Pjesëmarrja jonë është e rëndësishme në këtë delegacion përballë Serbisë kriminale, e cila ende mban peng politik fatin e shqiptarëve të zhdukur, por çfarë mund të pritet tjetër nga zoti Hyseni, i cili sa ishte ministër i Punëve të Jashtme nuk kishte bërë asgjë për të pagjeturit.

Ky emërim u përshëndet nga zoti Thaçi ende pa u nënshkruar vendimi nga Hoti. Një vendim ndërshtetëror që u tha shihet se më së paku Avdullah Hoti ka vendosur, por për çfarë koordinimi ndërshtetëror po bëhet fjalë, a po flitet për negociatorët e Kosovës apo për një person të pranuar jo vetëm nga zoti Thaçi, por edhe nga zoti Vuçiq. Ky Aleksandër Vuçiq që 25 vjet më parë deklaronte se për secilin serb të vrarë ne do të vrasim 100 myslimanë, është po ky i njëjti pra. Por, në...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu e ka fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar,

Kolege dhe ju kolegë deputetë,

Më lejoni fillimisht të përshëndes vendimin e qeverisë, vendimin që ka marrë për aprovimin e shtesave të punëtorëve shëndetësorë, por njëkohësisht kërkoj nga qeveria që të marrë edhe një vendim tjetër që të aprovojë shtesat për Policinë e Kosovës, të cilët punojnë nga 12 orë në ditë me orar të stërzgjatur dhe ju e dini që për shkak të pandemisë orari i tyre është i rënduar, sepse kanë të bëjnë direkt me qytetarët e Republikës së Kosovës 12 orë në ditë dhe pagat bazë nuk u mjaftojnë për udhëtime dhe për shujta.

Kështu që, i nderuar kryeministër,

E nderuar ministre e Financave,

Kërkoj nga ju që në mbledhjen e radhës të hedhet në propozim edhe vendimi për shtesat e Policisë. Policia e Kosovës meriton një trajtim më të dinjitetshëm gjatë kësaj kohe, sepse i gjithë populli i Kosovës tani ka sytë rreth angazhimit të Policisë së Kosovës për të vënë rend dhe disiplinë, ju e dini angazhimin që kanë pasur tani vetëm në aplikimin e vendimit për të bartur maskat dhe për të ruajtur distancën dhe respektuar masat e marra për shkak të pandemisë. Prandaj, meqë ne nuk po shohim se janë zbutur masat dhe kjo gjendje e rënduar po tejkalohet, e shohim të arsyeshme që puna e Policisë së Kosovës do të jetë më se e domosdoshme edhe në ditët e ardhshme me orarin e plotë 12 orë ose të stërzgatur 12 orë, kërkoj nga ju që ta vëni në shqyrtim këtë kërkesë timen që Policisë së Kosovës t'i aprovohen shtesat për orarin e shtuar. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputetja Teuta Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Unë në këtë pikë i kam dy çështje: e para që do ta ngre është shqetësimi i qytetarëve lidhur me kamatat që po ua bëjnë bankat në këtë kohë të pandemisë, edhe për shkak se ka qenë një marrëveshje që gjoja të mos u faturohen kamatat e larta, ata po ankohen që në kohën e tremujorit të pandemisë marrëveshja ka qenë që të ngrihet pagesa, por njëkohësisht edhe kamata.

Pra, ata nuk e kanë ngrirë kamatën, e kanë ngri pagesën për një kohë, mirëpo tani në këtë kohë po ua faturojnë kamata shumë të larta. Pra, ky është një shqetësim i qytetarëve, me të cilin do të duhej të merren institucionet, edhe BQK-ja, në mënyrë që të mos diskriminohen qytetarët, edhe për shkak të marrëveshjes që ka qenë dhe e cila nuk është respektuar.

Dhe, e dyta, kryetare e Kuvendit, unë sot kam dalë të marr fjalën për shkak të pamundësisë që nuk ma ke lejuar mundësinë në replikë, e pse e ke pozitën e kryetares, e ke mundësinë, mirëpo nuk e ke të drejtën të ma ndalësh fjalën. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës që 10 vjet vetëm një herë të vetme ma gjej një fjalë, vetëm një herë, që unë e kam fyer dikë në këtë sallë, në cilindo transkript, vetëm një herë për 10 vjet ma gjej, sepse ke thënë “fyen”, prandaj të kisha kërkuar vetëm një herë të vetme ma gjej një fjalë për 10 vjet kur dhe kënd e kam fyer unë në këtë sallë. Kurrë nuk fyej, kam pritur shumë, kryetare, prej teje që do të ishe një faktor unifikues dhe shembull se si udhëhiqet Kuvendi i Republikës së Kosovës si një grua, kam besuar shumë dhe po të ftoj ende që ta marrësh këtë rol, në mënyrë që faktori shqiptar të jetë bashkë kundrejt Listës serbe, sepse mendimi për Listën serbe edhe dje, edhe sot, edhe nesër imi ka qenë: ata janë me trup në Kosovë, por me kokë janë në Beograd. Këtë e kam thënë dhe e them edhe sot, mirëpo atyre duhet t’ua tregojmë vendin vetëm me ndryshimin kushtetues, e kam kërkuar prej teje dhe kam thënë jam “pas teje për të rregulluar diçka, jo për të bërë politikë”.

Megjithatë, edhe një herë, kryetare, them nuk është e sinqertë, po dua të besoj që do të marrësh një rol të unifikimit të faktorit shqiptar, në mënyrë që të mos ua japim mundësinë Listës serbe të bëjnë dasmë. Pra, në këtë mënyrë, në këtë rrugë kisha kërkuar prej teje ta marrësh këtë rol, sepse...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Zonja deputete, po e shfrytëzoi këtu një 30 sekonda nga vendi, me mirëkuptimin e deputetëve, për shkak të mundësisë që mund të përhapet pandemia. Në qoftë se doni të dini saktësisht cilat kanë qenë fjalët që unë i konsideroj fyese janë fjalët “mos shit moral”, sepse për mua morali nuk është në shitblerje, ose e ke ose nuk e ke. Urdhëroni, nëse doni të kundërpërgjigjeni!

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare! Atë që e kam thënë në Facebook i rri prapa, konsideroj që rezolutat janë humbje kohe dhe nuk janë obligative, kryetare, këtë e kam thënë. Vetë kryetarja dhe gjithë deputetët e dinë që rezolutat, fatkeqësisht, nuk janë obligative për qeverinë, prandaj në këtë kuptim e kam thënë dhe kjo nuk rregullon atë që keni synuar, e për të cilin unë jam pas juve, por me ndryshimet kushtetuese. Eja, fillo ndryshimet kushtetuese më ke prapa.

KRYETARJA: Faleminderit! E konfirmoj që rezolutat shprehin vullnet politik, siç e di secili deputet, e fundit që e merr fjalën, ju kish lutur të rrini brenda minutave, sepse edhe ashtu vetëm një minutë ka mbetur, por deputetes 3 minuta, deputetja Valdete Idrizi e ka fjalën, me kartelë të deputetit Bekim Haxhiu.

VALDETE IDRIZI: E nderuar kryetare!

Kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë dhe

Qytetarë të Kosovës,

Sot desha të shpreh një shqetësim jashtëzakonisht të madh sa i përket Veriut të Mitrovicës, apo Veriut të Kosovës.

Një kolonizim që është duke ndodhur atje, apo më mirë të thuhet një spastrim etnik që është duke ndodhur në Veri, edhe atë në mënyrë të heshtur nga Qeveria e Serbisë përmes strukturave paralele që janë të instaluar atje.

Të dashur kolegë deputetë, qytetarë,

Unë bashkë me kolegët e mi deputetë nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut ishim edhe në vizitë dje, pasi që e kemi prit në komision përfaqësues të Këshillit të Veriut edhe i kemi parë për së afërmi të gjitha ato shtëpi kolektive, banesa kolektive që janë duke u ndërtuar në Lagjen e

Boshnjakëve, në Lagjen 7 Shtatori apo Tre Rrokaqiejt, në Lagjen Kroj i Vitakut dhe qindra shtëpi në Luginën e Diellit apo Zveçanin e vogël. Ju lutem, kjo është për alarmim, qytetarët atje janë të frikësuar, po dua t'ju rikujtoj se vetëm gjatë kohës së pandemisë janë ndërtuar dhjetë banesa kolektive, në këta muajt e fundit, aktualisht janë duke u ndërtuar edhe 10, dje i kemi parë dhe me sytë tonë.

Ju kisha lutur, ne si shtet, si qeveri, duhet pasur një strategji të përbashkët. Në një, që t'i mbajmë shqiptarët atje që janë, nën 2, të rikthehen. Po dua t'ju them që lejet u jepën vetëm serbëve, lejet për rindërtim dhe për ndërtim nuk u jepën shqiptarëve që jetojnë atje, institucionet tona nuk kanë strategji dhe nuk ka buxhet, edhe ata që kanë dëshirën të jetojnë atje, të rindërtojnë, nuk kanë mundësi. Ju kishim lutur edhe një herë që të gjithë bashkë, t'i lëmë inatet personale, inatet ndërpartiake e të ndërtojmë një strategji që t'i mbajmë qytetarët atje. Me të vërtetë është për t'u shqetësuar, i kemi parë reagimet, në mënyrë vetjake kanë reaguar këshillat e të gjithë këtyre lagjeve etnikisht të përziera, mirëpo këtë nëse e lejojmë sot, pa reaguar, pa një strategji, mendoj që nesër do të jetë vonë. I kemi parë edhe në jug të Serbisë qysh është bërë me pasivizimin e adresave të shqiptarëve atje. Andaj ta kemi parasysh, të mos heshtim, të mos i mbyllim sytë, por të veprojmë sot. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, deputete! Më lejoni që t'i bashkohem këtij shqetësimi për këtë çështje tejet urgjente dhe ta lus deputeten që komisioni që e ka vizituar këtë pjesë të Kosovës që ta përgatisë një rekomandim për Kryesinë e Kuvendit dhe ta dimë se si ta procedojmë pastaj në seancë. Keni plotësisht të drejtë që ta aktualizoni këtë çështje, meqenëse e kam parë edhe me sytë e mi çfarë po ndodh atje, por në mënyrë që ta adresojmë së paku ne si Kuvend sa më shpejt, ju lus që të sillni rekomandimin në Kryesinë e Kuvendit.

Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministri Besnik Tahiri!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Do të doja të ndërlihem me dy çështje, me dy fjalime: me fjalimin e deputetit Tasholli dhe me fjalimin e Ganes.

E para, sa i përket temës së gastronomisë, kam për obligim që t'ju njoftoj juve si deputetë, si Kuvend, që si Qeveri i kemi marrë të gjitha masat dhe unë personalisht do të thotë me pamundësinë të hap këtë pjesë të ekonomisë, që është ekonomi zinxhirore, e cila ka një ndikim shumë të madh. Çka kemi bërë? E para, të martën, pra më 21 korrik, kam takuar Odën e Hotelarisë dhe Turizmit dhe kam adresuar një e-mail, një shkresë zyrtare edhe te ministri i Shëndetësisë, edhe te ministri i Tregtisë dhe Industrisë, edhe te Kryeministri që t'i shohin kërkesat që ju i adresuat sot. Pra, në aspektin logjik, të kemi një të dhënë empirike shkencore, çka dallon dy orë të mos punohet, pra të punohet deri në orën 21:00 e pse të mos punohet deri në

orën 23:00. Çka është dallimi, a ka dikush një institut që mund të japë një vlerësim në ato dy orë, cila është e dhëna empirike, shkencore, që rritet infeksioni në këtë temë.

E dyta, po ashtu në këtë letër kam adresuar një çështje tjetër, edhe unë isha për vikend në Shqipëri. Aty pashë një lëvizje shumë të madhe dhe kërkesa ime për Ministrinë e Shëndetësisë dhe për Institutin ishte të shoh se ky interaksioni ynë në Shqipëri, unë isha në Sarandë, interaksioni i qytetarëve të Kosovës ndër vete, mirëpo edhe me të tjerët, sa vijnë, sa shkojnë. E, ajo çka po ndodh është paraja publike, të mos më keqkuptoni, do të thotë është vendi ynë Shqipëria, edhe Kosova është Shqipëri, mirëpo në këtë rast ekonomia jonë po pëson në dëm të këtij vlerësimi. Tani, si kam ardhur deri te ky konstatim dhe deri te kjo shkresë zyrtare. Më 14 qershor kam takuar përfaqësues të hotelierisë, pse i kam takuar është me rëndësi të thuhet, për shkak se më 15 qershor në planin e ish-ministrit të Shëndetësisë ka qenë lirimi i plotë, ky ka qenë hapi i parë dhe menjëherë e kemi vendosur më 23 ka pasur takim ministri Veseli që mendoj që ka bërë një punë të shkëlqyer dhe pastaj të gjithë resorët i kemi mbledhur për t'i dhënë drejtim, fatkeqësisht çka ndodhi është që në fillim të korrikut, për arsye të ndryshme ndodhi një përhapje e virusit më shumë, disa e adresonin gishtin te gastronomia, disa diku tjetër. Pra, në këtë kuptim si Qeveri ne i kemi marrë të gjitha masat. Presim prej Institutit që të ketë një vlerësim serioz për këtë temë dhe të na adresojë, në qoftë se me të vërtetë këto dy orë qenkan kaq problematike, atëherë le të na e japin një evidencë empirike.

Mendoj se deputetja Ganimete Musliu e ngrehu një çështje shumë me rëndësi për rolin e Policisë dhe për shtesat. Kjo është temë e ministres së Financave, e cila duhet ta adresojë për shkak se jo vetëm policët, po një numër i madh i shërbyesve publikë janë në rrezik permanent. Unë e kam një kërkesë për të gjithë ju, për të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, me sinqeritetin më të madh, na ndihmoni ta bëjmë Ligjin e pagave. Ligji i pagave, ju them me përgjegjësinë më të madhe, është prishur në Kuvend, për shkak se në Kuvend është hequr neni, i cili e ka paraparë parashikueshmërinë e pagës, që ka qenë problemi kryesor. Jo, jo, shiko, nuk është e vërtetë kjo. Në komision kanë qenë të gjitha partitë. Unë ju them me sinqeritetin më të madh, në qoftë se duam të bëjmë një Ligj të pagave, ne jemi të gatshëm t'i kthehemi procesit edhe një herë për ta kthyer të drejtën në pagë normale edhe për të gjithë zyrtarët publikë.

Tani e kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese. Nuk po e komentojmë. Ata e kanë larguar një numër të madh të institucioneve, nëntë institucione i kanë larguar. Po ashtu, na i kanë dhënë disa udhëzime sa u përket disa subjekteve dhe sektorëve në Qeveri. Na ndihmoni ta bëjmë. Është zoti Lushtaku kryetari Komisionit Parlamentar, eja të mbledhemi, kushdo çfarë të ketë, ta bëjmë. Mirëpo, është koha e fundit që ta buxhetojmë për vitin e ardhshëm, për shkak se ne e kemi pasur buxhetin për këtë, mirëpo në Kuvend ka pasur një lobim të jashtëzakonshëm dhe është prekur Ligji i pagave, është dëmtuar parashikueshmëria, që nënkupton ruajtja e pagës dhe mbi këtë temë e kemi humbur Ligjin e pagave.

Pra, na ndihmoni Gane dhe të gjithë deputetët, që ta bëjmë këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARJA: Replikë ka deputetja Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryetare!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Nëse më jeni drejtuar si zëvendëskryeministër, për juve jam Ganimete Musliu, deputete e Kuvendit të Kosovës. Nëse më jeni referuar si mik e koleg, atëherë mund të më drejtohesh me Gane. Dhe, unë konsideroj se nga foltorja e Kuvendit dhe kur të ngremë tema të rëndësishme, ju duhet të paraqiteni në foltore si zëvendëskryeministër.

Në rend të parë dua të falënderoj për mirëkuptimin e çështjes që unë ngrita sot. Unë mendoj që Policisë së Kosovës duhet t'i aprovohet pagë shtesë për angazhimin e tyre 12-orësh në ditë, para se të vijë Ligji i pagave, sepse Ligji i pagave nëse tash inicohet, do të bëhet i plotfuqishëm vetëm për mandatin, ose për vitin e ardhshëm. Kështu që, duke pasur parasysh angazhimin maksimal të Policisë së Kosovës dhe të domosdoshëm që ata të jenë nga 12 orë në terren, unë kërkoj që Qeveria e Republikës së Kosovës ta trajtojë me urgjencë kërkesën time dhe në mbledhjen e ardhshme të marrë një vendim për paga shtesë për Policinë e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Lidhur me deklarimin e zëvendëskryeministrit për koment e ka kërkuar fjalën edhe nënkryetari i Kuvendit, Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetare!

Ju përshëndes të gjithëve!

U ngritën me të drejtë disa çështje të rëndësishme, por mendoj se tema e gastronomëve në Kosovë meriton një vëmendje më të madhe edhe nga Kuvendi, për shkak se vëmendja e Qeverisë u ka munguar deri tash.

Është inkurajuese ajo që e tha zëvendëskryeministri, por unë shpresoj se do të munden brenda Qeverisë që të gjejnë njëfarë lloj dakordimi për hapat që do t'i ndërmarrin. Pa hyrë për ta vlerësuar se a ka qenë e drejtë dhe sa ka qenë e drejtë çështja e ndalesës nga ora 21:00 e tutje, unë e kam parë që edhe gastronomët e kanë shprehur mirëkuptimin e tyre për këtë çështje. Por, në momentin kur ne si shtet, në këtë rast Qeveria, e cenon një të drejtë të dikujt, atëherë duhet pasur edhe një masë të lehtësimit apo kompensimit të asaj çështjeje.

Do të thotë, ne sot i kemi sjellë para falimentimit të gjithë gastronomët e Kosovës. Edhe një muaj unë nuk besoj se shumica e tyre mund të mbijetojë. Në anën tjetër, Qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë hap për t'i ndihmuar ata. Është në rregull, nëse ju i limitoni në veprimtari, por do të ishte minimumi i korrektesisë për të ruajtur një nga sektorët më vital në gjithë Kosovën, sepse janë me

mijëra e mijëra kompani të vogla që funksionojnë në këtë fushë, që së paku t'ua paguani 170 euro për punëtorët e tyre dhe së paku 50% të qirasë për qiratë e tyre dhe normalisht, që t'u ndihmoni në shtyrjen e pagesës së kredive, sepse të gjithë apo shumica janë në kredi.

Ju e keni parë që të hënën do të ketë edhe protesta prej tyre. Unë besoj që kjo protestë vjen normalisht sikur pasojë e mungesës së kujdesit që keni ndaj tyre. Ju ftoj, kryeministër dhe ministër i Financave, që së paku këto që i propozova t'i merrni parasysh dhe t'i ndohmoni sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse ndryshe janë të rrezikuar jashtëzakonisht shumë.

KRYETARJA: Faleminderit! Për dy kundër-replika, zëvendëskryeministri Tahiri, dy minuta i ka tani.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK TAHIRI: E nderuar deputete Musliu, Kjo është përvoja ime pak më e hershme në Parlament. Ju jeni më gjatë këtu, pra, në rregull, pajtohem me komentin tuaj.

Kështu, sa u përket shtesave, unë pajtohem plotësisht që të ndodhë një shtesë e tillë. Ku është rreziku, po tregoj, rreziku është që këto shtesa mund të prodhojnë efekt zinxhiror çdo kund. Çka unë po propozoj, tash këtu duhet parë Ministria e Financave se cila është mundësia, pasi që të kalojë buxheti. Çka unë propozoj është që të mbledhemi të gjithë për Ligjin e pagave, për shkak se në qoftë se me të vërtetë dikush ka bërë diçka për ta rregulluar sistemin e pagave në sektorin e Policisë, ka qenë Ligji i pagave që e kemi punuar bashkërisht me disa njerëz. Pra, në këtë temë jemi në rregull.

Të kthehemi në këtë që e tha deputeti Krasniqi, ajo që unë di është se ministri i Shëndetësisë dhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, i cili ka një komunikim jashtëzakonisht të mirë me këtë sektor, janë duke e trajtuar me Institutin për këto dy tema që lidhen me lirim. Ndërsa, sa u përket 170 eurove, besoj se ministrja mund të flasë. Faleminderit!

KRYETARJA: Edhe dy deputetë të tjerë kanë kërkuar replikë lidhur me këtë deklaram. Para se t'ua jap fjalën, vetëm një sqarim, meqenëse zëvendëskryeministri tha se ligji është prishur në Kuvend. Ta sqaroj se fjala është për Kuvendin paraprak, pra për legjislaturën paraprake. Në këtë Kuvend akoma nuk ka ardhur Ligji i ri me ndryshimet e nevojshme, por sapo të vijë, unë jam e bindur që deputetët do të tregojnë maksimalisht interesim që ta kalojnë.

Deputetja Mimoza Kusari dhe pastaj deputeti Mërgim Lushtaku, të dy kanë komente ose replika lidhur me deklaramin e zëvendëskryeministrit. Nga dy minuta i keni.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryetare!

Zoti Tahiri, veç kisha dashur t'jua bëj pyetjen, a je zëvendëskryeministër apo jo në atë Qeveri? Se pyetjet që ai i ngriti para deputetëve janë pyetje që ai duhet t'i ngre, ose t'i dijë, e të vijë t'u japë përgjigje deputetëve në Kabinetin qeveritar.

Zoti Tahiri foli për sëmundjet, gjegjësisht për pandeminë, për numrin e gjithashtu në raport me shëndetin publik ju si Qeveri keni bërë komitete, komisione e grupe këshillëdhënëse, e ende s'keni përgjigje pse dhe keni numrin më të madh të të infektuarve me COVID. Nëse flasim për masat që janë ndërmarrë, ato pyetje për shëndetin publik duhet t'i ktheni prapa dhe t'i bëni në Qeveri. Nëse nuk ju funksionon Qeveria, duhet të tregoni, por jo të vini e t'u bëni deputetëve këtu pyetje dhe të tregoni pse duhet në Shqipëri të ketë raport tjetër, e pse në Kosovë duhet pasur raport tjetër? Çfarë të dhëna empirike ka që infeksioni rritet pas orës 9:00? A nuk do të ishte kjo temë për Kabinetin qeveritar?

Në fund të ditës Kabineti qeveritar e ka marrë këtë vendim. Zoti Tahiri, që Kosova është Shqipëri e kemi ditur, por s'po di zyrtarisht ju si po funksiononi me këtë slogan, kur e thatë prej foltores së Kuvendit "Kosova është Shqipëri". Ndoshta, është mirë të koordinoheni me zotin Hoti, e të shihni se si mund të koordinoheni më tutje në delegacion në Bruksel për deklarata të tilla politike. Edhe për Ligjin e pagave, gjithashtu më duhet të them, është mirë që transkriptet janë, amendamentet e secilit deputet janë të regjistruara. Është mirë të merren dhe të shihet kush ka kontribuar në Ligjin e pagave dhe çfarë ndryshimesh janë kërkuar prej deputetëve dhe cilave parti.

Ka qenë në legjislaturën e kaluar, është e vërtetë dhe pastaj partitë që bashkë keni qenë në koalicion në atë kohë, i keni bërë pazare me grupe të interesit edhe është copëtuar e bërë sallatë Ligji i pagave këtu në seancë. Është e vërtetë, por ato janë të lidhura me të gjitha partitë politike që kanë qenë të përfaqësuar aty. Edhe seriozisht, është mirë të na jepet pak më shumë siguri neve për informacionet që i diskutoni ju në raport me pandeminë, se sa të vini e t'u bëni pyetje deputetëve këtu për gjëra që janë kompetencë e drejtpërdrejtë juaja.

KRYETARJA: Deputeti Mërgim Lushtaku, para se t'ia kalojmë prapë fjalën zëvendëskryeministrit.

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit, kryetare!

Fillimisht, duke u ndërlidhur edhe me zëvendëskryeministrin, zotin Tahiri, edhe mbështetje, edhe propozimit të Ganimete Musliut, se duhet të mbështetet paga shtesë për policët, pavarësisht që mund të krijohet një efekt zinxhiror, ne e dimë se jemi në gjendje të jashtëzakonshme, emergjente të pandemisë dhe sigurisht që policët po e kryejnë detyrën e vet maksimalisht dhe duke tejkalar edhe orët e tyre të rregullta. Prandaj, duhet mbështetur një kërkesë e tillë, edhe si kryetar i Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale, Zhvillim Rajonal dhe Media, e

mirëpres propozimin e projektligjit për pagat dhe besoj se bashkërisht me komisionin, por edhe me deputetët këtu do të punojmë ngushtë që të zgjidhim problemet që i ka paraqitur edhe Gjykata Kushtetuese dhe të gjithë ata që kanë bërë ankesa në drejtim të ligjit paraprak. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Zëvendëskryeministri ka dy kundër-replika, dy minuta!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BESNIK TAHIRI: Zoti Lushtaku, ne e kemi themeluar grupin në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike dhe do t'ju thërrasim shpejt që paraprakisht ta trajtojmë këtë temë. Të kthehem te deputetja Kusari-Lila. Unë këtu nuk jam për të dhënë informacion, jam këtu për të dhënë llogari. Jam i zgjedhur prej Parlamentit të Kosovës dhe e kam për detyrë dhe obligim t'ju jap llogari se çfarë kemi bërë si Qeveri. Përderisa, ne i përcjellim rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, ne nuk mund të dalim kundër tyre. Ne s'kemi bërë grupe as nëngrupe. Ajo që unë kam pyetur te ministria përkatëse dhe te të dy ministritë përkatëse, kam adresuar një çështje që më ka ardhur prej përfaqësuesve të gastronomisë. Dhe për këtë nuk shtrova pyetje, i informova dy deputetë, edhe deputetin dr. Arbrin, edhe zotin Tasholli, i njoftova për çfarë kemi bërë për dy muaj rresht dhe ku e kemi nisur. E kemi nisur në ditën, një ditë pasi është dashur të liberalizohet i gjithë sistemi, më 15 qershor, ashtu siç është paraparë nga Qeveria e kaluar. Pra, këtë e kam bërë unë.

Përndryshe, po kthehem edhe një herë tek policët. Unë jam ithtar për ta rregulluar sistemin të plotë. Janë shumë keq. Unë mendoj që shtesat në paga publike është gjëja më e vështirë dhe më sfiduese e më e rrezikshme për ta. Paga bazë për krejt sektorin është ajo që duhet të rregullohet.

Policia punon 12 orë dhe merr shtesë për orët shtesë. Edhe në Qeverinë e kaluar u kemi dhënë. Në qoftë se duan t'u japim shtesë për angazhimin në pandemi, ajo është tjetër. Por, ajo që po ju them unë, kjo nuk është e qëndrueshme dhe nuk u hyn në punë, mund t'u hyjë disa muaj. Çfarë u hyn në punë policëve, u hyn rregullimi i saktë i pagës.

KRYETARJA: Deputeti Bekim Haxhiu, replikë lidhur me deklarinimin e zëvendësministrit.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetare!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Edhe masat e Qeverisë së kaluar, edhe masat që ju i keni marrë, nuk kanë bazë ligjore, një. Nën dy, se a e ka arritur apo ka pasur efekt pozitiv ky kufizimi i lëvizjeve dhe ndalesat që janë bërë për bizneset, e dini. E keni rezultatin dje. Pra, kot i keni dëmtuar bizneset, sepse derisa nuk ka ligj anti-COVID, përmes të cilit mund të ndëshkohen ata që shkelin masat mbrojtëse, ne do të kemi këtë problem edhe më tutje. Prandaj, uroj që këtë ligj ta bëjmë më shpejt.

Sa i përket Ligjit për pagat, i nderuar zëvendëskryeministër, ai Ligj i pagave kur ka ardhur në Kuvend ka pasur shumë mangësi dhe deputetët e dhanë kontributin e tyre në Parlament. Veç po përmend një shembull, në Ligj të pagave kanë qenë të kategorizuar mjekët, por jo stomatologët. Kaq! Për çfarë të flasim më tutje!?

Nëse keni vullnetin si Qeveri, urdhëroni, silleni Ligjin e pagave në Kuvend. Nën dy, partitë politike në momentin të ka ardhur ligji në Kuvend për qëllime politike i kanë joshur sindikatat për të protestuar e për të bërë grave dhe kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në Ligjin e pagave. Po nëse ne i largohemi kësaj anës politike dhe e bëjmë vetëm atë profesionale, unë besoj që do ta bëjmë një Ligj për paga të mirë. Por, rrisni pagat për profesionistët shëndetësorë. Po i quani heronj, paguani ashtu siç e meritojnë, jo me shtesa, jo me donacione, jo me ndihma, sepse nuk janë mjekët për “sadak myftiaq”, kush t’i teket...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Ministrja Meliza Haradinaj e ka fjalën.

MINISTRJA MELIZA HARADINAJ: Faleminderit, kryetare!

Deputetë të nderuar,

Kryeministër i nderuar,

Ministra,

Sa për informatë dhe për rikthim të kujtesës së deputetit Hajrullah Çeku, do t’i kisha përmendur disa tema të rëndësishme për t’jua rikujtuar definicionin e politikës së jashtme, sipas logjikës së Vetëvendosjes.

Për vetëm 50 ditë, për vetëm 50 ditë, në kohë rekord keni thyer protokolle diplomatike në të gjitha nivelet, keni shkaktuar skandale të jashtëzakonshme në kuptimin e keq për Kosovën. Qe, qe, ngadalë, dëgjoni se jeni bërë kështu si klasa e parë dhe po duhet t’ju mbaj ligjërata pak.

KRYETARJA: Zonja ministre, ju lutem, keni kujdes me gjuhën që përdorni në raport me deputetët e Kuvendit të Kosovës.

MINISTRJA MELIZA HARADINAJ: Skandali diplomatik me Xhamajkën...

KRYETARJA: Në qoftë se, vazhdoni kështu, atëherë nuk do ta keni më fjalën.

MINISTRJA MELIZA HARADINAJ: ... na kujtohen këtu deputetët që na e kanë uruar njohjen nga Xhamajka dhe kanë tentuar të korrin suksese dhe të marrin merita për diçka që nuk ka qenë punë e tyre. Ju kujtohet me Xhamajkën era e ndryshimit. E keni hedhur idenë për faljen e korridorit për në Detin Adriatik, Qeveria Kurti. Çnjohje nga Sierra Leone një ditë pasi që e keni

hequr taksën. Një ditë pasi që i keni dhënë mirëkuptim edhe mirëbesim Serbisë me heqjen e taksës vjen çnjohja nga Sierra Leone. A ju kujtohet?

E keni sjellë në nivelin më të ulët raportin e Kosovës me SHBA-në, duke eskaluar madje edhe me gjuhën si “thika mbi hartën e Kosovës”, “shampanjat në Shtëpinë e Bardhë”, besoj shumë mirë ju kujtohet. Keni pranuar teste nga Serbia, ju kujtohet edhe kjo. Domethënë, jo që s’këni reaguuar, siç kanë reaguuar në Twiter, ose kudo edhe me letër notë proteste ndaj komisionerit Var Helli, që e ka mbajtur atë librin shovinist. Juve jo që nuk ju pengojnë ato libra, por ju edhe keni pranuar, jeni zbrapsur, jeni dorëzuar para Serbisë.

Tjetër, vazhdojmë! Keni defunksionalizuar shërbimin e jashtëm. E dini ju shumë mirë, ministri Konjufca çfarë vendime arbitrare, selektive, jolegjitime, ka marrë në kohën sa ka qenë i shkarkuar. Keni tërhequr vendimin për diplomatin tonë në Bruksel, i cili ka pasur ta mbulojë NATO-n për herë të parë në historinë politike e diplomatike të Kosovës. E kanë parë edhe letrën, se e keni marrë me vete kur s’e keni dorëzuar detyrën, po i keni marrë të gjitha dokumentet me vete. E kemi gjetur atë letër dhe do të publikohet shumë shpejt ajo letër, dhe me pa çfarë ka shkruar ish-ministri Konjufca në vendimin për tërheqje të diplomatit për NATO. Është e turpshme.

Keni rrezikuar defunksionalizimin e misionit tonë në Hagë qëllimshëm, në prag të arritjes së aktakuzave ndaj UÇK-së. Kjo është politika juaj e jashtme. E dini ju, e keni listën. Deputeti Gjyshinca ma ka bërë pyetjen parlamentare, e ke listën kë e ka tërhequr Glauk Konjufca prej Hagës. Me qëllim!

Vazhdojmë! E keni hequr taksën, e keni zbrapsur Kosovën para Serbisë dhe para rifillimit të dialogut. Në fakt, po të mos e hiqte taksën kryeministri Kurti, dhe po të mos i mashtronte qytetarët dhe miqtë tanë ndërkombëtarë me improvizime të të ashtuquajturit “reciprocitet”, i cili as për afërt nuk është nga ai reciprociteti politik, ekonomik e tregtar, rezolutën e të cilit e keni votuar këtu në Parlament. Do të thotë, Kosova po të mos e kishte taksën sot, po të mos e hiqnit ju, partia juaj, kryeministri Kurti, Kosova sot nuk do të rrëshqiste në dialog në tema teknike, po madje do ta kishte ndoshta edhe të nënshkruar marrëveshjen për njohje reciproke në kufijt ekzistues me Serbinë.

Domethënë, kjo është politika juaj e jashtme, deputet Çeku. Më fal, se paskam harruar, në mbledhjen e parë të Qeverisë e keni tërhequr aplikimin për Interpol. Publikisht, ia keni lehtësuar Ivica Daçiqit luftën e tij ndaj Serbisë. Kjo është politika juaj e jashtme, këto janë sukseset që i keni korrur ju për 50 ditë, në kohë rekorde. Ia keni humbur Kosovës momentumin për arritjen e marrëveshjes finale, na keni zbrapsur, na keni kthyer në dialog me tema teknike, e keni humbur vëmendjen ndërkombëtare të Kosovës.

Dhe, për fund, se i paskam edhe 30 minuta, për fund...

KRYETARJA: Sekonda...

MINISTRJA MELIZA HARADINAJ: ... ju njoftoj, se Ministria e Punëve të Jashtme e Disaporës nuk ka asnjë marrëveshje me Serbinë, as me Ivica Daçiçin, as për të pezulluar anëtarësimin, aderimin, lobimin për njohje, po as aderimin, siç e thashë dhe as për të pezulluar punën e saj, sipas fushëveprimtarisë të cilën e përcakton Kushtetuta, Ligji dhe rregulloret në fuqi. Kështu që, puna...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Ju njoftoj se në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, të drejtë fjale ministrat kanë vetëm kur kanë marrëveshje me kryetaren e Kuvendit. Ministria kishte marrëveshje me mua për ta marrë fjalën, mirëpo i lus ministrat që t'i lënë anash fyerjet për deputetët. Deputetët e kanë të drejtën kushtetuese të ngrenë cilëndo çështje që kërkojnë të ngrenë. Fjalën e ka deputeti Hajrullah Çeku, replikë në raport me deklaratën e ministres, pastaj edhe deputeti Gazmend Gjyshinca e ka kërkuar fjalën.

HAJRULLAH ÇEKU: Faleminderit, kryetare!

Unë e kuptoj sikletin e të qenit ministre në një ministri që është në pauzë. Domethënë, ajo ministri nuk po funksionon për momentin, se s'ka politikë të jashtme, e tash të jesh ministre aty është goxha e sikletshme se s'ke çfarë bën. E kur s'ke punë, pastaj merresh me këto muhabetë të tilla, që i dëgjuam tash këtu e që ishin akuza për t'u marrë me të kaluarën. Më e rënda ishte fyerja e deputetëve. Çka është kjo sjellje kështu?

Ju po mendoni që kjo është sjellja që i takon një ministreje karshi deputetëve, a? Kur po e shoh këtë performansë të turpshme që bëtë këtu, po frikësohem si do të mund të na përfaqësoni jashtë?! Dhe po them, ndoshta më mirë që është në pauzë pak Ministria e Jashtme se nuk dilni jashtë atje të na përfaqësoni me sjellje të këtilla.

Tash, t'i kthehemi çështjes kryesore, sepse ju replikuat në fjalimin tim. E fjalimi im kishte të bënte me diçka tjetër. Ju fare nuk u morët me atë, prandaj po e sjell edhe një herë këtu pyetjen kryesore.

Zonja Haradinaj, këtë retorikë e përdorët për ta mbuluar atë çështje. Prandaj, përgjigjuni. Nëse dilni në foltore edhe një herë, përgjigjuni. A vazhdojmë ta kemi të pezulluar aplikimin për anëtarësim në organizatën ndërkombëtare? Kaq ishte çështja.

KRYETARJA: Deputeti Gjyshinca e ka fjalën.

GAZMEND GJYSHINCA: Zonja ministre!

Fjala juaj e mëparshme vetëm sa e shpërfaqti se sa e padenjë jeni për ta përfaqësuar Kosovën jashtë.

Ne gjatë kohës sa kemi udhëhequr me Ministrinë e Punëve të Jashtme nuk kemi dërguar për ambasadorë, as nuk kemi graduar për ambasadorë njerëz brenda shërbimit tonë diplomatik që janë vëllezër të ministrave, nuk e kemi bërë këtë. Përkundrazi, Lëvizja Vetëvendosje në MPJD parashihte auditimin e gradave diplomatike dhe po krijonte hapësirë për diplomatët e karrierës.

Kurse, tash ju si Qeveri çfarë po bëni? Në kohën kur Kosova gjendet në pozicionin e saj më të vështirë ndërkombëtar, po e vazhdoni avazin aty ku e ka lënë më herët PAN-i. Në anën tjetër, më tregoni për çfarë shkëlqesh ligjore po flisni? Për t'i kthyer në Kosovës ambasadorët dhe diplomatët e llojit të Fatmire Musliut, që kanë ndenjur në shërbim diplomatik për dhjetë deri në njëmbëdhjetë vjet pa u krye...

KRYETARJA: Koleg, edhe juve ju lus, larg cilësimeve!

GAZMEND GJYSHINCA: Patjetër. Ose, për krijimin e një kabineti të përbërë nga njerëz si Florent Muçaj, që as të lejuar të hyjnë në ndërtesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme nuk janë. Për çfarë po na flisni? Kjo është ligjshmëria për të cilën po flisni ju?

KRYETARJA: Dy kundër-replika, dy minuta i ka ministrja.

MINISTRJA MELIZA HARADINAJ: Deputet Çeku, faleminderit shumë! Kurrë më të vëmendshëm s'keni qenë, kurrë më të pazhurmshëm s'keni qenë, se kur fola unë. Dhe për mua, në fakt, ishte hera e parë që po flas dhe më erdhi shumë mirë se keni çka të mësoni, se e keni treguar diturinë dhe suksesin tuaj në 50 ditë të Qeverisë. Kështu që, ju falënderoj për vëmendjen. Ju njoftoj po ashtu, prapë e kam thënë edhe në Facebook, në media sociale para disa ditësh, e thashë edhe në replikën time para disa minutash që Ministria e Punëve të Jashtme nuk e ka pezulluar asnjë aktivitet sa i përket fushëveprimtarisë së saj.

Sa për informatën tënde, veç dje i kam nënshkruar katërmbëdhjetë instrumente të aderrimit në konventa ndërkombëtare, të cilat janë depozituar. Kështu që, edhe presim rezultatin. Po, ju çfarë keni bërë? Prita përgjigje në krejt ato listime të "sukseseve" në thonjëza, tuajat dhe dëmeve që ia keni shkaktuar Republikës e qytetarëve të Kosovës, për rekord kohë për 50 ditë. Kjo është logjika juaj, ky është definicioni i politikës suaj të jashtme. Të qëndroni në shtëpi edhe t'ua lini këshilltarëve ta udhëheqin kabinetin.

Sa i përket pyetjes, ose replikës së deputetit Gjyshinca, ta rikujtoj, deputet, që ka ambasadorë me gradë dhe ka ambasadorë funksionalë. Shërbimi ynë i jashtëm i ka veç 11 a 12 vjet, kështu që

është shumë i shkurtër, shërbim i ri, për të pasur gradë funksionale ambasador. Një ndër të parët, ka edhe shumë të tjerë, që ambasadori Zemaj, i cili ka hyrë dhe i cili rastis të jetë vëlla i ministrit, aty e kam gjetur, prej vitit 2009 është pjesë e shërbimit të jashtëm. Edhe tjerë që i përmendët...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Përfundon kjo pjesë. Më lejoni vetëm, meqenëse edhe nesër kemi debat lidhur me dialogun Kosovë-Serbi, nuk ka të tjerë deputetë, sepse pas kundër-replikës nuk ka. Mirëpo, janë dy çështje tejet me rëndësi që këtu duhet të potencohen. E para, ministrja e tha që dialogu ka rrëshqitur drejt dialogut teknik, është me rëndësi të potencohet. Kurse e dyta, është që MPJ-ja kurrë nuk e ka pranuar konsesionin e bërë nga kryeministri për të pezulluar procesin e anëtarësimeve. Kjo tregon shumëçka.

2. Koha për pyetje parlamentare

Për këtë seancë i kemi 41 pyetje parlamentare. Fillojmë me pyetjet e mbetura nga seancat e mëparshme. Kush ka marrëveshje me mua, e merr fjalën. Askush nuk e ka kërkuar fjalën për këtë temë, siç e dini, te deklaratimet e ministrave. Rregullorja e sqaron qartë që qoftë deputeti, qoftë ministri, e merr fjalën vetëm kur ka marrëveshje paraprake me kryetaren. Meqenëse, kjo periudhë përfundoi, unë po vazhdoj me pyetje parlamentare. Pas pyetjeve parlamentare, mund ta kërkon fjalën. Në rregull, për procedurë, deputeti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Për procedurë e kërkoja fjalën, zonja kryetare. Dhe, që të shpjegojmë procedurën, ju nga ai pozicion, si kryetare e Kuvendit, nuk keni të drejtë të komentoni askënd dhe s'keni të drejtë të bëni konkluzë të tilla, sepse vetë e hapni debatin. As nga ky pozicion, si kryetare e Kuvendit, s'mund të bëni ndërhyrje të tilla.

KRYETARJA: I nderuar deputet, duhet ta kuptoni njëherë e mirë që i di fort mirë, i kam lexuar, jam katër mandate deputete, por jeni mësuar ju me kryetarë kuvendesh, të cilët i keni quajtur vetë "banda mafioze", e tash udhëheqjen e seancave në përputhje me Rregulloren nuk po mund ta përballoni. Ta dini, ta dini njëherë e mirë, neni i Rregullores, në bazë të së cilës bëhen deklaratat e ministrave, po ashtu thotë që në atë pjesë të Rregullores mund ta marrin fjalën edhe deputetët, qoftë për komente, qoftë për replika. Por që të dyja, qoftë deklaratat të ministrave, qoftë ato të deputetëve, duhet të vihen në marrëveshje me kryetarët.

E fundit, zoti deputet, sepse për fat të keq dhe për të cilin ju uroj që jeni shëruar, nuk keni qenë këtu në seancat e kaluara. Në secilën seancë, përfshirë edhe në këtë, unë kam kërkuar mirëkuptimin e deputetëve, që për të eliminuar përhapjen e infeksionit, edhe unë si deputete t'i japë vlerësimet e mia nga foltorja, nga mikrofoni, siç e bëni secili prej jush. Pse ju të keni të

drejtë të flisni nga vendi e unë jo? Pra, edhe unë do ta kem përderisa ka pandemi, pikërisht këtë të drejtë.

Prandaj, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, unë e komentova si deputete deklaratën e ministres. Ia dhashë vetvetes, sepse kushdo që e udhëheq Kuvendin ia jep fjalën deputetëve. Natyrisht, edhe unë si deputete kam të drejtë që të komentoj deklaratat e ministres në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Zoti ministër mos fyej se nuk je duke u ndalur! Ministri këtu po thotë: mos na rrej. Po e tregon mungesën e edukatës. Kaq!

KRYETARJA: Ministri po do ta sqarojë, urdhëro ministri Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Kryetare!

Përshëndetje për të gjithë,

Kryetare, të kisha lutur që si e para e Kuvendit edhe si njëra nga 120 deputetët, është pak mirë që debatin ta orientoni në relaksim të situatës. Edhe nëse ka ndonjë tension ndërmjet deputetëve apo kabinetit qeveritar me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nuk ju thash mos na rrej, se unë jam djalë i mësueses, po mos na gënje, nëse e them atë fjalë, por thash vetëm mos na rreh, se m'u duke se ishe pak e tensionuar dhe ishte për ta relaksuar debatin.

KRYETARJA: Ministri e di që s'ndodh ajo kurrë, sepse njihemi gjatë dhe natyrisht që e di.

Replikë, deputeti Kujtim Shala!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zonja kryetare!

Unë lexim më të çuditshëm të Rregullores s'kam parë ndonjëherë. Pra, po e përsëris. Ju si deputete keni të drejtë aq sa edhe unë dhe të tjerët, jo më shumë. Po s'mund të bëni konkluzione sa herë të doni ju. Nëse unë mund të flas një herë dhe vetëm një herë, apo mund të ndërhyjë atëherë kur më drejtohen drejtpërdrejt, ose kur i referohen përmbajtjes së asaj që them unë, kjo vlen edhe për ju. Pra, në pozicionin të cilin jeni ju, nuk lejohen pozicione politike, sepse aty jeni që të drejtoni seancën sa më teknikisht që mundeni. Sa më teknikisht i bie sa më shumë në përputhje me Rregulloren e ideale do të ishte të respektonit Rregulloren qind për qind.

Provat që po përpiqeni t'i jepni ju si kundërshtarë e Qeverisë janë të qarta, janë të njohura dhe unë besoj të mjaftueshme. Nëse ju politikisht i vlerësoni si të pamjaftueshme, mund të vazhdoni t'i bëni si një anëtare e këtij Kuvendi, si të gjithë të tjerët. Por, edhe një herë e përsëris, komente pas secilës fjalë të secilit nuk ka të drejtë të bëjë drejtuesi i seancës, sepse s'e lejon Rregullorja. Këtë e thash unë dhe kjo ka të bëjë me procedurën, jo me përmbajtjen e qëndrimeve tuaja, sepse mund të më interesojnë ose jo dhe ajo është çështje tjetër. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Ju lus për qetësi. Fjalën e ka për kundër-replikë znj. Osmani. Ju lus për qetësi!

VJOSA OSMANI: Sikur ta lexonit mirë Rregulloren e Kuvendit, të cilën unë jam duke e interpretuar në përputhshmëri të plotë, me çka e kuptoj nuk jeni mësuar më parë, por siç do të thoshin miqtë tanë amerikanë 'there is a new Sherif in town'. Kështu që duhet të mësoheni me një lexim të drejtë. Me një lexim të përpiktë, me një lexim që i trajton të gjithë të barabartë.

Të nderuar deputetë,

Ka shumë këtu që synojnë që rolin tim si Kryetare të Kuvendit ta shohin si rol tërësisht teknik, ku nuk kam të drejtë të mbajë qëndrime politike e të merrem me drejtimin teknik të seancave. Duhet ta harroni një gjë të tillë, sepse nuk do të ndodhë kurrë. Kështu që natyrisht që si deputete, përtej drejtimit të seancave si Kryetare e Kuvendit, kam të drejtë të bëj vlerësimet e mia politike dhe po ashtu meqenëse ministrja e pati fjalën për një çështje, unë e dhashë komentin tim për atë çështje dhe më vjen mirë që edhe ju u pajtuat që janë argumente të mjaftueshme.

KRYESUESJA: Faleminderit znj. Osmani! Z. Selimi e keni kërkuar fjalën?

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.)

KRYETARJA: Për procedurë Rexhep Selimi e ka fjalën. Për tema të tjera është mbyllur kjo pjesë e deklarimeve të ministrave dhe komenteve të deputetëve dhe do të vazhdojmë menjëherë me pyetjet.

REXHEP SELIMI: Zonja kryetare, ju falënderoj!

Për çështje të procedurave edhe unë e mora fjalën, por për të reaguam. E kuptoj pak a shumë shqetësimin që shumë deputetë mund ta kenë në raport me ju, por s'po e kuptoj egërsinë. Ju po e drejtoni shumë mirë seancën edhe unë personalisht dhe grupi jonë parlamentar nuk e kemi asnjë vërejtje. Por edhe njëherë e përsëris, e kuptoj shqetësimin edhe të LDK-së, edhe të PDK-së në raport me ju, por nuk po e kuptoj egërsinë përballë një zonje, që s'po ndodh vetëm në këtë seancë.

Andaj, po kërkoj zonja Kryetare që ju të vazhdoni, por edhe ta mbron integritetin edhe të deputetëve përballë anëtarëve të Qeverisë që janë të papërgjegjshëm dhe të cilët i japin të drejtë vetes edhe të fyejnë deputetët dhe po ashtu t'i trajtojnë si nxënës. Po të kishin nivel të një mësuesi, unë do t'i pranoja ndoshta edhe si të tillë, por që ta trajtosh dikë si nxënës, duhet të kesh nivel të mësuesit.

Zoti Hoti, kisha kërkuar prej jush ta keni parasysh dhe ta shihni pak edhe kabinetin tuaj dhe së paku të jepni vërejtje, nëse jozyrtare, sepse e keni pak të vështirë, së paku miqësore.

Andaj edhe një herë po kërkohet zonja kryetare që seancën ta mbani në vijë pavarësisht këtyre lajthitjeve, pavarësisht këtyre klithjeve që ju vijnë herë pas herë, qoftë përballë e qoftë anash dhe ju inkurajoj edhe një herë që ta vazhdoni, ashtu siç jeni duke e drejtuar seancën, sepse shumë mirë po e drejtoni.

KRYETARJA: Memli Krasniqi e ka fjalën, meqenëse u përmend PDK-ja.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Desha edhe unë të vij si z. Selimi për procedurë e pastaj të dalë në temë tjetër, por s'pati të bëjë me çështje të procedurës, po meqenëse edhe e përmende PDK-në mendoj në kontekst të gabuar, shumë prej vlerësimeve të z. Selimi i ndaj me të. Unë nuk mendoj që ju si Kryetare po dilni jashtë prej asaj që e përcakton Rregullorja e punës. Secili prej kryetarëve edhe në të kaluarën e ka pasur një mënyrë të veten të menaxhimit të temave. Është e vërtetë që ndoshta është krijuar një traditë e një tolerance më të madhe në mandatin e kaluar nga z. Veseli, i cili e ka lejuar sidomos opozitën të shprehet, ndonjëherë edhe jashtë Rregullores, gjë të cilën ne ndonjëherë kemi pasur mospajtime, po p.sh. deputetët e Vetëvendosjes i ka lejuar të flasin edhe nga disa herë, edhe me minutazh që s'u ka takuar me Rregullore, por ne mendojmë që ajo ka qenë e domosdoshme dhe e mirë për demokracinë, edhe debatin në Kuvend.

Mendoj që edhe ju zonja Kryetare brenda mundësive të jeni tolerante, por si grup parlamentar ne ju mbështesim në punën tuaj dhe e keni edhe përkrahjen time personale. Ndoshta, atë që e thatë, nuk më pëlqeu për vete, se nëse ju jeni sherif neve po na bie të jemi zëvendësshërifa, nuk më pëlqeu fort si thënie. Gjeje një thënie më të mirë.

Por ajo që ju takon në kuadër të Rregullores edhe të përgjegjësisë, pa dyshim që duhet ta zbatoni dhe po ashtu nuk mund të pritët që të kemi Kryetar anemik dhe steril prej bindjeve dhe mendimeve politike. S'ka qenë as në të kaluarën, s'duhet të jetë as tash dhe unë mendoj që s'duhet të jetë asnjëherë. Pavarësisht që je e para në mesin e të barabartëve, unë besoj që secilit i takon që të ketë qëndrimet e veta politike dhe t'i mbrojë ato.

KRYETARJA: Replikë ndaj fjalimit të Memli Krasniqit, deputeti Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit!

Është interpretim me probleme elementare, me moskuptime elementare. Pra, e përsëris, këtu jemi për qëndrime politike, por jo si drejtuese e seancës. Pra, kur një drejtues i seancës dëshiron të pozicionohet politikisht kthehet në një deputet të zakonshëm si gjithë të tjerët. Kjo është çështja e

parë. Nuk mund të ndërhyjë dhe të komentojë secilin qëndrim të secilit koleg apo të përfaqësuesve të Qeverisë.

Rregullorja është e njëjta. Rregullorja është norma. Nëse ne e matim punën e drejtuesve të Kuvendit me sa janë tolerantë, i bie që ne vërtet të matim masën përtej së cilës shkojnë drejtuesit e Kuvendit në raport me Rregulloren. Po të mund të shtrohej kështu, do të ishte çështje e vullnetit dhe institucionet nuk do të kishin fare Rregullore. S'do të kishim normat, sepse do të ishte çështje vullneti, çështje karakteri, motivimi politik etj.

Unë po flas për diçka tjetër, që ne të kemi mundësi të punojmë sa më normalisht, seancat duhet t'i drejtojmë teknikisht, të kemi kujdes dhe të balancojmë situatat. Kjo i bie që Rregulloren ta lexojmë njëjtë për të gjithë, si unë, si ju, si Kryetarja e Kuvendit. S'ka të bëjë kjo me punën e Kryetares së Kuvendit në tërësi. Unë i jap mbështetje Kryetares së Kuvendit në punën e saj. Nëse Kryetarja e Kuvendit s'ka mendim politik, ose qëndrime politike, nëse s'është kundërshtar apo nëse s'është mbështetëse e opsioneve politike, s'ka çfarë kërkon në Kuvend. Por, si deputete.

KRYETARJA: Kundër-replikë, Memli Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Realisht unë besoj që jemi duke humbur kohë të vlefshme të kësaj seance për çështje të cilat do të duhej t'i diskutonim ndoshta në Kryesi në një mbledhje të përbashkët. Besoj që do të ishte forumi i duhur për ta diskutuar këtë çështje nëse e sheh të arsyeshme qoftë z. Shala ose kushdo tjetër që e ngriti. Ma merr mendja që edhe pozicioni dhe personaliteti i secilit që e merr një pozitë e ndikon edhe mbarëvajtjen e asaj. Unë jua mora shembull, jeni mësuar ta shihni z. Veseli në të kaluarën që ka qenë më tolerant, tash kryetarja e Kuvendit s'po është shumë tolerante, po ajo në të drejtën e saj po sillet qysh ajo po e sheh të rrugës. Po jua marr shembull, përpara ne kurrë derisa ka ardhur kjo kryetare e ka interpretuar kurrë, pas deklarimit jashtë rendit të ditës nuk kanë folur ministrat. Interpretimi i saj është, e ka bazën në Kuvend, realisht po na i humb nga dy orë, po ndoshta nuk ka diçka të keqe. Kështu që po them përsëris le ta diskutojmë nëse ka nevojë në mbledhje të Kryesisë.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Për procedurë, ju njoftoj çka shkruan në Rregullore. Neni 17: Përgjegjësitë e Kryetarit të Kuvendit, ndër të tjera thotë: Kryetari e bën interpretimin përfundimtar të Rregullores së Kuvendit gjatë mbledhjes plenare. Pikërisht këtë po e bëj.

Neni 85 - Interpretimi i Rregullores së Kuvendit: Kur gjatë zhvillimit të mbledhjes plenare parashtrihen pretendime rreth interpretimit ose zbatimit të Rregullores, është kompetencë e Kryetares së Kuvendit ose kryesuesit të mbledhjes, në qoftë se Kryetarja mungon, për të vendosur për pretendimin e parashtruar.

Vendimi i kryetares, të nderuar deputetë, sipas nenit 85, nuk është as objekt diskutimi dhe as objekt kontestimi gjatë mbledhjes. Besoj isha shumë e qartë.

Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë me pyetjet parlamentare. Me kë? Zoti Memli Krasniqi kishte replikë në raport me diskutimin e z. Selimi. Atë e kërkoi dhe atë ia dhashë. Zoti Selimi kërkoi fjalën për procedurë, njëjtë siç ishte më herët kërkesa për procedurë lidhur nga diskutimi i z. Shala. Në qoftë se e keni për procedurë, ju lus të flisni për procedurë!

Zoti Arben Gashi e ka fjalën.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Meqenëse jemi te procedura, ne jemi pajtuar që Rregulloren e interpreton kryesuesi i seancës, qoftë ai kryetar apo kryetare apo kushdo që e ka të drejtë kushtetuese ta drejtojë seancën. Por nuk mund ta interpretojë përtej Rregullores. Duhet ta zbatojë Rregulloren.

Pra, kryesuesi i seancës e ka për obligim kushtetues dhe rregullativ ta drejtojë seancën në bazë të Rregullores dhe nuk mundet kushdo qoftë ai ta interpretojë përtej saj mbi bazën e vullneteve ose bindjeve personale. Pa dashur të gjykoj ose paragjykoj sjelljen e gjithsecilit, sa herë që kemi pasur situatë të tensionuar në Kuvend, ka ardhur kur kryesuesi i seancës ka shkuar përtej.

Krejt çka po kërkohet është që të mos shkohet përtej, të mos komentohet. Patjetër që Kryetarja, kryesuesi, ka të drejtë mendimi, deklarimi, shprehje etj. si të gjithë deputetët e tjerë. Jo komentim të qëndrimeve të një ministri ose dikujt tjetër. Por, deklarim në diskutim dhjetë minuta si çdokush tjetër, jo ndërhyrje në fjalë, përveç nëse bëhet ndërhyrja për procedurë. Nëse ministri ose deputeti po e tejkalon Rregulloren, atëherë i kërkohet nga kryesuesi që të kthehet në rendin e ditës etj.

Pra, të jemi të qartë, se kemi një Rregullore të cilën nuk mund ta tejkalojë askush, as ish-kryetari i mëparshëm me vullnetin e tij liberal, e as askush tjetër. Rregullorja është rregulli mbi të cilin ne funksionojmë. Është norma jonë. Nuk ka këtu vlerësim personal, individual për normën nga askush. Ne vlerësojmë dhe veprojmë mbi bazën e Rregullores. Kryesuesi i seancës e ka interpretimin për normën që është e shkruar, jo përtej saj, jo përtej normës. Askush nuk mund të interpretojë përtej normës. Vlerësimi, interpretimi, diskutimi dhe deklarimi.

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Për kundër-replikë e ka fjalën kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Kjo nuk ishte për procedurë, por ishte replikë në fjalimin tim, kështu që po ju kundër-replikoj.

E para, nuk ka asnjë dispozitë në Rregulloren e Kuvendit, pavarësisht keqintepretimeve që këtu pa të drejtë po jepen, por për plane dhe çështje komplet të tjera politike. Nuk ka asnjë dispozitë në këtë Rregullore të Kuvendit, të nderuar deputetë, të nderuar qytetarë, që Kryetares së Kuvendit ia ndalon ta marrë fjalën edhe si deputete. Pra, unë e mora fjalën si deputete dhe e shfrytëzova të drejtën time sipas Rregullores. S'keni nevojë të bërtisni. Të drejtën time sipas Rregullores që të jap koment mbi deklarinimin e ministres. Ministrja nuk e kërkoi pastaj fjalën për kundër-replikë. Kaq! Besoj isha e qartë se çka thotë neni 85. Kryetarja e Kuvendit e bën interpretimin e fundit të kësaj Rregulloreje dhe pas saj nuk ka diskutim e kontestim. Prandaj edhe do të vazhdojmë. Kjo ishte kundër-replikë dhe askush nuk ka të drejtë ta marrë fjalën pas kundër-replikë. Jo nuk ka të drejtë, prandaj vazhdojmë me pyetje parlamentare. Mund të ankoheni diku tjetër në qoftë se s'ju pëlqen.

KRYESUESJA: Faleminderit, znj. Osmani! Kjo ishte kundër-replikë në deklaratën e mëhershme, kështu që ju lutem që të keni durimin edhe të vazhdojmë me seancën sipas rendit të miratuar tashmë. Ju faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.)

KRYETARJA: Deputeti Shpejtim Bulliqi, pyetje për ministrin Arban Abrashi. Ministri nuk është këtu. A dëshironi deputet ta lexoni pyetjen?

Regjia, deputetit Bulliqi fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, kryetare!

Sigurisht që do ta pres ministrin që të na përgjigjet në këto pyetje. Nuk i di arsyet, por është java e tretë me radhë që mungon ministri për t'u përgjigjur në këtë pyetje. Është fjala për rrugën magjistrale Prishtinë-Podujevë, rreth punëve dhe neglizhencës së punëve që janë duke u bërë në këtë magjistrale, e cila po u shkakton telashe shumë të mëdha qytetarëve të asaj ane. Por jo vetëm qytetarëve të asaj ane, por edhe mërgimtarëve tanë të cilët lëvizin në atë rrugë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputetja Valdete Idrizi ka pyetje për ministrin Selim Selimi. Ministri është këtu, urdhëroni deputete!

VALDETE IDRIZI: Faleminderit!

I nderuar ministër,

Pyetja ime ka të bëjë sa i përket dhunës në familje. Fatkeqësisht, dhuna në familje ka shënuar rritje shumë të madhe. I kemi parë, kemi qenë dëshmitarë edhe të vrasjeve, dhunimeve e përdhunimeve që kanë ndodhur muajve të fundit, sidomos edhe gjatë kohës së pandemisë është rritur. Pra, pyetja ime është për ju se këtë 900 mijë euro që kanë qenë të planifikuar për trajtimin e kësaj problematike, si janë shpenzuar, ku janë shpenzuar dhe cili është plani juaj nëse mund të na e thoni? Faleminderit paraprakisht!

KRYETARJA: Urdhëro ministër!

MINISTRI SELIM SELIMI: Faleminderit!

E nderuar kryetare,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

E nderuar deputete Idrizi,

Sipas kërkesës suaj në lidhje me pyetjen sa i përket ndarjes së mjeteve për strehimore, dëshiroj t'ju njoftoj se Ministria e Drejtësisë në bazë të mandatit që ka, e ai është që të ofrojë ndihmë për viktimat e krimit, veçanërisht për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimin me qenie njerëzore. Në Qeverinë e kaluar, me miratimin e Ligjit nr. 07/L-001 mbi ndarjet boxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për v. 2020, në kuadër të kodit buxhetor të Ministrisë së Drejtësisë, me nënkod të veçantë programor është vendosur strehimorja shtetërore për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore. Në këtë ligj, për këtë strehimore shtetërore për këtë vit janë ndarë gjithsej 100 mijë euro. Strehimorja punon 24 orë në ditë dhe akomodon, strehon viktimat e trafikimit me rrezikshmëri të lartë dhe të mesëm të sigurisë.

Duke pasur parasysh të gjeturat dhe rekomandimet nga raportet e ndryshme ndërkombëtare, në veçanti nga raporti për vendin i BE-së dhe nga raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit që e publikon çdo vit për trafikimin me qenie njerëzore, të cilat ndërlidhen me qëndrueshmërinë e financimit të strehimoreve, e të cilat strehojnë kategoritë e ndryshme të viktimave, siç i kemi ato viktimat nga dhuna në familje, viktimat nga trafikimi me qenie njerëzore e të tjera. Vendosja e një strehimoreje të tillë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë në një kod të veçantë programor paraqet një hap të rëndësishëm, i cili konsiderohet si avancim në trajtimin, mbrojtjen dhe rehabilitimin e tyre.

Bazuar në gjendjen reale, duhet të vëmë në spikamë që Kosova është një ndër vendet e rralla në rajon që e ka privilegjin që viktimat e kësaj kategorie përveç shërbimeve që i merr nga strehimoret e OJQ-së, ato kanë mundësinë të strehohen edhe në institucione shtetërore.

E nderuar deputete Idrizi,

Për shumën 900 mijë euro që ju keni përmendur në pyetjen tuaj parlamentare për strehimoret, mund po ashtu t'ju informoj se një shumë e përafërt, më saktësisht 880 mijë euro, janë të

parapara me ligjin e lartpërmenduar mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës në vitin 2020 në kuadër të buxhetit sipas kodit buxhetor të Ministrisë së Shëndetësisë. Ndarja e këtyre e mjeteve për strehimoret e licencuara nga OJQ-të, të cilat ofrojnë shërbime strehimi për kategoritë e lartpërmendura bazuar në planin vjetor të punës, tani që është në përgjegjësinë e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, shihet se për strehimoret për këtë vit janë ndarë gjithsej afërsisht një milion euro. Pa dyshim Ministria e Drejtësisë do të ofrojë tërë mbështetjen e saj për të ofruar ndihmë për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore. Faleminderit!

KRYETARJA: A dëshironi pyetje shtesë? Jo. Po vazhdoj me deputeten Ariana Musliu-Shoshi, pyetje për ministrin Selim Selimi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: E nderuar kryetare, faleminderit!

I nderuar ministër,

Si deputete e këtij Kuvendi kam pranuar shumë kërkesa dhe ankesa nga të rinjtë të cilët janë duke kryer praktikën profesionale në Gjykatat dhe Prokuroritë e Kosovës. Ata ankohen se përgjatë kohës që ushtrojnë praktikën nuk kompensohen fare për punën që bëjnë. Atyre nuk u mbulohen shpenzimet e udhëtimit e as të ushqimit, ndërsa ju si ministër dhe zyrtarët e tjerë përgjegjës jeni në dijeni për punën që e bëjnë ata dhe për vështirësitë ekonomike të tyre. Pra, ministër, pyetja ime është se çka do të ndërmerri në këtë drejtim që këtyre praktikantëve dhe atyre në të ardhmen, të paktën t'u mbulohen shpenzimet e udhëtimit dhe të ushqimit?

KRYETARJA: Urdhëro, ministër!

MINISTRI SELIM SELIMI: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

E nderuar deputete znj. Musliu-Shoshi,

Faleminderit për pyetjen tuaj! Fillimisht ju bëjë me dije se kjo çështje është në përgjegjësi të Këshillit Gjyqësor, ku të tillë e përcakton neni 39 i Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, nën ky i cili i referohet bashkëpunëtorëve profesionalë, praktikantëve, përkthyesve, interpretove, si dhe ekspertëve gjyqësorë.

Sa i përket kësaj çështjeje, unë nuk jam në detaje i njoftuar për mospagesën e këtyre praktikantëve, por besoj që ka të bëjë me aspektin buxhetor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Nga takimet që kam pasur me udhëheqësit e sistemit të drejtësisë, i kam garantuar se si ministër i drejtësisë do të jem zë i kërkesave të tyre të arsyeshme, andaj e kam edhe një ftesë për juve, që ndoshta së bashku ta përgatisim, apo ju të bëni një gjë të tillë sa është buxheti në mes dy leximeve që të bëjmë ndonjë propozim apo ndonjë amendamentim të Ligjit të buxhetit.

Pra, është përgjegjësi e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe ata e kanë buxhetin e ndarë. Faleminderit!

KRYETARJA: A keni pyetje shtesë? Rri të lutem afër ministër që mos të ketë nevojë dy herë të dalësh.

Deputetja Ariana Musliu fjalën edhe një herë.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: Faleminderit, ministër!

Mendoj që nëse ndonjëherë bëhem ministre e planifikoj, po konsideroj që është punë e juaja që ta planifikoni edhe këtë pjesë.

KRYETARJA: A dëshironi ministër? Jo! Vazhdojmë me deputetin Alban Hyseni, pyetje për ministrin Selim Selimi sërish. Nuk është deputeti këtu. Edhe një pyetje tjetër e deputetit Alban Hyseni, por meqenëse nuk është këtu po vazhdojmë.

Deputetja Saranda Bogujevci, a është këtu? Nuk është. Deputeti Agon Batusha ka pyetje për ministrin Blerim Kuçi.

AGON BATUSHA: Përshëndetje ministër!

E nderuar kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Pyetja ime është e vjetër 14 ditë. Kjo çështje është tash e sa vjet duke ndodhur, po qe 25 ditë deponia ose stacioni i transferit të mbeturinave në Gjakovë është duke u djegur. Stacioni transfer i mbeturinave në Komunën e Gjakovës është themeluar si i tillë vetëm për t'i mbajtur mbeturinat për 24 orë dhe për t'i transferuar ato në Landovicë të Prizrenit. Po për shkak të keqplanifikimit, keqpërdorimit, po edhe keqmenaxhimit, stacioni transfer është kthyer në deponi ku përlllogaritet përafërsisht të jenë 600 mijë tonë mbeturina të grumbulluara aty. Vit për vit ajo deponi digjet dhe mbarë banorët e Gjakovës helmohen nga tymi toksik që përhapet edhe nga era.

Procesi i dhënies në shfrytëzim të këtij stacioni transfer të mbeturinave tash është proces gjyqësor për shkak se një eksponent i PDK-së, vëllai i kryetarit të PDK-së në Gjakovë është incizuar duke i kërkuar 30 për qind të aksioneve. Është premtuar sa e sa vite që kjo do të zgjidhet, po jemi sot dhe deponia po vazhdon të digjet. Kemi parë një memorandum bashkëpunimi me Komunën e Gjakovës për shkak se atë ditë z. ministër nuk ishit për t'u përgjigjur, por të nesërmen e pamë memorandumimin. E përshëndesim memorandumimin, por pyetjet ende qëndrojnë.

Pyetja është: cili është plani juaj që ta ndalni një ndotje të tillë të ambientit? A keni plan që ta zhvendosni këtë deponi? Nëse po, ku planifikoni ta vendosni deponinë e re? Deri kur duhet që

qytetarët, banorët e Gjakovës të presin të marrin hapa seriozë në drejtim të eliminimit të këtij problemi? Faleminderit!

KRYETARJA: Ministri Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI BLERIM KUÇI: Faleminderit zoti deputet për pyetjen!

Ashtu siç e dini që menaxhimi i mbeturinave është kompetencë e përgjegjësi të kompanive për administrimin e mbeturinave, ku komunat e Kosovës janë aksionarë. Por, meqenëse në Gjakovë është situatë më specifike dhe kjo deponi është vetëm deponi transfer, pasi që mbeturinat deponohen në Landovicë të Prizrenit, edhe pse vazhdimisht ka qenë problem në Gjakovë, kohëve të fundit është shtuar edhe rreikshmëria.

Duke u nisur nga kjo situatë, ne si Ministri që merret me politika dhe monitorimin e ndërmarrjeve publike, jemi njoftuar vazhdimisht nga kryetari i Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini, i cili ka këmbëngulur në zgjidhje të këtij problemi. Në buxhet të v. 2020 nuk ka pasur planifikim apo zë buxhetor për këtë çështje dhe përderisa i gjithë buxheti i Ministrisë është shfrytëzuar për masat e pandemisë, deri më tani nuk kemi pasur mundësi të iniciojmë procedura për sanimin e kësaj gjendjeje tani më emergjente. Tash kemi nënshkruar, pra z. deputet në kohën kur edhe ju e keni bërë pyetjen, kemi nënshkruar një marrëveshje mirëkuptimi me Komunën, edhe po ju njoftoj që vetëm ka filluar bartja e mbeturinave nga kjo deponi e cila vërtet është në gjendje katastrofale dhe të rëndë për qytetarët e Gjakovës, edhe është duke u bërë bartja e mbeturinave në drejtim të deponisë qendrore në Landovicë.

Po ashtu po ju njoftoj zoti deputet se në Kornizën buxhetore kemi futur si buxhet për rregullimin edhe të kësaj hapësire edhe pas bartjes së mbeturinave në deponinë në Landovicë. Pra, edhe me zë buxhetor e kemi paraparë ta rregullojmë këtë çështje. Ju e dini që është problem mjaft i madh dhe ky problem ka qenë i pranishëm pothuajse në gjashtë vitet e fundit edhe tek sot apo vetëm tash, dje ka filluar puna për bartjen e mbeturinave në drejtim të deponisë qendrore në Landovicë.

Pra kjo çështje veç është në procesin fillestar të zgjidhjes më në fund edhe shpresoj qytetarët nuk duhet të brengosen më, sepse kemi paraparë edhe buxhet për të rregulluar këto çështje. Ju faleminderit!

KRYETARJA: A dëshironi pyetje shtesë deputet? Agon Batusha e ka fjalën!

AGON BATUSHA: Po, faleminderit zoti ministër për përgjigjet!

Po, prapë përgjigjet e sakta nuk është që i mora. Këtë pyetje e kemi bërë bashkë me z. Elbert Krasniqi, por i cili besoj që do t'i shpreh edhe ky shqetësimet për banorët aty afër.

Unë pajtohem që Ministria e mbikëqyr, por është përgjegjëse edhe për ambientin. Në rast se ndotet ambienti, e kjo nuk është veç ndotje e ambientit, është edhe rrezik për shëndetin e qytetarëve, këtu duhet reaguar menjëherë. Unë e thash që e përshëndesim reagimin që e keni bërë, por ju e përmendët buxhetin. Në rishikim të buxhetit e kam analizuar buxhetin e Ministrisë, nuk ka asnjë cent ku mund të lëviz buxheti për të alokuar për këto planifikimet për Gjakovën. Andaj e kam bërë një amendament bashkë me znj. Arbërie Nagavcin dhe Elbert Krasniqin, i cili nuk ka kaluar në Komision. Ne kemi dashur t'i ndihmojmë procesit, planit që keni bërë ju dhe bashkë me kryetarin e Komunës për zhvendosjen e këtyre mbeturinave. Por, përveç transferimit në Prizren, këtu duhet të zhvendoset komplet stacioni transfer se është zonë e banuar dhe duhet të kthehet në zonë të gjelbër. Prandaj duhet një planifikim më i detajuar e jo vetëm të hiqen mbeturinat dhe pastaj të zgjidhet çështja ad hoc në bazë të dëshirave të ndokujt.

Përndryshe, janë gjashtë grupe të interesit që po duan ta fusin në dorë stacionin transfer të mbeturinave dhe janë grupe parapolitike të lidhura me partitë AAK dhe PDK. Kështu që ajo është çështje shumë e komplikuar, nuk është kaq e thjeshtë sa duket. Faleminderit!

KRYETARJA: Ministër?

MINISTRI BLERIM KUÇI: Faleminderit, deputet!

Edhe pse unë mendova që jam shumë i qartë. Deponi nuk do të ketë më në atë lagje të Gjakovës. Komplet materiali i deponisë, mbeturinat janë duke u bartur në drejtim të deponisë qendrore të Landovicës. Po ashtu, thashë që kemi paraparë buxhet për vitin 2021-2023, për ta rregulluar hapësirën dhe largimin i mbeturinave. Zoti Gjini vetëm ka filluar punët me një kompani të cilën e ka përzgjedhur përmes prokurimit dhe ka filluar puna e bartjeve. Ndërkaq, buxhet jemi duke paraparë për vitin 2021-2023.

Jo, nuk ka vend të ri. Të gjitha mbeturinat që shkojnë nga qytetari nëpërmjet një kompanie do të barten në Landovicë. Kjo është çështja.

Ajo që është interesante, pra edhe gjatë pandemisë, nuk është paraparë buxhet edhe gjatë kohës së pandemisë, si rrezik shëndetësor që ka qenë, nuk është paraparë buxhet. Ne e kemi gjetur mënyrën e buxhetimit edhe procedurat kanë shkuar mëtutje.

Kompania, të cilën e ka përcaktuar komuna në bazë të marrëveshjes së mirëkuptimit, është duke e kryer punën e vet. Për vitin e ardhshëm do të ketë buxhet për ta rregulluar si hapësirë, në harmoni me planet që i jep Komuna e Gjakovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Gazmend Gjyshinca, pyetje për ministren Meliza Haradinaj.

GAZMEND GJYSHINCA: Faleminderit, kryetare!

Pas konkursit të brendshëm, në kuadër të rrotacionit të diplomatëve të organizuar për herë të parë në historinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe për Diasporë, nga ish-ministri Glauk Konjufca, komisioni profesional, ku nuk kishte as anëtarë as ndikim nga kabineti politik i ish-ministrit Konjufca, ka dalë me rekomandime për dërgimin e diplomatëve në misione në kuadër të rrotacionit.

Nga publikimet që i kemi parë javëve të fundit, kuptohet se ministrja e Punëve të Jashtme nuk po i marr në konsideratë këto rekomandime profesionale, por po lejon dhe po e zbaton një politikë të pazareve për dërgimin dhe kthimin e diplomatëve në dhe nga misionet tona diplomatike.

Në këtë kuptim e drejtim, pyetja ime për zonjën Haradinaj-Stublla është se përse nuk po i marrin parasysh rekomandimet e komisionit profesional nga konkursi i brendshëm në MPJD? Përse e keni pezulluar vendimet për kthimin e diplomatëve në kuadër të rrotacionit dhe përse keni vendosur që nga mbi 40 diplomatë, t'i ktheni vetëm rreth 15? Cili ka qenë kriteri për këtë diferencim të diplomatëve tanë, koha sa kanë qëndruar në mision apo përkatësia e tyre partiake e familjare? Faleminderit!

KRYETARJA: Urdhëro, ministre!

MINISTRJA MELIZA HARADINAJ: Faleminderit, kryetare! Faleminderit, deputet Gjyshinca?

Është absolutisht e pavërtetë ajo që pretendohet në pyetjen tuaj. Si duket informacionet janë bazuar në ato dezinformatat që i ka shpërndarë ish-ministri Konjufca, të cilat kanë qenë të mangëta dhe jo të sakta.

E para që duhet theksuar është që vet procesi i rrotacionit dhe raporti të cilit i referoheni ju, është marrë në kohën kur Qeveria ka qenë e shkarkuar. Pra, kanë qenë rekomandime jolegjitime, vendime jolegjitime.

Në bazë të kësaj kam themeluar një komision për analizimin e të gjitha vendimeve të ish-ministrit Glauk Konjufca, për të kthyer legjitimitetin, sepse ato vendime janë marrë kur ai ka qenë në dorëheqje. Pra, për t'i nxjerr të vërtetat, sepse ato vendime janë marrë në baza selektive dhe të bazuara në informacione jo të sakta apo më mirë thënë, në informacione të cilat i kanë shpërndarë njerëzit që janë sjellë aty rreth kabinetit. Absolutisht ata njerëz nuk janë njerëz jopolitikë, po janë njerëz politikë.

Gjithashtu, për arsye se vendimet e nxjerra kanë rrezikuar që të defunksionalizojmë shërbimin tonë të jashtë.

Andaj, këto janë tri arsyt pse kam themeluar komisionin që t'i shqyrtojë të gjitha ato vendime. Pas analizimit të atyre vendimeve, është nxjerrë vendimi për pezullim i të gjitha vendimeve të ish-ministrit Konjufca, të cilat përkojnë me rrotacionin.

Pezullimi, siç e thashë, është bërë edhe për parandalimin e dëmit të pariparueshëm që mund t'i shkaktojë MPJ-së, nëpërmjet qasjes selektive dhe arbitraritetit të aplikuar në këto vendime.

Pozitat vakante të cilat kanë mbetur në shërbimin e jashtëm, sidomos në kryeqytetet me rëndësi të veçantë për Kosovën, e aq më shumë në kohën nëpër të cilën po kalojmë, sidomos në kryeqytetet e QUINT-it, në Bruksel dhe në Hagë, më kanë shtyrë që të punoj çdo ditë për të rikthyer funksionalitetin në shërbimin e jashtëm dhe ta aplikoj rrotacionin pas 11 vitesh.

Në këto vendime, siç ka pretenduar partia Vetëvendosje, nuk hyjnë vendimet e konsujve dhe këtë e kam bërë të qartë disa herë, e po them edhe sot këtu.

Në mesin e vendimeve ka pasur vendime me bazë të kontestueshme ligjore, sepse keni hequr nga shërbimi i jashtëm, njerëz të cilët kanë qenë pjesë e shërbimit të jashtëm, jo politike, gjashtë deri në tetë vite punë në shërbimin e jashtëm. Njerëz të cilët kanë kaluar komisionet për grada e disiplinë dhe i keni hedhur jashtë shërbimit. I keni pezulluar nga puna, vetëm e vetëm për arsye politike.

Andaj, unë...

KRYETARJA: Zoti deputet, a dëshironi pyetje shtesë? Zoti Gjyshinca e ka fjalën.

GAZMEND GJYSHINCA: Njëjtë sikurse më herët, vazhduat prapë. Pra, të na e dëshmoni se sa e padenjë jeni për të qenë ministre e Punëve të Jashtme.

Si Lëvizje Vetëvendosje, ne parashihnim auditimin e gradave diplomatike, ndërsa Qeveria koti në koordinim me presidentin, po shpërblen vëllezërit e ministrave me grada ambasadorësh.

Përderisa ne po realizonim një proces profesional të rrotacionit diplomatik, Qeveria koti tejzgjat mandatet e figurave dhe diplomatëve të tjerë të afërt me partinë në pushtet.

Pra, zonja ministre, ajo që unë po ju pyes është, se pse nuk keni vazhduar që t'i dëgjoni rekomandimet e komisionit profesional?

Orientimi juaj në të udhëhequrit e Ministrisë së Jashtme, tregohet edhe me faktin se kë e keni emëruar për zëvendësministër të Punëve të Jashtme, Gani Dreshaj? A është ky orientimi juaj?

Edhe diçka tjetër. Më 7 korrik, ju...

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: 30 sekonda, regjia, ju lutem!

GAZMEND GJYSHINCA: Shumë shkurt! Ju kemi ftuar më 7 korrik, ndërsa sot është 23 korrik, të vini e të raportoni në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë.

Zonja ministre, kthehuni këndeje, me juve po flas. Ju lutem, keni vëmendjen!

Pse nuk po vini që të raportoni në Komisionin për Punë të Jashtme dhe Diasporë? Pse por frikësoheni? Çfarë jeni duke bërë, në anën tjetër? Është obliguese raportimi para Kuvendit. Pse kjo ikje? Pse kjo shmangie?

MINISTRJA MELIZA HARADINAJ: Faleminderit, deputet!

Nuk i shmangem. E kam kthyer përgjigjen brenda dy orësh prej kur e keni dërguar ftesën, dhe ju kam thënë që kam agjendë të planifikuar për dy javë, dhe javën tjetër do të vij dhe do t'ju raportoj sa të doni.

Vetëm se, jo publikisht si Glauku që ia ka dhënë të gjitha informatat e politikës së jashtme Ivica Daçiqit.

Prandaj, edhe një herë, dua të theksoj që nuk janë 15 diplomatë që kthehen, por janë 52 diplomatë që kthehen. Do të thotë se informatat i keni të pasakta. Po ashtu, janë 5 vendime për të cilat është shtyrë pezullimi e për të cilat jemi duke e shqyrtuar bazën ligjore, sepse janë të kontestueshme.

Andaj, numri i përgjithshëm i diplomatëve që do të kthehen është 52, që nuk është realizuar në këtë formë gjithëpërfshirëse asnjëherë rrotacioni në shërbimin e jashtëm. Ju e dini, që komisioni paraprak të cilin e kam konsultuar, raportin të cilin e kanë nxjerrë, do të thotë nuk ua kanë nënshkruar anëtarët tjerë të komisionit, e dini edhe këtë shumë mirë, sepse ka pasur pretendime që ka pasur influencë politike në ato vendime.

Prandaj, është mirë ta thoni të vërtetën e plotë, kur flisni në publik.

Kështu që, unë e kam konsultuar të raport, edhe përtej atij raporti edhe rekomandimi të atij raporti të atij komisioni, kam kthyer 52 diplomatë, jo 35, sa i ka kthyer Glauk Konjufca. 52 diplomatë kthehen deri në fund të vitit, dhe normalisht 52 shkojnë, sepse ka filluar faza e dytë e rrotacionit. Një në shërbim, një ministri, ky është parimi i shërbimit të jashtëm.

Kështu që, ju falënderoj për pyetjen deputet. Jam në dispozicion tuaj në çdo kohë.

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputetja Fitore Pacolli-Dalipi. Pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti. Kryeministri nuk është këtu. Zonja deputete, a dëshironi ta bëni pyetjen?

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Zoti Hoti nuk është këtu për t'ju përgjigjur pyetjeve, por unë do ta lexoj pyetjen dhe pres që zoti Hoti të kthejë përgjigje, pasi që ministrja për Punë të Jashtme nuk kishte përgjigje më herët.

Për të rifilluar bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Kosova është pajtuar që të pezullojë përpjekjet për t'u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare, dhe këtë e ka konfirmuar zoti Hoti, dhe ka thënë që kjo do të zgjasë deri më 27 qershor 2020.

Mirëpo, nga deklarimi i shefit të diplomacisë së Serbisë, ne e kuptuam një çështje tjetër. Që, përveç se Prishtina është zotuar që të mos bëjë fushatë për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, u pa që është zotuar edhe për mosangazhim në njohje të reja për shtetin e Kosovës.

Prandaj, është shumë e rëndësishme që zoti Hoti të përgjigjet në këto pyetje. Të na tregojë saktë, nëse ka hequr dorë nga këto të dyja. Heqja dorë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare dhe heqja dorë nga njohjet e reja. Pra, këto dy gjëra janë vënë në pah nga deklarimi i Ivica Daçiqit.

Prandaj, zoti Hoti, e ka për obligim që të raportojë dhe të na tregojë se çfarë në të vërtetë ka premtuar.

Pyetja është: A do të vazhdon të mbetet ky pezullim në fuqi edhe pas datës 27 qershor, siç ka thënë edhe zoti Daçiq, apo kjo do të shndërrohet në një fusnotë të dytë? Sepse kështu na mashtruan me fusnotën. Thanë që shkrihet në vitin 2012, ajo nuk është shkrië. Tani po vazhdojnë ta sjellin një fusnotë tjetër e cila do ta ndjekë Kosovën për vitet me radhë.

Prandaj, është shumë me rëndësi kjo dhe unë do ta përsërisë pyetjen edhe në seancën e radhës, derisa të kam përgjigje prej zotit Hoti. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputeti Eman Rrahmani. Pyetje për ministrin Armend Zemaj. Ministri nuk është këtu. A dëshironi fjalën? Regjia, fjalën deputetit Rrahmani.

EMAN RRAHMANI: Faleminderit, nënkryetare!

Meqë nuk është ministri këtu, pyetjen e shtyjë për seancën e radhës.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputeti Rrahmani. Deputeti Dimal Basha ka pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti. Kryeministri nuk është këtu. Deputet, a e doni fjalën? Jo. E shtynë pyetjen.

Deputeti Dimal Basha ka, po ashtu, pyetje për zëvendëskryeministrin dhe ministrin Goran Rakiq. A dëshironi fjalën deputet? Po. Fjalën, deputetit Basha.

DIMAL BASHA: Faleminderit, nënkryetare!

Unë kam marrë një përgjigje të shkurtët ne shkrim, por desha ta ceku meqë është e rëndësishme, që kuvendi komunal në Ferizaj ka pasur një mbledhje, ku një ndër pikat e propozuara nga ekzekutivi i komunës, ka qenë propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Rregullores për dhënien e tokës së komunës për ndërtim dhe përdorimin e bonusit.

Kjo është e bazuar, sipas tyre, në Ligjin për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e paluajtshme të komunës.

Dihet tashmë që në Ferizaj ekziston njëfarë sekreti publik, ku kemi një pushtet lokal në krye me Agim Aliun, që lojalitetin e ka me mafinë e betonit dhe asnjëherë me qytetarët, dhe tani që ju ka mbetur edhe një vit në pushtet, po nxitojnë që ta bëjnë një Rregullore që t'i betonojnë komplet pronat komunale, në bashkëpunim me mafinë e betonit, të cilëve edhe ju shërben.

Prandaj, unë vazhdoj të insistoj te Ministria e Pushtetit Lokal që është e rëndësishme që të mos lejohet, sepse ligji e thotë qartazi se kjo Rregullore duhet të miratohet në Qeveri me propozim të ministrisë, e jo nga komuna. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Fidan Rekaliu ka pyetje për ministrin Ramë Likaj. Ministri nuk është këtu. Deputet, a e doni fjalën? Fjalën, deputetit Rekaliu, ju lutem!

FIDAN REKALIU: Faleminderit, e nderuara nënkryetare e Kuvendi!

Pasi ministri nuk është këtu, pyetjen do ta bëj në seancën e radhës.

KRYESUESJA: Faleminderit!

Edhe një pyetje nga deputeti Fidan Rekaliu për ministren Vlora Dumoshi. Ministrja nuk është këtu. Deputet a e doni fjalën?

FIDAN REKALIU: Jo, do ta shtyj për seancën e radhës.

KRYESUESJA: Faleminderit! Deputeti Ekrem Hyseni, pyetje për ministrin Arban Abrashi. Ministri nuk është këtu, deputet a e doni fjalën?

Fjalën deputetit Hyseni, ju lutem, regjia!

EKREM HYSENI: Meqenëse, sot mungon ministri, atëherë e shtyj pyetjen për seancën tjetër. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Hyseni! Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti. Kryeministri nuk është këtu. Deputete a e dëshironi fjalën?

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesuese!

Pyetja për kryeministrin Hoti ka të bëjë me vendimet të cilat Qeveria Kurti i ka marrë, të cilat edhe vet, atëherë zoti Hoti si zëvendëskryeministër i ka votuar, në raport me procesin e privatizimit dhe ndaljen e të gjitha veprimtarive pranë Agjencisë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht privatizimi, likuidimin dhe qiradhënien.

Në mbledhjen e parë të Qeverisë Hoti, bashkë me heqjen e masës së reciprocitetit ka anuluar edhe vendimet për veprimtari të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, gjegjësisht, ka anuluar vendime të cilat ndalin qiradhënien dhe likuidimin.

Pyetja e drejtpërdrejt për zotin Hoti kur të vjen është: A ka të bëjë me pazaret politike, me partitë të cilat është tani në koalicion? Dhe, çfarë ndodhi, si ekonomist dhe profesionist që është, një ndryshim në bindjen e tij brenda tre muajve, prej një vendimi për ndalim të të gjitha aktiviteteve dhe anulim të atij vendimi dhe lëshim të aktivitete kundrejt Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Natyrisht, na intereson edhe strategjia e kësaj Qeverie në këtë raport, por gjithsesi kur të kthehet zoti Hoti, ia lexoj pyetjen në detaje. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Kusari! Deputetja Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, ka po ashtu pyetje për kryeministrin Hoti. Kryeministri nuk është këtu. Deputet a e dëshironi fjalën?

FATMIRE MULHAXHA-KOLLÇAKU: Po e lexoj, meqenëse kjo vetëm edhe do ta humb kuptimin nëse presim. E kemi pasur edhe një debat sa i përket pandemisë dhe pak a shumë kryeministri e ka dhënë njëfarë përgjigje, por jo të argumentuar.

Prandaj, veç po e lexoj sa për informim të publikut edhe le të përfundojë me këtë seancë, dhe nëse ka diçka në mënyrë të argumentuar, kisha pritur që në seancën e radhës të marr përgjigje.

Çështja ka të bëjë me atë që më 13 mars 2020, kur ishin dy rastet e para të infektuar me COVID-19, të regjistruara në Kosovë, një rast në Komunën e Vitisë dhe një në Komunën e Klinës, vendimi i menjëhershëm i Qeverisë së atëhershme të Kosovës, pra Qeverisë Kurti, ka qenë që të karantinoren këto dy komuna.

Paraqitja e rasteve të infektuar me COVID-19, ka vazhduar edhe në komunitat tjera, ku një varg masash parandaluese dhe luftuese të këtij virusi janë ndërmarrë nga Qeveria Kurti.

Kjo bëri që më 24 mars 2020 të kemi zero raste të infektuar me Covid-19. Përpjekjet e Qeverisë Kurti apo Qeverisë së Kosovës, Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve të tjera relevante, minohesh nga brenda, ndërsa lëvdoheshin nga jashtë Kosovës.

Qeveria Kurti kishte gjetur një sistem të shkatërruar shëndetësor, të degraduar e të korruptuar. Qeveria i pati ndarë menjëherë 20 milionë euro për t'i adresuar me urgjencë nevojat e sistemit shëndetësor karshi pandemisë, e në anën tjetër besimi në qeverisje të mirë, bëri që të reagojnë edhe donatorët ndërkombëtar me donacionet e tyre.

E dimë ku jemi tani. Tani kemi numër rekord të rasteve me 241 raste vetëm dje dhe 150 raste të vdekjeve nga fillimi i pandemisë Covid-19 në Kosovë.

Në programin qeverisës 2020-...

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Deputetja Labinotë Demi-Murtezi, pyetje për ministrin Armend Zemaj. Ministri nuk është këtu. A e dëshironi fjalën?
Regjia, fjalën deputetes Murtezi.

LABINOTË DEMI - MURTEZI: Faleminderit për fjalën kryesuese!

Këto pyetje janë të adresuara më herët për ministrin, por meqë nuk ka ardhur radha deri tash dhe më vjen keq që edhe sot ministri nuk është këtu që ta marr një përgjigje, unë do t'i shtroj si pyetje dhe shpresoj që ta marrë përgjigjen ndërkohë prej ministrit.

Masa bazike për mbrojtje nga COVID-19 mbetën; distanca sociale, bartja e maskave dhe higjiena personale e në veçanti larja e shpeshtë e duarve. Këshillohen të gjithë qytetarët që t'ju shmangen kontakteve me njëri-tjetrin, sa më shumë që të jetë e mundur, ngase secili individ mund të jetë potencialisht i infektuar asimptomatik.

Nuk do mend se me raste të diagnostifikuara tashmë, dhe në veçanti ata që hospitalizohen, kontakti i vetëm duhet të jenë vetëm personeli shëndetësor i pajisur me rrobat mbrojtëse.

Ndërkohë, këto ditë, ne kemi parë nga afër dhe është raportuar edhe në media se familjarët e të infektuarve janë në kontakt të vazhdueshëm me të infektuarit, qoftë nga papërgjegjësia apo nga nevoja për t'u kujdesur për të afërmit e infektuar.

Kësisoj, virusi që ka prekur një person në familje, tashmë e ka derën hapur për t'i kapluar të gjithë.

Pyetja ime për zotin Zemaj ishte: Kush ka pasur guximin që të lejojë që të infektuarit me COVID-19 në Klinikën Infektive dhe në atë të Pulmologjisë të shoqërohen nga familjarët? Për çfarë rregulli disiplinor e preventiv flitet në publik nga ju, kur ato rregulla thyhen para syve tuaj në institucionet shëndetësore që menaxhohen pikërisht nga Ministria e Shëndetësisë?

Cili ligj apo protokoll, ju lejon që të ndërmerrni hapa të tillë me çka rrezikohet jeta e qytetarëve të tjerë, duke rrëshqitur kështu edhe kah veprat penale?

Është shumë e rëndësishme për neve, që ta dimë në këtë situatë të vështirë që po kalojmë, se sa dhe si po inspektohet gjendja dhe kushtet nëpër klinikat e Qendrës Klinika Universitare dhe spitalet regjionale në qytetet tjera.

Mbi të gjitha, cili është mekanizmi i monitorimit të zbatueshmërisë së të gjitha masave në përgjithësi?

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! E kemi edhe një pyetje përsëri për ministrin. A dëshironi ta lexoni pyetjen?

LABINOTË DEMI-MURTEZI: Me fillimin e lirimit gradual të masave, Qeveria Kurti, konkretisht Ministria e Shëndetësisë e udhëhequr në atë kohë nga ministri Arben Vitia, kishte një plan të detajuar vlerësimi që korrespondonte me rezultatet e rasteve të të infektuarve dhe respektimit të masave kufizuese, nëse duhej të vazhdohej me lirimin e tyre apo të vazhdohej që të mbaheshin kufizimet në fuqi.

Strategjia ishte sa shpresëdhënëse për rikthim gradual në normalitet, aq edhe këshillueshme për të vazhduar me kujdesin e shtuar edhe gjatë lirimit gradual.

Sot, jemi në një situatë ku nuk respektohen masat e që rezultojnë me numër rekord të të infektuarve, duke na bërë kështu, si njërin nga vendet me rrezikshmërinë më lartë, sa i përket pandemisë Covid-19.

Kjo huqje e juaja po na kushton me rikthim të kufizimeve për të cilat thoshit se janë kundër-kushtetuese. Ndërkaq, deri sot, ju do të duhej që tashmë t'i kishit kryer të gjitha procedurat formale për Ligjin për Luftimin e Pandemisë.

Zotëri Zemaj, pse keni vazhduar me heqjen e masave në vazhdimësi, pa e vlerësuar shkallën e rrezikut? A nuk janë barrë morale edhe institucionale për juve, rastet e vazhdueshme tragjike apo thjesht, po punohet vetëm për statistika?

Në kohën e ish-ministrit Vitia, masat kanë qenë duke u tërhequr në përputhje me gjendjen në të cilën kemi qenë, jo në këtë që jemi. Ndërsa, ju keni vepruar në shpërputhje me realitetin. Keni pranuar 100 mjekë të rinj që kryesisht punojnë në Qendrën Klinike Universitare, por nuk keni provuar të angazhoni pulmologë të cilët nuk punojnë në institucione shtetërore, por vetëm në klinika private, në mënyrë të veçantë sa i përket punës së pandemisë.

Siç duket, inteligjenca pandemike, kjo shprehje që ende nuk është deshifruar se çka nënkupton dhe situata e stabilizuar, në thonjëza dhe vetëm si pas jush, bordet, komitetet dhe koordinatorët e shumtë nuk po ju bëjnë punë. E ne me gjithë insistimin tonë...

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Murtezi! Deputetja Donika Kadaj-Bujupi ka pyetje për ministren Hykmete Bajrami. Deputetja nuk është këtu.

Deputeti Kujtim Gashi ka pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti. A e dëshironi fjalën deputet? Jo. E shtynë për seancën e radhës.

Deputeti Kujtim Gashi ka edhe një pyetje për ministrin Blerim Kuçi.

KUJTIM GASHI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar deputetë,

Siç jeni në dijeni, edhe në të kaluarën ka pasur probleme të shumta me deponinë e mbeturinave në Landovicë. Aty, disa herë qytetarët kanë protestuar për shkak të kundërmimit të madh që ndodh me një perimetër jashtëzakonisht të gjerë përreth deponisë.

Ky kundërmimin, nuhatet fare thjesht nga kushdo që e merr rrugën për të hyrë në autostradën "Ibrahim Rugova". Po ashtu, besoj që e dini se jo larg deponisë ka edhe shtëpi banimi. Së fundmi edhe uji i puseve del të jetë i kontaminuar. Për më keq, në vijë ajrore shumë afër deponisë, gjendet edhe shkolla e fshatit Landovicë, ku vijnë mësimet nxënësit e fshatit.

Pyetja për ministrin është kjo: Çfarë do të ndodhë me këtë deponi dhe a ka plane ministria për zhvendosje e saj ose për ndonjë projekt riciklimi, i cili do ta bënte zgjidhjen për deponinë e mbeturinave, jo vetëm në Landovicë, po në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe të njëjtat do të mund të kthehen në hapësira të gjelbra, pse jo edhe në fabrika të cilat do ta ndihmonin zhvillimin ekonomik të vendit? Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Gashi! Fjalën e ka ministri për përgjigje.

MINISTRI BLERIM KUÇI: E para, faleminderit për pyetjen zoti Gashi!

Deponija rajonale e Prizrenit në Landovicë është ndërtuar në vitin 2013, si financim nga Komisioni Evropian.

Si deponi, ajo u shërben komunave, Prizren, Rahovec, Malishevë, Suharekë, Mamushë, Gjakovë. Kjo deponi menaxhohet nga kompania për menaxhimin e deponive në Kosovë dhe do të jetë në funksion deri në vitin 2025, me këtë koncept të deponive.

Në raportin për mbeturina të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, thuhet se ka probleme me ujërat e deponisë, të cilët rrjedhin jashtë për shkak të mosfunksionimit të disa pompave të ujit. Gjithashtu, një sasi e madhe e ujit është grumbulluar në anën juglindore të deponisë, që realisht paraqet një rrezik potencial për ndotjen e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Për momentin, Ministria e Ekonomisë dhe e Ambientit, në bashkëpunim me KFV-në dhe GIZ, janë duke bërë një studim gjithëpërfshirës për deponinë regjionale.

Bazuar në studimet preliminare të KFV-së dhe të ministrisë sonë, kemi planifikuar ta bëjmë një përmirësim të gjendjes aktuale teknike të deponive për mbeturina komunale dhe ka hartuar një projekt-strategji për vitin 2020-2029 dhe planit të veprimit 2020-2022, për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë.

Këto dy dokumente janë pothuajse gati dhe së shpejti do të procedohen në Qeveri.

Nga ajo që më është raportuar nga Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit dhe Ujërave, për deponinë regjionale për mbeturina komunale në Landovicë, pra në Prizren, janë paraparë që të realizohen projektet si në vijim; e para, një studim fizibiliteti dhe hartimi i tij për qendrën e ndarjes dhe qendrën e kompostimit të mbeturinave organike në Prizren, në vlerë 231 mijë e 176 euro.

Po ashtu, është paraparë edhe ndërtimi i qendrës së ndarjes dhe qendrës së kompostimit në Prizren, e planifikuar të ndërtohet gjatë vitit 2020-2023, në vlerë 4 milionë e 760 mijë euro.

Dhe, po ashtu është paraparë përmirësimi dhe zgjerimi i deponisë në Prizren, e planifikuar të ndërtohet gjatë vitit 2020-2023, në vlerë 5 milionë euro.

Të gjitha këto janë grande të cilat janë paraparë për ta përmirësuar gjendjen në deponi dhe për...

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër! A keni pyetje shtesë zoti Gashi? Po. Pyetje shtesë, një minutë, regjia ju lutem!

KUJTIM GASHI: Faleminderit, ministër!

Më lejoni që fillimisht t'ju përgëzoj për të gjitha këto plane që i ka Qeveria. Megjithatë, deponia e Landovicës, siç dihet, është në mes të shumë fshatrave dhe kohëve të fundit e viteve të fundit është bërë e pamundur edhe jetesa në vendbanimet përreth kësaj deponie.

Prandaj, po ju lus edhe si deputet i asaj pjese, edhe besoj edhe ju si ministër i asaj pjese, e njihni mirë këtë pjesë, këtë zonë, dhe dëmet që i shkakton deponia.

Ju kisha lutur që me mirëkuptim t'i përshpejtoni të gjitha këto projekte, në mënyrë që kjo deponi njëherë e përgjithmonë t'i ketë standardet më të larta. Faleminderit!

KRYESUESJA: Ju faleminderit! Përgjigjet ministri, ju lutem!

MINISTRI BLERIM KUÇI: Edhe një herë faleminderit, zoti deputet!

E bashkëndiejmë shqetësimin tuaj për atë pjesë dhe do të mundohem që të jem shumë konkret.

Në aspektin teknik ajo deponi veçse është duke u rregulluar edhe janë paraparë tri buxhete që do ta bëjnë dhe do ta shtimë në funksion dhe nuk do të jetë në dëm të qytetarëve të asaj zone. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë,

Kanë mbetur edhe 15 minuta kohë për pyetjet parlamentare, mirëpo meqenëse në fillim të kësaj seance u pajtuam që pushimi të jetë në orën 14:00, vazhdojmë punimet e seancës në orën 15:00, me 15 minutat vijuese për pyetjet parlamentare dhe pastaj me diskutimin e pikës së radhës. Faleminderit!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë, i kemi edhe 15 minuta për pyetje parlamentare.

Deputeti Kujtim Gashi, a është këtu?

Deputeti Frashër Demaj, pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti, deputeti nuk është këtu.

Deputeti Gazmend Zyla, pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti, a është deputeti këtu? Nuk është deputeti këtu.

Deputetja Fitore Pacolli-Dalipi... Deputeti Gazmend Sylja është këtu, po kryeministri nuk është këtu, sepse na njoftoi që kishte disa obligime. A dëshironi ta bëni pyetje në seancën e radhës apo tani ta lexoni? Tani do ta lexojë deputeti Gazmend Sylja e ka fjalën, me kartelë të Arbër Tolajt.

GAZMEND SYLA: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar

Meqenëse kryeministri sigurisht ka ndonjë temë të rëndësishme, shumë të madhe për vendin, nuk qenka këtu.

Në qoftë se ministri Blerim Kuçi ia përcjell kërkesën time, pyetjen time kryeministrit, unë me gjithë qejf e kisha thënë këtu.

Ministër, a pranon t'ia përcjellësh këtë që po e them?

Ministër, meqenëse kryeministri nuk po e di ku është një zyrë, quhet Zyra për Çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta e UÇK-së, ajo zyrë është në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, është një kat më poshtë se zyra e tij, jo dera e parë, është tualeti, as e dyta jo, është Zyra për Informim, po zyra e tretë operon në atë grup.

Aty veç e dërgon një djalë t'ia mundësojë asaj zyre të funksionojë për shkak se kemi shumë njerëz, të cilët po presin të marrin shërbimin nga ajo zyrë, e në fakt, zyra është jashtë funksionit. E paramendoni cilët njerëz kanë nevojë për atë zyrë, njerëz që po vuajnë për një kafshatë bukë.

Po të lutem, ia përcjell kryeministrit, të emërojë dikë, një drejtor, një këshilltar politik që quhet edhe drejtor i zyrës sa më parë për shkak se kërkesat janë emergjente. Faleminderit, ministër!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputetja Fitore Pacolli-Dalipi ka pyetje për kryeministrin Hotin. Pra, kryeministri ka kërkuar që t'ju njoftoj që kishte angazhime të tjera. Urdhëro, zonja Dalipi, a dëshironi ta parashtroni tash pyetjen apo në seancën e radhës?

FITORE PACOLLI-DALIPI: Do ta lë për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputetja Vlora Limani-Hajnuni ka pyetje për ministrin Armend Zemaj, ministri nuk është këtu. A dëshironi ta lëni për seancën e radhës apo ta lexoni pyetjen. Deputetes Vlora Limani, fjalën!

VLORA LIMANI-HAJNUNI: Faleminderit, kryetare!

Pyetja ime ka të bëjë me sëmurit kronikë dhe gjendjen e tyre gjatë kësaj periudhës së pandemisë. Meqenëse ministri nuk është këtu, do e lë për seancën e radhës.

KRYETARJA: Faleminderit! Sërish deputetja Vlora Limani-Hajnuni, pyetje për ministrin Skënder Reçica. Ministrin nuk po e shoh që është këtu.

VLORA LIMANI-HAJNUNI: Faleminderit, kryetare!

Pyetja ime ka të bëjë për një kategori të veçantë, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët e tjerë, të cilët kanë nevojë për shërbime sociale gjatë periudhës së pandemisë. Meqenëse prapë ministri nuk është këtu, do e lë pyetjen për seancën e radhës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit, mbetet për seancën e radhës.

Deputeti Elbert Krasniqi ka pyetje për ministrin Ram Likaj, ministri nuk është këtu, atëherë po e lëmë po seancën e radhës. Faleminderit!

Deputeti Gazmend Syla, pyetje për ministrin Selim Selimi, a dëshironi ta lexoni, ministri nuk është këtu. Atëherë mbetet për seancën e radhës.

Deputeti Eman Rrahmani nuk është këtu, mbetet për seancën e radhës, sepse ka pyetje për kryeministrin Avdullah Hoti.

Deputeti Arbër Tolaj ka pyetje për ministrin Besian Mustafa, ministri nuk është këtu. A dëshironi ta lëni për seancën e radhës. Në rregull, faleminderit!

Urdhëro, deputeti Arbër Tolaj, fjalën. Erdhi ministri Selim Selimi, do të kthehemi prapë kushdo që kishte pyetje për të. Vetëm një herë fjalën deputetit Arbër Tolaj.

ARBËR TOLAJ: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Meqenëse parashtrimi i pyetjes në aspektin administrativ po kërkon kohë, nga momenti i kërkesës pastaj protokollimi e deri në seancë në rastin konkret në pyetjen time kërkesa është parashtruar më 16 korrik, kurse më 20 ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, veç ka njoftuar opinionin se do të shpallet i hapur aplikimi për grante dhe subvencione.

Për shkak të korrektësisë ndaj buqëve, pyetjen do ta lexoj ashtu siç e kam parashtruar.

Si qëndron situata me grante dhe subvencione në bujqësi këtë vit? A ka vështirësi në aplikimin dhe kryerjen e obligimeve nga ana e ministrisë dhe deri ku ka arritur ky proces? Pra, kjo ka qenë pyetja, edhe pse ministri ka dhënë sqarimin më datën 20. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputeti Gazmend Syla, me kartelë të Arbër Tolajt, pyetje për ministrin Selim Selimi.

GAZMEND SYLA: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kabinet qeveritar,

Unë e kam një pyetje për ministrin Selimi.

Zoti ministër, meqenëse në media e kam parë se e keni pasur një takim ose keni komunikuar me ministrin e Drejtësisë të Maqedonisë, a keni diskutuar rreth çështjes së shtetasve kosovarë, të cilët gjenden në burgun e Maqedonisë, të ashtuquajtur si Grupi i Kumanovës, a keni gjetur vend

për diskutim edhe për këtë pjesë, meqenëse keni pasur një konferencë, nëse nuk gaboj, me video link qysh e kam parë në media. Faleminderit!

KRYETARJA: Urdhëro, ministër!

MINISTRI SELIM SELIMI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

I nderuar deputet zoti Syla,

Me të marrë detyrën si ministër i Drejtësisë kam vendosur kontakte me ministrin e Drejtësisë të Maqedonisë së Veriut, ku kam shprehur një gatishmëri për bashkëpunim mes dy ministrive tona.

Në takimin virtual që e kam pasur me ministren e Drejtësisë së Maqedonisë së Veriut, zonjën Renata Deskoska, kemi biseduar edhe për trajtimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen në Institucionet e Shërbimit Korrektues të Maqedonisë së Veriut.

I kam treguar që ne jemi duke e përcjellë me interes të veçantë, pasi që janë qytetarët tanë, zhvillimet rreth këtij rasti deri në epilogun përfundimtar. E di që rasti është ende në pjesën ankimi apo të mjeteve të jashtëzakonshme, nëse nuk gaboj juridikisht.

Do të angazhohemi në rritjen e hapësirave në institucionet tona korrektuese, në mënyrë që të krijojmë kushte sa më të favorshme dhe i kam treguar që shteti i Kosovës është i gatshëm të lidhë marrëveshje ekstradimi të veçantë me shtetin e Maqedonisë së Veriut, kurdo që ky rast e merr epilogun.

Për më shumë, i kam përcjellë mesazhin se ne kemi besuar dhe besojmë se drejtësia ndaj këtyre qytetarëve të Kosovës nuk do të jetë diskriminuese, pra do të jetë drejtësi, e cila është meritore me rrethanat edhe rastin atje.

Për fat të keq, sa për informatën tuaj, numri i shtetasve kosovarë që vuajnë dënimin jashtë Kosovës është më i madh se sa numri i qytetarëve të Kosovës që vuajnë dënimin në Kosovë.

Ministria e Drejtësisë është e përkushtuar të gjejë modalitete me shtetet që shprehin interes dhe me marrëveshje të reja t'i mundësoj që qytetarët e Kosovës, do të thotë në bazë të atyre marrëveshjeve të kryejnë dënimin apo të kthehen në Kosovë për mbajtjen e dënimit të tyre. Faleminderit!

KRYETARJA: A keni pyetje shtesë, deputet? Sërish deputeti Syla e ka fjalën.

GAZMEND SYLA: Faleminderit, kryetare!

Ministër, faleminderit për përgjigjen!

Por, përgjigjja ishte shumë sipërfaqësore, e konkretisht pyetja është kur do të ndodhë kjo marrëveshje që ju e mendoni që duhet të ndodhë për ekstradimin e shtetasve tonë në vuajtje të dënimit në burgjet tona? Faleminderit!

KRYETARJA: Urdhëro, ministër!

MINISTRI SELIM SELIMI: Faleminderit, zoti Sylja!

Çështja e marrëveshjes do të thotë mund të fillojë modalitetet e diskutimit të saj në momentin kur ky rast e merr epilogun final të tij.

Unë e di që është një grup, i cili ka kaluar nëpër një pjesë të sistemit të drejtësisë së Maqedonisë së Veriut që është konsideruar që ka qenë diskriminues. Ne e presim epilogun përfundimtar të këtij rasti dhe pastaj mund t'i vendosim, ashtu siç i kam thënë edhe zonjës Deskoska, t'i vendosim kontaktet me Maqedoninë e Veriut për të shikuar modalitetet e mundësisë së vuajtjes së dënimit këtu.

KRYETARJA: Faleminderit! Deputeti Arbër Tolaj ka pyetje për ministrin Besian Mustafa, nuk është këtu.

Deputeti Ali Berisha ka pyetje për ministrin Arban Abrashi, ministri Abrashi nuk është këtu. Fjalën e ka Ali Berisha.

ALI BERISHA: Faleminderit, kryetare!

Meqenëse ministri nuk është këtu, prapëseprapë pyetja ime ka të bëjë me rrugën Pejë-Prishtinë dhe tani në atë rrugë, në segmentin Kijevë-Zahaq punimet kanë stagnuar totalisht dhe është jashtëzakonisht i vështirë qarkullimi, ku frekuentojnë mbi 500 mijë banorë. Do ta rezervoj të drejtën që pyetjen ta adresoj në kohën kur ministri është këtu.

KRYETARJA: Faleminderit! Sërish deputeti Ali Berisha, pyetje për ministren Vlora Dumoshi. A e dëshironi fjalën?

ALI BERISHA: Edhe ministrja Dumoshi nuk është këtu sot. Pyetja ka të bëjë me stadiumin e qytetit të Pejës, do ta adresoj këtë pyetje në momentin kur ministrja do të jetë prezente.

KRYETARJA: Faleminderit! Deputetja Besa Ismaili, pyetje për ministrin Ramë Likaj, deputetja nuk është këtu.

Bekim Haxhiu ka pyetje për kryeministrin Hoti. Urdhëroni, nëse dëshironi fjalën, kryeministri nuk është këtu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryetare!

Për shkak të aktualitetit, po e lexoj pyetje. Për shkak që pas pyetjes që kam bërë, kanë filluar edhe disa lëvizje nga ana e kryeministrit.

Pra, me Ligjin numër 06/L-059 për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz, përcaktohet statusi i Kompleksit Memorial Adem Jashari në Prekaz dhe obligimet e institucioneve të Kosovës për planifikim, ndërtim, mbrojtje, konservim, restaurim e administrim.

Duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e veçantë të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kontributin e komandantit legjendar Adem Jashari dhe të familjes së tij për lirinë e pavarësinë e Kosovës, Kuvendi i Kosovës me ligj e ka shpallur Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz, Komuna e Skenderajt, zonë e veçantë me interes shtetëror dhe kombëtar.

Përkundër kësaj, gjendja e shtëpive muze, Kompleksi Memorial Adem Jashari në Prekaz është jo e mirë dhe po rrezikohet të shemben.

Sipas Ligjit numër 06/L-059 për Kompleksin Memorial “Adem Jashari” në Prekaz, restaurimi dhe konservimi duhet të realizohet sipas projektit, i cili përzgjidhet në bazë të shpalljes së hapur publike, për realizimin e projektit me ligj parashihet themelimi i Komitetit ndërministror, të cilin e emëron Qeveria e Kosovës. Në Qeverinë Haradinaj ishte emëruar Komiteti Ndërministror, por mandati kishte skaduar me rënien e Qeverisë Haradinaj.

Komiteti ndërministror për Kompleksin Memorial Adem Jashari në Prekaz do të duhej të emërohej edhe nga Qeveria Kurti, por nuk u emërua. Gjithashtu pas 45 ditë qeverisjes së kryeministrit Hoti, ende nuk është emëruar Komiteti ndërministror për Kompleksin Memorial Adem Jashari. Përveç saj...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Përsëri deputeti Bekim Haxhiu ka pyetje për ministren Vlora Dumoshi. Urdhëro, deputet!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Ngase jemi në prag të miratimit të buxhetit, pyetja ka të bëjë me stadiumin nacional të Kosovës, i cili parashihej të ndërtohet në rrugën magjistrale Prishtinë-Pejë, në lokacionin Korroticë.

Fillimisht për këtë projekt ishin planifikuar 25 milionë euro, më 2019. Porse me projektbuxhetin e vitit 2020 dhe tani me plotësim-ndryshimin e buxhetit të tanishëm, kjo shumë është reduktuar në tre milionë e gjysmë euro. Shtrohet pyetja për Qeverinë dhe për ministren Dumoshi, si munde të realizohet një projekt madhor nacional, çfarë është stadiumi nacional me 30 mijë ulëse, me tre milionë e gjysmë euro, sepse kjo është vlere totale e këtij projekti. Apo dëshirojmë ta lëmë të

figurojë si projekt në buxhetin e shtetit, por që nuk kanë ndërmend të vazhdojnë tutje, edhe pse janë shpenzuar deri më tani për studim fizibiliteti dhe për projektin detal afro një milionë e gjysmë euro. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputeti Gazmend Bytyçi, pyetje për ministren Hykmete Bajrami, a është deputeti këtu? Urdhëro, deputet, në qoftë se dëshironi ta lexosh, ose në seancën e radhës, meqenëse nuk është këtu ministrja.

GAZMEND BYTYÇI: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë,

Unë kam dy pyetje, nëse do të bënte kryetare që t'i lexoj të dyja, a lejohet kjo apo për shkak të kursimit të kohës.

KRYETARJA: Po, po, mund t'i lexoni të dyja, edhe ashtu nuk janë këtu asnjëri nga ministrat për të cilët keni pyetje ju.

Unë në fakt kam dy pyetje të ndryshme që përfaqësojnë dy interesa të grupeve të ndryshme të qytetarëve tanë.

Pyetja e parë ka të bëjë ministrit të Transportit, zotit Abrashit, siç dihet, për shkak të pandemisë stacionet e autobusëve janë mbyllur ndër të parët me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kjo mbyllje për shkak të ruajtjes së shëndetit ka prekur ndjeshëm sektorin e transportit publik. Stacionet e autobusëve varen nga të hyrat vetjake, si pagesa e kanalizimeve, qiratë dhe rrjedhimisht ato për këto muaj kanë qenë fare pa të hyra dhe pa paga mujore për punëtorët e tyre. Janë rreth 15 ndërmarrje publike lokale të stacionit të autobusëve nëpër tërë Republikën e Kosovës, më afër 500 të punësuar dhe përveç stacionit të Prishtinës që është duke u subvencionuar nga Komuna e Prishtinës, të gjitha stacionet e tjera punëtorët e tyre kanë mbetur pa paga për tre muaj dhe tani janë në muajin e katërt.

Po kështu pa të hyra kanë mbetur edhe me qindra kompani të transportit publik të udhëtarëve dhe mijëra punëtorë të sektorit apo të këtij sektori.

Pyetja ime është: Çka ka bërë Qeveria që t'i dalë në ndihmë këtij sektori shumë të rëndësishëm? Dhe, ajo që është kryesorja, ku ka mbetur çështja e subvencionimit të kompanive publike, në këtë rast, të ndërmarrjeve publike të stacionit të autobusëve?

Pyetja tjetër i drejtohet ministres së Financave...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: E vazhdon, të lutem!

GAZMEND BYTYÇI: Faleminderit!

Pyetja e dytë ka të bëjë me çështjen e pagesës së shpronësimit të banorëve të Hanit të Elezit për shkak të ndërtimit të autostradës “Arbër Xhaferi”. Banorët e Hanit të Elezit, të cilëve u janë marrë pronat dhe shtëpitë e tyre, e që janë 10 familje, ata tani janë duke u detyruar të paguajnë edhe qira dhe, për shkak të situatës së rënduar ekonomike, ata që 16 muaj janë në pritje të pagesave që u takojnë. Deri më tani nuk kanë marrë asnjë përgjigje nga këto ministrinë përkatëse.

Pyetja ime, duke kërkuar informacion për këtë çështje është që t’u japim banorëve apo Qeveria e Republikës së Kosovës t’i ndajë mjetet që u takojnë këtyre banorëve dhe t’u dalim në ndihmë dhe të kryhen pagesat që u takojnë. Nëse nuk do të kemi përgjigje nga këto ministri, atëherë unë detyrohem të bëjmë këto pyetje edhe një herë me shkrim. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Ju njoftoj se në bazë të nenit 45, paragrafi 11 i Rregullores së Kuvendit, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Po vazhdojmë me pikën e radhës:

3. Debat parlamentar për situatën financiare të Telekomit të Kosovës, pas lejimit të përmbarimit të vendimit përfundimtar OEN nr. 20990/MHM, të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Paris

Nënkryetarja e Kuvendit, zonja Arbërie Nagavci, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me situatën financiare të Telekomit të Kosovës pas lejimit të vendimit përfundimtar të Arbitrazhit.

E ftoj atëherë nënkryetaren që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Para 10 ditësh u njoftuam se Gjykata Themelore e Prishtinës ka nxjerrë aktvendimin, me të cilin ka lejuar ekzekutimin e vendimit përfundimtar të Arbitrazhit, sipas të cilit Telekomit të Kosovës do t’i bllokoheshin xhirollogaritë për të inkasuar për Dardafonin një vlerë prej 25 milionë eurosh.

Si një çështje tejet e rëndësishme për vendimmarrjen dhe për ndërmarrjen publike, për sigurinë shtetërore, punëtorët dhe për shërbimet e telekomunikimit ne kemi kërkuar që kjo çështje të trajtohet me urgjencë nga Kuvendi i Kosovës në seancën e kaluar, gjegjësisht më 13 korrik.

Fatkeqësisht kërkesa jonë nuk mori mbështetjen e duhur nga të gjitha partitë parlamentare këtu dhe pushtetit të PDK-së nuk i ngutej as për të diskutuar për këtë temë, e në ndërkohë shumë vendime ndodhën në drejtim të falimentimit të Telekomit të Kosovës.

Shpejt iu bllokuan xhirollogaritë Telekomit, edhe më shpejt u zbrazën ato.

Kështu që sot ne do të diskutojmë këtu për Telekomin e Kosovës, të cilit tashmë xhirollogaritë i kanë rënë në zero euro dhe gjendet në prag të falimentimi, e krejt kjo po ndodh për shkak të ndikimit politiko partiak që për 10 vjet pa ndërprerë partitë që kanë qenë në pushtet e kanë keqpërdorur në të gjitha format një ndër asetet më të rëndësishme të Kosovës, siç është Telekomit i Kosovës.

Shfrytëzimin e Telekomit e pati filluar Monako Telekom, duke përdorur administrimin ndërkombëtar. Telekomit në atë kohë PTK i imponua partneri i Monakos, Telekom Monako dhe teknologjia franceze Alkatel.

Por, fillimi i shkatërrimit të vërtetë të Telekomit, shkatërrimit të përshpejtuar ka filluar nga viti 2009, në këtë kohë Bordi i atëhershëm i Telekomit të Kosovës, përkundër vërejtjeve me shkrim nga grupi i financierëve, juristëve dhe inxhinierëve të njohur e të mirëpërgatitur profesionalisht të Telekomit, e autorizoi menaxhmentin e asaj kohe që të lidhte këtë kontratë të dëmshme me Z-Mobile.

Duke mos u nisur nga asnjë argument racional e afarist, por vetëm nga shtytjet e interferencat kriminale përfituese, Telekomit i kishte filluar negociatat në atë kohë për një operator virtual me kompaninë Dardafon.

Në segmentin kohor në mes të vendimit përfundimtar të Arbitazhit dhe njohjes së ligjshmërisë së vendimit në Kosovë, aksionarët në këtë korporatë do të jetë edhe shoqëria njëpronarëshe Devolli GMBH me seli në Vjenë të Austrisë.

Kalimin e licencës nga një etnitet te tjetri si me shkop magjik në atë kohë e bëri Bordi i ART-së apo Arketi i mëparshëm, pa asnjë bazë dhe vetëm pak kohë pas kësaj në krye të këtij institucioni me emërimin e ri ARKET do të vendoset vetë personi, i cili e plotësoi dhe e procedoi aplikimin për regjistrim të Dardafon.net në regjistrin tregtar ARBK.

Kjo kontratë, në fakt, shërbeu si një autostradë, e cila brenda 10 vjetëve e solli Telekomin nga një ndërmarrje profitabile buzë falimentimit.

Në këtë kontratë ishin paraparë elementet, të cilat Telekomin e kanë bërë fabrikë të prodhimit të shërbimeve, derisa Z-Mobile shitës të këtyre prodhimeve dhe atë me kushtin që mbi 70% e fitimit të derdhet në kompaninë Dardafon.net.

Kjo kontratë e nënshkruar në vitin 2009 ka qenë fatale për funksionimin e Telekomit të Kosovës, për shkak edhe të vështirësive të përmbushjes së saj. Kjo edhe, sepse ka paraparë që Telekomit duhet të japë për Z-Mobile numra, minuta e gigabajt në një mënyrë të pakufizuar dhe në sasi të pakufizuar, kurse Z-Mobile i ka dhënë vetëm 27% të shitjeve dhe atë të shitjeve joreale, por ashtu si ata vetë i kanë deklaruar.

Për numra Telekom nuk ka marrë asnjë qindarkë nga Dardafon.net me arsyetimin se një gjë të tillë nuk e parashihte kontrata.

Në fakt, këtë kontratë Z-Mobile e kishte shkruar vetë dhe e vetmja pjesë nga Telekomit ishte nënshkrimi i parakontratës dhe nënshkrimi i kontratës finale.

Në të njëjtën kohë Telekomit ishte i detyruar që për çdo numër t'i paguajë nga 50 centë për Monako Telekomin, sepse përdorej numeracioni i Monakos, ndërsa në të vërtetë ajo kishte shërbyer për Z-Mobile.

Telekomit i përcaktonte çmimet mbështetur në koston e prodhimit, kurse Z-Mobile vepronte sipas maksimës “Blej pa pare e shit me pare”, ose më mirë “Merr pa pare e shit me pare” për përfitimet e veta. Kjo dhe shumë avantazhe të tjera që janë dhënë Z-Mobile me këtë kontratë kanë bërë që Telekomit të pësojë dëmin real dhe material mbi 263 milionë euro, ndërsa Z-Mobile të ketë mbi 80 milionë euro të hyra.

Si për të mos mjaftuar ky fitim pa asnjë shpenzim, me arsyetimin e mosdhënies së pakufizuar të numrave për Z-Mobile, kjo e fundit e ka dërguar Telekomin në Arbitrazh Ndërkombëtar, i cili filloi nga vendimi i famshëm numër 381 i ARKEPIT, në krye të të cilit tashmë qëndronte personi që i ka plotësuar praktikat për regjistrimin e Dardafon.net.ls në regjistrin tregtar.

Deri te marrja e vendimit të Arbitrazhit ka ndodhur edhe marrëveshja kriminale në mes të menaxhmenteve të Telekomit dhe Z-Mobile dhe kjo ka bërë që dëmshpërblimi i dëmshëm për Telekomin t'i shkojë Z-Mobile.

Këtë e arritën duke e marrë vendimin, i cili pastaj në mes të pandemisë u bë i njohur nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe krejt kjo ka bërë që kjo autostradë e krimit të përfundojë me

bllokimin dhe pastaj edhe me tërheqjen e parave aq para sa kanë qenë në bankat vendore në xhirollogarinë e Telekomit.

Si rrjedhojë e kësaj, aktualisht do të mbeten pa paga rreth 2 mijë e 300 punëtorë që janë të Telekomit, mbi 800 kreditorë humbën të ardhurat e vetme që kanë pasur nga Telekomit dhe këtu rrezikohen edhe pagat gati të një mijë punëtorëve të Postës së Kosovës, afarizmi i së cilës lidhet ngushtë me Telekomin.

Për më tepër dhe ajo që është jashtëzakonisht shqetësuese, vihet në rrezik serioz edhe siguria shtetërore e Kosovës, duke e ditur se të gjitha institucionet dhe organet e sigurisë së Kosovës i shfrytëzojnë shërbimet e Telekomit.

Për të mos përfunduar me kaq, falimentimi i Telekomit do të dërgojë shumë shpejt në falimentim edhe të Postës, ku dihet se mbi 60 për qind e të hyrave të kësaj ndërmarrje publike derivojnë nga Telekomit.

Njëkohësisht me këtë proces zhvatja, gllabërimi dhe plaçkitja e Telekomit ka ndodhur si nga brenda, me ndërhyrje direkte të eksponentëve të partive politike, kryesisht PDK-së, LDK-së, AAK-së dhe Nismës dhe nga këto parti kanë rrjedhë edhe menaxhmentet dhe bordet e Telekomit, këto kanë kontrolluar gjithçka në Telekom. Kanë kontrolluar dhe janë kontrolluar me qëllim që keqpërdorimet dhe shitja të vendoset në disa nivele. Ato nivele kanë bashkëpunuar pastaj ndërmjet vete, me qëllim që keqpërdorimet të jenë të harmonizuara dhe këtë harmonizim e kanë udhëhequr eksponentë të partive politike në Kosovë, përfshirë edhe vetë presidentin.

Pastaj kjo mbikëqyrje është paguar prej Telekomit dhe kështu ka funksionuar krimi i organizuar pluralist partiak.

Grupe të caktuara brenda këtyre partive politike kanë vepruar nën maksimën që korrupsioni dhe krimi i organizuar le të ecë, ndërsa drejtësia ashtu sikurse po e shohim, le të ngeçë.

Por, duhet të jemi të bindur që ecja e korrupsionit dhe krimi i organizuar është i përkohshëm, përderisa drejtësia është e përhershme dhe një ditë ajo do të thotë fjalën e vet. Ndaj drejtësia duhet të identifikohet me organet e tërësishme të shtetit, e keqpërdoruesit që krekosen se po punojnë për shtetin, e në fakt këtë shtet po e rrezikojnë duke mos punuar asnjëherë për të, e qe besa as për Telekomin, por duke keqpërdorur nënsiglat e partive.

Këto iniciativa dhe këta individë që derivojnë nga kjo treshe e partive PDK, LDK, AAK, që në vazhdimësi kanë ndërhyrë në Telekom, e kanë vënë në rrezik tashmë sigurinë kombëtare, kanë cenuar rendin publik dhe janë sjellë në kundërshtim me moralin e shoqërisë.

Por, treni i korrupsionit dhe krimit të organizuar, në të cilën e keni futur Telekomin, do të dalë nga hekurudhat bashkë me ju. Keqpërdoruesit e të korrumpuarit do të përmblyten nga djersa e punëtorëve dhe nga e drejta pozitive në një të ardhme jo të largët. Nuk mund e nuk duhet të lejojmë që Telekomin ta merrni me vete.

Prandaj, do të bëjmë të pamundurën që Telekomit të mbetet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Edhe tekstin e rezolutës deputetja e lexon, ju lutem vazhdoja fjalën.

ARBËRIE NAGAVCI: Atëherë për të marrë fund e gjithë kjo, ne edhe në mbrojtje të Telekomit e kemi përgatitur një projekt-rezolutë, të cilën e kemi dorëzuar dhe në administratë dhe jua kemi ndarë tashmë besoj deputetëve.

Kuvendi i Kosovës në seancë plenare konstaton se kontrata Telekom Dardafon e vitit 2009 ka të evidentuara nga hetimi parlamentar i zhvilluar nga Kuvendi i Kosovës në Legjislaturën VI elemente të mjaftueshme për të hetuar penalisht dhe për të kërkuar dëmshpërblim financiar ndaj palëve që me veprimet e tyre kanë dëmtuar Telekomin e Kosovës si dhe parimet kushtetuese, rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralin në shoqëri.

Po ashtu ka evidencë të mjaftueshme për të konkluduar që në procesin e Arbitrazhit ndërkombëtar të përfunduar në vitin 2016 interesat e aksionarit, pra, Qeveria e Kosovës dhe Korporatës Telekomit i Kosovës, shoqëri aksionare, nuk janë mbrojtur në proces.

Si pasojë Bordi i krijuar nga ky proces duhet të mos pranohet. Një proces i ri gjyqësor, ku sigurohet mbrojtje e plotë e palës së dëmtuar, pra Telekomit të Kosovës, duhet të ndodhë.

Bazuar në legjislacionin në fuqi, ne propozojmë këto pika:

1. Qeveria të zbatojë në përpikëri Vendimin numër 02/39 të 3 qershorit 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi masat për parandalimin e keqpërdorimeve në ndërmarrjet publike. Qeveria të mbikëqyrë vazhdimin, zbatimin dhe përshtatshmërinë e masave, si dhe të shqyrtojë mundësinë e plotësimit të tyre.

2. Aksionari, ndërmarrjet dhe organet kompetente shtetërore të kërkojnë vërtetimin e nulitetit të marrëveshjeve, që cenojnë rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralin e shoqërisë. Nuliteti të kërkohet edhe në procedura civile, pa marrë parasysh epilogun e rasteve penale.

3. Të nisen procedurat për ndryshimin e Ligjit 04/L-220 për Investime të Huaja për të tërhequr

pajtimin e pakufizuar të Republikës së Kosovës për arbitrazh ndërkombëtar me cilëndo palë që pretendon se është investitor i huaj dhe që nuk i ka të deklaruar aksionarët e vërtetë.

4. Qeveria të ndërmarrë masa konkrete për të mbrojtur Telekomin nga kreditorët e pandërgjegjshëm, me qëllim të stabilitetit financiar të Telekomit dhe të punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje.

5. Qeveria brenda 60 ditëve të hartojë një plan strategjik për rimëkëmbjen financiare të Telekomit dhe gjithashtu Qeveria brenda këtij plani 60-ditor të ketë prioritet rritjen e kapitalit me qëllim të rritjes së vlerës së ndërmarrjes.

6. Aksionari nëpërmjet të zgjedhurve në Bordin e drejtorëve të shqyrtojë të gjitha kontratat komerciale që janë lidhur paraprakisht, në kundërshtim me masat e përcaktuara në Vendimin numër 02/39.

Ju ftoj që ta mbështetni këtë rezolutë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Atëherë, vazhdojmë me përfaqësuesit ose udhëheqësit e grupeve parlamentare, në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, fjalën e ka deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, kryetare!

Siç tha edhe nënkryetarja, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e ka shtruar këtë çështje në Kuvend më 13 korrik, siç është urgjente, por deputetët e pushtetit atë ditë nuk pranuan ta fusin në rend të ditës.

Sot kur po flasim që nga ajo ditë janë bërë shumë zhvillime, por mbi të gjitha llogaritë e Telekomit janë bllokuar dhe si pasojë Telekomit është në kolaps financiar dhe kontot e Telekomit tash janë zbrazur deri në centin e fundit, madje Telekomit ia morën edhe tremilionëshin e Pakos emergjente. Pra, kjo është gjendja aktuale në Telekom.

Që në gjenezën e saj vetë kontrata e Telekomit me Z-Mobile ka qenë e kurdisur të rezultojë me dështimin e Telekomit në favor të Dardafon.

Madje, procesi, duke u përfshirë edhe kontratën e pafavorshme për Telekomin, ka qenë i dizajnuar për ta pasur këtë përfundim që ka sot, gjuhëzimin e Telekomit para Dardafon, deri në falimentim apo edhe gllabërim.

Çdo veprim që është bërë dhe po bëhet mbi Telekomin është i orkestruar dhe i toleruar në bashkëpunim me drejtuesit politikë që gjenden në Qeverinë e Kosovës dhe partnerët e tyre politikë.

E ky proces që nuk hezitohet nga qeveritarë e ish-qeveritarët e të quhet si proces shumëvjeçar i falimentimit të Telekomit i ka përgjegjësit e vet.

Është dikush që e ka ideuar, dikush që e ka kurdisur, dikush që e ka nënshkruar këtë kontratë, dikush që e ka realizuar, dikush që e ka mbrojtur e deri te dikush që është kujdesur për implementimin e këtij plani nga pika e parë te pika e fundit.

E krejt këta dikushat duhet të japin përgjegjësi për nënshkrimin e tyre. Por, edhe përgjigje në një proces të veçantë hetimor që do të duhej dhe do të ndodhë një ditë nga prokuroria. Por, deri më tani heshtja e prokurorisë dhe Qeverisë është e patolerueshme. Dëmet e kësaj kontrate nuk janë vetëm milionat që po i grabiten Telekomit, dëmet janë të shumëfishta, por ashtu edhe rreziqet.

Kjo kontratë nuk e falimenton vetëm Telekomin, por prek edhe mijëra familje të të punësuarve.

Bizneset që janë furnitorë të Telekomit e dëmtojnë Postën e Kosovës që Telekomi e ka partner kryesor afarist, dëmton rëndë ekonominë, po rrezikon edhe sigurinë kombëtare shtetërore.

Telekomi i Kosovës është thjesht i sigurisë shtetërore, e sigurisë së 2350 punëtorëve të Republikës së Kosovës dhe gjithë sektorit të komunikimeve elektronike e shumë ndërmarrjeve të tjera publike e private të lidhur me Telekomin.

Krejt ky proces ka ndodhur për përfitime milionëshe. Por, kush ka përfituar dhe kush përfiton më së shumti nga kjo kontratë? Nuk përfiton vetëm Dardafoni, madje po të ishte se përfiton vetëm Dardafon, kjo kontratë edhe nuk do të nënshkruhej asnjëherë. Por, pikërisht që nuk përfiton vetëm kjo palë, është bërë kjo kontratë, është bërë që të përfitojnë edhe individë, politikanë dhe grupe të tjera politike.

Pra, jo të gjithë milionat kanë shkuar aty ku thonë letrat. Madje, as aty ku thotë Arbitrazhi, ku ta dijë se ku janë ata miliona tash, ndoshta në Qipro apo në ndonjë kantier ndërtimi në Perëndim, në ndonjë vilë në Stamboll apo në Monako. Madje as këta 25 milionët nuk do t'i marrë vetëm Dardafon.

Prandaj, Lëvizja Vetëvendosje as që ka hezituar e as që ka pasur frikë të thotë se kjo është një grabitje.

Prokuroria nuk mund t'i gjejë milionët e grabitur vetëm në kontot e Dardafonit, ato duhet t'i kërkojë edhe në konto të tjera.

Qeveria e Kosovës është aksionar në Telekom, ky institucion duhet të ndërhyjë menjëherë në shpëtimin e kësaj kompanie aksionare e së cilës është nëse ndërkohë nuk është dikush nga e njëjta Qeveri aksionar në palën tjetër.

Lëvizja Vetëvendosje do të vazhdojë të jetë në anën e së drejtës, në anën e Telekomit si kompani publike, në anën e punëtorëve dhe familjeve të tyre, të cilëve po u rrezikohen tash edhe të ardhurat.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje e mbështet rezolutën e paraqitur nga thirrësi i këtij debati dhe i ftoj të gjitha grupet e tjera ta bëjnë të njëjtën gjë.

KRYETARJA: Faleminderit! Kush flet në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputetja Doruntinë Maloku-Kastrati.

DORUNTINË MALOKU-KASTRATI: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Sot po flasim për një ndërmarrje publike, Telekomin e Kosovës, i cili dikur ishte konsideruar si një nga asetet më të mëdha të Republikës së Kosovës, kur flasim sot po ashtu për një ndërmarrje, e cila prej vitesh është shndërruar në gjah të grupeve parapolitike, si dhe atyre të krimit të organizuar.

Përkeqësimi i gjendjes në Telekom ka nisur vite më herët dhe ka kulmuar ditë më parë me bllokimin e llogarive nga ana e përmbaruesit në favor të operatorit virtual Z-Mobile, me ç'rast u rrezikua mirëqenia e mijëra familjeve kosovare dhe siguria nacionale e Kosovës.

Ka qenë e ditur prej ditës së parë që është nënshkruar një kontratë e tillë se kjo do t'ia sillte fundin Telekomit dhe pavarësisht se të gjithë e kanë ditur, askush nuk e ka ndaluar dhe kjo çështje përbën bazë shumë të fortë për t'u hetuar.

Pra, kur sot jemi në situatë që Telekomit rrezikon të falimentojë, ku rreth 2400 familje mund të mbesin pa të ardhura, kur jemi në situatë kur na është rrezikuar seriozisht siguria nacionale, të gjithë pyesim pse organet e ligjit nuk hodhën kurrë dritë mbi këtë çështje?

Bllokimi i xhirologarive dhe bllokimi i një veprimtarie të tillë do të thotë që t'i vësh barriera ekonomisë në zinxhirë, të lësh familje pa rrugëdalje ekonomike, të shkaktosh krizë dhe trazira.

Gjendja në Telekom përgjatë viteve është përkeqësuar për shkak të një morie keqpërdorimesh, keqmenaxhimit, shpërdorimit të parasë publike, vjedhjeve të ashtuquajtura sim to sim, borxheve të akumuluar që sot pa e llogaritur çështjen e Z-Mobile, vlera e përgjithshme e borxheve të Telekomit arrin shumë rreth 58 milionë euro dhe kur ia shtojmë edhe 26 milionët e Devollit, borxhi arrin në 84 milionë euro.

Pagat e larta që kanë përvetësuar drejtuesit e Telekomit dhe anëtarët e bordeve kanë qenë gati dyfish më shumë se paga e presidentit të vendit dhe pesë herë më shumë se ajo e kryeministrit dhe sot ata njerëz qëndrojnë anash dhe nuk bartin asnjë përgjegjësi për katandisjen e Telekomit, as për kontratat e dëmshme dhe dëmin kolateral që po i shkaktohet vendit.

Telekomi sot përballet edhe me rrezikun e rënies së shërbimeve për shkak të mosnënshkrimit të marrëveshjes me NOKIA-n, marrëveshje që ka kohë të gjatë që pret të finalizohet.

Kjo mund të duket në pamje të parë si e parëndësishme, mirëpo duhet të bëhet e ditur se për më gjatë se katër vjet sistemi i rrjetit nuk ka mirëmbajtje dhe për më shumë se 10 vjet nuk ka investime në pjesën e modernizimit. Dhe, rrezikimi i rënies së shërbimeve të Telekomit është baras me rrezikim direkt të sigurisë nacionale të vendit tonë.

Të nderuar deputetë,

Bazuar në ekspertizën financiare dhe sipas opinionit të ekspertëve ligjorë, të brendshëm dhe të jashtëm, Telekom i Kosovës do të mund të ushtronte kundërpadinë për kompensimin e dëmeve, të cilat rrjedhin nga humbjet direkte të Telekomit të Kosovës.

Kompensimin e dëmeve që lidhen me shpenzimet e pagesës së kodit shtetëror të Monakos për numrat e Dardafon.net si dhe për kompensimin e dëmeve për përgjegjësinë e Z-Mobile për aktivitetin sim to sim. Ka qenë e qartë si loti se procedura e Arbitrazhit është e natyrës urgjente dhe kërkon vëmendjen urgjente të ministrisë së linjës dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës në cilësi të aksionares.

Se sa të papërgjegjshëm ishin shumica e atyre që ishin në krye të Telekomit, tregon edhe heqja dorë e anëtarëve të Bordit të përkohshëm nga përgjegjësia për t'u përballur këto ditë me situatën e krijuar së fundmi në Telekom dhe duke i lënë vetëm mijëra punëtorë dhe në mëshirë të fatit.

Si rrjedhojë e kësaj i bëjmë thirrje Qeverisë së Kosovës që në asnjë mënyrë të mos bëjë emërime të përkohshme të anëtarëve të Bordit të Telekomit, por t'i ndjekur procedurat e rregullta për funksionalizimin e tij. Çdo emërim i përkohshëm në këtë fazë do të thotë rëndim dhe zvarritje e gjendjes tashmë katastrofale në këtë ndërmarrje publike.

Qeveria duhet të bëjë çfarëdo që është e nevojshme për t'u kthyer në binarë këtë ndërmarrje, duke e pasur përherë në vëmendje se Telekom i Kosovës ka paraqitur një prej veprimtarive më të rëndësishme të ekonomisë kosovare.

Telekomi është i Kosovës dhe jo i grupeve kriminale. Dhe, Kosovës më shumë se kurrë i duhet fuqi nga ndërmarrjet e veta në këtë periudhë kur ne të gjithë po synojmë rimëkëmbjen nga pandemia.

Qeveria e Republikës së Kosovës në kontinuitet nuk do të duhej të sillnin sot në gjendje si kjo e tanishmja për Telekom i Kosovës. Telekom i takon vendit tonë dhe në asnjë mënyrë nuk do të duhej të rrezikonim fillimisht punëtorët që sot kanë dalë në rrugë për të luftuar për një të drejtë elementare, një të drejtë që ua rrezikon stabilitetin financiar në familjet e tyre. Pra, Telekom është pronë publike e Kosovës. Jashtë rrezikut për të punësuarit, Kosova po rrezikon të humbë me një kompani publike shumë të rëndësishme si rezultat i një qeverisje të keqe dhe të papërgjegjshme korporative, të karakterizuar me grupe të interesit mbi baza partiake dhe me fundament kriminal. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, kush e dëshiron fjalën? Deputeti Ferat Shala!

FERAT SHALA: E nderuar kryetare!

Të nderuar deputetë,

Sot ne mund të bëjmë debat dhe garë politike, por kjo nuk i ndihmon aspak Telekomit e as 2 mijë e 300 punëtorëve që po rrezikohen të humbin vendet e tyre të punës dhe mirëqenien e familjeve të tyre. Ajo që ndihmon sot është që debati të jetë konstruktiv dhe të ketë mesazh të qartë rreth masave dhe planeve për të dalë nga kjo situatë e Telekomit që është mjaft e rënduar.

Para dy ditësh ne patëm në Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike aktorët që sot menaxhojnë me Telekomin, aksionarin dhe qeverinë, ministrinë e linjës dhe menaxhmentin aktual të Telekomit. Derisa ne pritnim si deputetë që të kemi një plan operacional për dalje nga kriza, ne aty pamë vetëm kundërthënie, akuza, kundërakuzë, mospajtushmëri ekstreme mes dy aktorëve kryesorë që duhet ta menaxhojnë situatën aktuale. Fatkeqësisht, pra pamë që situata është ende kaotike, përkundër nevojës imediate që ka sot Telekom për të gjetur rrugë dhe alternativa se si ta sanojmë të kaluarën dhe të tashmen dhe si të planifikojmë të ardhmen e Telekomit. Kjo situatë e mospajtimeve aktuale në menaxhmentin e përkohshëm dhe qeverinë që praktikisht është aksionar, e vështirëson edhe më shumë situatën në Telekom i Kosovës. Por, si duhet të trajtojmë sot problemin e Telekomit? Mendoj që ne duhet ta trajtojmë në tri kohë dhe në tre hapa: koha e shkuar, e djeshme që është mjaft problematike, e përfolur, diskutabile, është problem për ne tipik juridik dhe organet e shtetit, të drejtësisë, është kohë e tyre, moment i tyre, edhe ashtu kemi informacione edhe nga menaxhmenti dhe qeveria që po punohet në këtë punë ta shohim rezultatin e tyre. Pra, e djeshmja

është krejtësisht juridike, ne mund të debatojmë, mund të polemizojmë, mund të shtyhemi sidoqoftë, por ajo është tashmë veç e kaluar juridike dhe shteti dhe drejtësia duhet të funksionojë. Fatbardhësisht, tanimë qeveria i ka të gjithë mekanizmat dhe levat institucionalë juridikë, le të veprojë dhe le të zbatojë ligjin.

Faza e dytë, ose periudha e tashme është problem i aspekteve ekonomike, financiare, teknologjike, por këtu prapë kemi gërshetim edhe të faktorit juridik. Sepse, sot Telekom ballafaqohet me problemin financiar të skajshëm. I dimë kontratat që po përflitet dhe po shkruhet, janë të faktuara, të dokumentuara, të gjitha këto, pra është problem financiar, teknologjik, sepse në mungesë të keqmenaxhimit dhe të situatës së krijuar, tashmë edhe teknologjitë janë të stërvjetruara dhe koha i ka shkelur ato. Pra, kemi edhe problemin teknologjik të Telekomit të Kosovës dhe është problem po ashtu, menaxhues dhe juridik, sepse sot institucionet vendimmarrëse të Qeverisë ende kanë në menaxhim në Telekom institucione ose menaxhues të përkohshëm që praktikisht po merren me problematikat aktuale. Dhe, këtu kemi edhe një shkallë tjetër të rrezikut që sot na paraqitet në Telekom, ka filluar një proces, gjithmonë sipas informacioneve në komision, i ristrukturimit. U tha që ka filluar ristrukturimi nga menaxhmenti i përkohshëm aktual pa pëlqimin e aksionarit, pa asnjë analizë, pa asnjë debat paraprak, pa siguruar plan operacional për ristrukturim, por edhe pa siguruar mjete financiare, kur e dimë që strukturimi edhe si proces, edhe si metodë kërkon edhe kosto, koordinim edhe transparencë.

Pra, shkalla e rrezikut në këtë situatën e tashme në Telekom është po ashtu e njëjtë, sepse praktikisht nuk kemi ende qartësi të hapave menaxhues operacionalë, por nuk kemi ende zgjidhje të problemeve teknologjike e as atyre financiare. Dhe, rreziku ekziston që të bëhen gabime edhe juridike, sepse nëse aksionari nuk ka dijeni për fillimin e procesit të ristrukturimit, atëherë këtu kemi një diçka që është goxha pikëpyetje e madhe në kuptimin juridik, si do të mund të mbulohet në të ardhmen një proces i tillë apo pasojat qoftë pozitive, qoftë negative që procesi i ristrukturimit të ndërmarrjeve publike mund të sjellë në këtë fazë, e veçanërisht te Telekomit që ka mbi 2 mijë e 300 punëtorë, e procesi i ristrukturimit në kushte normale edhe shkencore nuk kalon pa mbetje të tepricës teknologjike, nuk kalon pa pasur probleme të mëdha sociale, nuk kalon pa probleme sindikale, e kështu me radhë, për të cilat shumë pak po përfillen në këtë kohë dhe në këtë moment në situatën e tashme të Telekomit. Pra, parimisht do të duhej që fokusi i qeverisë, i aksionarit të jetë shumë më i madh në këtë moment se çka po ndodh sot, cilat janë hapat që po ndërmarrin, a kemi ndonjë afat, ndonjë plan, veprim të koordinuar për të nxjerrë Telekomin nga kjo apo vetëm po bëjmë përsëritje të gabimeve, qoftë edhe të kaluarës, nëse veç po pretendohet që janë bërë.

Dhe, faza e tretë apo periudha e ardhshme është çka sot po e shohim që ende nuk kemi zgjidhje, por çka nesër? E kemi obligim edhe si qeveri, por edhe si përfaqësues të popullit ta dimë dhe ta shkruajmë, ta trasojmë një trase të rrugëtimit të ardhshëm të Telekomit. Unë nuk dua dhe as nuk

besojmë që ne duhet të pranojmë në situata të tilla falimentimin. Pra, urgjentisht Qeveria duhet ta shpëtojë, ka mekanizma, ka leva, ka gjithë mekanizmin institucional dhe financiar në dorë dhe mbi bazën e argumenteve shkencore, profesionale duhet ta shpëtojë Telekomin dhe ta trasojë rrugën çka nesër, në cilat forma, çfarë forme të zhvillimit do të ketë Telekomit, çfarë tip teknologjie, cila do të jetë faza e ristrukturimit të mirëfilltë transparent mbi bazën e një debati, mbi bazën e një analize, mbi bazën e një studimi të mirëfilltë, mbi bazën e transparencës dhe bashkëpunimit edhe sindikal, ta trasojmë rrugën dhe ta zgjidhim problemin e ardhshëm të Telekomit. Mendoj që këtu të gjitha praktikatat menaxhuese ndërkombëtare janë të hapura se si duhet ta orientojmë ne sot dhe ta menaxhojmë sot një ndërmarrje. Besoj që Qeveria duhet të mos jetë pasive, të mos jetë inerte, duhet të ketë qëndrim të prerë edhe për të djeshmen, edhe për të sotmen, edhe për të nesërmen e Telekomit.

Prandaj, këtu presim edhe e ka obligim Qeveria si aksionar, presim që shpejt të na sjellë planin detal çka sot e çka nesër, ta shohim çfarë po na sjell, si po mendon ta nxjerrë nga kjo situatë, cilët janë hapat që ka marrë, edhe juridikë, ekonomikë, financiarë, por edhe socialë, ndryshe nuk mund të vazhdojmë me debate dhe me shtyrje poshtë e lart, e institucionet më të larta të shtetit si aksionarë të kenë kohë për të vjedhur faktikisht në këtë rast para punëtorëve, para sindikatave, para të gjithë mekanizmave të tjerë socialë dhe ekonomikë të vendit. Pra, shteti dhe Qeveria i ka të gjitha mundësitë për të vepruar, i ka të gjitha levat e shtetit, veproni, sepse është përgjegjësi juridike, edhe kushtetuese, sepse edhe e keni pushtetin, edhe e keni kërkuar dhe sot nuk mund të ankoheni për asgjë, të gjitha në dorë i keni, zgjidhni nëse një qeveri nuk ka kapacitete intelektuale, nëse një qeveri nuk ka kapacitete shkencore, profesionale, buxhetore të zgjidhë problemin e një ndërmarrjeje, me gjithë problemet që i ka trashëguar, atëherë duhet të tregojë çka më tutje. Na presin sfida shumë më të mëdha edhe përveç Telekomit. Kërkoj që ne të diskutojmë shumë shpejt për hapat operacionale të qeverisë se si sot besoj dhe kërkoj që ne ta mbyllim debatin konstruktiv dhe unifikues, por ne duhet ta kemi një debat të shpejtë që i jep zgjidhje dhe kahe Telekomit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, deputeti Pal Lekaj e ka fjalën.

PAL LEKAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Për vite të tëra Telekomit i Kosovës ka qenë njëra nga ndërmarrjet publike më të suksesshme në Kosovë. Telekomit i Kosovës që nga themelimi e deri më sot i ka ndarë dividendë Republikës së Kosovës rreth 480 milionë euro, domethënë deri në vitin 2015. Në Telekomin e Kosovës janë rreth 2 mijë e 218 të punësuar, të cilët ndër vite kanë ofruar kapacitetet e tyre njerëzore e intelektuale që kjo kompani t'iu ofrojë shtetit të Kosovës këtë dividendë përgjatë këtyre viteve.

Nga ndërmarrja më e suksesshme e shtetit të Kosovës për vite të tëra, Telekomit i Kosovës sot përballlet me krizë të jashtëzakonshme financiare. Në krijimin e kësaj krize të thellë financiare brenda Telekomit të Kosovës kanë ndikuar shumë faktorë e arsye, të cilat ndër vite i kemi cekur pareshtur e madje edhe e kemi krijuar Komisionin Hetimor Parlamentar në lidhje me Telekomin e Kosovës. Në vitin e fundit për shkak të disa marrëveshjeve paraprake funksionimi i Telekomit të Kosovës është determinuar jashtëzakonisht shumë nga veprimet paraprake ndër vite të menaxhmenteve të ndryshme. Këto veprime kanë limituar mundësinë për manovrimet financiare për të siguruar investime të mjaftueshme në produkte dhe shërbime të reja, në menaxhimin efikas të resurseve fizike dhe humane, si dhe problemet legale që kanë shkaktuar dëme financiare, vitale, për zhvillimin e Telekomit. Kontratat me operatorët e tjerë ekonomikë, si ajo me Dardafonin dhe vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit në dëm të Telekomit të Kosovës ka dobësuar kapacitetet funksionale të Telekomit dhe ka vënë një barrë të madhe buxhetore për t'i paguar detyrimet ndaj këtij veprimi apo këtij operatori.

Unë mendoj që të gjitha institucionet vartëse, Telekomit, Qeveria, Ministria përkatëse, Kuvendi, ARKEP-i, dhe institucionet e tjera sa më parë duhet të krijojnë një strategji dalëse dhe kjo gjendje në mënyrë që Telekomit i Kosovës asesi të mos falimentojë. Kjo strategji duhet të përmbajë të gjitha hapat e nevojshme që duhet ndërmarrë në mënyrë që Telekomit të shpëtojë e të fillojë t'i sjellë sërish vendit devident. Ndër masat e propozuara mund të jenë: 1. Investimet emergjente të domosdoshme, 2. Sigurimi i financimit përmes kredisë në vlerë prej 30 milionë euro, 3. Zgjerimi i infrastrukturës së rrjetit me kapacitete përcjellëse, konform kërkesave të përdoruesve, 4. Zgjerimi i infrastrukturës së rrjetit në aspektin e mbulueshmërisë së tregut, inkasimi urgjent i borxheve ndaj Telekomit të Kosovës, ulja e shpenzimeve operative, ristrukturimi i menaxhimit të objekteve, për të cilat Telekomit paguan qira, nga pagesat më të mëdha për qira mbizotëron qiraja ndaj Postës së Kosovës, Telekomit paguan rreth 400 mijë euro në muaj për shfrytëzimin e rreth 34 mijë metrave katrorë. Pra, rreth 11,6 euro për metër katror.

Nga kërkesa kryesore është kthimi në shfrytëzimin ose në pronësi Telekomit objektin kryesor në Prishtinë. Implementimi i marrëveshjes në mes të Telekomit dhe Ministrisë së Administratës Publike, pavarësisht kontratës që Telekomit ka me MAP-in që u mundëson institucioneve që të marrin shërbimet e telekomunikimit, një numër i konsiderueshëm i institucioneve publike ende përdorin shërbime të kompanive të tjera private.

Sipas hulumtimeve, analizave konkludohet se nëse institucionet e Republikës së Kosovës do të shfrytëzonin shërbime të Telekomit, Telekomit do të kishte të hyra direkte vjetore mbi 5 milionë euro, pa llogaritur të hyrat indirekte, me të cilat vlera do të arrinte mbi 7 milionë euro hyrje vjetore. 5. Implementimi sa më i shpejtë i planit të ristrukturimit. Në takimet e fundit ministri Kuçi me Bordin e Telekomit është treguar për sabotim që janë bërë Telekomit përgjatë gjithë procesit gjyqësor të Arbitrazhit. Këto sabotime e kanë dëmtuar jashtëzakonisht shumë Telekomin, flitet edhe për sabotime nga vetë ana e përfaqësuesve ligjorë që e kanë përfaqësuar

Telekomin në këtë proces. Prokuroria duhet të angazhohet dhe të hetojë qartësisht të gjitha këto kundërthënie, prokuroria duhet t'i hetojë të gjitha vendimet që janë marrë dhe e kanë sjellë Telekomin e Kosovës në këtë situatë të rëndë financiare që është sot. Përgjegjësit duhet të japin përgjegjësi, Telekomu duhet të shpëtojë, Telekomu është aset i rëndësishëm i Republikës së Kosovës, prandaj unë edhe i kërkoj deputetes së nderuar, meqë vëllai i saj pa fajin e deputetes ka qëlluar të jetë ai që ka kërkuar të merret një shumë e madhe e përmbarimit, do të thotë që ta lutësh që në këtë drejtim të ketë mëshirë. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar Lista serbe ose 6+ nuk ka të lajmëruar, po vazhdojmë me deputetët. Deputeti Shpejtim Bulliqi e ka fjalën! Më falni, para se të vazhdoni, nga Qeveria e ka fjalën ministri Blerim Kuçi.

MINISTRI BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryetare!

Të nderuar deputetë,

Edhe të nderuar deputetë, të cilët sot e kanë kërkuar ta ngrenë këtu një debat më se të nevojshëm edhe për të shikuar, edhe për ta ndihmuar ndoshta edhe Qeverinë, edhe për të ndikuar për të dalë prej krizës lidhur me Telekomin.

Po e shoh të udhës t'i jap disa informata, të cilat shpresoj që do t'i ndihmojnë këtij debati në këtë Kuvend për një çështje kaq të ndjeshme. E para, derisa ne jemi këtu ka pasur një protestë të punëtorëve të Telekomit dhe protestuesit kanë pasur edhe një takim me kryeministrin, ende nuk di, nuk kam ndonjë informatë kthyesë, por e di që protesta është ndalur tani për tani dhe protestuesit ose sindikata që ka organizuar këtë protestë ka pasur takim me kryeministrin. Secili prej nesh këtu në sallë në një formë ose tjetër kemi kritikuar punësimet e shumta në Telekom. Dhe, tash kanë 2 mijë e 315 punëtorë që marrin pagë, pa marrë parasysh se si janë punësuar, ne duhet tash t'u dalim zot. U detyrova të nis këtë fjalim me këtë çështje, pasi në këtë kohë pandemie edhe është një merak shtesë ose një merak shumë më i madh për punëtorët edhe për gjendjen e tyre, statusin e tyre në të ardhmen. Kush e ka sjellë këtu, është çështje që do të diskutohet dhe mund të diskutojmë. Gjithçka që tash ka ndodhur me Telekomin, bllokimi i llogarive bankare, e më pas edhe tërheqjen e mjeteve monetare, ka një histori të gjatë, tashmë edhe të njohur.

Që nga fillimi i mandatit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit jam marrë me fokus të veçantë për Telekomin. Mirëpo, çështja e bllokimit të llogarive pas një vendimi të Gjykatës Themelore që rrjedh nga një proces në Tribunalin Ndërkombëtar të Arbitrazhit, na ka nxjerrë në një pozicion tjetër. Ne është dashur edhe kemi tentuar të gjejmë një zgjidhje të shpejtë, veç situata na ka imponuar të veprojmë shpejt. E kuptoj që ka dilema për kontratën bazë me Telekomin dhe Dardafonin, mirëpo sikur ua kam bërë të ditur edhe Bordit të Telekomit që tash është dorëhequr sa për informatën tuaj dhe ka pasuar dorëheqja e Bordit të përkohshëm mbikëqyrës. Ne jemi gjendur përballë një akti të kryer, neve na është dashur të vepronim që

llogaritë të zhblllokohen. Çështja e kontratës bazë e asaj çka është nënshkruar dhe, në fakt, ka përfunduar si kontratë vitin e kaluar, duhet të jetë subjekt i hetimit. Jam në dijeni të Komitetit Hetimor Parlamentar për Telekomin, i krijuar në mars të vitit 2019. Mirëpo, në përfundim të legjislaturës së kaluar edhe ai komision ka marrë fund, ose puna e atij komisioni në njëfarë mënyre është shuar. Tash e kemi rastin edhe ju lus të aktivizoni një komision hetues prapë për të vazhduar punën.

Arsyeja e parë është se i gjithë sistemi qeveritar është bazuar në shërbimet e Telekomit, ku përfshihet edhe pjesa e sigurisë, pra me kolapsin e Telekomit rrezikojmë cenim të sigurisë kombëtare. Arsyeja tjetër është që i gjithë operimi i Telekomit është bllokuar pasi nuk kanë llogari bankare aktive që mund ta përdorin, si rrjedhojë asnjë shpenzim operativ nuk mund të kryhet, përfshirë edhe pagat e punëtorëve. Nga lajmërimi i situatës se llogaritë janë bllokuar, me të gjitha resurset kam filluar punën. Menjëherë kam filluar takimin me secilin aktor që ka qenë i përfshirë në këtë temë. Të parët që kam ftuar për të informuar për gjendjen kanë qenë njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjeve publike. Ata kanë pranuar thirrjen për mbledhje të jashtëzakonshme dhe jemi mbledhur që të shohim se cilat do të ishin veprimet e radhës. Të nesërmen kam takuar bordin, menaxhmetin dhe sindikatën e Telekomit. Të gjithë kanë qenë prezentë, bordi ka treguar për situatën dhe ka thënë që ata nuk kanë tentuar të takohen me Dardafonin para bllokimit të llogarive, edhe pse ata e kanë ditur se do të vijë deri te bllokimi.

Menaxhmenti, në anën tjetër, ka ngritur alarmin se pas bllokimit të llogarive, operimi është i pamundur. Zyrtari ligjor i Telekomit tregoi kronologjinë e gjithë rastit si ndodhi, si organ që duhet të japë zgjidhje. Bordi në atë takim dështoi që të thotë se si duhet të veprohet, sepse është përgjegjësi edhe e bordit, edhe e menaxhmentit. Pa zgjidhje ishte edhe menaxhmenti, në këtë pikë Bordi i Telekomit kërkoi ndihmë nga unë si ministër që të kryej tri veprime: e para, të takohem me kryetarin e Gjykatës së Apelit dhe të sqarojë rëndësinë e lëndës që ka, sepse çështja ka shkuar me ankimim në Gjykatën e Apelit. E dyta, takimi me menaxhmentin e Dardafonit për të gjetur një zgjidhje ose për të kërkuar nga ata t'i zhblllokojnë llogaritë dhe, e treta, normalisht sindikata ka kërkuar mënyrën e sensibilizimit për këtë çështje, sepse ka pasur shqetësimet e veta, siç shqetësohemi edhe ne të gjithë për më shumë se 2 mijë e 300 punëtorë. Jam angazhuar që të kontaktoj direkt kryetarin e Gjykatës së Apelit, edhe menaxhmentin e Dardafonit. Së pari, jam takuar me menaxhmentin e Dardafonit, atyre u kam bërë të qartë se duhet të zhblllokohen llogaritë e telefonit dhe të takohemi për të bërë një zgjidhje, e gjitha kjo pasi mund të ketë shumë pasoja. Menaxhmenti i Dardafonit në atë takim ka konfirmuar se do të diskutojë me instanca të larta të kompanisë për propozim dhe me kaq ka përfunduar takimi.

Te Gjykata e Apelit jam takuar me kryetarin e saj, e gjitha çka kam bërë aty ka qenë një sqarim, sepse duhet të procedohet më shpejt lënda e dorëzuar nga Telekom. Kryetari të Gjykatës ia kam sqaruar rëndësinë e çështjes, asnjëherë nuk kam tentuar të ndikoj në vendimmarrjen e Gjykatës, pra nuk mund të thotë askush që kam ndikuar në Gjykatën e Apelit. Duke e ditur se kryeministri

Avdullah Hoti ishte në Bruksel, takimi me të u bë sapo ka ardhur. Ai e ka thirrur në takim Bordin, menaxhmentin dhe Sindikatën e Telekomit për të gjetur një zgjidhje. Aty edhe u shqyrtuan veprimet e radhës se çka duhet bërë për të dalë nga kjo situatë. Si rezultat i këtij takimi doli që njësia për politika dhe monitorim të ndërmarrjes publike t'i dërgojë letër përmbaruesit Ilir Mulhaxhës për pezullim dhe shtyrje të afatit të përmbarimit. Në këtë letër janë përmendur të gjitha arsyet që ky përmbarim duhet të shtyhet, duke filluar nga rëndësia e shërbimeve të Telekomit, pasi kjo ndërmarrje përveç që u ofron shërbime afro 1 milion qytetarëve, gjithashtu shumë hallka të funksionimit të shtetit janë të lidhura me shërbimet e Telekomit. Atëherë kemi pas edhe një takim me pjesëmarrës të njëjtë sikur në takim te kryeministri, mirëpo pjesëmarrja edhe e përfaqësuesve me Dardafonin, nuk kemi gjetur zgjidhje, sepse edhe Bordi nuk ka dashur të bisedojë, të hyjë në çfarëdo marrëveshje me udhëheqësit e Dardafonit.

Ne bashkë me kryeministrin, sidomos kryeministri ka insistuar që llogaritë të zhblokohen deri më 1 tetor, në këtë periudhë të kemi një marrëveshje mes Telekomit edhe Dardafonit, ku ne do të jemi si garantues të saj. Prapë, këto për shkak edhe të kohës po shoh që ky ka qenë një proces që unë e pashë si ministër t'ju informoj dhe të kontribuoj në debat, mirëpo ajo çka ne, edhe pse kemi kërkuar deri dje prej Telekomit të kemi një strategji dalëse dhe t'i kemi disa rekomandime të tyre, tek dje i kemi marrë, sepse nuk ka qenë në traditën e Telekomit të komunikojë me Qeverinë, e sidomos me njësinë monitoruese që është kompetente për këtë çështje. Ne kemi parë disa mundësi që ju si Kuvend mund t'i debatoni dhe ndoshta mund të na ndihmoni të gjejmë mënyrën ose të na lehtësoni si qeveri të dalim prej kësaj situatë.

Nën një, duhet pasur mundësi për marrëveshje për shtyrjen e detyrimeve.

Nën dy, t'i jepet si subvencion Telekomit për...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Edhe një minutë për ministrin, ju lutem!

MINISTRI BLERIM KUÇI: ...Telekomit për të kryer borxhin, më pas ata që kanë qenë, ata të kenë përgjegjësi kthimin e kredisë. Nën katër, si mundësi është të huazojnë mjete nga Qeveria, të huazohen mjete nga qeveria në llogari të Telekomit, mirëpo mjete të cilat duhet të kthehen në qeveri në një periudhë që caktohet më pas.

Nën pesë, si mundësi t'i jepet kredi afatgjate Telekomit në kuadër të masave të pandemisë që t'ia lehtësojnë këtë çështje dhe t'ia bëjnë të mundshme dhe më të lehtë. Nën gjashtë, të shqyrtohet privatizimi i pjesshëm i Telekomit. Sa i përket vazhdimit të mëtejshëm të funksionimit të Telekomit pas bllokimit të llogarisë, duhet të kemi gjithashtu plan të amortizimit të borxheve,

vlerësimin e riskut, studimin e fizibilitetit dhe për alternativa të mundshme të së ardhmes në Telekom. Dje i kam marrë kërkesat për herë të parë prej Telekomit, disa kërkesa...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Faleminderit! Të nderuar deputetë, në ndërkohë ju ka ardhur një letër, meqenëse origjinali ka ardhur dhe është protokolluar te unë, kurse në e-mail është dërguar pa këtë pjesën në fillim, ju njoftoj që letra është nga menaxhmenti i Telekomit të Kosovës, mund ta shihni në qoftë se dëshironi, por teksti është i njëjtë. Nuk e di pse në e-mail ka ardhur pa këtë pjesën në fillim, mirëpo teksti është i njëjtë, pra është nga menaxhmenti i Telekomit dhe është kërkuar që të informohen të gjithë deputetët lidhur me përmbajtjen.

Në ndërkohë erdhi edhe një herë e protokolluar dhe e nënshkruar, kush do që dëshiron ta shohë, mund ta shpërndajmë tash te deputetët, por është me rëndësi të jeni të informuar për përmbajtjen e kësaj letre.

Atëherë, deputeti Shpejtim Bulliqi e ka fjalën.

SHPEJTIM BULLIQI: E nderuar kryetare e Kuvendit, zonja Osmani!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Pasojat e largimit të Qeverisë kushtetuese e legjitime të udhëhequr nga kryeministri Kurti, për më pak se dy muaj pas kthimit të qeverisë jolegjitime, në Kosovë po ndjehen pothuajse në të gjithë sektorët. U rikthyen emërimet e paligjshme e familjare në diplomaci, u anuluan konkurse për borde drejtorësh të ndërmarrjeve publike me qëllim që të riktheheshin e të rivendoseshin njerëz nga partitë e Plan-it të turpit. U hoq dorë nga reciprociteti si kualitet thelbësor i shteteve sovrane, u hoq dorë nga anëtarësimi në organizata ndërkombëtare, me çka Qeveria jolegjitime shkeli vrazhdë obligimet e saj kushtetuese. Të mos flasim pastaj për rritjen e vdekjeve e infektiveve në këtë pandemi.

Ajo për të cilën sot jemi mbledhur dhe po flasim është shëmbëlltyra më e qartë e të këqijave që e presin vendin tonë nga një qeverisje e shpërdoruesve të së djeshmes, dhe atë vetëm për një muaj e gjysmë kohë. Telekomit iu dha goditja përfundimtare nga fijet e krimit ekonomik në vendin tonë, që pas vdekjes së Presidentit Rugova, kishte filluar që t'i mblidhte të gjitha fijet e korrupsionit ndërpartiak në një qendër të vetme. Ardhja e Isa Mustafës në krye të LDK-së e kurorëzoi përfundimisht këtë koalicion të përhershëm të krimit politik e ekonomik ndërpartiak në Republikën e Kosovës. Kompania Devolli Group sot është qendra që i përbashkon udhëheqjet e LDK-së dhe të PDK-së. Edhe në këtë qeveri ajo kompani është jashtëzakonisht thellë e përfshirë, madje ata vendosin edhe se kush e ku do të bëhet edhe ministër.

Telekomi në vitin 2007-2008 ishte një gjigant ekonomik në tregun e Kosovës. Ajo deri në vitin 2010 mendohet se vlerë deri në 1 miliard euro. I jepte qeverisë fitim mbi dividendën deri në 250 milionë euro dhe dhjetëra miliona euro tatime. Punësonte me mijëra punëtorë në vendin tonë dhe kishte një treg të qëndrueshëm prej 800 mijë deri në 1 milion konsumatorë. Se vjedhja masive ishte për gjoja që i udhëhiqte drejtuesit e qeverisë dhe institucioneve të kohës, u dëshmuua pikërisht në mënyrën se si u projektua plandosja për toke e një pasurie tejet të vlefshme publike në Kosovë. Nënshkrimi i një kontrate të dëmshme në atë kohë, në kushte të paligjshmërisë totale, me operatorin virtual Z-Mobile, e nisi Telekomin në rrugëtimin e falimentimit të qëllimshëm e të planifikuar. Parametrat ekonomikë e biznesorë qartazi flisnin për një kontratë vetëvrasëse në kuptimin e profitit për PTK-në, e cila nuk kërkonte shumë mundim për të konstatuar se këtu bëhet fjalë për një operacion të vjedhjes gjigante. Ajo çfarë ndodhi më pas, ishte vetëm zhvillim më tutje i ndarë në episode i një plani për të vjedhur e plaçkitur atë pasuri të Republikës së Kosovës.

Kosova fatkeqësisht nuk kishte prokurorë e gjyqtarë që do të kishin guximin për ta goditur me mjete penalo-juridike një vjedhje masive, e përmasave të pangjashme në territorin e Evropës. Atyre nuk u mungonte dija dhe ekspertiza për ta provuar një krim të qartë, sepse qartësia nuk lë vend për shumë ekspertizë të sofistikuar, por e dinin se kush ishte i përfshirë në atë operacion. Sot, ata që në vitin 2009 e planifikuan shkatërrimin e PTK-së me nënshkrimin e kontratës kriminale me Dardafone, më vonë me Z-Mobile, janë në fundin e skenarit të tyre të asgjësimit të Telekomit. Ndërkohë, Kosovës do t'i shtohen edhe afro 3 mijë e 500 familje që mund të mbesin pa të ardhura, konsumatorët e këtij operatori pa shërbime, si dhe shumë segmente të sigurisë publike e sigurisë kombëtare që do të rrezikohen nga asgjësimi i Telekomit që u bë ditëve të fundit, falë edhe sistemit të drejtësisë që nuk vepron ndaj të gjithëve njësoj. Ky trimërim i celulave të krimit ekonomik dhe politik në Kosovë po ndodh tani kur Kosova u parandalua me mjetet e shtetit të kapur që të qeverisej në mënyrë demokratike ashtu siç kishte vendosur populli i Kosovës më 6 tetor. Me një qeveri koti, të parët që përfitojnë janë kriminelët, të parët që humbasin janë njerëzit e zakonshëm që mbesin pa të ardhura dhe është shteti ai, i cili duhet të mbulojë këto gropa financiare që krimi i organizuar ia vë përpara buxhetit të shtetit. Faleminderit!

KRYETARJA: Deputeti Haxhi Avdyli e ka fjalën.

HAXHI AVDYLI: E nderuar kryetare!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Një ndërmarrje publike si PTK me fitim deri në 97,7 milionë dhe të silltet në një humbje mbi 51 milionë duhet goxha një angazhim destruktiv dhe një organizim kriminal, sepse këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me një keqmenaxhim. Ky falimentim nuk do të mund të vinte edhe pa angazhimin e njerëzve, apo mosangazhimin, të cilët gjatë kësaj kohe kanë qenë në pushtet.

Vetëm në vitin 2011 kjo ndërmarrje kishte fitim 51 milionë, ndërsa në vitin 2016 ka humbje 50.1 milionë, domethënë 102,6 milionë vetëm për pesë vjet. Po si erdhi deri te kjo? Çdo vit fitimi ka shkuar duke rënë, ndërsa shpenzimet në mënyrë enorme kanë shkuar duke u rritur, pa një arsye, edhe pse afarizmi i kësaj ndërmarrjeje vazhdonte të binte. Edhe pse nuk kishte nevojë, vazhdonin punësimet edhe më të mëdha, kishte sponsorizime të ndryshme të paarsyeshme, siç janë sponsorizime për këngë, këngëtarë, filma, klishe dhe të cilat vazhdonin duke zhvatur buxhetin e kësaj ndërmarrjeje. Qiratë, të cilat do të duhej të zvogëloheshin, përkundrazi, vazhduan të rriteshin. Edhe pse ishte një operator pa konkurrencë, 28,8 milionë euro u shpenzuan në marketing, duke financuar edhe portale të dyshimta, të lidhura shpeshherë me politikën apo edhe portale joekzistente. Për qira u paguan 48,8 milionë euro, për dëme gjyqësore, të cilat i ka pësuar kjo ndërmarrje janë paguar për këto vite deri në 42,7 milionë, por të gjitha këto dëme janë dëme, të cilat kjo ndërmarrje fitimprurëse ka arritur t'i përballojë, por goditjen finale për ta sjellë PTK-në buzë falimentimit përfundimtar, të cilin si dhe është duke ndodhur tani, është kontrata me Z-Mobile, e cila pa asnjë investim në këtë ndërmarrje e mori 22% të fitimit, duke ekzistuar vetëm si një operator virtual, duke marrë 150 mijë abonentë, domethënë pa investim në infrastrukturë, pa investim në rrjet, kjo firmë Z-Mobile, domethënë firmë e Devollëve, ka marrë 150 mijë abonentë, duke shkaktuar humbje të konsiderueshme te kjo ndërmarrje.

Tani, edhe pse kjo kontratë po anulohet, në të njëjtën kohë kjo firmë po vazhdon t'i fitojë edhe në forma të tjera kontestet gjyqësore dhe i vetmi qëllim siç po duket është falimentimi i PTK-së, Valës. Pyetja shtrohet: pse ky angazhim kaq i madh dhe pse po falimentohet kjo ndërmarrje, kur dihet që janë më fitimprurëse në botë dhe është shumë vështirë të falimentojnë. Qëllimi si duket është përvetësimi apo privatizimi në një çmim sa më të ulët apo deri aty sa që t'u falet firmave, të cilat shpeshherë janë të dyshimta për krijimin e kapitalit dhe kush qëndron prapa tyre. Në raportimin, të cilin e ka pasur Bordi i Valës në Komisionin Hetimor për këtë çështje vitin e kaluar, në të cilin kam qenë anëtar, në pyetjen sa mund të vlerësohej vlera e PTK-së, Valës, nëse kjo do të privatizohej tani, përgjigjja ishte "se është diku rreth 24 milionë euro". Domethënë kjo është ajo që na është thënë nga Bordi, në bazë të kësaj letre që e kemi marrë nga Vala, një ndërmarrje e cila ka pasur shitje me vlerë 1 miliard e 765 milionë, një ndërmarrje e cila i ka dorëzuar Qeverisë së Kosovës 285 milionë dividenda, të thuhet se vlera e saj është 24 milionë euro, kjo me të vërtetë po tregon qëllimin përfundimtar të kësaj, domethënë një firmë apo një ndërmarrje milionëshe, ku vetëm vlera sipas ekspertëve të PTK-së e antenave dhe e fibrave optike e kap shumën 1 miliard euro.

Domethënë, një ndërmarrje miliardëshe po falimentohet që të merret falë apo për disa milionë dhe pastaj kjo firmë, kjo ndërmarrje të fillojë të afrojë për qëllimet e firmave private apo grupeve parapolitike që mund të jenë prapa këtyre firmave. Prandaj, shteti, qeveria për hir të mijëra punëtorëve, për hir të ekonomisë sonë, kjo ndërmarrje fitimprurëse që është tepër absurde që po falimenton, sepse nuk ka pasur arsye, të fillojë me një plan konkret për shpëtimin e saj, në

mënyrë që grupet dhe firmat e dyshimta të mos e arrijnë qëllimin e tyre fillestar, falimentimin e kësaj ndërmarrjeje dhe përvetësimin jo të drejtë të këtij aseti, i cili është aset i qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Deputeti Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Për ata të cilët nuk e dinë në mandatin e kaluar kam qenë pjesë e Komisionit Hetimor për Telekomin, si Komision Hetimor kemi bërë një punë gjashtëmujore intensive, por për shkak të rrethanave të cilat janë zhvilluar, ky komision nuk ka arritur që tërë punën e tij voluminoze ta dërgojë në organet e prokurorisë dhe në fund kemi përgatitur një raport dhe do të kërkoja edhe nga Administrata e Kuvendit që raportin, të cilin e kemi përgatitur si komision, ta kenë në dispozicion deputetët se është shumë me interes të dihen faktorët, individët dhe grupet politike, të cilat e kanë sjellë Telekomin në një situatë të tillë.

Pra, po flasim për një numër faktorësh që kanë ndikuar drejtpërdrejt, marrëveshjet e dëmshme biznesore, largimi i profesionistëve të brendshëm, sjellja e menaxherëve nga jashtë pa kurrfarë përvojë menaxhuese në lëmin e telekomunikacionit, emërimi i kryeshefave ekzekutivë dhe anëtarëve të bordit me ndikime politike, dështimi i projekteve të caktuara dhe ndalja e investimeve, humbja në proceset gjyqësore, shpenzimet enorme për marketing, sponsorizim të panevojshëm, reklama të mediave inekzistente, shpenzime të mëdha të panevojshme, udhëtimet luksoze e tjera, kontrata të qirave të dëmshme, e kontrata për konsulentë pa asnjë vlerë, kontrata të antenave e të tjera, e të tjera. Dhe, ndërkohë e merr të mbrapshtën Telekomit, është fillimi i procesit të MVNO-së. MVNO si proces nga ajo që kemi rezultuar, Komisioni Hetimor Parlamentar fillon në vitin 2006, për herë të parë Telekomit shpall ofertën për operatorët në vitin 2007, më 30. 3. Atëherë, ju që keni dëshirë ta adresoni gishtin kah PDK-ja, nuk ka qenë PDK-ja në pushtet as në Telekom. Bile ky proces ka filluar pa pasur as normativë ligjore të MVNO-së, në një deklaratë të cilën e thotë Sabaudin Ramaxhiku, sekretar në atë kohë në Telekom, thotë se qëllimi ka qenë që të zgjerohemi në hapësirat ku nuk kemi pasur shtrirje, por më vonë pasi është bërë shpallja për MVNO, është bërë edhe normativa ligjore.

Së pari ka filluar procesi, e pastaj janë bërë ligjet për MVNO. Kompania që ka dalë përfituese në këtë proces fare nuk ka aplikuar në procesin e tenderimit dhe unë befasohem se si në këtë proces gjyqësor që është udhëhequr atëherë, ku dyshohej edhe baza e transferimit të licencës, prokurorët dhe gjykatësit e EULEX-it kanë arritur me kaq lehtësi ta kalojnë këtë proces.

E them me përgjegjësi se nënshkrimin e parë në kontratën me Dardafonin, që më vonë do të njihet si Z-Mobile, e ka bërë Adnan Merovci, anëtar i Këshillit Drejtues të Lidhjes Demokratike

të Kosovës. Po, në atë kohë në Telekom kanë përfituar kontrata milionëshe edhe deputetë të mëvonshëm të Vetëvendosjes, bile deputetë të zhurmshëm, që i kanë marrë tre milionë e gjysmë euro prej Telekomit për konsulencë. Për konsulencë, pa asnjë investim.

Partitë politike, dikush më shumë, dikush më pak, të gjithë i kanë futur duart në Telekom. Të gjithë, ama bash të gjithë. Këtë e kanë thënë edhe kryeshefët ekzekutivë të Telekomit kur kanë ardhur në Komisionin Parlamentar Hetimor, disa duke shfrytëzuar pozitat e dikush pozicionin prej opozitari për të bërë presion atje.

Por, t'i kthehemi situatës së tanishme, procesit të bllokimit të llogarive të Telekomit nga përbaruesi Ilir Mullhaxha, i kontraktuar nga Telekom. Moskundërshtimi i përbaruesit nga Telekom, Bordi dhe ushtruesja e detyrës së kryeshefit përbën vepër penale të tentativës për falimentim të qëllimshëm të ndërmarrjes publike. Telekom kishte afat shtatëditor për t'u ankuar në vendimin për përbarim, por ata nuk e bënë një gjë të tillë. Duke pasur fakte se gjendja në kompani është jo e mirë, se po rrezikohet siguria kombëtare, Bordi ka dështuar, sepse nuk ka bërë përpjekje as minimale që Ilir Mullhaxhës, përbaruesit të Z-Mobile, t'ia kthejë një shkresë për të qartësuar rrethanat, në të cilën ndodhet kompania.

Jemi të sigurt se në bazë të Ligjit përbarimor llogaritë e Telekomit nuk do të bllokoheshin dhe as nuk do të zbrazeshin. Juve që ishit në Qeveri më herët dhe juve që jeni tani ju pyes, qe sa vjet i ka pasur Telekom në xhirologari 3 milionë euro? A u përgatit terreni që për qëllime përfituese në llogarinë e Telekomit janë grumbulluar mjete qëllimshëm, që më pas ato mjete të grumbulluara sa më shumë të merren përmes procesit përbarimor? Duke ditur se obligimet e Telekomit kapin shifrën afër 40 milionë euro, atëherë si ka mundësi që në konto të Telekomit të jenë mbi 3 milionë euro?

Pyetja është, pse me ato mjete nuk janë kryer obligimet që ka pasur Telekom? Thjesht, ju që keni ndërruar dy borde në Telekom për katër muaj, tregojuni qytetarëve dhe punëtorëve të Telekomit këtë skenar që keni aranzhuar me Bordin tuaj dhe përbaruesin tuaj. Tregojuni qytetarëve pse keni ndërruar dy borde për ta shkarkuar një kryeshef, i cili nuk ia ka vazhduar kontratën Z-Mobile. Tregojuni pse e keni shkarkuar dhe cilat janë arsytet që shkarkuat kreshefin, i cili nuk e nënshkroi vazhdimin e kontratës me Devollët. Tregojeni lidhjen tuaj me Devollët, edhe në procesin përbarimor, edhe në atë procesin që një ish-deputet juaji ua përmend që keni marrë edhe para për lagje fyti ngapak prej Devollit, në kafenenë e Florim Krasniqit.

Pra tregojuni se nuk është ashtu që ju jeni kundër oligarkëve. Atë e flisni vetëm ditën, natën bashkëjetoni me oligarkët, prandaj është mirë të tregoni saktë, sa përfiton përbaruesi në këtë rast dhe ju si subjekt. A ishte e rastësishme ajo mbështetje që të marrë përbaruesi hisen e tij. Pra, ky proces nuk është ashtu si duket, se atje e bllokoni, i zbrazni e i leni punëtorët pa paga, e vini e vajtoni këtu. Jo. Atje i keni bllokuar e i keni lënë pa paga dhe asnjë të drejtë morale nuk

keni pasur, sepse për katër muaj jeni thirrur në emër të profesionistëve, keni ndërruar dy borde, keni shkarkuar kryeshef, i keni shtirë duart, këmbë e kokë në Telekom.

Prandaj, nuk është kështu, por nëse dëshironi vërtet si po e thoni ju, por nëse vërtet dëshironi ta ndihmoni Telekomin, merrni ekspertë që i keni, nëse i keni edhe ulemi bashkë dhe e bëjmë strategjinë. Të gjithë punëtorëve të Telekomit ua bëj me dije, Telekomit nuk falimenton. Sipas Kushtetutës, ligjeve të Kosovës, aksionar i Telekomit është Qeveria e Kosovës. Telekomit mund të falimentojë vetëm nëse falimenton Qeveria. Përndryshe, në situata të tjera është detyrë dhe përgjegjësi e aksionarit për ta gjetur zgjidhjen. Edhe katër muaj e më shumë, ai bordi që ishte e që dha dorëheqje në mes të natës e i la punëtorët vetëm në këtë betejë me Dardafonin dhe me Z-Mobile, sigurisht që ka përgjegjësi, sepse ka ikur në momentet kyçe dhe i ka lënë punëtorët vetë.

Kosovës dhe Telekomit i rrezikohet edhe nga një proces tjetër i Arbitrazhit në emër të investimeve strategjike në kohën e Albin Kurtit. Devolli ka bërë një padi në Arbitrazh, për fat të keq, për 15 ditë padia e tij është mbajtur në sirtarët e Qeverisë, derisa e ka humbur afatin kohor për ta prapësuar, ose për ta kundërshtuar atë.

Dhe, Z-Mobile na paraqitet si investitor, Devolli paraqitet si investitor i huaj me origjinë nga Mali i Zi. Prandaj, mendoj që kjo duhet të rregullohet dhe të shihet në përgjithësi. Ka qenë një proces hetimor për Telekomin dhe sugjeroj që Kuvendi ta votojë rishtazi Komisionin Hetimor të Telekomit prej fillimit e deri më tani. Faleminderit!

KRYETARJA: Replikë në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, nënkryetarja Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Zoti Haxhiu, janë të tjerë ata që u laget fyti. I kemi dëgjuar të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, e kanë dëgjuar zotin Grabovci dhe i dinë shumë mirë kush janë ata që u teret fyti. E para.

E dyta, fole për Bordin dhe dorëheqjen e Bordit. Bordi ka dhënë dorëheqje, sepse siç e tha edhe ministri në tavolinë, e ashtu siç tha njëri nga deputetët, kryeministri dhe ministri u kanë kërkuar që të ulen në tavolinë me Devollët dhe të negociojnë për diçka që nuk negociohet. Pra, shteti duhet t'i kryejë obligimet e tij, e jo të kërkojë mëshirë, ashtu siç u tha këtu.

Përderisa po flisni për përmbaruesin, ju lutem, më lejoni t'ju përkujtoj diçka që mund të keni harruar. Në vitin 2012 Ministria e Drejtësisë, që atë kohë udhëhiqej nga Hajredin Kuçi dhe kryeministër ishte Hashim Thaçi, e solli në Kuvend Projektligjin për procedurën përmbarimore. Dhe, menjëherë pas kësaj, pas votimit në parim të projektligjit, Lëvizja Vetëvendosje në atë kohë kishte bërë një amendament, ku kërkonte që të mos bëhej ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nga përmbaruesit privatë, por vetëm nga përmbaruesit publikë, që do të ruanin interesin e publikes. Vetëm 11 vota i ka marrë ky amendament. Partitë, përfshirë partin tuaj, AAK-ja dhe të tjerët

kanë qenë kundër kësaj dhe ua kanë mundësuar përmbaruesve privatë që tash të jenë në shërbim të korporatave, e jo në interes të qytetarëve.

Kështu që, kur flisni për fakte, do t'i flasim të gjitha, një nga një. Shumë mirë që e përmendët LDK-në dhe ndikimin e LDK-së, por përmendeni po ashtu se keni qenë bashkë gjatë gjithë këtyre viteve. Dhe, kur thuani “një deputet i Vetëvendosjes”, përmendeni kush është ai deputet i Vetëvendosjes. Ashtu siç po mundoheni të manipuloni, tregojeni të vërtetën, sepse nuk ka përfitues nga Vetëvendosja, jo në këtë çështje, po në asnjë çështje korruptive. Këtë është mirë të jeni deri në fund të sinqertë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Kundër-replikë Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Po, e nderuar kryetare dhe nënkryetare.

Deputeti i Vetëvendosjes që ka përfituar kontratë tre milionë e gjysmë në Telekom të Kosovës është Fisnik Ismajli. Deputeti tjetër i Vetëvendosjes që ka deklaruar se në prezencën e tij Albin Kurti i ka marrë dhjetë mijë euro nga Devolli, në kafenenë e tij, edhe ai ka emër e mbiemër dhe e keni deklaratën e tij publike.

Çështja tjetër, mos na shitni pallavra këtu. Folni, sa para i keni marrë, sa ua ka marrë përmbaruesi, sa kanë shkuar në Vetëvendosje. Flisni me shifra saktë. Qytetarëve u intereson, sepse punëtorët e shkretët i keni lënë pa paga, ndërsa ju përfitoni. Qysh bre, u bë shteti i kapur e vëllai i deputetes suaj të jetë përmbaruesi? A nuk gjeti Devolli asnjë tjetër a? Prej krejt këtyre përmbaruesve paska pasur besim te ju? Po, sepse ju jeni kontraktuesit e tyre. Juve jua ka lagur fytin, jo tjetërkujt.

KRYETARJA: Vazhdojmë me deputetët që e kanë kërkuar fjalën. Nga AAK nuk po shoh dikë. Nga Lëvizja Vetëvendosje fjalën e ka deputetja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Përshëndetje!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është një temë, e cila mbi të gjitha më së paku duhet të ketë personalizime apo personifikime, kur diskutohet për gjendjen e Telekomit në raport me faktet. Nëse asgjë tjetër, faktet janë shumë kokëforta dhe ato tregojnë datat, emrat, ata që kanë sjellë vendime, emrat e atyre që janë punësuar, emrat e atyre që janë në Bord, kryeshefat dhe veprimet.

Prandaj, më së paku çka neve na takon këtu është të ngremë gisht, por të flasim për ato fakte, ama jo të shtrembëruara. Tash, një fakt që është shokues për të gjithë ne është ta shohim që

ministri i linjës, zoti Kuçi, vjen këtu dhe deklaron që kryeministri pa prezencën e tij është takuar me Sindikatën, në ditën kur në Kuvendin e Republikës së Kosovës diskutohet për Telekomin. Kompetencë e cilës ministri është fati i Telekomit, ose ndërmarrjeve publike.

Ministri gjithashtu u ankua se nuk ka pasur, ose nuk është krijuar kulturë komunikimi në mes të Njesisë për mbikëqyrje të ndërmarrjeve publike dhe korporatave. Por, ministri po harron se vetë kryetari i partisë së tij kur është deklaruar në mandatin e kaluar për punësimet në Telekom, ka thënë hiç më pak e hiç më shumë se “po valla, me mujtë edhe të tjerë i çoj”. Domethënë, ka kapërcyer komunikimi i Telekomit me njësinë si linjë zyrtare. Komunikimi i Telekomit ka qenë me krerë të partive. Komunikimi i Telekomit ka qenë me zyrtarë të lartë të shtetit, por jo me shërbyes civilë dhe kjo është me të vërtetë për brengosje.

Tash, ne këtu po diskutojmë që nuk kemi fuqi ekzekutive. Ministri ka fuqi ekzekutive, por ai është këtu me ne, e kryeministri ka bërë një marrëveshje tjetër. Tjetra, te përmbaruesi, te Ligji për procedurën përmbarimore, është me të vërtetë për keqardhje të etiketohet një deputete, po flas edhe sikur e cilëso parti të kishte qenë kjo deputete, për arsye se vëllai i saj që është përmbarues për 15 vjet ka ekzekutuar një procedurë që është sipas ligjit. Më konkretisht, kompetencat e përmbaruesit neni 5, a ka pasur procedurë tjetër e cila kishte ndaluar këtë përmbarues të ekzekutojë këtë procedurë? Nëse nuk ka pasur ligjërisht, atëherë licenca e përmbaruesit nuk vlen, ose mund të kontestohet. Prandaj, nëse shkoni në personale, të paktën shikoni faktet dhe ligjet që ka kaluar ky Kuvend.

Nuk mund të shkohet në një skenar, i cili ka filluar që në vitin 2008. Në fakt, a po hyjnë në radhë, se Telekomit, u përmend më herët prej parafolësit, ka pasur shumë marrëveshje të dëmshme. Marrëveshje kontraktuale, të cilat i kanë sjellë edhe përmbarime e edhe dëme dhjetëmilionëshe. Një prej tyre, në fakt, përveç kur është vendosur në vitin 2009 prej Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave që të ndërprehen investimet, është ndërprerë edhe një projekt në platformën e billingut, i cili ka pasur vlerën e investimit 20 milionë euro. Për shkak se është ndërprerë pa paralajmërim dhe me vendim të ministrit, edhe të Qeverisë, i ka kushtuar atëherë Telekomit 10 milionë në Arbitrazh. Telekomin nuk e kanë shkatërruar njerëzit e Telekomit, as inxhinierët, as juristët, as ekonomistët, Telekomin e ka shkatërruar politika. Njerëzit e Bordit gjithmonë janë zgjedhur politikisht, të cilët e kanë sjellë menaxhmentin joprofesional. Për ta vërtetuar këtë e tregojnë edhe dy grupe punuese, të cilat në vitin 2008, një pas një janë emëruar për të treguar a ka fizibilitet që Telekomit të nënshkruajë, atëherë PTK-ja, të nënshkruajë një kontratë për operator virtual mobil.

Grupi i parë i ekspertëve me bazën një ekonomist, një jurist edhe një teknik, kanë thënë jo. As nuk është në biznes-plan tonin dhe as nuk është financiarisht e qëndrueshme dhe as në aspektin ligjor nuk e kemi bazën ligjore, se në Kosovë as ligj nuk ka pasur për ta rregulluar operatorin virtual mobil.

Çka ka ndodhur? I njëjti ushtrues i detyrës, zoti Ramaxhiku asokohe, e formon grupin e dytë. Grupi i dytë i ekspertëve prapë i thotë, në fund të vitit 2008, që nuk ka kushte dhe nuk rekomandon nënshkrimin e një marrëveshjeje. Në ndërkohë, gjithashtu edhe Autoriteti Rregullativ ngutet me rregullore, por gjithashtu edhe kryhen të gjitha procedurat e kompanisë së regjistrimit Dardafon, më vonë Dardanet. Përkundrejt faktit që ka ardhur prej brenda PTK-së, që nuk mund të nënshkruhet, kontrata nënshkruhet. Kjo kontratë nënshkruhet në janar të vitit 2009. Tash, datat dhe adresat politike i keni të gjithë.

S'kemi nevojë të etiketojmë e të bëjmë me gisht se kush ka qenë në cilin pozicion në janar të vitit 2009. Çfarë ka ndodhur në këtë dekadë të marrëveshjes së Telekomit me Dardanet. E para, vlera e humbjeve reale, që është e regjistruar është 107 milionë euro. Prej tyre 31 milionë euro të humbura në Arbitrazh, ndërsa 84 milionë euro kosto për shërbime të Z-Mobile. Nga vlera e përlllogaritur e të hyrave të humbura shkon shifra deri në 140 milionë euro. Përkundër këtyre të hyrave të larta, Dardafonitt fitimi i tyre është deklaruar i ulët, në më pak se 6 milionë euro. Përkundrejt faktit që marrëveshja gjithashtu ka përfshirë një kontratë, në të cilën ndarja e qarkullimit në shërbimin që është ofruar ka qenë 27 me 73%. Është llogaritur se fitim bruto ata kanë pasur 73 milionë, por kanë pasur fitim 6 milionë.

Në cilin shtet me sistem, në të cilin e ke administratën tatimore dhe institucionet, nuk verifikohet kjo e dhënë? A ka mundësi të verifikohet, se si mundet prej 73 milionëve të deklarohen fitim neto 6 milionë? Është thënë edhe këtu në Komision Parlamentar.

Në vitin 2013 kërkesa e Dardafon.net për numra shtesë nuk miratohet nga Telekomit, por miratohet nga ART-ja, ose tash një institucion tjetër, ARKEP, i cili në formën e vet na ka treguar mungesë të përgjegjshmërisë edhe në komision kur e kemi pasur në raportim, mungesë totale të përgjegjshmërisë për detyrat dhe obligimet që i ka. I njëjti vendim i ARKEP-it dhe deklarata e vetë atij që e ka përgatitur kontratën për Telekomit, është vendimi që është përdorur në Gjykatën e Arbitrazhit. Do të thotë, shteti i Kosovës, Telekomit me njerëzit e vet, me mekanizmat e vet, ia ka mundësuar në të gjitha mënyrat që kjo kontratë dhe ky vendim në Arbitrazh të dalë në favorin siç ka dalë.

Ne jemi fajtorë për ato ku është Telekomit sot, politika. Në të gjitha këto vite të jetës ose të funksionit tim, qoftë në mbrojtje të interesave të biznesit, qoftë në promovim të legjislacionit për një ambient të mirë biznesor, një konkurrent të vazhdueshëm e kam pasur, politikën apo situatën politike. Në rastin konkret, politika është ajo që e ka sjellë këtë punë. Asnjë kompani në Kosovë nuk do ta kishte pasur forcën dhe nuk do ta kryente këtë aksion, të cilin e ka kryer Dardafon.net, ose Z-Mobile, sikur të mos e kishte pasur politikën pas vetes.

E jona këtu është që ta demaskojmë kush janë politikanët që e kanë shtyrë deri në këtë gjendje. Nuk është jona këtu vetëm të gjykojmë, ose të shajmë e të ofendojmë, as përmbauesin e as

aktualisht Bordin. Kjo katrahurë në Telekom ka ndodhur prej periudhës kur kanë filluar të hyrat e mëdha, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me interesat, me rekomandimet e inxhinierëve. Punësimet që kanë ndodhur aty janë jashtë çdo norme, në fakt, të biznesit. S'ka plan biznesi që mund ta nxjerrë një kompani profitabile në atë se çfarë i ka ndodhur Telekomit.

A do të kemi ne interes që ta shtyjmë përpara? Unë dyshoj! Dyshoj, për arsye se çfarë po ndodh me Telekomin është paralele me çfarë është duke ndodhur politikisht në Kosovë. Pse mu tani u ekzekutua vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit? Pse tash u vendos kërkesa për tërheqjen e këtyre mjeteve?

Gjykata sjell një vendim, të cilin përmbartuesi e ka obligim ta ekzekutojë. Përderisa, në proces është edhe një përmbartim tjetër, në fakt, kërkoj ndjesë, një proces i ri në Gjykatë të Arbitrazhit. Tash shkon ende më larg, se pronari i Dardanet-it, ose Z-Mobile, deklaroi se si investitor i huaj ai është ndjekur, ose është keqtrajtuar nga Kosova. Ne të gjithë e dimë që investitori i Dardanet-it është kosovar. E ka një biznes të madh dhe ka shumë punëtorë që varen nga të hyrat e atij biznesi, por të kemi një shtet, në të cilin sot mund të thuash që je kosovar, e nesër mund të thuash që je shtetas i huaj, e tregon mungesën e seriozitetit dhe mekanizmave të shtetit. Nuk ka pasur nevojë të vijë deri në këtë pikë. Kjo është tërësisht e koordinuar dhe e orkestruar.

E nëse ne nuk kemi guxim të tregojmë kush janë ata, atëherë duhet organet e rendit. Fatkeqësisht, në këtë sistem, as organet e rendit s'e kanë pasur këtë guxim, për arsye se kemi pasur Prokurorinë e Shtetit dhe i kemi pasur të gjitha mekanizmat e tjerë që kanë hyrë e kanë dalë dhe asnjë hap nuk e kanë ndërmarrë në këtë raport.

A ka mundësi zgjidhjeje? Ka mundësi zgjidhjeje, por nuk ka nënshtrim. Nuk ka në asnjë mënyrë të tregohet se tash jemi të nënshtruar dhe prej pozitës së nënshtruar Telekomit do të negociojë me këdo. Absolutisht, jo! Duhet përdorur, nëse ka hapësirë dhe nëse ka forcë. Unë dyshoj që ka, nga kjo Qeveri dhe mënyra se si po diskutohet. Po diskuton kryeministri vetëm, pos s'po e merr ministrin, a sepse është i partisë tjetër, apo sepse janë biseda, të cilat ata nuk mund t'i ndajnë në mes vete, ose i kanë llogaritë e ndara? Është me të vërtetë për keqardhje ne si Kuvend të kemi këso informatash gjysmake e të kemi kaq mungesë të koordinimit e t'i kemi punëtorët në rrugë, 2350 sa kanë qenë. E 2350 edhe ata e dinë që s'janë të nevojshëm për Telekomin, por duhet pasur proces të ristrukturimit të mirëfilltë, i cili nuk e cenon interesin e askujt, e më së paku të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Ministri Blerim Kuçi e ka fjalën.

MINISTRI BLERIM KUÇI: Hajde për hair na qoftë!

E kam pasur më herët, veç po frikohem se po jua ngjis juve.

Zonja deputete,

E di që jemi në Kuvend dhe duhet të flasim. Ju e keni pasur mundësinë për të vepruar, e keni pasur kohën tuaj. E keni pasur edhe para disa muajsh, po besa dikush prej jush edhe para disa vjetësh. Falë edhe atyre që kanë qenë para disa muajsh dhe me mënyrën e menaxhimit edhe sot dhe të deklarimeve, siç po i shohim, kemi ardhur në këtë gjendje.

Nuk po e heq edhe veten ku jam aty në atë parti, nuk po e heq edhe partinë këndeje që është, edhe këtej, të gjithë jemi fajtorë së bashku për gjendjen në Telekom. Po, ajo që është për mua me rëndësi, s'kam ardhur unë sot të flas, por kam ardhur t'ju informoj dhe t'ju dëgjoj që të na e lehtësoni dhe si Qeveri të dalim prej kësaj gjendjeje.

Po, ajo që po më brengos, Bordi, që ka dhënë dorëheqje nuk e ka pasur këtë ndjenjë, se është frymëzuar nga politika e deputetes për të mos u zgjidhur dhe për të ardhur në këtë gjendje. Sot duke iu falënderuar kësaj politike i kemi llogaritë të bllokuara. Ne kemi kërkuar, edhe kryeministri ka kërkuar, edhe pse është sot i ndarë me mua në kuptimin se s'kemi mundur të arrijmë njëri në debat e tjetri u desh të shkojë me Sindikatën, i kemi ndarë detyrat. Kemi bërë një ndarje të detyrave dhe sot kam ardhur unë të përballem, sepse besoj se jam më në rrjedha sesa kryeministri për këtë çështje.

Ne i kemi organet tona gjyqësore dhe ato që janë, edhe ashtu çfarë jemi edhe ne, i kanë marrë vendimet të cilat nuk mund të kthehen, së paku për këtë kohë prapa.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Vazhdoja, të lutem, fjalën!

MINISTRI BLERIM KUÇI: A mund të më ndihmoni, si ministër, të dalim prej kësaj situatë? Kjo është më urgjente. Pastaj, e shohim, e kemi komisione hetuese, që i kemi lënë përgjysmë, a janë procese të tjera që dikush nuk po do t'i shtyjë më tutje? Me krejt ato përballemi dhe shtyhemi mes vete.

Ju lutem sot, zotërinj deputetë e deputete të nderuara, në qoftë se keni një rekomandim, qoftë edhe ligjor, pati edhe ligjor, që mund t'i ndihmojmë kësaj situatë, mua më keni shumë afër. Do të jem shumë afër punëtorëve, e para 2 300 punëtorëve, e dyta shërbimeve vitale të shtetit, e pastaj ulemi edhe një herë e debatojmë se kush është fajtor.

Hajde, cila është zgjidhja? Unë i dhashë disa rekomandime. Për fat të mirë, për herë të parë kemi marrë, e tha një deputet që ka qenë në komision, nuk kam dashur të dal me rekomandimet e mia, se Bordi Drejtues është i obliguar të dalë me rekomandime. Nuk ka dalë me rekomandime. Dje i kemi pasur rekomandimet zyrtare dhe ato rekomandime do t'i shqyrtojmë dhe në bazë të atyre rekomandimeve dhe fuqisë ligjore që ka Qeveria, do të shkojmë tutje.

Prapë po kërkoj ndihmën tuaj dhe për të hapur rrugën edhe në aspektin ligjor, në qoftë se kemi ndonjë problem ligjor. Kurse Qeveria, normalisht që do të marrë masat e duhura. Cilat janë masat e duhura? Nuk do të shkojë kjo ndërmarrje në falimentim! Faleminderit!

KRYETARJA: Replikë, deputetja Mimoza Kusari-Lila.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, zoti Kuçi, për përgjigjet, ose për tentim përgjigjet, për arsye se unë përgjigje nuk mora.

E para, s'të kuptova se çka është prioritare te ju. Nëse prioritare është Telekom, ai takim i kryeministrit kur ka ndodhur, ne ishim jashtë duke e përcjellë, në fakt, duke biseduar me protestuesit. Këtu nuk zhvillohej seanca për Telekom, këtu ishim ende në pjesën e pyetjeve parlamentare. Do të thotë, nuk ka pasur interes të përfshirjes suaj, siç po e shoh unë, ose të paktën një tentativë për t'ju pasur juve në takim me Sindikatën.

E dyta, sa i përket përgjegjësisë, është e vërtetë. Të gjithë kemi përgjegjësi dhe e kam thënë edhe më herët në këtë Kuvend, postet tona janë publike dhe dihen datat, dihen vendimet çfarë kemi marrë kur kemi qenë dhe siç e thashë edhe në fillim aty, secili vendim për Telekom është faktik, përfshi edhe emrat e anëtarëve të Bordit, kujt i janë deleguar, kënd e kanë dëgjuar, kush ka qenë menaxhmenti, e kështu me radhë.

Ndërsa, mua po më frikëson edhe bindja juaj që Bordi, po thoni, Bordin s'e keni inspiruar kështu Bordin. Unë, zoti Kuçi, as nuk i kam njohur, as s'i kam emëruar, se ne jemi deputetë. Ne s'kemi pasur punë, ose s'kemi pasur dorë si politikë në këtë Bord. Në rast se është ajo praktikë që është komunikuar drejtpërdrejt partia politike me Bordin, po më vjen keq, ky s'ka qenë rasti.

Tash, unë nuk i di intimisht arsyet e tyre. Ata janë deklaruar me një letër publike, po duhet referuar asaj që ata kanë deklaruar dhe jo ato tjerat aludime që mund të jepen. Në fund të ditës, ata kanë qenë me "institucion të thyer" në dorë, po e them, në thonjëza. Ka qenë institucion vetëm i shkatërruar. Nuk është Telekom i tërheqjes së dividendës që ka qenë para shtatë-tetë, ose nëntë vjetëve që ka mbushur arkën e shtetit. Mënyra se si ka ndodhur është tepër, tepër dramatike. Përderisa po kërkon zgjidhje, u lexua më herët një rezolutë. Bëju apel deputetëve të partisë suaj ta miratojnë rezolutën dhe ecim përpara në zbatim të rekomandimeve të rezolutës. Është shumë e thjeshtë!

Nuk është kjo rezolutë politike, është rezolutë që bazohet në praktikat e menaxhimit...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARJA: Kundër-replikë, një minutë, ministri!

MINISTRI BLERIM KUÇI: Tash po e kam problem a të bisedoj si deputet, se dikur kemi qenë kolegë. Dhe, nuk është bash lehtë të ndërrohet gjuha e komunikimit.

Po, ajo që kam para vetes, në qoftë se e ke për zotin Haradinaj, më herët e pate, për herë të parë i është ndërprerë kontrata e atyre shërbimeve që po thoni ju, të dëmshme, ka marrë dikush një vendim dhe ka shkëputur kontratën, pra u janë ndërprerë shërbimet. OK, mund të bëjmë me gisht, po ajo ka ndodhur në vitin 2019. Unë nuk kam ndonjë dokument tjetër, përveç kësaj.

E dyta, unë po them që vërtet po kërkoj ndihmën tuaj, vërtet edhe tuajën personale. Ju e keni një rezolutë. Ju merrni vendime, ne do t'i zbatojmë ato vendime. Unë apeloj, atëherë te partia ime, që ta shikojnë atë rezolutë edhe në qoftë se...

(Ndërprerje nga regjia)

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Arbërie Nagavci.)

KRYESUESJA: Fjalën e ka kryetarja e Kuvendit, zonja Osmani.

VJOSA OSMANI: Të nderuar deputetë,

Meqenëse tashmë edhe u shpërnda letra që ka ardhur nga menaxhmenti i Telekomit, kam marrë një kërkesë prej tyre që ta lexoj këtë letër para jush, që në të njëjtën kohë të informohen edhe qytetarët e Kosovës për rëndësinë jetike që ka shpëtimi i Telekomit.

Pra, po e lexoj ashtu siç e kanë shkruar, pa ndonjë ndërhyrje, duke shpresuar që do të ketë kohë të mjaftueshme.

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

E përshëndesim këtë debat në kohë kritike për fatin e Telekomit të Kosovës, kompani kjo publike, e cila aq shumë i dha kësaj shoqërie dhe ka potencial të jashtëzakonshëm që të vazhdojë edhe më tutje të jetë kontribuese e fuqishme e buxhetit të shtetit dhe të sjellë përfitime të mëdha për aksionarin, pra për Qeverinë.

Do të përpiqemi sa më shkurt të argumentojmë për ju, përse ia vlen të investohet në të dhe në të ardhmen e Telekomit të Kosovës dhe përse është e nevojshme të hetohen vendime strategjike dhe kontrata të mëdha, të cilat këtë kompani prej një kontribuesi të fuqishëm të buxhetit e sollën para bankrotimit dhe e shndërruan në borxhli.

Që nga viti 2005 Telekom i Kosovës realizoi shitje të shërbimeve në vlerë prej 1 765 000 000 euro, ndërkaq nga viti 2008 e këndej i pagoi aksionarit, pra Qeverisë së Kosovës, rreth 285 000 000 euro dividendë. Gjatë kësaj periudhe Telekom i Kosovës pagoi po ashtu rreth 115 000 000 euro TVSH dhe 142 000 000 euro tatim në fitim. Përpos kësaj, edhe 38 000 000 euro janë paguar në emër të tatimit në paga. Në këtë periudhë kohore edhe shoqëria, përkatësisht qytetarët kanë përfituar në emër të qirave e po ashtu edhe miliona euro në formë subvencionesh, si përkrahje për kulturën, sportin, studentët, veteranët, Universitetin publik, QKUK-në, e të tjera.

Sot, përkundër kësaj historie të gjatë suksesi, ndodhemi në një situatë tejet të rënduar financiare, si rezultat i vendimmarrjes së gabuar, mungesës së investimeve, kontratave të dëmshme, ndërhyrjes së politikës në vendimmarrjen strategjike të kompanisë. Kështu, borxhi i përgjithshëm i Telekomit të Kosovës kap shumën prej 39 000 000 eurosh dhe fatkeqësisht këto janë detyrime të cilat duhet shlyer menjëherë.

Telekomi i Kosovës nuk ka kapacitete t'i përballojë këto detyrime. Sidoqoftë, borxhet po përbarohen pa marrë parasysh se kjo, nëse nuk ndalohet nga ju, do të jetë fatale për Telekomin. Me masat e ndërmarra Telekom arriti t'i ulë shpenzimet mujore për rreth gjysmë milioni euro dhe janë hapur bisedime me partnerë, të cilëve u kemi borxhe dhe gati të gjithë kemi hasur në mirëkuptim, falë trajtimit korrekt, qasjes serioze dhe besimit të krijuar mes nesh.

Menaxhmenti ishte përkushtuar të arrinte një stabilitet të përkohshëm, me qëllim që para aksionarit t'i shtronte strategjinë afatmesme dhe afatgjatë për rimëkëmbjen e tërësishme të Telekomit. Në këto përpjekje dhe në rrethana relativisht të përmirësuara na gjeti ndërhyrja e vrazhdë e përbaruesit privat në emër të Dardafon.net, duke ngrirë llogaritë bankare dhe duke insistuar në një përbarim të detyrueshëm, në një kohë kur ne po funksiononim vetëm me staf esencial për shkak të fatkeqësisë në formën e Pandemisë COVID 19.

Kjo kompani, e cila deri më tash si rezultat i kësaj kontrate ka përfituar shumë nga Telekom i Kosovës, ka arkëtuar rreth 42 000 000 euro, pa marrë parasysh pasojat ekonomike, sociale dhe politike për shoqërinë, e sidomos nëpërmjet përbaruesit privat, i cili ndërhyri që të arkëtojë detyrueshëm dhe në shumën prej 26 000 000 euro, sa pretendon të jenë humbjet e tyre vetëm për dy vjet. Me këtë akt Telekom u soll në rrezik të falimentojë. Dëmet e Telekomit të Kosovës nga kjo kontratë disa fish i kalojnë ato që pretendon të jenë dëmtuar Dardafon.net dhe kapin shifrën për rreth 107 000 000 milionë euro. Këto para do të shkonin te aksionari dhe në Buxhetin e Kosovës.

Për të hedhur pak dritë mbi këtë kontratë, sidomos për shumën e borxhit prej rreth 26 milionë, sa pretendon kjo kompani, mund t'ju ofrojmë vetëm disa të dhëna publike që nxjerrin në dritë të diellit këtë kontratë. Për dhjetë vjet operimi mbi këtë kontratë Dardafon.net kishte deklaruar gjithsej vetëm 5 milionë euro fitim. Ndërkohë, deklaroi, përkundër logjikës që humbjet e tyre

për vetëm dy vjet nga mosdhënia e internetit të kenë qenë rreth 26 milionë euro, pa llogaritur që ndërkohë ka shitur shërbimet me zë dhe SMS. Ky kontest pastaj mori epilogun e çuditshëm në Arbitrazh, ku Telekom i Kosovës nuk kishte pasur mbrojtje adekuate dhe për këtë dikush duhet të përgjigjet.

Ju ftojme që këtë debat të mos e trajtoni si kërkesë për ndihmë sociale, por si një debat ku ka shumë argumente, se me një investim të aksionarit në shumën prej rreth 50 milionë euro, Telekom i Kosovës për dy vjet me një menaxhim të përgjegjshëm do të kthehej në radhën e paguesve të dividendës për Qeverinë dhe të tatimit në fitim për buxhetin e shtetit. Nga kjo shumë 39 milionë euro do të shkonin për sanimin e borxheve dhe pjesa tjetër për investime të domosdoshme, për të kapur sërish hapin me kushtet e tregut të konkurrencës.

Është me rëndësi të përmendet fakti se në strukturën e borxheve një pjesë e rëndësishme është pikërisht ndaj institucioneve, të cilat sërish do të ktheheshin në buxhet, siç është ARKEP, ATK, Posta e Kosovës e të tjera. Si rezultat i këtij debati do të ishte me interes të ndërmerren masa mbështetëse nga Qeveria për të siguruar një këndellje të suksesshme të Telekomit të Kosovës, si vijon:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, si pronare e 100%-të e aksioneve të Telekomit, të gjejë mundësinë e arritjes së një zgjidhjeje urgjente për lirimin e llogarive bankare dhe kthimin e mjeteve financiare, tashmë të bllokuara, dhe të tërhequra sipas urdhrit për tranferim nga procedura përmbarimore.
2. Sigurimin e mbështetjes financiare për realizimin e investimeve urgjente teknologjike.
3. Implementimi i planit të ristrukturimit të kompanisë.
4. Mbështetja e korporatës, zgjidhjen e shpejtë të inkasimit të borxheve të këqija.
5. Implementimi i planit strategjik për përmirësimin e gjendjes aktuale dhe rritjen e vlerës së kompanisë, në koordinim dhe harmonizim ndërmjet aksionarit dhe Telekomit të Kosovës.
6. Trajtimi i problematikave në Telekom, që kërkojnë zgjidhje nëpërmjet organeve të drejtësisë, apo edhe Komisionit Hetimor Parlamentar.

Të nderuar deputetë,

Mosveprimi me masa urgjente dhe veprime të shpejta do të rrezikojë të sjellë momentin e ndërprerjes së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, shërbime vitale, të cilat Telekom i Kosovës u ofron institucioneve shtetërore, institucioneve të sigurisë nacionale dhe forcave e misioneve ndërkombëtare dhe atyre paqeruajtëse.

Në fund, na lejoni t'ju sigurojmë, se me ndërhyrjen tuaj do të rimëkëmbim një kompani që ka kapacitete të jashtëzakonshme njerëzore e profesionale, ka motivimin e duhur për të ofruar shërbime të pranueshme për qytetarë dhe dividendë të fuqishme për aksionarin. Një vendimmarrje që obligon Qeverinë të rimëkëmbë Telekomin e Kosovës, të hetojë kontratat dhe vendimmarrjen e dëmshme, do të sjellë shpresë te punëtorët dhe te familjet e tyre dhe qindra operatorë ekonomikë, të cilët operojnë bashkë, në mënyrë që të realizohet misioni, vizioni dhe objektivat e Telekomit.

Mbi të gjitha, është me rëndësi të theksohet se në këtë gjendje që është krijuar punëtorët e Telekomit janë tërësisht të pafajshëm dhe nuk meritojnë të ndëshkohen për veprimet që tashmë janë të njohura për opinionin. Mungesa e mjeteve financiare në këtë kohë pandemie dhe krizë globale është kërcënim serioz për mirëqenien e punëtorëve dhe të familjeve të tyre. Dimensioni social është shumë i rëndësishëm edhe për ju dhe jemi të sigurt që do të jetë një motiv shtesë për një qasje të përgjegjshme dhe të vendosur që kjo çështje të trajtohet me seriozitetin që kërkon momenti dhe të merren vendime nga të cilat do të përfitojnë qytetarët, aksionari dhe mijëra e mijëra të interesuar që kompania të rikthejë shkëlqimin e saj të dikurshëm.

Kjo ishte letra nga ana e menaxhmentit të Telekomit.

Të nderuar deputetë, vetëm dy fjali, për fund.

Dihet se janë disa baza ligjore, mbi të cilat marrëveshjet e Arbitrazhit mund të shpallen të pavlefshme, madje me pavlefshmëri absolute. Një ndër to është, në qoftë se një marrëveshje Arbitrazhi është arritur nëpërmjet veprimeve të paligjshme apo korrupsioni. Në këtë drejtim, dua të risjell në vëmendjen tuaj një fjalim të ish-kryeministrit Isa Mustafa, të datës 10 maj 2017, pra ditën kur është votuar mocioni i mosbesimit ndaj Qeverisë.

Në atë kohë, kryeministri Mustafa kishte thënë se, po citoj: “Kjo Qeveri ka trashëguar pasojat e parregullsive në të kaluarën dhe kjo është Z-Mobile”. Kontrata me Z-Mobile është lidhur më 16 janar 2009. Secili pajtohem se kjo kontratë është e dëmshme për PTK-në dhe për Kosovën, mirëpo nënshkruarit e kësaj kontrate do të duhej të ishin përgjegjës për pasojat e këtij dëmi, sepse pasojat e kësaj kontrate janë të njohura. Edhe ju e dini, edhe ne e dimë, që kjo çështje duhet t'i takojë drejtësisë dhe në cilësinë e kryeministrit i kishte bërë apel drejtësisë, që ta hetojë këtë kontratë dhe përgjegjësit për nënshkrimin e saj t'i vërë përpara drejtësisë.

Arsyeja pse e risolla këtë fjalim është për shkak se, në qoftë se një kryeministër flet para këtij Kuvendi dhe bën thirrje publike për prokurorët dhe për Drejtësinë, që të hetohen kontrata të dëmshme dhe e shohim se nuk është ndërmarrë asgjë në këtë drejtim, pasojat janë këto që po i shohim sot. Sepse, sikur të kishte hetime dhe sikur përgjegjësit të dilnin para drejtësisë, atëherë as në Arbitrazh ajo marrëveshje e Arbitrazhit nuk do të shpallej e vlefshme. Rrjedhimisht, edhe

sot Telekomit nuk do të duhej fare të paguante këtë shumë që po kërkohet nga Z-Mobile, e rrjedhimisht, edhe nuk do të ishte në rrezik që të falimentojë.

Pra, për fat të keq, sot debati po tregon që këtu nuk kemi të bëjmë vetëm me keqpërdorime në fushën e Telekomit, por është një dëshmi edhe më e madhe për një politizim të skajshëm të sistemit të drejtësisë, i cili për vite me radhë ka dështuar që ta kryejë punën e vet për të hetuar kontrata të tilla të dëmshme, dëmet e së cilës tani nuk do t'i shohë vetëm kjo kompani dhe vetëm Qeveria apo institucionet e Kosovës, por edhe me mijëra familje të tjera, për të cilat edhe flet letra e menaxhmentit në këtë rast. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Osmani! Fjalën e ka deputeti Sejdi Hoxha.

SEJDI HOXHA: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar punonjës të Telekomit dhe Postës së Kosovës,

Jemi duke folur për një temë jashtëzakonisht të ndjeshme sot, e cila e ka problemin e saj në retrospektivë.

Unë mendoj që janë bërë disa gabime në hapa, që e kanë sjellë Telekomin e Kosovës në këtë situatë. Fillimisht, mendoj se ka qenë një gabim kur është bërë bllokimi i investimeve të projekteve kapitale në Telekomin e Kosovës, që nga viti 2011. Ky ka qenë gabim, sepse teknologjia mobile ka avancuar me shpejtësi të dritës në gjithë botën. Ky bllokim i investimeve kapitale në Telekomin e Kosovës i ka pamundësuar këtij operatori që të bëjë investime kapitale në teknologji, në mënyrë që të jetë në trend me shërbimet e reja në raport me operatorët e tjerë konkurrues.

Gabimi i dytë, që mendoj se është gabim strategjik që ka bërë Qeveria e Kosovës lidhur me Telekomin e Kosovës, është kur Qeveria në formë të njëanshme e ka tërhequr dividendën në vlerë prej 15 milionë eurosh në vitin 2015 ndaj Telekomit të Kosovës. Kjo ka qenë ajo pika kritike, kur Telekomit i Kosovës ka filluar të ketë rënie dhe tërheqja e 15 milionë euro investimeve në formë të njëanshme ka bërë që Telekomit i Kosovës të rrëshqasë më shpejt drejt kësaj sate, në të cilën është sot.

Gabimi i tretë i radhës ka ndodhur brenda Telekomit, kur aty nuk është treguar kujdes në reduktimin e shpenzimeve operative, hapësirave reklamuese, donacioneve dhe kontratave të pafavorshme. Kujdesi ndaj këtyre shpenzimeve do ta parandalonte Telekomin e Kosovës që të vihej në këtë situatë që është sot, në formë kaq të shpejtë.

Tani jemi në një situatë të rëndë, e cila kërkon vendimmarrje institucionale. Qeveria ka obligim të ofrojë zgjidhje dhe ta ndihmojë këtë ndërmarrje, e cila ka rreth 2300 punonjës, si dhe rreth 1100 punonjës të Postës së Kosovës, të cilët në një mënyrë apo tjetër, në formë indirekte i atakon apo i prek kriza e krijuar në Telekomin e Kosovës.

Mendoj se dorëheqja e Bordit të Telekomit mbrëmë është joetike dhe e pasinqertë, joprofesionale, sepse Bordi ka obligim t'u qëndrojë punëtorëve afër edhe në momentet më kritike, siç është kjo situatë në të cilën ndodhemi sot. Pra, dorëheqja apo dezertimi i Bordit në këtë situatë nuk është etik.

Tash, po dua të flas pak nga këndi i menaxherit. Qeveria e Kosovës, respektivisht ministria përkatëse, përmes konkursit publik duhet të zgjedhë një bord profesional, i cili së bashku me një menaxhment profesional duhet të prezantojë një strategji që garanton stabilitet të mëtutjeshëm financiar. Qeveria, Bordi dhe menaxhmenti duhet të prezantojnë një strategji të orientuar në katër shtylla kryesore.

Shtylla e parë do të ishte përmirësimi i ofrimit të shërbimeve aktuale, që sot ofron Telekomi i Kosovës. Telekomit të Kosovës sot i duhet t'i mbajë konsumatorët e saj besnikë, jo t'i dalin apo t'i shkojnë në operatorë të tjerë. Të gjithë jemi dëshmitarë rreth ofrimit të shërbimeve të internetit, për të cilat konsumatorët nuk janë të kënaqur dhe po ikin në operatorin tjetër mobil.

Si pikë e dytë e rëndësishme do të ishte optimizimi i infrastrukturës ekzistuese telekomunikuese, si dhe menjëherë Telekomi duhet të fillojë investimet e reja në implementimin e teknologjive të trendëve të fundit, të cilat janë në industrinë e telekomunikimeve.

Duhet të ndërtohet një rrjet i qëndrueshëm i shpërndarjes së fijeve optike, të cilat janë përçues të mirë të sinjaleve telekomunikuese. Ju e dini që një pjesë jashtëzakonisht e vogël e qytetarëve të Kosovës i shfrytëzojnë shërbimet e IPTV-së së Telekomit të Kosovës, për shkak të ndërprerjeve të shpeshta që ka ky operator.

Investimet në Telekom apo ky investim është i pashmangshëm, sepse një pjesë e rrjetit të Telekomit është i përbërë nga fije të bakrit, të cilat nuk janë përçues të mirë të sinjaleve dhe ka fakt e vendos Telekomin e Kosovës në një pozicion më të pafavorshëm konkurrues, në raport me operatorët e tjerë që ofrojnë shërbime të njëjta.

Shtylla e tretë, që ka të bëjë me strategjinë e Telekomit, është strategjia për krijimin e shërbimeve të reja. Është me rëndësi të identifikohen dhe të lansohen shërbime të reja në segmentet e reja të tregut, të cilat janë të paeksploruara deri më tani. Telekomi duhet të synojë analizë të potencialit të rritjes së shërbimeve digjitale në tregjet e reja, si: shëndetësi; financa; transport; ekonomi; siguri publike, në shërbimet e komunave etj.

Këto janë shërbimet kryesore që ofrojnë një pjesë e operatorëve mobilë ndërkombëtarë. Krijimi i këtyre shërbimeve është garanci dhe siguron një stabilitet afatgjatë në Telekomin e Kosovës.

Shtylla e katërt, që duhet të jetë shumë e rëndësishme dhe që duhet ta kemi parasysh, është një ristrukturim i përgjithshëm në ndërmarrjen publike Telekomit i Kosovës. Aty duhet të vendosen detyra dhe përgjegjësi të caktuara për secilin punonjës, për secilin menaxher dhe duhet të kërkohet llogaridhënie për pagat e tyre që i marrin në Telekomin e Kosovës.

E dëgjova çka u tha me çështjen e qirasë që Telekomit i ka ndaj Postës së Kosovës. Të bëhem i sinqertë, t'ju them shumë sinqerisht nuk është qiraja ndaj Postës së Kosovës që e ka sjellë në këtë gjendje Telekomin e Kosovës. Objektet apo zyrat postare me marrëveshje të ndarjes i kanë takuar Postës së Kosovës sikur në çdo vend tjetër të botës dhe operatori mobil i paguan qira në këtë rast Postës së Kosovës. Nuk është ideja që ta zgjidhim një problem me Telekomin, ndërsa ta shkaktojmë një krizë tjetër në Postën e Kosovës.

Krejt në fund, ne kemi obligim për punonjësit e Telekomit dhe për punonjësit e Postës, por ideja nuk është që ta zgjidhim vetëm problemin sot e pas disa muajve të kemi probleme të tjera. Qeveria aktuale ka obligim që ta sjellë një strategji të shpejtë e cila e zgjidh problemin aktual me të cilin janë duke u ballafaquar punonjësit e Telekomit të Kosovës, ndërsa ka obligim që të ndërtojë strategji afatgjate që Telekomit i Kosovës të bëhet një ndërmarrje e qëndrueshme financiarisht dhe mos të përballet më me situata të tilla të palakmueshme, siç janë sot punëtorët e Telekomit dhe vetë ndërmarrja Telekomit i Kosovës.

Pra, është e pashmangshme ndërtimi i një strategjie e cila e sjell në profit Telekomin e Kosovës dhe krijon një stabilitet afatgjatë financiar. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Fitore Pacolli-Dalipi.

FITORE PACOLLI-DALIPI: Të nderuar deputetë!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

‘State capture’ ose kapja e shtetit dhe shtet gjysmautoritar janë frazat që e shoqëruan Kosovën në raportet e Komisionit Evropian dhe në ato të organizatave ndërkombëtare. Nuk është më sekret se ish-Kryeministri Thaçi dhe tash Presidenti bashkë me patericat e tij në pushtet dhe përreth pushtetit kanë qenë ideatorë, nxitës dhe promovues i inxhinieringut të kapjes së shtetit, ku të mirat publike vihen në dispozicion të grupeve parapolitike e interesave financiare mu nga ato që mbajnë poste publike.

Rastet e shembujt që e ilustrojnë këtë, nuk mungojnë në Kosovë. Prej proceseve të dështuara gjyqësore deri te shuma marramendëse milionëshe të marra nëpër procese gjoja arbitrazhi apo si gjoba ndaj shtetit. Kur morëm lajmin se Kosova u anëtarësua zyrtarisht më 2016 në Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, secili prej nesh që vjen nga fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare e pritëm sigurisht me optimizëm dhe si avancim i shtetësisë. Vetëm pak ditë pas formalizimit të tij, kërciti çështja e parë. Dardafon.net paditi Telekomin, çuditërisht në një sinkronizim perfekt dhe në një kalendar shembullor. Njëjtë si vendimi i fundit i marrë rrefeshëm nga Gjykata Themelore.

Pas vjedhjes, shkatërrimit dhe në fund privatizimit të shumë ndërmarrjeve shoqërore që dikur ishin profitaile, Telekom i Kosovës është viktima e radhës e ciklit të grabitjes të orkestruara nga trinomi PDK-LDK-AAK. Ky cikël i grabitjes ka vite që synon Telekomin e Kosovës. Secili bord dhe menaxhment i Telekomit nga viti 2010 deri në 2019 kanë pasur vetëm një qëllim, nisjen dhe përfundimin e marrëveshjeve korruptive në njërën anë dhe zhvatjen e Telekomit nga brenda në anën tjetër. Pra sulmi joligjor dhe i dyfishtë nga jashtë dhe nga brenda e ka përplasur përtokë Telekomin.

Qëllimi i krejt kësaj çështjeje është pasurimi i pabazë i individëve të caktuar. Në njërën anë gjithë paraja që rrjedh nga kontratat e dëmshme dhe kriminale, duke filluar nga titulli e deri te ekzekutimi i saj, janë përdorur për financimin e aktiviteteve faktike me qëllim të menaxhimit dhe ushtrimit të ndikimit në gjithë strukturën shtetërore, përfshirë edhe ndërmarrjet publike.

Në anën tjetër, paratë që rrjedhin nga zhvatja, punësimet, trajnimet, udhëtimet, format e tjera të ushtrimit të veprimtarisë së paligjshme brenda Telekomit kanë për qëllim të pasurojnë krerët e partive politike të rrethuara me grupe të caktuara. Ajo që mbetet më tej për t'u analizuar në kuptimin e asaj se pse ende këta njerëz nga këto parti menaxhojnë me shtetin, ka të bëjë me strategjinë e tyre korruptive që përmes mjeteve të caktuara të informimit promovojnë dhe manipulojnë opinionin publik që të pastrojnë veprimet kriminale të këtyre grupeve që kanë kapur Telekomin dhe organet e tjera shtetërore në përgjithësi.

Pra, shpërndarja e parasë që rrjedh nga krimi i organizuar dhe korrupsioni është mekanizmi më i përsosur që pastron këto figura të kriminalizuara. Këto grupe të caktuara brenda partive bashkë me oligarkë kanë krijuar mekanizma të përshtatshëm për të krijuar një opinion pozitiv në shoqëri që kinse çdo gjë që është bërë deri më tani, është në përputhje me ligjin dhe interesin publik. Krejt kjo me qëllim që krimi e korrupsioni të shpërndahet në aso nivele ku personat përgjegjës nuk bartin as përgjegjësinë më të vogël ndaj zhvatjes dhe gllabërimit të parasë së punëtorëve dhe vetë Telekomit. Ky veprim i cili krijon një bashkëdyzim krim e korrupsion në mes të oligarkëve e grupeve të individëve brenda partive politike, pra brenda LDK-së, AAK-së dhe PDK-së, na ka sjellë këtu situatën me industrinë e telekomit, duke cenuar rëndë rendin publik, sigurinë kombëtare. Pra, këto tri parti, në mungesë të koncepteve të përfaqësuar që kanë parë si

mekanizëm për mbijetesë në pushtet shfrytëzimin e kundërligjshëm të parasë publike brenda Telekomit dhe jo vetëm, po vazhdojnë akoma të zhvatin shtetin dhe ndërmarrjet publike.

Pra, kështu, këto vetes ia zgjatin jetën politike duke kontrolluar dhe ndarë paranë publike për nevojat e tyre personale. Në pamundësi që krejt asetë publik privatizohet në afat rekord në përputhje me interesat e tyre, kundërligjshëm kanë marrë nën kontroll financat e këtij asetë. Kontrolli mbi financat e Telekomit, me qëllim të avancimit të interesave të tyre, kanë vënë në rrezik serioz sigurinë e komunikimit elektronik shtetëror, e që rrjedhimisht paraqet sulm direkt ndaj sigurisë shtetërore dhe rendit publik. Mirëpo, këtyre nuk u intereson rendi publik, as interesi publik e as siguria shtetërore. Prandaj, për ta është shumë me rëndësi falimentimi dhe mëpastaj privatizimi nga grupe të caktuara kriminale me çmim më të lirë sesa fal.

Pra, sipas logjikës së këtyre grupeve kriminale, krimi që ka filluar nga koka e Telekomit mund të zhduket vetëm me mbylljen e Telekomit, mirëpo mbyllja e Telekomit në asnjë variant nuk do të ndodhë, sikurse do të ndodhë mbyllja e kriminelëve në burg për këtë dëm të madh që ia kanë shkaktuar Telekomit. Prandaj, Telekomit do të mbijetojë dhe do të rimëkëmbet. Është detyrë kushtetuese e Qeverisë, pra e aksionarit ta mbrojë, të ndihmojë të rimëkëmbet dhe t'ia kthejë dinjitetin ndërmarrjes dhe punëtorëve.

Duhet ta bëjmë të qartë se Vala është e Kosovës, ndërsa kriminelët e Telekomit të shtëpive korrektuese. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Marigona Geci.

MARIGONA GECI: Faleminderit e nderuar nënkryetare e Kuvendit!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Sipas informatave që kam unë, në v. 2010 Postë-Telekomi i Kosovës i atëhershëm ka pasur një vlerë rreth 300 milionë euro dhe në v. 2010 sipas raportit të Auditorit të pavarur, Postë-Telekomi kishte fitim prej 51.5 milionë euro. Kurse, në v. 2016 kishte humbje për 51 milionë euro. Atëherë është përfolur se do të shitet dhe sipas informatave ka pasur edhe shumë blerës seriozë, si blerës amerikanë, austriakë, por edhe nga Shqipëria. E prej atëherë dikush e ka menduar mirë që ta shkatërrojë Telekomit e Kosovës, duke bërë një kontratë me operatorin virtual Z-Mobile.

E çuditshme që produktet dhe shërbimet e Valës t'i shfrytëzojë një operator tjetër që është nënoperator dhe me nënkontraktues dhe del në treg më i mirë se vetë operatori mëmë dhe në këtë mënyrë Telekomit i Kosovës vit pas viti shkoi duke u dobësuar nga fitimet vjetore, sa që tani është në prag të falimentimit. Ky dobësim sipas një analize të thjeshtë u bë që dikush brenda politikës sonë ta blejë Valën me një çmim shumë të ulët apo që edhe kjo kompani të falimentojë e tëra. Pra, ne tani në Kosovë kemi dy kompani: Vala dhe operatorin e dytë të telefonisë mobile IPKO.

Por, nëse IPKO i shitet Serbisë, atëherë siguria e komunikimit të telefonisë mobile të Kosovës mbetet në duar të Serbisë. Nëse Telekom i Kosovës shitet dhe IPKO-n e blen Telekom i Serbisë, atëherë ne prapë do të mbetemi me vetëm një operator dhe çmimet i dirigjon vetëm pronari i ri i Valës, sepse të gjithë konsumatorët do të ikin nga IPKO me pronarë serbë. Të gjitha të dhënat tona që posedon IPKO do t'i kalojnë pronarëve serbë dhe siguria e të dhënave personale të qytetarëve të Republikës së Kosovës do të kalojnë në Serbi. Andaj, Qeveria e Kosovës duhet të bëjë përpjekje maksimale për të gjetur ndonjë zgjidhje për Telekom i Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit znj. Geci! Fjalën e ka deputeti Enver Haliti.

ENVER HALITI: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë fjalimin tim do ta nis me raportin e auditorit nga Zyra Kombëtare e Auditimit, raport i cili për herë të parë është bërë në v. 2018 për kompaninë publike Telekom i Kosovës. Opinioni i Zyrës Kombëtare të Auditimit është opinion i kundërt. Është njëri ndër opinionet më negative që mund t'i japë Zyra Kombëtare e Auditimit për pasqyrat financiare për një ndërmarrje publike apo institucion, i cili është shumë i rëndësishëm siç është edhe Telekom i Kosovës

Pasqyrat vjetore financiare për vitin 2018 thuhet në raport nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale. Viti 2013 u mbyll me 36,1 milionë fitim nga Telekom i Kosovës. Viti 2014 me 16,5 milionë euro fitim. Ndonëse kjo ishte përgjysmë më pak sesa viti 2013 kur fitimi ishte 36,1 milionë euro, me zgjedhjen e Mustafës në krye të Telekomit pritej që të ndalej ky trend negativ i performansës financiare, por përveç që nuk u ndal trendi negativ, ndërmarrja në vitet pasuese shënoi edhe rënien më të madhe ndër vite.

Telekom i Kosovës ka vazhduar trendin e operimit me humbje, përkatësisht në v. 2015 humbja në total ishte 7 milionë e 904 mijë euro. Në vitin 2016, humbja ishte plot 50 milionë e 931 mijë euro. Në vitin 2017, humbja ishte 13 milionë e 904 euro. Në vitin 2018, humbja 15 milionë e 575 mijë euro. D.t.th. në total për pesë vjet Telekom i Kosovës ka humbur 88 milionë e 314 mijë euro. Dhe ai bordi politik për të cilin disa kolegë të mi nga PDK e akuzojnë bordin aktual, i cili ka bërë një punë të shkëlqyeshme, pse nuk kërkuan përgjegjësi nga bordi që të merren masa ndaj ish-kryeshefit Mustafa, ku gjatë pesë viteve shënoi këtë trend negativ duke i shkaktuar humbje Telekomit të Kosovës në hiç më pak se 88 milionë e 314 mijë euro.

Borxhi i Telekomit ndaj ARKEP-it e tejkalon vlerën e 6 milionë e 818 mijë euro. Telekom i gjithashtu ka obligime ndaj Administratës Tatimore, rreth 4 milionë euro dhe ndaj Postës së Kosovës, 2,6 milionë euro, ku në këto momente derisa po bëjmë debat rreth Telekomit, kemi informatën se Administrata Tatimore i ka bllokuar edhe llogaritë e Postës së Kosovës, për shkak se Posta e Kosovës ka borxh ndaj Administratës Tatimore hiç më pak se 1,6 milion euro.

Kjo kompani, Telekom pra, gjatë vitit 2018 kishte angazhuar 178 punonjës dhe detyra të ndryshme pa shpallur konkurs publik, kryesisht familjarët dhe militantë partiakë, edhe pse po përballë me vështirësi të mëdha financiare, ku ishte buzë falimentimit. Fillimisht janë punësuar me kontratë mbi vepër dhe pastaj janë rehatuar me kontrata me afat të pacaktuar. Kompania gjatë v. 2018 kishte bërë edhe 296 lëvizje të stafit brenda në pozita dhe grada pa përfillur asnjë kriter për lëvizje të stafit. Prej gradës 5 në gradën 14, prej 7 në 15, prej 9 në 12 dhe prej 10 në 14. Dhe duke bërë edhe degradime të pozitave për punonjës të tjerë të padëshirueshëm për ekzekutivin, për Bordin që është përballur me padi të shumta, kjo kompani, dhe janë hiç më pak se 800 padi të parashtruara nga punëtorët që janë degraduar nëpër pozita, ku Telekomit të Kosovës i kanë kushtuar më shumë se dy milionë euro, duke i humbur këto raste nëpër gjykatat vendore.

Gjatë v. 2018 gjithashtu nuk ka pasur krahasim ndërmjet trafikut të regjistruar 'switch 3' dhe rrjetit qendror të sistemit të faturimit, ku kjo ka bërë që shërbimet e ofruara nuk janë faturuar të gjitha dhe rrjedhimisht kjo ka shkaktuar dhe humbje të kompanisë. Trafiku i anashkaluar apo aktiviteti ilegal sim to sim që është për Telekomit që ka vërejtur që ky aktivitet ka pasur trend të ri dhe muajve të fundit vitit 2018 dhe 2019, ku në tremujorin e parë të vitit 2019 mesatarisht kanë arritur 200 aktivitete të tilla në muaj. Nga rastet e identifikuar, 90 për qind e këtyre numrave kanë qenë të aktiviteteve sim to sim që i përkasin operatorit Z-Mobile. D.m.th. vjedhja e kredive nga Z-Mobile në numrat e Telekomit të Kosovës.

Ka pasur keqpërdorime në të gjitha format dhe mundësitë, deri te mospagesa e fondeve, numrave humanitarë, ndihma përmes thirrjeve telefonike, zakonisht numrat 0800 e 0900. Deri edhe në këta numra e këto fonde kanë vjedhur.

Mospagesa e fondeve vullnetare të punëtorëve, edhe pse u është ndaluar nga pagat e punëtorëve të Postës. Krijimi i mundësive për tërheqje të mallrave nga depo si telefonat celularë të blerë për fushata të marketingut apo për rritje të besueshmërisë së shërbimeve të Telekomit. Krijimi i mundësive të keqpërdorimeve me kompanitë e sigurimeve shëndetësore, lidhje kontratash dhe vazhdim i tyre pa i kryer këto shërbime dhe pa paguar faturat e këtyre kompanive të sigurimeve, ku janë grumbulluar borxhet dhe derisa i kanë dërguar në përmbarrim, me çka nuk i kanë marrë shërbimet e kompanive të sigurimit, mirëpo faturat janë paguar me penalizime.

Kontrata me kompani fiktive të krijuara vetëm për një qëllim, lidhje e kontratave në emër të shërbimeve të marketingut, me dhjetëra kompani fantome që nuk njihen në Kosovë.

Ekzekutim i pagesave sipas preferencave dhe lidhjeve politike dhe të interesit. Nga shtatë departamente që kanë ekzistuar në Telekomit të Kosovës, janë krijuar 14 departamente. D.t.th. janë dyfishuar departamentet. Në secilin departament, përveç drejtorit janë emëruar edhe dy zëvendës drejtorë, shumë menaxherë fiktivë, sektorë fiktivë, me qëllim kënaqjen e interesave të

ngushta, ku ka departamente që në total ka një drejtor, dy zëvendësdrejtorë, tre menaxherë, një koordinator dhe një zyrtar. D.m.th. departament me gjashtë punëtorë. Ka departamente ku detyrat dhe përgjegjësitë brenda sektorit i ka të përziera dhe konflikte ekstreme dhe mundësi për arsyeshmëri dhe për ikje nga përgjegjësia.

Disa nga kolegët e mi parafolës i përmendën vetëm një kontratë të dëmshme që ka nënshkruar Telekom i Kosovës, si kontratën me Z-Mobile, mirëpo Telekom i Kosovës ka vazhduar apo të them më mirë Bordi ose Kryeshefi Ekzekutiv me kontrata të tjera të stilit të Z-Mobile, siç është kontrata me Pay-Kos, një kompani fantome e cila, negociimi është bërë kinse është një kompani greko-angleze derisa është arritur marrëveshja dhe pas arritjes së një marrëveshjeje të dëmshme për Telekom i Kosovës, është paraqitur një kompani e Kosovës e cila ka nënshkruar këtë marrëveshje me Telekom i Kosovës, duke i stërshitur shërbimet e Telekomit të Kosovës me një përqindje që në fillim ka qenë 10 për qind dhe më vonë Kryeshefi Istrefi e ka ndryshuar këtë kontratë me një aneks ku i ka rritur deri në 30-35 për qind provizionin për shitjen e shërbimeve të Telekomit të Kosovës nga kjo kompani. Një kompani e cila është regjistruar në dhjetor të vitit 2014, ndërsa hiç më pak se tre muaj ditë pas është shpërblyer me kontrata milionëshe nga Telekom i Kosovës pa pasur asnjë ditë përvojë në sektorin e telekomunikimeve. D.t.th. ka fituar në vitin 2015 Pay-Kos minimum 7,5 milionë euro si komisioni për shitje të mbushjeve, minimum rreth një milion euro bonuse për arritje të targeteve si dhe minimum një milion euro për blerje të mbushjeve me çmime me zbritje nga operatori i Telekomit.

Gjithashtu kemi kontratën Advan-Tech, një kontratë tjetër që këto Qeveri, atë që s'kanë arritur ta bëjnë me privatizimin e Telekomit të Kosovës e kanë bërë pikë e pesë dhe po e privatizojnë copa-copa, ditë për ditë me këso kontrata të dëmshme, ku njëra ndër to është edhe kontrata me kompaninë Advan Tech e cila është nënshkruar në fillim të këtij viti, ku e ngjashme me Z-Mobile, duke ia dhënë 60 për qind të hyrave nga shërbimet e internetit, IPTV, IPTV/OTT. Pra kontratë e nënshkruar në fund të v. 2019 nga kryeshefi i atëhershëm Bedri Istrefi.

Desha t'i cek edhe disa nga vendimet që i ka marrë Bordi, sepse u sulmua jashtëzakonisht shumë. Janë mbajtur 15 mbledhje nga Bordi dhe disa sosh nga Auditimi. Janë bërë filtrimi dhe orientimi i pagesave të mirëfillta, ndryshimi i strukturës së zyrtarëve të lartë të cilët kanë pasur ndikim direkt në performancën e korporatës, janë shkarkuar kryeshefi ekzekutiv, zyrtari kryesor financiar dhe suspendimi i drejtorit teknik. Ndalimin e gradimeve dhe mosvazhdimin e kontratave mbi vepër, uljen e strukturuar dhe të domosdoshme të pagave. U vendos dialogu social me organizimet sindikale dhe u arrit pajtueshmëri që të ketë ulje emergjente. Zyrtarët e lartë dhanë shembull personal ku ushtruesi i detyrës së kryeshefit e zvogëloi rrogën rreth 65 për qind nga paga 5800 euro, gradat e ulëta bënë një zvogëlim prej pesë për qind.

KRYESUESJA: Faleminderit z. Haliti! Fjalën e ka deputeti Ardian Shala.

ARDIAN SHALA: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje edhe për ministrat që janë në sallë,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Pasojat e të qenit të papërgjegjshëm ndaj pozicioneve publike sjell në situata të këtilla që pikërisht në momente kritike për ekonominë e vendit kur duhet mbështetje financiare nga asetet publike për t'u ballafaquar me krizën ekonomike të shkaktuar nga pandemia, jo vetëm që nuk mund të kemi të hyra, por duhet të diskutohet edhe për mbijetesën e saj, në mos edhe për të paguar nga paratë e taksapaguesve për gabimet e menaxhmentit.

Është për të ardhur keq që nuk janë ndërmarrë masa konkrete që nga momenti kur Telekomin e Kosovës patën filluar të lajmërohen defektet serioze. Rënia e të hyrave dhe rritja e shpenzimeve që një nga sinjalet e para se ky aset kombëtar ishte futur qëllimisht në rrugën e kolapsit. Këto janë pasojat e politizimit të secilës sferë në vend, përfshirë edhe atë të Telekomit të Kosovës. Nuk mund të imagjinohet sesi një gjigant ekonomik, i cili dikur i sillte të hyra shtetit mbi 100 milionë euro në vit, të vjen në një situatë buzë falimentimit. Në të vërtetë, kjo situatë nuk do të duhej të ndodhte, sepse tani janë të kanosura vendet e punës për 2300 punonjës të Telekomit të Kosovës. Pastaj komunikimi në këtë kohë pandemi seriozisht do ta rrezikonte falimentimi eventual.

Po ashtu institucionet shëndetësore, institucionet e sigurisë kombëtare dhe misionet ndërkombëtare do të ballafaqoheshin me një kaos tjetër, duke iu ndërprerë shërbimet e komunikimit, internetin, telefonia fikse dhe mobile.

Kjo situatë kërkon zgjidhje emergjente, e cila duhet të bëhet duke filluar me ndërrimin e menaxhmentit dhe përkrahje institucionale derisa të kthehet sërish në binarët e zhvillimit. Nuk mund të shitet një gjigant i këtij niveli në këtë gjendje të rëndë, sepse e degradon edhe vlerën e saj në treg. Prandaj duhet filluar me menaxhimin e duhur të saj, duke e fuqizuar atë, edhe kur do të piqeshin kushtet pastaj, do të mund të diskutohej edhe shitja e këtij asemi me rëndësi kombëtare Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit z. Shala! Fjalën e ka Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputete, deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Ju Kabineti qeveritar që jeni këtu,

Qytetarë të nderuar,

Veçanërisht ju punonjës të ndërmarrjes publike të Telekomit të Kosovës,

Ndërmarrja publike Telekomit të Kosovës është duke u ballafaquar me sfida e probleme të rënda.

Në këto momente kësaj situatë kritike që e karakterizon këtë ndërmarrje publike që për fatin e

keq të kësaj dhe të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje, kjo Qeveri dhe Qeveria e kaluar nuk kanë bërë asnjë veprim pozitiv për rimëkëmbjen e saj. Përderisa në të kaluarën sa ishin në opozitë trumbetonin dhe inicionin rezoluta për Telekomin e Kosovës dhe bënin veprime të tjera kinse për ta mbrojtur këtë ndërmarrjeje.

Duke pasur parasysh rëndësinë dhe ndjeshmërinë tejet të lartë të sektorit strategjik të komunikimeve elektronike, që ndërlidhet me interesin nacional dhe shumë segmente të tjera, Qeveria e Kosovës bazuar në Ligjin për ndërmarrjet publike e ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në ndërmarrjet publike qendrore. Prandaj është e nevojshme dhe e domosdoshme të veprohet dhe të bëhen veprime të shpejta dhe aktivitete urgjente në mënyrë që të mos rrezikohet ndërprerja e operimit dhe ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike, si dhe të mos rrezikohet funksionaliteti i kësaj ndërmarrjeje vitale për interes shtetëror dhe për interes të Kosovës.

Veprimet e domosdoshme dhe reagimet e shpejta për përmirësimin e situatës së krijuar në Telekomin e Kosovës lidhet me faktin se në ndërmarrje i është përkeqësuar jashtëzakonisht gjendja financiare, rrezikohet ndërprerja e ofrimit të shërbimeve telekomunikuese, rrezikohen të ardhurat e 2300 punonjësve dhe mirëqenia e familjeve të tyre. Rrezikohet edhe operimi dhe aktiviteti biznesor i kësaj ndërmarrjeje.

Gjendja aktuale kritike në Telekomin e Kosovës që karakterizohet me mungesë të parasë së gatshme, rënie të të hyrave, pamundësi për të kryer detyrimet financiare ndaj obligimeve ligjore e ndaj operatorëve ekonomikë si rrjedhojë e mungesës së investimeve të nevojshme teknologjike, menaxhimit joefikas, monitorimi joefikas dhe i duhur i njësisë për monitorimin e ndërmarrjeve publike, ministrisë së linjës, që kanë lejuar që për disa vite Telekom i Kosovës të performojë me humbje financiare duke mos ndërhyrë në përmirësimin e gjendjes financiare të kësaj ndërmarrjeje. Përkundër gjithë këtyre lëshimeve dhe dukurive, situata në këtë ndërmarrje publike dhe aset vital të rëndësishëm të Kosovës, kërkohet nga aksionari, Qeveria që të ketë veprime konkrete me masa urgjente për të shpëtuar Telekomin e Kosovës nga pezullimi i plotë operimit dhe nga falimentimi.

Meqenëse Qeveria e Republikës së Kosovës është titullare qind për qind e aksioneve të Telekomit të Kosovës, e ka përgjegjësinë dhe kompetencën e plotë të ndërmarrë veprime dhe vendime që do t'i japin orientim dhe kahje pozitive për të mundësuar vazhdimësinë e biznesit dhe zhbllokimin e situatës së rëndë e të ndjeshme në këtë ndërmarrje me peshë.

Qeveria dhe ndërmarrja duhet të përballen me sfidat e kësaj ndërmarrjeje. Duhet të gjejnë mundësinë e arritjes së një zgjidhjeje urgjente për lirimin e llogarive bankare dhe të ndërmarrin masa efikase dhe të shpejta që të mundësohet vazhdimësia e biznesit të Telekomit të Kosovës.

Mendoj që do të duhej që në radhë të parë të hartojnë sa më parë planin emergjent strategjik për rimëkëmbjen dhe rritjen e vlerës së kompanisë, të sigurohet mbështetje financiare dhe garanci kreditore për rimëkëmbjen e ndërmarrjes së re dhe kthimin e saj në treg. Të realizohet riskstrukturimi efikas i ndërmarrjes. Të hetohen e të trajtohen të gjitha fenomenet dhe faktorët determinues që kanë ndikuar në gjendjen e krijuar në Telekomin e Kosovës përmes organeve ligjzbatuese dhe të marrin epilogun e duhur. Faleminderit!

KRYESUESJA: Deputeti Mefail Bajqinovci e ka fjalën.

MEFAIL BAJQINOVCI: Faleminderit e nderuar kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Kolegë,

E nderuar Qeveri,

U tha shumë. Desha të flas goxha shumë për Telekomin, por i treguan edhe kolegët e mi të Lëvizjes Vetëvendosje për keqpërdorimet që kanë ndodhur aty me vite të tëra. Telekom i sa është buzë falimentimit, ne po e shohim për shkak të keqmenaxhimit dhe vjedhjes permanente dhe keqpërdorimeve të drejtuesve në këto njëzet vjet prej partive politike që i kanë emëruar. Por e keqja më e madhe tashmë veç u tha këtu është kontrata më kriminale e nënshkruar me Dardafon apo mund të them me Z-Mobile.

Ju e dini, po i përmendni shumë ju menaxherët, por ju e dini që politika është prapa gjithë kësaj. Ju e dini kur thoshte Shyqyri Haxha në EULEX që unë jam detyruar nga Hashim Thaçi të nënshkruajë kontratën, pastaj pas dy javësh harronte, thoshte valla kam harruar, jo nuk e di që më ka thënë.

Këtu i kemi edhe rreth 800 kontrata të cilat janë përmendur edhe ditë më herët që kontraktorë të cilët nga PTK-ja marrin para, pra pothuajse shumë pak punohet dhe gjithçka pothuajse është e privatizuar në atë institucion. E dëgjova dje kryetarin e Sindikatës, që ishte shumë situatë e rëndë kur tha se Qeveria e Kosovës në prani të Devollëve nuk guxonin as të flisnin, dje në mbledhjen që e kishin me ta. Edhe Qeveria e luste Kryeministri Devollin me çdo kusht që mos të bëhet kjo nguti, ndërsa ata tha as nuk e bënin hesap Kryeministrin në mbledhje. Z. Kuçi e di, aty me siguri ke qenë. Zoti Lamih Balaj tha nuk e dita a jam në Qeverinë e Kosovës apo diku në kafe. Kush është Devolli bre që po tuteni kaq fort prej tij? Pse ka kaq frikë edhe kaq zbutje prej tij? Çka është puna? Pse ai krejt ta ketë shtetin në dorë? Nuk janë fajtorë veç politikanët, edhe këta zvatësit politikanë që e kanë udhëhequr PTK-në që njëzet vjet. Janë fajtorë edhe policia e krimeve ekonomike. Që njëzet vjet e përcjell këtë institucion, edhe çka ndodh, bëjnë me dhjetëra filma duke bërë bastisje, duke bërë hetime, duke qëndruar nëpër zyra të drejtorëve dhe në fund veç dëgjon kur një polic i krimeve ekonomike iu punësua gruaja, një komandantit iu punësua familja, një ministrit iu punësua motra, një deputetit gruaja. Gjithçka. Edhe çka ndodh? Ia kanë filluar tash t'i ndërrojnë edhe mbiemrat në Telekom.

E kam këtu edhe një, prej 98 menaxherëve apo si do quajeni, 56 janë të PDK-së, 15 janë të LDK-së, 16 janë të AAK-së, Nisma 5 dhe disa minoritete të tjera të parëndësishme. S'ka! Edhe tash, lëre që i keni sekretarët e degëve, që qendrave, s'keni lënë kë pa e punësuar aty.

Kur flasim pak për operatorin virtual. Para se të kaloj te operatori virtual, nuk e di a është z. Haxhiu këtu. E përmendi, na atakoi me emra. Desha edhe t'ia bëj një pyetje. Nëse ka mundësi të na tregojë sa anëtarë të familjes i ka të punësuar në Postë dhe sa anëtarë i ka në Telekom? Kaq! Pastaj edhe për institucionet e tjera, nëse ka mundësi të na tregojë?

Z-Mobile, pra ky operator virtual që iu mundësua ta shfrytëzojë infrastrukturën komplet të Telekomit, një operator virtual i mirëfilltë ka më shumë pajisje dhe kryen shumë më shumë punë teknike se Z-Mobile që kufizohet njëfarë ripaketimi e bën të shërbimeve dhe kujdes ndaj konsumatorit. Kjo nuk dallon aq shumë prej shitësit të mbushjeve në mëhallë. Kurse, Z-Mobile ka mbajtur shumicën dërmuese dhe nuk i ka mbuluar kostot e mirëmbajtjes, që sa vjet madje. Nuk ka paguar as 27 përqindëshin.

Telekomi i Kosovës nga viti 2007 - 2020, po flas pas shpalljes së pavarësisë dhe kalimit të kompetencave nga ndërkombëtarët te vendorët fillon degradimi i tij. Në v. 2009, buxhetit të Kosovës PTK i jepte me qindra miliona euro, pra derisa ka ardhur PDK-ja në krye në pushtet. Më pastaj e kemi pra të fundit, Agron Mustafën, që e ka marrë me 50 milionë dhe e dini që me minus 300 milionë e ka lëshuar këtë Telekomini.

Kthehemi pak te kontratat e nënshkuara nga ish-Kryeshefi Mustafa. Nënshkrimi i kontratës me Nokia-Cactus me vlerë prej 34 milionë për zgjerimin e shërbimeve 3G dhe 4G, e cila sipas ekspertëve të PDK-së kishte mundur të përfundojë me 20 milionë euro. Nënshkrimi i kontratës me Pay kupton shitjen, distribuimin e mbushjeve elektronike me fitim prej 15 për qind me gjithë bonuse dhe ankes-kontrata. Këtë shërim më herët e kanë kryer punëtorët e kompanisë. Humbja e rastit në arbitrazh, më e rënda me Z-Mobile, është bërë e qëllimshme, sepse Zyra Ligjore tashmë e thanë kolegët as nuk e kanë mbrojtur. Pra, kanë qenë miq të tij, që ka qenë edhe njëfarë konflikti i interesit. Pra, mbrojtja është bërë qëllimisht.

Pastaj, zhatja e buxhetit përmes marketingut në reklama që u përmend diku në promocione përreth 39 milionë euro. Megjithatë, gjëja kryesore mos të harrojmë gjatë kohës së z. Mustafa, punësimi ka qenë 50-50, apo 50 LDK-ja 50 PDK0ja, në kohën e Isa Mustafës.

Megjithatë, gjëja kryesore që e ka rrëzuar përtokë këtë gjigant të rëndësishëm të telekomunikimeve është pra kjo kontratë që u përmend dhe që po e falimenton. Them është goditja më e madhe deri më sot. Kjo marrëveshje, mos të shkojmë më tej duke thënë se jo ky drejtor, jo ky sekretar, jo ai menaxher, është bërë direkt, e ka thënë Shyqyri Haxha, me detyrim të Hashim Thaçit. Ju i dini edhe kontratat e tjera të dyshimta të ndërmarrjes publike me djemtë e

Adem Grabovcit, koordinatori të PDK-së që përmendej edhe në Pronto. Kontrata pra me Fleksus, por që është në pronësi të tyre. Ata kanë përfituar çdo muaj nga 5 mijë euro, pra mbi 400 mijë euro.

Kompanitë e afërta me Telekomin, kompanitë që kanë fituar më së shumti tenderë janë të afërta me PDK-në. PTK-ja ka shpenzuar afro 37 milionë deri 39 milionë gjatë këtyre 14 vjetëve për kompani, pra për portale, media të ndryshme. Nuk jam kundër që mediat duhet të avancohen, por jo mediat fiktive të cilat veç janë bërë publike.

Në v. 2018, për një vit Telekom lidhi 202 kontrata mbi vepër dhe është interesant, kthehemi pak edhe më herët, para 15-16 vjetëve, nuk ka asnjë të arrestuar në rastin më kriminal të dështimit për të arkëtuar garancinë bankare në vlerë prej 16 milionë euro, që është 20 për qind e ofertës financiare të të ranguarit të parë të tenderit të telefonisë mobile Kosmocell.

Telekomi është dënuar në arbitrazh dhe kjo tash nuk kemi çka të shtojmë dhe dëmi që është duke iu faturuar çdo ditë, Qeveria po e bën njëfarë marrëveshje me ta që prapë ndoshta ta bëjë hisedar Devollin. Andaj, ministër Bleim Kuçi, a mund të na tregoni se cila është oferta që do t'ia bëni ju Devollit tash? Kjo është pyetja ime për juve, sepse shpesh po flitet që prapë mund të na futni për t'i larë këto 26 milionë ta bëni hisedar aty. Nëse është e vërtetë, ju lutem na e thoni!

Prokuroria dhe Policia duhet urgjentisht të hetojnë dhe të ndiqen të gjithë ata që e kanë bërë këtë dëm me mbi 100 milionë si dhe të atyre qindra e mijëra e kontratave të dëmshme që menaxherët dhe Bordi i ka marrë. Këtë masakër ndaj pasurisë publike nuk e di nëse do ta kishte bërë edhe ndonjë shtet e armik sesa ia keni bërë ju këtij aseti kombëtar, pra aset mjaft i rëndësishëm. Tashmë krejt lufta për të negociuar nga ana e Qeverisë është pra për t'i futur Devollët brenda, për ta shfrytëzuar prapë infrastrukturën e Telekomit.

Nuk po e zgjas shumë se i thanë të gjitha krimet e hajnitë kolegët e mi për Telekomin se çka ka ndodhur, kontratat e dëmshme, andaj besoj që Policia e krimeve ekonomike mos të shkojë më në PTK dhe për t'u punësuar aty, por le të shkojë t'i hetojë dhe le të dalin para Prokurorisë ata të cilët e kanë vjedhur dhe e kanë keqpërdorur Telekomin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, z. Bajqinovci! Për replikë është paraqitur deputeti Bekim Haxhiu dhe pastaj edhe ministri.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, nënkryetare!

Mefailit, si gazetar i ka marrë këtu, që njëkohësisht edhe ka punuar më herët edhe në KTV edhe në Antikorrupsion. Këtu tash për të gënjyer e të shpifur, e të spekulojë e ka bahçe, thotë çka të dojë ky se këtu s'e kap ligji. Por po të tregoj kështu, asnjë familjar i imi nuk punon në Telekom. Asnjë! Dhe në Postë kam të punësuar po aq sa ka Albulena Haxhiu dhe ju të Vetëvendosjes.

Njëjtë! Sa ka Albulena Haxhiu. Edhe kështu po ta them, më jep tre milionë e gjysmë euro qysh ia keni dhënë atij Fisnik Ismailit, asnjë anëtar i familjes sime, as kushëri, edhe katundit i them rrini te shpija se të gjithëve do t'ju mbaj unë. Vetëm m'i jepni 3,5 milionë, sikurse që ia keni dhënë Fisnik Ismailit. A po kupton!

Vetëm m'i jep 3,5 milionë edhe katundit do t'i them rrini në shtëpi se ju mbaj unë deri sa të jem gjallë. Lëreni more këto marre, atje shko vjedh e hajde këtu akuzo tjetër kë. Me përmbarues keni marrë para dhe tregoni se sa para i keni marrë prej përmbaruesit.

Sa para i ka përfituar Vetëvendosja prej përmbaruesit, sa ju si parti dhe sa ai vet? I keni lënë punëtorët e shkretët pa paga, e këtu vini e shitni moral. E keni pasur mundësinë që ta padisni Devollin. Ia keni mbajtur 15 ditë në sirtarë, Albin Kurti ia ka mbajtur dosjen. S'ka bërë as padi as kundër-padi, e këtu vini dhe më shisni moral duke thënë, Devolli, jo fyti këtij jo fyti i atij.

Fyti i të gjithëve, fyti i korrupsionit. Me emër me mbiemër, kushdo mund t'ia jap. Kam qenë në komision hetimor, 240 milionë euro kanë qenë të hyrat e Z-Mobile në Telekom, të deklaruara në ATK nuk i ka as 85 milionë euro. Atëherë kam kërkuar që kjo çështje të shkojë deri në fund.

Kushdo që i ka pasur duart në të, që është i zhytur, në prokurori. Për fat të keq prokuroria e EULEX-it e ka heshtur këtë rast, jo shqiptarët. Se e ke njëfarë obsesioni ndaj PDK-së.

Ky proces ka filluar pa qenë në PDK...

KRYESUESJA: Deputeti Bajqinovci, kundër-replikë!

MEFAIL BAJQINOVCI: Unë ju pyeta deputet se kë e keni në postë. Nuk tregove, e mos të them tash se e ke edhe vëllain kryeshef. Pra, krejt familjen e ke nëpër pozita të larta.

A është në deponi? Po, pra. Pse veç ju po i keni të gjithë? Jo, nuk thashë që është hajn, por raportet e auditorit po e tregojnë të veten se qysh e keni menaxhuar shtetin këto 20 vite.

Raportet e auditorit janë krejt masakra dhe raportet ndërkombëtare, raportet e Departamentit të Shtetit, raportet e Progresit, tregojnë që ky vend keqmenaxhohet, keqpërdoret, vidhet dhe të gjitha të zezat. Pra, na thuaj që një raport ka dal pozitiv për vendin tonë për menaxhimin e këtyre aseteve, pra institucioneve tona.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Kuçi.

MINISTRI BLERIM KUÇI: Zoti Bajqinovci, se ma dhe njëfarë mesazhi për trimëri. Por, ta kesh me dije se Dardafonat edhe Bajqinovcat i kam kaluar moti.

Unë prita prej jush, që së paku të ma jepni një rekomandim për zgjedhje. Keni pasur rastin zoti Bajqinovci që ta bëni zgjidhjen, s'e keni bërë. Të flasësh është kollaj, të kundërshtosh është kollaj, por kundërshtimi nuk është gradë e lartë e inteligjencës, po e kundërta, është e ulëta.

Ndërkaq, për trimëri, eja kur të duash!

KRYESUESI: Kundër-replikë, deputeti Bajqinovci!

MEFAIL BAJQINOVCI: Ta përmenda emrin dhe s'keni guxuar. Ai e tha dje në Tv Dukagjin, të dëgjoheni aty brenda e po vini e po na thoni neve. Unë nuk thash vet, po thash zoti Lami Balaj. Nuk e di a isha në Qeveri a ku. Prej Devollëve, nuk e dija se ku jam ulur.

Unë nuk po e them vet ministër. Pse po e qet Bajqinovci, ministër, ashtu? Pse po tenton që thuash, na kërcënove me Bajqinovca? Pse?

Unë thash Lami Balaj, kryetari i federatës tha, nuk e dija se ku jam. Kështu tha kryetari i sindikatës. Mos e qit tash personale.

KRYESUESJA: Faleminderit! S'ka përgjigje ministri. Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zonja kryesuese!

Edhe pse nuk e pata ndërmend të diskutoj, por më bëri përshtypje kërkesa e ministrit edhe për shkak të respektit, do t'i them dy-tri fjalë me disa rekomandime si koleg që e kam pasur.

Para se t'i them ato konkretisht, nëse ia kam qëlluar diku, po i jep përkrahje të plotë një debati i cili u zhvillua këtu për krejt historikun që ka ndodhur në këtë ndërmarrje me rëndësi të veçantë për shtetin, të cilën politika, udhëheqësit më të lartë të vendit, bashkë me udhëheqësit apo menaxherët në këtë kompani tonën publike, për 10 vjet rresht e kanë sjellë në këtë derexhe, para falimentimit.

Unë pajtohem plotësisht me konstatimin se kjo kompani nuk duhet të lihet që të falimentojë në asnjë variant, sepse do të falimentojë një pjesë e shtetit dhe një pjesë e sovranitetit tonë.

Besoj që asnjë deputet nuk mund të thotë ndryshe, se s'ka mendim ndryshe për këtë. Por, për t'i dhënë kuptim këtij diskutimit tim, unë po i përkrahi plotësisht dy deputetë të Vetëvendosjes, zotin Rexhep Selimi dhe Mimoza Kusarin për pjesën e paraqitjeve në mënyrë shumë sistematike dhe kronologjike, qoftë të asaj politike, ekonomike dhe të masave të përgjegjësisë, që të mos e përsërisë.

Është historik i plotë që u tha këtu, po e them kështu, me emër, me funksion, me detyrë, se kush ishin përgjegjësit që kanë sjellë.

Nëse do ky Parlament, edhe ndonjëherë ndonjë qeveri edhe ndonjëherë drejtësi në këtë Kosovë, ka për çka të angazhohet për këto çështje që janë ngritur ose për këtë ndërmarrje për atë se çfarë ka ndodhur brenda 10 vitesh. Qoftë për ata që i kanë nënshkruar kontratat, për ata që kanë qëndruar pas kontrata, qoftë edhe për sektorin privat, se asnjëherë nuk po themi, edhe ai nuk ka të drejtë t'ia bëjë shtetit tonë këtë.

Kanë ndodhur dhe jam për atë që të nxirren rekomandimet për pjesët që i kanë thënë këta dy kolegë.

Tani, sa i përket kërkesës së ministrit. Unë ndërkohë, nëse rekomandimet janë të arsyeshme, gjendja është, mund të themi nëse doni e përmasave të dhunshme, ose përmasa të jashtëzakonshme, emrin ngjitjani si të doni, por Qeveria si aksionar, unë mendoj që duhet ta marr nën administrimin e vet, e jo siç është administruar deri më sot.

Për shkak të situatës aktuale edhe për t'i dhënë një mundësi një hap më tutje, thjesht ta zëmë hapin e ri, por kjo nuk mjafton vetëm me fjalë. Pra, si të doni thoni, unë po them, nën administrim shtetëror.

E dyta, duhet ta bëni menjëherë emrin e një ekipi profesional, prej inxhinierëve, prej ekonomistëve brenda që janë në postë edhe ndonjë konsultant nga jashtë, por jo ata që i keni paguar, siç u tha këtu, për faqe të zezë, edhe ndonjë jurist, dhe realisht këta të përgatisin komplet strategjinë e ristrukturimit, të organizimit, të menaxhimit dhe përshtatjes së kësaj ndërmarrjeje për këtë situatë aktuale. Pra, për një periudhë kohore tre deri në pesë vite.

Pra, të merremi me krejt panoramën e kësaj kompanie dhe ta shohim se çfarë duhet në mënyrë imediate të ndryshohet brenda.

Pajtohem plotësisht që kjo ndërmarrje nuk duhet të lihet që të shkojë në falimentim.

Ne, duhet qoftë prej anës së brendshme, qoftë prej anës së jashtme, a duhen 40 milionë a duhen 50 a duhen 80, a duhen 100. Është një pjesë e sovranitetit të shtetit tonë.

Duhet t'ia japim si administrim, por duhet t'ia japim si hua për tri deri në pesë vjet. Deri ne tash folëm çfarë kompanie dhe si ka mundur që kjo të punojë pozitivisht, të ketë afarizëm të mirë, të ketë difientë, të ketë fitim, të ketë të mira edhe shteti, jo vetëm punëtorët që kanë hyrë atje.

Kanë hyrë si kanë hyrë, ajo këngë u këndua këtu, u tha. Ata janë vëllezër, motra tona, janë kujt lë jenë, dikush më shumë dikush më pak. Është një çështje sociale, nuk pajtohem me atë, sepse nuk është në pajtim me ekonominë e tregut, me konkurrencën, me ndërmarrjen, me logjikën sesi organizohet edhe një ndërmarrje edhe shtetit.

Por, ia lëmë kohë, e këtë le ta bëjë ekipi i ri. Se nuk të mund të bëjë konkurrencë, por sot s'mund ta bëjmë atë.

Prandaj, unë them që ndihma ekonomike, kësaj ndërmarrjeje i duhet. Sa, është çështje tjetër. Si hua m'i dhënë tre deri në pesë vjet.

Tjetra, duhet patjetër që Qeveria si aksionar së bashku me këtë ekip ta bëjë dezinfektimit e kësaj kompanie prej krejt individëve të cilët janë inkriminuar në këtë që e thanë kolegët këtu. Nuk kanë vend brenda.

Po ashtu, duhet të dezinfektohet prej të gjitha kontratave, të cilat u përmenden këtu, me kompani fantome.

Nuk keni kë ta pyesni tjetër. Ju ka zgjedhur Parlamenti, e keni këtë të drejtë, bëjeni këto. Keni drejtë ta sillni në emër të shtetit. S'keni pse të prisni dhe as të bëni debate të gjata në Parlament. Jeni ekzekutiv, e keni përkrahjen e plotë ministër.

Tjetër, në ndërkohë. Unë po e them që deri në fund të tetorit, unë po e them kështu ndoshta s'e kam me vend, është mirë që bëhet së bashku me Parlamentin, strategjinë çfarë ndryshimesh ligjore duhet bërë për këtë kompani, gjegjësisht për sektorin e telekomunikacionit në Kosovë, lidhur me përgatitjen për privatizimin, lidhur me këtë ristrukturim që i duhet.

Ta bëjmë bashkërisht, që fundi i tetorit të na gjejë me ato masa të tjera të ekipi tjetër.

Mendoj që këtu do mbetem borxh në qoftë se nuk e them një të vërtetë që ka ndodhur në vitin në vitin 2009-2010. Pse politika i ka borxh kësaj kompanie? Kam qenë në po këtë ulëse këtu, i deleguar nga Lidhja Demokratike në Komision FunkSIONAL për Ekonomi, Telekomunikacion dhe të tjera.

Tre muaj ditë kemi punuar në strategjinë, në atë kohë, për përgatitjen për privatizimin e kësaj kompanie. Nuk kam qenë vet. Kryetare e komisionit ka qenë Myzejene Selmani nga AKR-ja, nënkryetar ka qenë Ethem Çeku, ka qenë zonja e nderuar Berisha-Shala. Kështu që, bashkërisht kemi punuar me një ekip për tre muaj ditë dhe i kemi ofruar këtij parlamenti strategjinë që ta aprovojë, në prag të aprovimit.

Që do të ndodhte një privatizim 51-55% të kompanisë në atë kohë, na doli kundërshtarë politika prej të parit deri të i fundit, në këtë Kuvend. Si prej Partisë Demokratike që e kishte kryeministrin si prej Lidhjes Demokratike që unë e përfaqësoja këtu, si prej Parlamentit, dhe nuk u aprovua. Mendoj që prej atëherë, kjo kompani e ka marrë teposhtën.

Sikur të aprovoj ajo strategji në atë kohë, sikur të lejohej privatizimi 51-55%, që ne i kërkuar që në 20-25% pas tre vjetësh, por asnjë kompanie tjetër të mos i jepej në ndërkohë konkurrenca, për arsye që të valorizohet. Ndoshta, ai 25% që do të shitej më vonë, pas tre vjetësh, do të ishte me qindra-qindra miliona më shumë se ajo pjesa e parë. Po edhe e para ka pasur që të kuotohet, jo të thuhet po shitet për 50 milionë.

Këtë do ta vlerësonte ekipi profesional. Ndoshta do të thoshte ndër 500 s'e shesim, ndër 1 miliard s'e shesim. Kjo është çështje tjetër.

Pra, edhe një herë po ju tregoj. Ka ndërhyrë politika dhe nuk na ka lejuar. Tre muaj ditë këtu i kemi thyer dhëmbët ne si deputetë, dhe i kanë mbetur borxh dhe për këtë arsye kanë ndodhur krejt këto që kanë ndodhur. Edhe është për turp.

Emër e mbiemër kanë, Rexha e tha shumë mirë më herët, dikush-dikushi. Unë po them, dikush në krye të institucionet dhe ata kanë emër dhe mbiemër dhe duhet të përgjigjen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Rexhepi. Fjalën e ka deputeti Hekuran Murati.

HEKURAN MURATI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë të pranishëm,

Ju kisha referuar dhe fjalimit të mëhershëm të ministrit që e përmendi fjalën shkëputje dhe ia bëra me dorë që mos thuaj shkëputje.

Tani që je ministër, ke përgjegjësi të tjera. Si qytetar i thjesht, mund të flasësh çfarë të duash, nuk je imunitet nga ligji, por nuk mund t'i bësh dëm shtetit. Mund t'i bësh dëm vetëm vetës. Në pozitën ekzekutive mund t'i bësh dëm shtetit.

Nuk ka pasur shkëputje të kontratës, ka pasur mosvazhdim. Duhet të ketë shumë kujdes kur fliten këto fjalë. Përveç nëse ka ndonjë qëllim tjetër dhe po tentohet që më këso deklaratash, t'i ndihmohet tash prapë Devollit, në arbitrazhin e ri, dhe të thuhet që Telekomit njëanshëm e ka shkëputur kontratën. Nuk ka pasur shkëputje të kontratës, ka pasur mosvazhdim.

E thatë që bordi që paskëshit vendosur ju Qeveria e PAN-it edhe menaxhmenti e paska shkëputur. Edhe një herë, ka qenë mosvazhdim për të cilin i kam njoftuar për herë të parë në

vitin 2018. Pra, edhe menaxhmenti deri atëherë, ka thënë që kontrata me Z-Mobile është e përhershme, sepse edhe ashtu shkruan.

Në kontratë shkruan përderisa të ketë licencë, mirëpo kurrë askush nuk e ka marrë mundin që të shikojë se deri kur i përfundon licenca Telekomit, e licenca i përfundonte më 31 korrik 2019. Pra, kishte fund kjo kontratë.

Në momentin që ka përfunduar licenca e Telekomit, e që është dashur të rinovohet, ka përfunduar edhe kontrata e Z-Mobile, e cila është dashur, se u tha mosvazhdimi, që përveç mosvazhdimit, qysh në atë kohë do duhej të goditet me kundër-padi.

Fillimisht, të tentohet të shpallet e pavlefshme. Të kërkohet që të shpallet e pavlefshme ajo kontratë, sepse dihet si ka ardhur deri të nënshkrimi i saj. Dhe së dyti, do duhej që t'i kërkohet dëmshpërblim Z-Mobile për dëmet financiare që ia ka shkaktuar Telekomit.

U përmend edhe këtu. Tash janë dy pika kyçe të cilat mund ta zbërthejnë dëmin që ka ndodhur deri tash. Është nënshkrimi i vetë kontratës, i cili është një akt kriminal. Edhe u tha që kontrata është përgatitur nga Adnan Merovci, por nëse PDK-ja e ka pasur për zemër këtë kompani, pse e la Shyqyri Haxhën që ta nënshkruaj, të cilin e quanin menaxher të vitit asokohe.

Domethënë, janë lajmet. Mund t'i shohim të gjithë.

Edhe pika e dytë është mosmbrojtja e Telekomit në gjyq, para drejtësisë nga vet personeli i Telekomit dhe nga palët e lidhura që do duhej ta mbronin.

U tha këtu që Qeveria Kurti nuk paska dërgua kundër-padi tash së fundmi, gjë që është shpifje dhe e pavërtetë, për shkak se avokatura shtetërore së bashku me këshilltarët e kabinetit të Qeverisë, e kanë bërë gati kundër-padinë në mënyrë të shkëlqyeshme dhe i është dorëzuar Sami Istrefit, i cili me sa kuptova, qenka vëllai i menaxherit të atëhershëm, pra i ish-kryeshefit ekzekutiv, Bedri Istrefit.

Tash, nëse ky që e ka marrë këtë edhe e ka pasur detyrë që ta deponojë dhe nuk e ka kryer, pra po vijmë te kjo pika e dytë, ku Telekomit, interesi shtetëror nuk është mbrojtur. Nuk është mbrojtur prej palëve që e kanë për obligim që ta mbrojnë.

Sa i përket kompanisë, ndërmarrjes publike. Është e vërtetë, siç e thanë edhe disa të tjerë, që lëngon prej shumë e shumë të metave. Ka pasur punësime të panevojshme. Ka pasur shpenzime të panevojshme. Ka pasur lidhje të këtyre kontratave që kanë harxhuar dhjetëra e dhjetëra miliona pa qitur kurrëgjë në dritë.

Ka pasur qindra kontrata të tjera për qira me shumë eksponentë të partive politike, sidomos të PDK-së, është evidente kjo. Po ashtu, edhe kontrata të marketingut në shumë e shumë prej mediave, në mënyrë që ato pastaj të vihen nën kontroll edhe në shërbim të partisë në pushtet.

Mirëpo, ishte kontrata me Z-Mobile që ia dha goditjen përfundimtare, dhe kjo dëshmohet me vet faktin që nuk është veç Telekomit që punon me humbje në Kosovë, është edhe IPKO. Edhe kompania IPKO operon me humbje në Kosovë.

Prandaj, edhe është detyruar tash që ta qesë njësinë Telekom Sllovenia, ta qesë këtë njësi në shitje edhe dëshiron të largohet si investitor i huaj nga Kosova, sepse e ka vlerësuar që në një ambient të tillë, me një konkurrencë të tillë të paligjshme, nuk mund të operojë siç duhet.

Por, nuk është vetëm Telekomit, ku shteti është vendosur në shërbim të kësaj kompanie apo të këtyre personave. I kemi edhe shumë shembuj të tjerë.

Do të filloja prej KOSTT-it, meqenëse nuk është shembull që e dinë shumë persona edhe nuk kanë shumë njohuri. Korporata KOSTT, pra Operatori i rrjetit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut, ka investuar në kablllo fibër optik.

Pra, edhe një herë po e përsërisë. Një kompani shtetërore me kapital shtetëror, shoqëri aksionare, ka investuar në kablllo fibër optik, që nuk e ka as aktivitet primar as sekondar të operimit. Mbi 1 mijë kilometra. Çfarë ka ndodhur me ato kablllo fibër optik? I janë dhënë me qira kompanisë së Devollëve, kompanisë Artmotion.

Pra, kompania Artmotion e shfrytëzon një investim me para të shtetit që të operojë me një biznes dhe të bëjë konkurrencë në treg, konkurrencë të jashtëligjshme.

E kemi ZRRE-në. E kemi pasur edhe në Komision për Ekonomi, ZRRE-ja ia ka mundësuar, prapë kompanisë Devolli, që të përfitojë miliona euro duke ia fiksuar tarifën nxitëse kundërligjshëm.

Pra, kemi pasur reagime për këtë çështje prej ambasadave, prej të gjitha institucioneve relevante evropiane që merren me energjetikë, të cilat e kanë kundërshtuar këtë praktikë.

Kemi Ministrinë e Infrastrukturës e cila vjedh në shërbim, duke ia dhënë ose duke i obliguar të gjitha qendrat e kontrollit teknik t'i paguajnë nga pesë euro kompanisë Eurolab, që po ashtu është pronë e Devollit, për t'i fotografuar dhe verifikuar automjetet nga larg.

E kemi Doganën e Kosovës që është vënë në shërbim, po ashtu, të kësaj kompanie, të kësaj korporate për procesin e homologimit. Në momentin kur dikush e importon një veturë, qoftë e re,

qoftë e përdorur, doganieri që është punëtor i shtetit detyrohet ta marrë një letër edhe t'ia jap qytetarit dhe t'i thotë, i ke 15 ditë, nëse s'shkon që t'ia japësh 100 euro kësaj kompanie, duhet ta konfiskojmë kerrin.

Tash, përmbajtja në atë letër është kundër-kushtetuese, po megjithatë shteti i është vënë në shërbim një kompanie private.

E kemi edhe Telekomin për rastin për të cilin po bisedojmë sot. Tash, që të kthehem edhe një herë te pika e parë. U provua që të bëhet njëfarë normalizimi, të nxirret njëfarë përgjithësimi me fjalë e terme të përgjithshme, është shumë e qartë, dihet kush e ka nënshkruar këtë kontratë. Dihet në kohën e kujt është nënshkruar kjo kontratë dhe kush ka qenë në pushtet.

Pra, ka qenë PDK-ja në pushtet kur është nënshkruar kjo kontratë.

Pas Shyqyri Haxhës, le të themi hajde paska qenë gabim. E kemi Agron Mustafën i cili e nënshkroi kontratën me PayKos-in dhe u përmend këtu se sa e dëmshme është.

Pas Agron Mustafës e kemi edhe Bedri Istrefin, po ashtu i emëruar nga PAN-i, i cili përveç që ka nënshkruar aneks kontrata me kompaninë PayKos, duke ia siguruar...Po e marr një krahasim, 6-7% i merr Posta e Kosovës, si provizion për shitjen e produkteve të Telekomit, kurse kësaj kompanie ia kanë siguruar 30% provizion, PayKos-it. Pra, Bedri Istrefi në mars vitit 2019, nënshkruan aneks kontratë, ku ia siguron 30% provizion PayKos -it.

U përmend edhe Advantegu, kompani tjetër, ku po ashtu ngjashëm si me Z-Mobile është krijuar një Z-Mobile i ri, ku Telekomit pranon t'ia japë 60% të të hyrave kompanisë tjetër, dhe vet t'i marrë vetëm 40%.

Pra, çfarë operimi kemi këtu. Të gjitha këto nuk do të ishin të mundura pas e pasur dikë të fuqishëm prapa. Nuk do të ishin të mundura, ngase një kompani të jetë më e fortë se shteti edhe ta gjuhëzojë shtetin, ta rrezikojë sigurinë kombëtare duke tentuar ta gjuhëzojë një kompani si Telekomit, që është veshi i popullit, veshi i qytetarëve, e kjo s'ka shanse të ndodh pa e pasur dikë prapa. E kush është prapa? Anglisht thuhet; follow dhe money, shiko ku po shkojnë paratë.

Nëse doni ta shihni se ku po shkojnë paratë, mjafton ta shihni bilbordin te Grandi. Ai është bilbord që gjatë tërë kohës, kompania Devolli e ka në shfrytëzim. Tash, janë dy persona aty. E nëse doni që ta dini se kush janë ata, shkoni te Grandi dhe i shihni se ku po shkojnë këto para. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Murati. Në emër të PDK-së, replikë zoti Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Gjithsesi, do të thotë se këta të Vetëvendosjes janë të pafajshëm. Edhe kur Albin Kurti e mbanë në sirtarë padinë e Devollëve për 15 ditë, edhe këta shikojnë ta fajësojnë ndonjë zyrtari të ulët, edhe paskan gjetur që qenka diku në Qeveri, vëllai i Bedri Istrefit, i cili nuk ia ka vazhduar kontratën Z-Mobile e i cili i ka kërkuar nga Rozeta Hajdarit që t'i bëjë kundër-padi Devollit, e ajo e ka prolonguar.

Këto janë argumente të dëshmuara me e-mail zyrtarë. Por, sa herë të mbesin pa kauzë edhe folow maney, po follow money, prapa shpine e ke, deputeten. Vëllai i saj, follow money. Po, follow money.

Jeni mësuar ju që t'i përmendi familjarët edhe Mefaili tha, vëllain e ke kryeshef. Po bre, kryeshef është. Kur e ka marrë më 2009, kompania ka qenë me humbje 960 mijë euro, në vitin e kaluar kanë dalë me profit mbi 1 milion euro. Raporti i auditimit është pa vërejtje.

Jeni përpjekur që t'i gjeni vegë e ta shkarkoni, s'keni pasur ku t'ia ngjitni. Prandaj, ka mbetur kryeshef, se është i zoti. Nuk vjedh, punon. Dhe duhet të jetë shembull. Pse jo. Por, jeni mësuar ju, hajde tash ta përmendi. Shikoni sa familjarët i keni edhe në Telekom edhe andej.

Nuk keni qenë shembull i mirë. Brenda 120 ditëve e keni mbushur Qeverinë familjarë e axhallarë, e Vetëvendosje, e turli fare. Po valla, krejt i dini. Krejt në media i keni pasur. Bile ti që je spekulant i mediave Musë. Kështu që, i di më së miri këto gjëra.

KRYESUESJA: Replikë, deputeti Mefail Bajqinovci.

MEFAIL BAJQINOVCI: Nga deputeti Haxhiu, deputeti që është më i përfolur në të gjitha anët kur të shkosh në Mitrovicë.

Kalove në goxha personale kamish. Unë veç desha të të tregoj që nëse jeni ju i involvuar, duke filluar prej shitjes së notave në fakultetin e mjekësisë atëherë, të ta përmendshin emrin, e deri në biznese që t'i kanë qit, me ikje të tatimit nëpër media je ti.

Nëse je për punësime, je ti. Pra, përmende një emër, thuaj, deputet, këta janë të punësuar me emër.

KRYESUESJA: Kundër-replikë, deputeti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Shiko, Mufë nuk bën t'ju marr seriozisht. Është gabim që ju kemi marrë seriozisht juve të Vetëvendosjes.

Thjesht, po ma çon mallin e një palaçoje që te dera i vjedh qytetarët duke hyre brenda, e këtu mundohesh me luajt të ndershmin. Spekulant ke qenë në media, do të vazhdosh të jesh një spekulant këtu, edhe nuk do të të marr seriozisht. Edhe një herë, ma çon mallin e një palaçoje, asgjë më shumë.

KRYESUESJA: Fjalën e ka deputeti Faton Bislimi.

FATON BISLIMI: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ky është debat ose debati që po bëhet sot, ka të bëjë me një çështje e cila realisht e prek në themel edhe në thelb ekzistimin e vet shtetit të Kosovës. Telekomit dhe shërbimet që Telekomit i Kosovës i ofron, janë pjesë e pandarë për neve të paktën këtu në Kosovë, e sigurisë tonë nacionale.

Këtu, tash e tri orë me gjasë apo më shumë, u fol e u debatua shumë për atë që ka qenë eventualisht problemi dhe për atë që ka mundur të jetë shkaktar i problemit. Akuza e kundër akuza, edhe individuale edhe personale, të cilat nuk i ndihmojnë në asnjë mënyrë zgjidhjes së problemit që e kemi sot.

Problemin, ne e kemi sot. Problemi para nesh është sot.

Mbi 2 mijë e 300 punëtorë të Postë-Telekomit të Kosovës rrezikojnë të mbesin pa punë sot. Jo dje, jo pardje, jo në 2009 as në 2010, por sot, nesër e tutje.

Prandaj, përderisa është shumë e rëndësishme që të dihet mirë dhe të përcaktohet mirë diagnoza e problemit, shumë më i rëndësishëm për zgjidhjen e problemit është tretmani. E këtu asgjë, thujtë s' u tha për atë punë.

Zgjidhja me hesap, nuk qenka ajo që po e bëkemi ne, sepse krejt çka u tha më së shumti në këtë Kuvend, është se politika i paska fajet për dështimin kaq flagrant të Telekomit të Kosovës. Ndërkaq, unë nuk e di se a ka institucion, a ka forum a ka platformë politike në këtë vend se sa vet Kuvendi i Kosovës.

Në qoftë se politika është fajtorë, i bie që faji qenka në mesin tonë. E në qoftë se faji është në mesin tonë, si ta luftojmë ne atë faj edhe si të krijojmë zgjidhje.

Unë jam i bindur që jo politika si nocion, po politikanët e veçantë me emra e me mbiemra, disa u përmenden e disa ndoshta jo, janë fajtorë edhe ndoshta janë bazamenti i këtij problemi. Po ajo që neve ma takon si deputetë, mendoj unë, është që ne të ofrojmë zgjidhje për aq sa ne mundemi.

Në qoftë se ky shtet edhe kjo Qeveri e jona e ka të pamundur në baza ligjore për shkak të mungesës së legjislacionit adekuat ose për shkak të nevojës për ndryshim të ndonjë ligji, do duhej të ishte kërkesë nga kjo Qeveri drejtuar këtij Parlamenti që ne të jemi pjesë e zgjidhjes.

Në qoftë se paska probleme ligjore, nuk ka legjislacion adekuat nëpërmjet të cilit shtetit e mbron interesin e vet themeltar, shteti e mbron sigurinë e vet nacionale dhe shteti në asnjë moment, për asnjë arsye nuk i përulet askujt, atëherë le të tregojnë se ku është problemi, edhe ne besoj se mund të bëhemi pjesë e zgjidhjes duke e amendamentuar cilindo ligj, i cili ua mundëson njerëzve të thirrur që të marrin vendime ekzekutive që t'i ekzekutojnë interesat e shtetit para çdo interesi të kujtudo tjetër.

Ne jemi në një situatë kur e kemi në pikëpyetje sigurinë tonë nacionale, sepse Telekom tjetër, pos këtij që e kemi sot e që është i bllokuar për momentin, nuk kemi.

Prandaj, në qoftë se problemi është edhe te legjislacioni ministër, në qoftë se nuk keni bazë ligjore mbi të cilën ju i zhbllokoni llogaritë e Telekomit edhe diskutoni pastaj për problemin edhe për zgjidhjen eventuale me ata që po pretendojnë se Telekomit u paska borxh, atëherë sillni një iniciativë ligjore këtu, po e amendamentojmë atë ligj, po jua japim të drejtën që të veprojnë, e shpëtoni Kosovën, i shpëtoni ata 2 mijë e 300 punëtorë, po mbi të gjitha e shpëtoni identitetin themeltar të një shteti e që është siguria nacionale.

Kështu ia bëni me dije gjithkujt tjetër, që ky shtet aq i fortë e aq i dobët sa është, aq i vogël e aq i madh sa është, nuk është pre e lojës së askujt, njëherë e përgjithmonë.

Kështu që, ju lutem të mos hezitoni. Le të jetë në barrën e deputeteve pastaj se a e çojmë përpara një iniciativë të tillë apo jo.

Kurse nëse vazhdojmë ne të bisedojmë për qysh e tek ka ardhur deri te problemi, të themi politika i paska fajet, është të bësh llaf pas darke, thotë populli, sepse zgjidhje s'jemi duke ju ofruar.

E ata qytetarë që ndoshta që katër orë i kanë sytë në televizor, më vjen keq që veç ju kanë bërë dëm syve, ndoshta edhe veshëve nganjëherë, se po dimë ta ngremë zërin, por nuk mendoj që kanë marrë ndonjë mesazh të mirë, as inkurajues e as të rëndësishëm për zgjidhjen që është nevojë imediate.

Prandaj, është obligim i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i juaji ministër pikërisht, sepse jeni ministri përgjegjës për Telekom, që ta propozoni zgjidhjen, e në qoftë se legjislacionin e keni të mangët që ta çoni zgjidhjen në implementim, urdhëroni zotëri sillni këtu, edhe pastaj na e leni fajin neve në qoftë se qojmë përpara.

Përndryshe, të cenohet interesi nacional i Kosovës, nuk është dhe nuk do të duhej të ishte asnjëherë interes i askujt që normalisht edhe racionalisht e ndien veten qytetar të këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Bislimi. Ministri e ka kërkuar fjalën për replikë.

MINISTRI BLERIM KUÇI: Në fakt nuk është replikë, po është një lloj falënderimi.

Të nderuar deputetë,

Ju e keni ftuar këtë debat dhe mirë keni bërë. Edhe unë jam këtu së bashku me juve. Meqë ju keni kërkuar që të ketë debat për Telekom, unë jam këtu.

Unë në rekomandimet e mia si ministër që do t'ia propozoj Qeverisë, veç i kam dhënë fillim. Ato janë rekomandimet e mia si ministër edhe ne do të procedojmë më tutje.

Por, nga ju sot kam pritur mos do të keni rekomandime shtesë të cilat do të jenë të mirëseardhura edhe mos po krijoni vija, ndoshta edhe ligjore se pati edhe asi propozime që të na lehtësoni neve si Qeveri që të veprojmë edhe atë sa më shpejtë.

Unë e kuptoj që duhet të krijohen strategji afatgjate dhe ajo është mirë. Por, ne duhet të dalim prej kësaj situatë në të cilën gjendemi momentalisht.

Momentalisht, ne jemi në rrezik që të ndërpriten të gjitha veprimet dhe shërbimet që i kryen Telekom. E kemi të rrezikuar edhe gjendjen e 2 mijë e 30 punëtorëve.

Ne i kemi dy faza; fazën emergjente edhe atë duhet të veprojmë shumë shpejtë për ta tejkaluar këtë situatë, për deblokimin e xhirollogarive edhe për funksionimin normal të Telekomit edhe atë afatgjate të cilën së bashku me Telekom, së bashku me bordin që do të emërohet, shpresoj qysh nesër e po ashtu së bashku edhe me menaxhmentin e Telekomit.

Ato që ju premtoj e që i thatë edhe ju, që nuk do të ketë falimentim dhe assesi sa do jem unë ministër nuk do të ketë falimentim të kësaj ndërmarrje. Por, do t'i marrim hapat edhe kundrejt Ligjit për ndërmarrje publike, Ligjit për shoqëritë tregtare, konform kompetencave të mia si ministër...

KRYESUESI: Edhe një minutë ju lutem, ministrit!

MINISTRI BLERIM KUÇI: Normalisht, për neve si Qeveri do të ishte shumë që të votohet rishikimi i Buxhetit sa më shpejt që është e mundshme si dhe janë disa ligje të cilat kanë të bëjë me rimëkëmbjen ekonomike.

Ne do të na e lehtësonte, do të na e mundësonte që ma lehtë ta gjejmë këtë zgjidhje. Ju falënderoj të gjithëve, sidomos atyre që kanë dhënë rekomandime, po edhe ish-kolegut tim zotit Rexhepi edhe të tjerëve. Pra, të gjithë atyre që i kanë dhënë rekomandimet dhe ato rekomandime i kam marrë.

Në qoftë se na krijohet një bazë tjetër ligjore që na e lehtëson, do të ishte e mirëseardhur. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër!

Ashtu siç mund të keni njohuri tashmë, ne prezantuam një rezolutë në fillim me propozimet tona, dhe meqenëse aktualisht jemi vetëm 48 deputetë në sallë nuk ka kuorum të mjaftueshëm për të vendosur në votim.

Kështu që, e vazhdojmë këtë seancë nesër në orën 10:00.

Debati për pikën e radhës... Zoti Selimi e ka kërkuar fjalën.

REXHEP SELIMI: Ju faleminderit, zonja nënkryetare!

Unë propozoj që seanca të ndërpritet këtu dhe debati i paraparë për çështjen e pensionistëve kontribut-dhënës të vazhdojë nesër.

Kjo edhe në përputhje me dakordimin tonë që kemi pasur, Kryesia me kryetarët e e grupeve parlamentare, po ashtu edhe me kërkesën e thirrësit të kësaj seance, ne jemi dakorduar atje.

Andaj, mendoj ose propozoj, besoj që edhe e kam aprovimin e kolegëve, që seanca të vazhdojë nesër në orën 10:00, me debatin e paraparë për këtë punë. Por, para debatit edhe me votimin. Të hidhet në votim kjo rezolutë nesër, për shkak se siç po shihet tani nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

Kështu që, propozimi im është që të ndërpritet tani seanca dhe të vazhdojmë nesër me votimin e rezolutës dhe me vazhdimin e seancës me debatin e paraparë. Ju faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Selimi. Zoti Gashi në emër të LDK-së.

ARBEN GASHI: Faleminderit!

Është e vërtetë që në mbledhjen e Kryesisë jeni dakorduar që nëse ky debat vazhdon përtej orës 20:00 të ndërpritet edhe të mbahet në ditën pasuese.

E kam vetëm një paqartësi me zotin Selimi për vazhdimin nesër, sepse nesër kemi një seancë në orën 12:00, ku është paraparë raportimi i kryeministrit.

Ndoshta është më mirë që të shtyhet pas raportimit të kryeministrit, pra të vazhdojë kjo seancë, në mënyrë që të mos konfliktohen agjendat.

Përndryshe, mund të fillojë në 10:00 ose 9:00 kur të doni, dhe nëse shkojmë deri pas orës 12:00, ndoshta ta ndërpremë dhe kjo seancë të vazhdojë pasi që ta kryejmë raportimin e kryeministrit.

Po mendoj që raportimi është një çështje e rëndësishme për të cilën jemi dakorduar edhe me Qeverinë që ta mbajmë në atë kohë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Gashi! Zoti Selimi dhe pastaj përfaqësuesi i PDK-së.

REXHEP SELIMI: Në cilindo situatë, unë nuk e kam problem. Mundet që nesër edhe të vazhdohet seanca në orë 9:00 mund të vazhdohet në orën 10:00 dhe të ndërpritet seanca, sepse ekziston kjo praktikë.

Në cilindo situatë, unë nuk e kam problem. Vetëm se po e ndiej si obligim ta respektojmë dakordimin që e kemi mbajtur në seancën e fundit që në ditën vijuese të jetë pikë e parë debati i thirrur nga deputeti Haxhiu.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, zoti Memli Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Siç e dini, zonja nënkryetare, ne jemi dakorduar atë ditë që këtë pikë ta fusim para pikave të tjera, përkundër që ka qenë më vonshme se pikat tjera.

Ne e kemi mbështetur që kjo të diskutohet duke e konsideruar si më urgjente. Andaj, kërkesa e sponsorizuesve të pikës që vjen pas debatit për pensione, ka qenë që së paku të mos e vazhdojmë në mbrëmje që të ketë një interesim më të madh.

Meqenëse edhe pozicionet pak a shumë, të paktën të deklaruara për çështjen që do të diskutohet në vijim, nuk kanë ndonjë, në perceptimin tim, dallim shumë të madh.

Unë besoj që ndoshta është e mundshme që brenda dy orëve të konsumohet debati. Mund të jetë edhe më gjatë. Por, besoj që ia vlen ta vazhdojmë seancën nesër në orën 10:00, dhe pastaj të vazhdojmë me raportimin e kryeministrit.

Unë nuk jam i sigurt që Qeveria ose në fakt, tashmë komisionet a e kanë përfunduar punën edhe për një pikë tjetër që ka pasur dakordim që nëse përfundon procedura të futet, e që ka të bëjë me Ligjin për plotësim-ndryshimin e Buxhetit. Që i bie që nëse ajo është kryer proceduralisht, vazhdon nesër në këtë seancë që e kemi nisur, por edhe nëse po, ajo mund të vazhdojë vetëm pas raportimit të kryeministrit.

Pra, ne duhet që këtë seancë në një formë ose tjetër që ta ndërprejmë nesër në mesditë. Kështu që, për ta përmbledhur, besoj që ta vazhdojmë nesër prej orës 10:00 me pikën që është e paraparë në rendin e ditës së kësaj seance. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Krasniqi!

Andaj, ishte edhe propozimi im në fillim, që ta ndërprejmë sonte për të vazhduar nesër në orën 10:00. Po besoj që ka pajtueshmëri.

Pra, vazhdojmë punimet e kësaj seance nesër në orën 10:00, me votimin e rezolutës dhe me debatin e kërkuar sipas rendit të ditës. Ju faleminderit!

* * *

E premte, më 24 korrik 2020

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 korrik 2020

Mbledhjen e drejton kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Siç po e shihni, për momentin nuk kemi kuorum të mjaftueshëm për ta vënë në votim rezolutën nga debati i djeshëm për Telekomin.

Kështu që, në qoftë se pajtoheni, ne po vazhdojmë me debatin për të drejtat e pensionistëve, kurse në fund të tij e qesim në votim rezolutën për Telekomin.

Sikurse dje, vlejné rregullat e njëjta që kanë të bëjnë me parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.

Sa i përket distancës fizike, përdorimit të maskave, higjienës dhe secili deputet të tentojë të flasë nga vendi, pra të gjithë 120 deputetët, përfshirë mua.

Po procedojmë me pikat e papërfunduara. Në këtë rast votimi i propozim rezolutës nga Telekomi do të ndodhë në fund të debatit për pensionistët, meqenëse për momentin nuk kemi kuorum të mjaftueshëm.

4. Debat parlamentar për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës

Të nderuar deputetë,

Deputetja Teuta Haxhiu, mbështetur edhe nga shtatë deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për debat parlamentar lidhur me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës.

E ftoj deputeten Haxhiu që në emër të propozuesit ta paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar debati parlamentar.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë dhe ju kolege deputete,

I nderuar ministër,

Debati, të cilin e kam propozuar në këtë legjislaturë është hera e dytë që e thërrasim për shkak se është i një rëndësie të veçantë. Unë mendoj që nuk është temë e zgjidhur, prandaj po e përsëris të njëjtin debat që e kam thirrur edhe në legjislaturën e kaluar.

Pra, megjithëse unë konsideroj që është temë me rëndësi, është mirë që secili prej deputetëve të japë kontributin e tij, në mënyrë që në fund të dalim me disa pika të një rezolute që do t'i

harmonizonim edhe me grupet e tjera, e që unë jam normalisht e gatshme që ta kemi vërtet një koordinim të plotë sa u përket pensionistëve kontributdhënës.

Në këtë rast, kjo temë që na është adresuar shpeshherë, qoftë si deputetë apo edhe si grupe parlamentare, çështja e pensioneve kontributdhënës nga pensionistë të caktuar, por njëkohësisht edhe nga takimet që i kemi pasur me Shoqatën e Pensionistëve të Kosovës, personalisht kam marrë shumë herë edhe nga ata sugjerime dhe kërkesa që ata u kanë bërë në vazhdimësi institucioneve të vendit.

Pensionistët kontributdhënës vazhdojnë të kërkojnë nga autoritetet vendore dhe ato ndërkombëtare kthimin e Fondit Pensional të Kosovës, i cili për më shumë se 20 vjet në mënyrë joligjore mbahet në Serbi.

Që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë kjo kategori e shoqërisë ka realizuar disa nisma, madje në mënyrë individuale, por asgjë nuk ka përfunduar në favorin e tyre.

Megjithatë Qeveria e Republikës së Kosovës, përmes Ligjit për skemat sociale të financuara nga shteti, të gjithë pensionistëve të kontributdhënës dhe jokontributdhënës ua ka dhënë pensionin bazë, por ky pension më shumë konsideroj është një mbështetje sociale për këtë kategori.

Të drejtën në pensionin kontributdhënës të moshës e realizojnë të gjithë personat, të cilit kanë shtetësi të Kosovës dhe kanë mbushur moshën 65-vjeçare, pastaj duhet të kenë stazh pensional kontributdhënës sipas Ligjit për sigurimin pensional invalidor numër 011/2483, të shpallur në Gazetën Zyrtare të asaj kohe, pra që për mua është shumë shqetësuese, të KSAK-së, numër 26/93, pra po flasim për ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës. Pra, para datës 1 janar të vitit 1999.

Pika tre pastaj ofron dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor, numër që e ceka më herët para kësaj date të vitit '99.

Në Ligjin 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, neni 8, që për mua është diskriminues, deri këtu pra është pothuajse gjithçka rregull, mirëpo më vonë ajo që ka ndodhur dhe që konsideroj që është shkelja më elementare e të drejtave të njeriut, është që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në atë kohë ka nxjerrë një Udhëzim Administrativ që është 9/2015 për kategorizimin e pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës të kontributeve. Stazhit pensional, me të cilin janë rregulluar të gjitha kushtet dhe kriteret për përfitimin e këtij pensioni.

Ky udhëzim duket se ka rregulluar në detaje disa kushte për përfitimin e këtij pensioni, megjithatë në këtë Udhëzim Administrativ ka diçka që është shumë diskriminuese, e përmenda

edhe më herët, dhe kërkon që së paku 15 vjet para datës 1 janar të vitit '99, sipas Ligjit të SPI-së së Kosovës, numër 26/83, duke ditur se në këtë kohë kush ka mundur të punojë. Pra, thjesht i bie që ata që janë larguar dhunshëm nga puna nuk përfitojnë pensionin kontributdhënës dhe përfitojnë të gjithë ata, të cilët në një farë forme kanë qenë bashkëpunëtorë të sistemit të atëhershëm.

Pra, unë mendoj që kjo është shumë e rëndë për të gjithë punëtorët, të cilët janë larguar dhe ata konsideroj që dy herë, edhe shteti po i diskriminon. Shumë pensionistë kontributdhënës para vitit '99 e shohin si shumë diskriminuese këtë periudhë 15-vjeçare të stazhit për ta.

Si rrjedhojë e këtyre fakteve, ka shumë pak kontributdhënës, të cilët mund të plotësojnë periudhën 15-vjeçare dhe ajo që është shumë shqetësuese për mua, ka shumë prej tyre që kanë 14 vjet e 9 muaj apo edhe 11 muaj më shumë se 14 vjet dhe për disa javë nuk e plotësojnë këtë kriter. Pra, që i bie megjithatë ka punuar gjithë ato vite dhe prapë ai nuk gëzon pensionin ose kontributet e tij dhe merr një pension, pa keqkuptime, sikur një që fare asnjë vit nuk ka punuar, është pension i moshës.

Pra, është një periudhë prej 26 vjetëve që rrjedhimisht 26 gjenerata nuk ua njohin këtë të drejtë. Normalisht nëse ka pak prej tyre që janë ende gjallë, pra duke u bazuar në të dhënat edhe të Sindikatës, unë them që numri është shumë i paktë i atyre që sot nuk e gëzojnë këtë të drejtë.

Mirëpo, ata që çdo ditë shkruajnë dhe me të drejtë flasin për një diskriminim, po kërkojnë diçka që meritore dhe është mirë të paguhet për vitet e punës, qoftë një vit, dy, tri apo edhe më shumë vjet. Pra, për aq vjet sa kanë punuar, për aq vjet edhe të paguhet dhe të mos kërkohet pra diçka që ka qenë diskriminuese e largim prej punës në kohën nuk ata nuk i kanë përfillur interesat e shtetit të ish-Jugosllavisë.

Në rezolutën që unë sot do ta paraqes, por nuk do ta paraqes tani, duke kërkuar nga kolegët e mi deputetë, e kam thënë edhe në mbledhjen e Kryesisë, nuk është me interes politik. Jam shumë e sigurt që të gjitha grupet parlamentare e kanë të njëjtën ndjeshmëri për t'u bërë zgjidhje këtyre pensionistëve dhe për të marrë kontributet e tyre dhe të mos diskriminohen nga shteti i tyre, nga Republika e Kosovës.

Pra, unë me shumë sinqeritet pres nga të gjitha grupet parlamentare që ta bëjmë një zgjidhje. Unë jam shumë e sigurt dhe e di që Udhëzimin Administrativ e ndryshon Qeveria, përkatësisht ministria.

Mirëpo, ajo që mu më së shumti më ka shqetësuar në debatin e legjislaturës së kaluar ka qenë fakti që ky Udhëzim Administrativ bazohet në ligj të ish-Jugosllavisë. Pra, ne ende merremi me

ligje të ish-Jugosllavisë, kjo është për mua shqetësuese. Pra, cili është shteti ynë, cili është vendi ynë dhe në çka ne bazohemi.

Pra, nëse kushtimisht do të ishte gabim teknik, kjo do të duhej të largohej menjëherë, e jo të flasim sot në një ligj të bazuar në atë periudhë.

Pra, edhe një herë kolegë deputetë,

Pa dashur fare të bëj politikë, jam për të zgjidhur këtë problem dhe më lejoni të kërkoj sinqerisht nga gjithë ju që të kontribuoni që në fund të dalim me një rezolutë të përbashkët, por që i bëjmë zgjidhje kësaj kategorie.

E nderuara kryetare,

Më lejo, e di që është fundi i fjalimit, se nuk po dua ta zgjas më shumë, por sot ne kemi parë në lajme që sot kanë humbur jetën dy mjekë të Republikës së Kosovës dhe më lejo që dy familjeve, të doktor Ali Tolajt, kirurg dhe Sylejman Rexhepit, t'u shpreh ngushëllimet më të sinqerta dhe, tre, kërkoj falje, dhe të gjithë atyre doktorëve, mantelbardhëve, por edhe të gjithë qytetarëve, sinqerisht jam shumë e prekur, duke e njohur doktor Aliun, por edhe të tjerët që humbën jetën fatkeqësisht duke mbrojtur qytetarin e vendit, duke mbrojtur edhe familjet tona. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, zoti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: I kam në dorë dy kërkesa për debat parlamentar për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës.

Njëra që ka ardhur më 26 prill 2020 dhe tjetra e 29 tetorit 2018.

Ajo çka i dallon këto dy kërkesa është data, koha kur janë parashtruar, kurse të tjerat janë pothuajse të njëjta, duke qenë edhe teksti i njëjtë, duke qenë edhe qasja e njëjtë, duke qenë po ashtu edhe thirrësi i njëjtë, duke qenë edhe projekt-rezolutë e njëjtë me rekomandimet pothuajse të njëjta. Madje, kur po e lexoj edhe rekomandimin ose propozim rekomandimin po më del pikërisht i njëjti me atë që ka ndodhur më herët. Kjo nuk ka problem pse është e njëjta, mund të përsëritet edhe për herë të tretë dhe nuk prish shumë punë.

Ajo çfarë unë desha të them këtu që ne si Lëvizje Vetëvendosje jemi që kjo çështje të zgjidhet, jemi po ashtu që ky Udhëzim Administrativ t'i heqë kufizimet për të përfituar pensionistët kontributdhënës, por kemi të bëjmë me një Udhëzim Administrativ, të cilin nuk e ndërron Kuvendi, Udhëzimin Administrativ e ndërron dikush në Qeveri, madje ai nuk është kryeministri, mund ta bëjë ministri. Më rezulton që edhe ministri të jetë i njëjtë, por një gjë që unë nuk po e kuptoj është që edhe atëherë, edhe sot deputetët e mazhorancës kërkojnë nga Kuvendi t'i

rekomandojë Qeverisë, të cilët e kanë votuar dhe e kanë zgjedhur, që i bie ajo që nuk është arritur në Qeverinë Haradinaj, sot po kërkohet nga zoti Hoti. Unë nuk po e kuptoj, me gjithë dëshirën për ta kuptuar, çfarë po kërkohet nga Kuvendi i Kosovës sot.

Edhe atëherë, edhe tash kryesuesja ka qenë pjesë e mazhorancës, madje atëherë ka pasur favor më të madh, sepse Qeverinë e ka udhëhequr kryetari i subjektit politik që ajo e përfaqëson.

Pra, ajo çka po kërkohet nga Kuvendi thjesht mund ta bëjë ministri. E në vend që të kërkohet nga ne, thirrësi i kësaj seancës është dashur ta kërkojë direkt nga Qeveria e tyre.

Sikur të ishin pjesë të opozitës, do t'i kisha kuptuar, por nuk po i kuptoj si një deputet i mazhorancës kërkon nga Kuvendi një gjë, të cilën thjesht me një akt administrativ mund ta bëjë Qeveria.

Pra, zonja Haxhiu, drejtoju Qeverisë suaj, nuk po kuptoj çka po kërkoni nga ne, ke adresën e gabuar. Nuk është kjo dera e cila zgjidh këtë problem.

Po ashtu, ne jemi edhe që kjo çështje të zgjidhet edhe në kuadër të skemës pensionale. Prapë, po jua përsëris, udhëzimet administrative janë akte nënligjore dhe ne nuk mund t'i ndryshojmë ato.

Madje, më kujtohet që kjo çështje është diskutuar edhe në mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit me kryetarët e grupeve parlamentare, të njëjtën gjë e kam thënë edhe atje, ne mund të debatohet. Madje neve si opozitë na leverdis që këto tema t'i sjellim në Kuvend dhe të tregojmë pse Qeveria nuk po bën një gjë të tillë. Por, po mendoj që ky debat sot, kam të drejtë të mendoj kështu, që nuk e ka qëllim zgjidhjen e këtij problemi, se po të kishte qëllim zgjidhja e këtij problemi, ka rrugë shumë më të shkurtra.

Po ashtu kemi diskutuar në atë mbledhje të Kryesisë të Kuvendit, ku edhe vetë thirrësja e këtij debati është deklaruar që rezolutat nuk janë obligative për Qeverinë. Një Qeveri e përgjegjshme dhe ndërgjegjshme do të duhet ta bënte vetë, kështu me sa më kujtohet pati thënë, kështu po themi edhe ne. Një Qeveri e përgjegjshme dhe e ndërgjegjshme do të mund ta bënte vetë një gjë të tillë.

Keni të drejtë atë çfarë po kërkoni, pra nuk po mohojmë, por këtë kërkojeni nga Qeveria juaj, nëse doni zgjidhje, zgjidhjen jua bënë Qeveria, jo Kuvendi, me gjithë dëshirën tonë për ta zgjidhur këtë problem.

Prandaj, unë nuk shoh ndonjë rezultat në fund me një rezolutë ose me një rekomandim që mund ta zgjidhim këtë problem. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Shkëmb Manaj.

SHKËMB MANAJ: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar zoti ministër Reçica,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës vlerëson se thelbi i problemit të pensionistëve kontributdhënës qëndron në faktin se shteti i Serbisë e ka grabitur ish-Fondin Pension të Kosovës dhe sot e saj dite, edhe pas 20 vjetëve të përfundimit të luftës, Serbia në kundërshtim me të gjitha normat ndërkombëtare këtë fond ende nuk e ka kthyer te pronarët e vet, që janë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Duke u gjendur në një situatë të tillë të moszgjidhjes së këtij problemi, janë goditur me mijëra pensionistë kontributdhënës të vendit tonë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës në vazhdimësi i ka përcjellë shqetësimet dhe është angazhuar për zgjidhjen e problemit të tyre.

Në dispozitat e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti është përcaktuar subvencioni kontributdhënës i moshës është pensioni i rregullt mujor për qytetarët e punësuar të Republikës së Kosovës, të cilët kanë paguar kontributet në ish-Fondin Pension të Kosovës para datës 1 janar të vitit 1999.

Në këtë ligj po ashtu është obliguar Qeveria e Kosovës që me akt nënligjor t'i përcaktojë kriteret e përfituesve.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ MPMS 9/2015 për kategorizimin e pensionit kontributdhënës sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve apo stazhit pensional, duke përcaktuar si kriter të përfitimit të këtij pensioni obligimin që qytetari duhet t'i dokumentojë që ka paguar kontributet në ish-sistemin pensional të Kosovës të paktën për 15 vjet para vitit 1999.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës fillimisht vlerëson se kriteret për përcaktimin e të drejtës në pension duhet të përcaktohen me ligj dhe jo me një akt nënligjor, sepse përfitimi apo humbje e një të drejte pronësie, siç është pensioni, duhet të përcaktohet mbi bazën e kriterëve ligjore të Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e vendit. Prandaj, kjo çështje duhet të adresohet me seriozitet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Sa i përket gjendjes së tanishme të kësaj kategorie pensionale, ne vlerësojmë se është diskriminues barazimi i pensionistëve kontributdhënës që i kanë paguar kontributet e tyre pensionale në periudhë kohore më të shkurtër se 15 vjet me persona që nuk kanë punuar asnjëherë, rrjedhimisht nuk kanë kontribuar në sistemin pensional të Kosovës as edhe për një muaj.

Po ashtu duhet të marrim parasysh faktin se qytetarët e vendit tonë janë larguar dhunshëm nga puna gjatë viteve '90-ta nga regjimi serb, për 10 vjet me radhë, duke ua pamundësuar të drejtën në punë.

Shteti ynë duhet ta ketë parasysh këtë dhe, përkundër vështirësive buxhetore, si shtet nuk guxojnë të rrëshqasin në pozicionin që t'ua mohojnë të drejtën e pensionit kontributdhënës këtyre personave.

Prandaj, në këtë drejtim, ky Kuvend ka arritur më herët që të përfshijë në ligj sistemin arsimor dhe shëndetësor që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës në vitet e '90-ta duke ua njohur stazhin e punës. Në këtë frymë ne vlerësojmë që të gjithë personat që janë larguar dhunshëm nga puna në vitet e '90-ta nga regjimi serb dhe të cilët në çfarëdo forme kanë qenë të përfshirë në jetën institucionale, politike, kulturore, arsimore, të sigurisë, të mbrojtjes, të informimit, sistemit humanitar e tjerë, të Republikës së Kosovës gjatë viteve të '90-ta, këto vite duhet t'u njihen me automatizëm si stazh pensional njëjtë sikur të ishin në marrëdhënie të punës.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e ka mbështetjen tonë të plotë në shtyrjen përpara të këtyre nismave ligjore që e rregullojnë këtë aspekt, të cilën e kemi obligim moral e shtetëror ndaj gjithë asaj gjenerate që kanë sakrifikuar mirëqenien e familjes së tyre për të mos iu nënshtruar pushtetit të dhunshëm serb, duke u radhitur në kuadër të lëvizjes politike institucionale dhe të rezistencës së armatosur për liri, pavarësi dhe demokraci.

Ne po ashtu vlerësojmë se duhet të ketë reformë rrënjësore të skemave pensionale në vend. Aktualisht i kemi përmbi 25 skema pensionale, të cilat janë të rregulluara me tetë ligje dhe të gjitha këto skema dhe gjithë kjo shpërndarje në tetë ligje ka krijuar pabarazi që ndërlidhen me personat me aftësi të kufizuar, me invalidët e punës, me pensionet e vlerave të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kufizimi i qytetarëve në të drejtën e marrjes së vetëm një pensioni dhe në rastet kur i njëjti ka plotësuar kriteret edhe të përfitimit të pensionit invalidor, pensionit për shkak të aftësive të kufizuara si dhe të pensionit të vlerave të luftës është i padrejtë dhe kjo çështje duhet të rregullohet, duke bërë kategorizimin me rastin e përfitimit të më shumë se një pensioni.

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne kemi analizuar projekt-rezolutën e iniciatorit të këtij debati parlamentar, i cili ka kërkuar që periodha e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ nga 15 vjet të zvogëlohet në 10 vjet.

Me vlerësimin tonë si grup parlamentar e drejta në pension kontributdhënës është e drejtë pronësore e të gjithë atyre që i kanë paguar kontributet pensionale, prandaj, kjo çështje nuk mund të rregullohet duke zvogëluar kriterin e viteve nga 15 vjet në 10 vjet, sepse kështu do t'i dëmtonim të gjithë ata pensionistë kontributdhënës që nuk e arrin pastaj minimumin e 10-vjetëve për ta gëzuar të drejtën e tyre në pension.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës mendon që Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Qeveria e vendit duhet t'i analizojnë variantet më të mira që janë në favor të pensionistëve kontributdhënës, duke përcaktuar këtë pension në mënyrë të përshkallëzuar, në përqindje të caktuar për secilin vit të kontributeve të secilit qytetar të Kosovës që kanë kontribuar në ish Fondin Pensional të Kosovës, duke garantuar paralelisht pensionin bazë të moshës, të përcaktuar me legjislacionin në fuqi. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar i PDK-së, kush e dëshiron fjalën, sepse nuk po shoh këtu emër që ka kërkuar dikush fjalën. A dëshiron të flasë dikush nga Grupi Parlamentar i PDK-së, deputeti Fatmir Xhelili e ka fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, kryetare!

Përshëndetje për ministrin,

Përshëndetje për deputetët,

Kjo çështje është shumë komplekse pasi që ka pasur tentativa që të rregullohej edhe më herët, është prezent edhe ministri Reçica, për të cilin kam respekt me iniciativën të cilën e ka marrë në mandatin e kaluar për t'ia qasur një reforme të strukturave pensionale dhe sociale dhe t'i rregullojë këto skema në mënyrën më të mirë të mundshme, për shkak që me të vërtetë ka shumë defekte dhe padrejtësi në ligjet ekzistuese të aplikueshme për pensionistët.

Faktikisht kur ka vendosur shteti ynë të kalojë në metodën që gjenerata ta mbajë gjeneratën, edhe një pjesë e pensionistëve të shumtë kanë mbetur, ku gjenerata e tashme ta ketë obligim për gjeneratën e kaluar, ka bërë që të dalin shumë defekte dhe padrejtësi në skemat ekzistuese pensionale e invalidore.

Është shumë e padrejtë për një kategori të pensionistëve, të cilët nuk e kanë plotësuar kriterin e përcaktuar me ligj prej 15 vjetësh për të pasur të drejtë në pensionin kontributdhënës dhe duke marrë parasysh kontributet që kanë dhënë ata për vjetët që kanë punuar dhe kontributi në socializëm ka qenë jashtëzakonisht i madh, për ata që nuk e dinë kanë qenë deri 120 deri 140%

të pagesë neto kontribut për shtetin, për aktivitetet shtetërore dhe për tatimet. Kështu që kjo kategori është e dëmtuar në përcaktimin e kriterit 15 vjet.

Janë të diskriminuar në një farë mënyre edhe të gjithë ata pensionistë që kanë diplomuar në periudhën '90-99, janë jashtëzakonisht të diskriminuar punëtorët, të cilët janë larguar prej punës në vitet '90-ta, të cilëve nuk u është numëruar stazhi i punës dhe ata që punojnë prapë kanë mangësi në çdo pagë për 5% për arsyen se 10-vjeçar, në të cilën kanë punuar ose 5-vjeçari në të cilën kanë punuar, fatkeqësisht nuk u llogaritet stazh i punës. Janë të diskriminuar edhe familjet e dëshmorëve, të cilat e gëzojnë vetëm një pension, në qoftë se i kanë të rënë në luftë dy apo më shumë djem apo vajza në familje.

Nuk zgjidhen këto me një rezolutë, nuk zgjidhen me një qasje të njëanshme për përcaktimin e kriterit dhe limitit prej kur të llogaritet ajo. Unë e kisha lutur ministrin dhe deputetët ta përkrahin ministrin të vazhdojë reformën, të cilën e ka filluar në mandatin e kaluar, t'u qasen në mënyrë strukturale të gjitha skemave pensionale dhe sociale duke e marrë parasysh modelin e shteteve që e vlerësojnë edhe kanë në funksion qoftë edhe një vit të vetëm në qoftë se ka punuar, duke u llogaritur për qindja për atë vit, për dy vjet, për tre vjet, për pesë vjet, për pesëmbëdhjetë vjet dhe aq sa ka punuar, se nuk rregullohen këto me një prerje 5-vjeçar, 10-vjeçar apo 15-vjeçar.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah ministrin të vazhdojë reformën që nga mandati i kaluar dhe besoj që me pak punë dhe me ekspertizën e njerëzve që dëshirojnë të kontribuojnë në vazhdimin e plotësimit të asaj reforme, do të thotë solucioni më i mirë i zgjidhjes të të gjitha këtyre problemeve dhe padrejtësive të pensionistëve dhe atyre që do të dalin në pension në këtë kohë të shkurtër.

Është e diskutueshme edhe periudha e vitit 2000 dhe 2001 që në një farë mënyre ka shumë padrejtësi për gjeneratat, të cilat do të dalin në pension në periudhën e ardhshme, e kam fjalën të mëvonshme, kështu që, zoti ministër, ju kisha lutur në emër të grupit parlamentar të vazhdoni reformën, të cilën e keni filluar në mandatin e kaluar.

Ju dëshiroj sukses dhe do ta keni përkrahjen e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

KRYETARJA: Faleminderit. Nga Grupi Parlamentar i AAK-së, urdhëro zoti deputet te foltojta.

ARBËR TOLAJ: E nderuar kryetare e Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës,

Është i njohur fakti se shteti i Serbisë që nga qershori i vitit '99 ndaloi kontributet e pensionistëve të Kosovës dhe nga ajo kohë pensionistët që i takojnë periudhës para vitit '99 nuk arritën të kthejnë fondin e tyre të grabitur nga shteti serb.

Bazuar në të dhënat e shoqatave të pensionistëve të Kosovës, në kohën kur në mënyrë joligjore është marrë Fondi Pensional nga Serbia, numri i pensionistëve ka qenë 89 mijë, e shumë nga ata, fatkeqësisht, kanë ndërruar jetë pa arritur ta jetësojnë këtë të drejtë të tyre ligjore.

Gjersa sot rreth 50 mijë pensionistë presin realizimin e pensioneve të grabitura që në total kapin vlerën mbi 2 miliardë euro.

Megjithatë, mbetet imperativ i kohës që autoritetet shtetërore me seriozitet ta trajtojnë çështjen e Fondit pensional, duke e vënë si temë diskutimi në dialogun Kosovë-Serbi, ku ekipet përkatëse negociuese do të inicionin dhe do të shtonin presionin ndaj Serbisë që ta kthejë Fondin e pensionistëve të Kosovës.

Kur jemi te kontributet pensionale duhet theksuar se edhe shteti i Kosovës domosdoshmërisht obligohet t'i kryejë detyrimet që i takojnë. Pensionistët tonë me dekada ishin pre e padrejtësive nga Serbia, ndaj është e patolerueshme që edhe më tutje të atakohen nga ne.

U bënë vite që atyre nuk i është rregulluar mjaftueshëm e drejta e tyre. Këtë e dëshmon edhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale numër 9/2015 për kategorizimin e pensionit kontributdhënës sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve, pra stazhit pensional si dhe Ligji për sigurimin pensional dhe invalidor me numër 26/83, përmes të cilëve kërkohet që stazhi para datës 1. 1. 1999 të jetë minimalisht 15 vjet. Kjo vërtet është jashtë çdo logjike, për arsye se që të kërkohet nga shqiptarët, të cilët në vitet e '90-ta ishin të detyruar dhunshëm të largohen nga puna, të argumentojnë stazhin e tyre për periudhën kohore mbi 15-vjeçare.

A duhet t'ua rëndojmë edhe ne gjendjen, edhe ashtu të rënduar dikur bazuar edhe në situatën e rëndë ekonomike në të cilën gjendet vendi ynë.

Ne duhet që atyre t'u krijojmë lehtësi, e jo vështirësi, kur i referohemi periudhës së mbijetesës së shqiptarëve në kohën e regjimit serb.

Pra, domosdoshmërisht njohja e së drejtës së kontributdhënësve duhet të përcaktohet maksimum deri në 10 vjet, për shkak të rrethanave diskriminuese dhe përjashtuese të kohës.

Konsideroj se është kohë e fundit që institucionet shtetërore të drejtojnë vëmendjen te realizimi i së drejtës legjitime të pensionistëve kontributdhënës.

Konkretisht çështja të adresohet tek institucionet kompetente për ta ndryshuar legjislacionin, i cili dëmton qytetarët e Republikës së Kosovës.

Mbetet detyrim yni moral dhe institucional që të përkushtohemi në lehtësimin e rrethanave dhe rikthimin e dinjitetit të pensionistëve kontributdhënës.

Dhe, në fund, mendoj se Kuvendi është vendi ku do të bëhet zgjidhja e këtij problemi, sepse edhe sindikalistët e pensionistëve paraprakisht veç i kanë takuar edhe grupet parlamentare dhe njëherësh kanë kërkuar zgjidhjen e këtij problemi afatgjatë. Faleminderit!

KRYETARJA: Nga Grupi Parlamentar Lista serbe, a dëshiron dikush fjalën? Nuk është askush këtu. Nga Grupi 6+ deputeti Albert Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, e nderuar kryetare e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot jemi duke diskutuar për një kategori njerëzish, për të cilët ne kemi një respekt të veçantë dhe mendojmë se puna e këtyre pensionistëve kontributdhënës është stërzgatur vite me radhë dhe ky proces është duke pritur zgjidhje ligjore. Duhet të bëhet kategorizimi i pa marrë parasysh vitet e kontributit të këtyre kontributdhënësve. Iniciativa e propozuesit për të gjetur një zgjidhje është për t'u përshëndetur, ndërsa ne si Grup Parlamentar 6+ e përkrahim, por mendojmë se ka nevojë për plotësimin e rezolutës dhe sa më shpejt në një kohë optimale ministria dhe Qeveria ta hartojë ligjin për rregullimin e kësaj çështje mjaft sensitive për të gjithë pensionistët pa dallim, sepse kjo kategori e qytetarëve meriton një jetë më të dinjitetshme. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Nga Qeveria fjalën e ka ministri Skënder Reçica. Urdhëro, ministër!

MINISTRI SKËNDER REÇICA: Faleminderit, zonja kryetare e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Fillimisht më lejoni t'ju falënderoj për këtë debat për një çështje kaq të rëndësishme për qytetarët e vendit.

Çështja e pensionit kontributpagues ka qenë preokupim imi si ministër i Punës dhe Mirëqenie Sociale në mandatin e kaluar dhe vazhdon të mbetet edhe tani dhe jo vetëm preokupim, por edhe prioritet imi dhe i Qeverisë së tanishme.

E them prioritet, sepse në programin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, por edhe të Qeverisë në përgjithësi, por edhe në agjendën legislative kemi paraparë veprime konkrete për t'u dhënë zgjidhje të gjitha problemeve që janë ballafaquar pensionistët tanë tash e 20 vjet.

Tani dua që këtë temë ta shtroj në tri rrafshë.

E para, si kemi ardhur deri te kjo situatë, si kemi ardhur deri te kjo gjendje me pensionistët kontributpagues.

E dyta, çfarë kemi bërë në mandatin e kaluar dhe

E treta, çfarë jemi duke bërë tani.

Si kemi ardhur deri këtu? U fol nga një pjesë e deputetëve, por dua ta shpjegoj për të gjithë qytetarët e vendit, por edhe për ju në esencë se si kemi ardhur deri këtu.

Të nderuar deputetë,

Ju jeni të informuar se sistemi pensional në Kosovë ka pasur ndërprerje të plotë nga fundi i vitit 1998 deri në vitin 2001. Gjatë kësaj periudhe kohore pensionet në Kosovë nuk janë trajtuar me ndonjë ligj apo edhe me ndonjë rregullore të veçantë.

Në dhjetor të vitit 2001 UNMIK në atë kohë nxjerr Rregulloren 2001/35 për pensionet në Kosovë, në të cilën trajton vetëm pensionet obligative, të cilat kanë përfshirë dy forma të pensioneve: pensionin bazë dhe pensionet e bazuara në kursimet individuale apo Trusti, si njihet në opinion.

Në bazë të së cilit nuk është paraparë pension kontributiv dhe nuk janë njohur kontributet e paraluftës.

Në vitin 2007, Qeveria e asaj kohe, konkretisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr Udhëzimin Administrativ numër 11/2007 për zbatimin e Vendimit numër 13/277 të Qeverisë së Kosovës, i cili ka pasur për qëllim rritjen e shumës së pensioneve, ndërsa në nenin 3 të këtij udhëzimi janë përcaktuar kushtet dhe kriteret e përgjithshme për përfitim në rritje të pensionit bazë.

Për të përfituar në këtë rritje shfrytëzuesit e pensionit bazë të asaj kohe dhe personat të cilët në të ardhmen do të aplikojnë për këtë pension, sipas Vendimit të Qeverisë të asaj kohe numër 13/277, duhet përmbushur kushtet dhe kriteret e përgjithshme citoj: “Parashtruesi i kërkesës duhet ta ketë moshën 65 vjet dhe minimumi 15 vjet stazh të sigurimit pensional” dhe këtu ka qenë pikënisja e parë e ndarjes mes pensioneve bazë dhe pensioneve kontributpagues.

Gjithashtu më vonë me Udhëzimin Administrativ 15/2009 po ashtu Qeveria e asaj kohe nxjerr Udhëzim të ri Administrativ numër 202/51 për zbatimin e vendimit të Qeverisë për rritjen e pensionit. Edhe në këtë udhëzim administrativ konfirmohen kriteret e njëjta 65 vjet, 15 vjet stazh pune.

Për të ardhur në vitin 2014, ku Kuvendi i Kosovës miraton Ligjin 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe unë mendoj se ky Kuvend në vitin 2014 ka pasur mundësi që këtë padrejtësi tash 14 vjet deri në atë kohë ndaj pensionistëve kontributpagues ta përmirësojë. Çfarë ka ndodhur me këtë ligj?

Në nenin 8 të këtij ligji janë paraparë kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtës në pension kontributpagues të moshës. Pika 1, citoj: “Të drejtën në pension kontributpagues të moshës e realizojnë të gjithë persona, të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe të cilët: 1.1. kanë të mbushur moshën 65 vjet,

1.2. duhet të kenë stazh kontributdhënës sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor numër 01124/83 Gazeta Zyrtare KSAK, numër 26/83, para datës 1 janar 1999. 1.3. ofrojnë dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor numër 01124/83 Gazeta Zyrtare KSAK 26/83 para datës 1 janar '99.

Të nderuar deputetë,

Për hir të vërtetës dua të zbërthej akoma më qartë për ju dhe për të gjithë qytetarët e vendit se kriteret e parapara sipas pikës 1.1. dhe 1.2 të nenit 8 të Ligjit për skema pensionale të financuara nga shteti, miratuar nga ky Kuvend i Kosovës në vitin 2014, bazën e kanë në Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor numër 01124/83 Gazeta Zyrtare e KSAK 26/83, konkretisht në Ligjin për të drejtat bazike të sigurimit pensional dhe invalidor të RSFJ-së numër 18304/1982 dhe atë në nenin 21, pensioni i pleqërisë, ku parashihet që përfituesit e këtij pensioni të kenë moshën 65 vjet dhe së paku 15 vjet stazh pension kontributpagues.

Këtu është historia që kërkohet 15 vjet stazh në ligjin e Federatës së Jugosllavisë që ky Kuvend e ka marrë si model në vitin 2014.

Ndërsa në vitin 2015, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale me qëllim të zbatimit të Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti nxjerr Udhëzimin Administrativ numër 9/2015, me ç'rast zbërthen më detajisht kriteret e parapara në nenin 8 të Ligjit për skemën pensionale të financuar nga shteti.

Të nderuar deputetë,

Ju të gjithë si ligjvënës tashmë e keni të qartë dhe besoj që këtë nuk e kërkonin që në udhëzim administrativ Qeveria të ndërrojë dispozitat e ligjit, ligji ndërrohet me plotësim-ndryshim, e jo me udhëzim administrativ.

Kjo është historia si kemi ardhur deri te kjo situatë me pensionistët kontributpagues. Këto kritere të përcaktuara me Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti kanë shkaktuar probleme në realizimin e së drejtës në pension kontributiv për shumë qytetarë të Kosovës.

Kanë privuar nga e drejta për pension kontribut pagues, fillimisht rreth 17 mijë pensionistë që tani pas njohjes së stazhit të punës të viteve '90 të personelit arsimor, kanë mbetur rreth 11 mijë, të cilët në vitin 1990-99 regjimi serb i asaj kohe me dhunë i largoi nga vendet e tyre të punës, e si pasojë nuk kanë arritur të përmbushin kriterin prej 15 vjet kontribute dhe sot e kësaj dite marrin pension bazik të moshës, në vend që të gëzojnë pensionin kontributpagues.

Gjithashtu ka qytetarë të Republikës së Kosovës, të cilët janë pensionistë kontributpagues, por njëkohësisht janë familjarë të familjes së dëshmorit ose invalidë të luftës dhe me Ligjin aktual të skemave pensionale të financuara nga shteti kanë të drejtë vetëm një pension të vetëm.

Unë e kam thënë shpeshherë dhe konsideroj se është shkelje e të drejtave të tyre, sepse në këto familje është derdhur gjak, po njëkohësisht është derdhur edhe djersë për kontributin e tyre në punë.

Lajmërimi i pensionistëve çdo 6 muaj ka shkaktuar telashe për pensionistë të Republikës së Kosovës, sepse me gjithë pleqërinë e tyre, duhet që çdo 6 muaj të vizitojnë zyrat pensionale anekënd vendit për t'u lajmëruar se janë ende në jetë apo janë ende banorë të Kosovës.

Çfarë kemi bërë në mandatin e kaluar?

Të nderuar deputetë,

Për informimin tuaj dhe të gjithë qytetarëve, Kosova nuk ka sistem të mirëfilltë pensional, por ka skema pensionale të financuara nga shteti dhe Trustin pensional. Pra, Kosova nuk ka instaluar fare sistemin e sigurimeve sociale në vend, sistem i cili në mënyrë uniforme do të rregullojë çështjen pensionale, edhe pse kemi obligim ndërkombëtar, sepse në vitin 2015 me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, bazuar edhe në Kartën e Budvës të vitit 2012, Kosova merr obligime që deri në vitin 2020 të ndërtojë Fondin për sigurime sociale, këtë nuk e kemi bërë.

Si rrjedhojë, diskrepanca në sistemin aktual të sistemeve pensionale janë të shumta. Sistem jo i konsoliduar, i përbërë prej 23 skemave pensionale, të cilat janë krijuar në bazë të nevojave të kohës.

Të gjitha këto skema pensionale ose kompensime aktualisht janë të rregulluara në tetë ligje të ndryshme, të cilat shpesh bie ndesh njëra me tjetrën dhe kanë shkaktuar zbatim në praktikë të këtyre dispozitave ligjore.

Duke u bazuar në analizën dhe gjendjen aktuale, kemi konstatuar se në vend kemi mungesë të një:

Sistemi të sigurimeve sociale bazuar në kontributet e punëdhënësve dhe punëmarrësve.

Mungesë të një ligji bazik dhe sistemor që rregullon dhe menaxhon pensionet dhe beneficionet për të gjitha kategori.

Mosharmonizim të skemave pensionale, përfitime të ulëta dhe të ardhurave pensionale, vështirësitë në realizimin e të drejtës në pensionet e jashtme, presione fiskale buxhetore, organizim joadekuat të institucioneve që merren me pensione.

Të gjitha këto që i përmenda janë vështirësi, probleme dhe mangësi që kanë ndikuar ndoshta edhe në disa raste në mostrajtimin adekuat të kriterëve të supozuara për njohjen e së drejtës në pension.

Prandaj, bazuar në këto analiza, në mandatin e kaluar ne kemi hartuar koncept dokumentin për reformën e plotë të sistemit pensional dhe institucional dhe ky reformim bazohet në:

1. Hartimin e një ligji unik për pensione, në të cilën do të përfshiheshin ose trajtoheshin të gjitha të drejtat në pensione. Projektligj i cili përcakton, respektivisht trajton të gjitha ato të drejta me një kërkesë dhe në një vendimmarrje.

2. Krijimin e fondit për sigurime sociale i hartuar me një ligj përkatës, e në të cilën do të përcaktohej struktura organizative, forma menaxhuese, norma e kontributeve pensionale invalidore.

Këtë koncept dokument ne e patëm përfunduar në nëntorin e viti 2018 dhe të njëjtin e patëm dërguar në Qeveri për miratim.

Sot dua të jem shumë i hapur, nuk ka pasur kapacitete dhe vullnet politik për ta shtyrë përpara këtë reformë. Më vonë, në vitin 2019 Kuvendi i Kosovës pati krijuar Komisionin e veçantë për të

hartuar Kodin pensional, kështu e patën quajtur, mirëpo duke ditur rrethanat në të cilat kemi kaluar, Kosova mbetet pa reformë pensionale dhe pa kod pensional.

Çfarë jemi duke bërë tani? Duke ditur nevojën dhe rëndësinë e realizimit të reformës pensionale në vend, ne jemi duke punuar me prioritet në këtë reformë dhe në bazë të agjendës legislative të Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale planifikojmë që koncept dokumentin e reformës ta miratojmë në vjeshtën e këtij viti, për të vazhduar hartimin e dy projektligjeve të cilat do të burojnë nga ky koncept dokument.

Meqë çështjet e përmendura më lart kërkojnë një intervenim të shpejtë, tani ne jemi duke punuar në dy drejtime. Fillimisht në Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, por gjithashtu jemi duke vazhduar punën në reformën e plotë të pensioneve dhe beneficioneve në Kosovë.

Nisur nga fakti që reforma pensionale do të marrë kohë më gjatë dhe bazuar në gjendjen dhe trajtimin jomeritor të pensionistëve kontributpagues, kemi konsideruar se është nevojë urgjente për të intervenuar në Ligjin për skema pensionale të financuara nga shteti. Prandaj, paralel me punën në koncept dokumentin për reformën pensionale, tani më kemi hartuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe aktualisht jemi në pritje të deklaratës financiare nga ana e Ministrisë së Financave për të proceduar tutje për miratim në Qeveri konform agjendës legislative që nënkupton datën 30 korrik, konkretisht edhe një javë.

Me këtë projektligj janë paraparë ndryshimet e domosdoshme, të cilat do të përmirësojnë të gjeturat, të cilat një kohë të gjatë kanë qenë barrierë për të drejtat e pensionistëve tanë.

Me projektligjin e ri do t'u njihet stazhi i punës të gjithë punonjësve të larguar nga puna me dhunë në vitet 1990-1999 dhe me këtë rast do t'u njihet e drejta në pension kontributiv këtyre punëtorëve të viteve të '90-ta. Nën dy, përfituesit e pensionit kontributiv dhe pensionit bazik, përveç këtyre pensioneve, do të fitojnë të drejtën e përfutimit njëkohësisht edhe të pensionit familjar të dëshmorit apo invalidit të luftës, sipas Ligjit për kategoritë e dala nga lufta.

Nën tre, lajmërimi i pensionistëve do të rregullohet me udhëzim administrativ dhe kjo do të rregullohet në bazë të rrethanave dhe kushteve, në të cilat jemi tani, ndoshta do të zgjatet një vit, ku pensionistët do të lajmërohen në zyrat e pensioneve, por është e mundur që edhe në aplikacionin online pensionistët të lajmërohen nga shtëpia, por kjo mbetet të rregullohet me udhëzim administrativ, e jo siç është deri më tani me ligj. Gjithashtu, jemi në përfundim të ndryshimeve të akteve nënligjore për njohjen e diplomave të të gjithë pensionistëve, të cilët kanë diplomuar nga viti 1991 deri në vitin 1998.

Të nderuar deputetë,

Debati i iniciuar sot në Kuvend ka qenë i domosdoshëm dhe është shumë me rëndësi të debatohet për çështjet, të cilat i preokupojnë qytetarët tanë, mirëpo kërkohet nga ne dhe nga ju, por edhe nga partitë politike që çështjet me rëndësi të veçantë për qytetarët të mos ngrihen vetëm për poenë politike, por të tregohet një sinqeritet dhe bashkëpunim që iniciativat e ndërmarra të mbështeten, e të cilat në të kaluarën nuk kanë gjetur përkrahje. E them këtë, sepse ka dy vjet që ne kemi përfunduar koncept dokumentin e reformës pensionale dhe ka qëndruar nëpër sirtarë e nuk është miratuar fillimisht në qeveri, për t'i hapur rrugë krijimit të dy ligjeve që sot ne kishim mundur të debatojmë sa po zbatohen ato dy ligje. Ndërsa, sot jemi kthyer dy vjet mbrapa, po debatojmë për iniciimin e projektligjeve për ndryshimin dhe realizimin e të drejtave të pensionistëve tanë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministër!

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se aktualisht janë të lajmëruar 8 deputetë për fjalë dhe siç e dini, në orën 12:00 është raportimi i kryeministrit, është një propozim që fjalimet e deputetëve të reduktohen në 5 minuta, nëse është pajtueshmëria juaj, kështu që ju kisha lutur të deklaroheni a mund të mbajmë në pesë minuta fjalimet dhe të provojmë ta përfundojmë para orës 12:00. Domethënë, po, ka pajtueshmëri, faleminderit, atëherë për secilin deputet nga pesë minuta fjalimi.

Fjalën e ka deputeti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Faleminderit, kryesuese!

Zoti ministër, përshëndetje, sa po e shoh qeveria të paska lënë vetë, kështu së paku ka qenë dashur këtu të jetë ministrja e Financave dhe e Transfereve, se ka të bëjë me çështjet që kanë edhe implikime buxhetore.

Kolegë deputetë,

Pensionistë të dashur,

Qytetarë të respektuar,

E nderuar kolege Teuta Haxhiu, faleminderit për iniciimin e këtij debati parlamentar. E drejta e sigurimeve pensionale është e drejtë themelore e njeriut, e njohur, e garantuar me aktet juridike ndërkombëtare. Politikat pensionale të shtetit luajnë rol kryesor në promovimin e një jetese të sigurt, të shëndetshme, si dhe të denjë në realizimin e një qenie njerëzore. Reformimi dhe modernizimi i politikave pensionale është gur themeli i një shteti modern që përfshihet aktivisht në dhënie dhe promovimin e drejtësisë dhe barazisë sociale. Politikat pensionale para vitit '99, e veçanërisht ajo para vitit 1989, dominojnë nga institucionet e sigurimit social duke e ndjekur kryesisht modelin konservativ, ose siç quhet të "Bizmarkut", njëjtë si në etnitetet e tjera të ish-Jugosllavisë.

Ajo politikë kishte përparësitë e veta, sepse lëshonte pensione gjeneroze për pensionistët që kishin dhënë kontribute si punëtorë të mëhershëm dhe krijonte solidarizime të ndryshme brenda grupeve të atyre që kishin punuar më mirë. Megjithatë, kjo politikë kishte edhe mangësitë e saja më kryesore, prej të cilave ishin paqëndrueshmëria ekonomike dhe përjashtimi i madh i atyre që nuk kishin pasur fatin të punonin. Ndërprerja e sistemit pensional dhe invalidor para vitit 1999 dhe krijimi i një sistemi tërësisht të ri pensional i bazuar në skemat të financuara nga buxheti i shtetit dhe krijimi i shtyllës së dytë pensionale për gjeneratat e reja të punësuaras pas vitit 2002, ka krijuar pakënaqësi të një numër i madh i qytetarëve kosovarë, për shkak të mosvazhdimësisë, duke u pamundësuar atyre mbrojtje të mirëfilltë sociale, si dhe pasiguri të pamjaftueshme të kursimeve që mund t'u kanosen gjeneratave të ardhshme. Me një fjalë, sistemi që është vendosur pas luftës nuk krijon zgjedhje as për gjeneratat e kaluara që kanë dhënë kontribute, por as zgjidhje adekuate për gjeneratat e reja dhe të ardhshme, të cilat lihen të përballen me rreziqe dhe nevoja sociale pa mbrojtje të duhur institucionale.

Përveç kësaj, pensionet janë rritur përgjatë viteve dhe kanë krijuar një numër të drejtash të kontestueshme edhe nga këndvështrimi i barazisë dhe i qëndrueshmërisë financiare. Aktualisht sistemi pensional në Kosovë organizohet në tri shtylla: shtylla e parë, përbëhej fillimisht nga pensionet publike të paguara për të gjithë kosovarët, duke përfshirë pensionin me aftësi të kufizuar. Kjo shtyllë është plotësuar më vonë vazhdimisht me shtimet në pensionet shtetërore. Shtylla e dytë, është program i kursimeve të obliguara individuale, i financuar nga çdo person që punon te punëdhënësi i tyre së bashku. Dhe, shtylla e tretë që përfshin pensionet vullnetare në treg. Problemet kryesore të sistemit pensional në Kosovë janë: mungesa e plotë e një sistemi të sigurimeve sociale të bazuara në kontributet e të punësuarve dhe punëdhënësve. Mungesa e një ligji bazik dhe sistemor unik që rregullon dhe menaxhon pensionet dhe beneficionet nga sigurimi social për të gjitha kategoritë, paqëndrueshmëria financiare dhe pamjaftueshmëria e të ardhurave pensionale, presioni i kërkesave urgjente nga grupet e interesave për përfshirje në skemat e mbrojtjes sociale, vështirësitë në realizimin e së drejtës për pensionet e jashtme, të drejtat e pensionistëve kontributdhënës.

Pensioni kontribuues mbulon të gjithë individët, të cilët kanë shtetësi të Kosovës dhe, të cilët në pikën 1.1 kanë mbushur moshën 65 vjeç. Pika 1.2. duhet të kenë eksperiencën e punës së paguesit të kontributit pensional sipas Ligjit për sigurimin pensional dhe invalidor të gazetës që u përmend edhe më herët, të Kosovës. Megjithatë, skema quhet kontribuuese dhe shuma e pensionit dhe kategorizimi nuk ka të bëjë me shumën e kontributit të paguar para vitit 1999, është plotësisht e mbuluar nga buxheti i shtetit. Zbatimi i kësaj skeme ka filluar në vitin 2008, ndërsa më 2015 është bërë kategorizimi brenda kësaj skeme dhe ka filluar të zbatohet në vitin 2016. Për shkak të të dhënave të pamjaftueshme në lidhje me kontributin e paguar para vitit 1999, kategorizimi është bërë sipas nivelit të arsimimit, sipas Udhëzimit Administrativ, të cilin e përmendi edhe ministri. Për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas

strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve, stazhi pensional. Sipas këtij Udhëzimi ekzistojnë katër kategori: arsimi fillor...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Reçica! Fjalën e ka deputetja Rrezarta Krasniqi! A ka mundësi edhe 30 sekonda, regjia ju lutem, ta përfundojë!

ELMI REÇICA: Nuk mund ta përfundoj, kryesuese, veç desha që ta mbështes ministrin në atë çështjen se është vërtet turp për ne që familjet e dëshmorëve që kanë edhe kontributdhënës që janë në pensionin e tyre t'i ndalen njëri nga ato pensione, vërtet është turp për të gjithë ne dhe do të duhej që sa më shpejt, dhe kisha për të thënë urgjentisht kjo çështje të rregullohet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Rrezarta Krasniqi!

RREZARTA KRASNIQI: E nderuar kryesuese e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Ata që u angazhuan në një formë apo në formën tjetër për të krijuar mirëqenie në familje e shoqëri sot nuk e kanë përkrahjen dhe kujdesin e shtetit ashtu siç e meritojnë. Fjalën e kam për prindërit dhe gjyshërit tanë, përkatësisht pensionistët kontributdhënës, të cilëve nuk u është njohur e drejta e pensionimit si kontributdhënës për shkak të problemit me shtetin serb, ku siç e dini që 19 vjet Fondi Pensional i Kosovës mbetet atje në mënyrë të paligjshme.

Tani është përgjegjësi jona si deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës që të angazhohemi për të drejtat e kësaj kategorie që ka mbetur e diskriminuar tash e sa kohë. Ne si deputetë duhet ndërtuar praktika të mirëbesimit mes vete dhe të zgjidhim hallet e qytetarëve, siç është ky me pensionet e kontributpaguesve, të cilët sot nuk marrin pensionin kontributdhënies, por marrin vetëm atë të moshës 65-vjeçare, i cili nuk plotëson as nevojat bazike për jetesë. Jo rrallë i kemi dëgjuar edhe thirrjet e pensionistëve se paratë që i marrin si pension bazë nuk u mjaftojnë as për barna, lëre më për t'u furnizuar me ushqime apo diçka tjetër. Andaj, duhet të jemi të vullnetshëm të mbështesim nisma të tilla, ku në radhë të parë është interesi i qytetarëve, siç është edhe rasti i pensionistëve, ku po diskutojmë sot për të ulur stazhin e punës përmes Udhëzimit Administrativ, në mënyrë që të jenë të përfshirë të gjithë ata që kanë punuar aq vite dhe kanë kryer kontribut ndaj shtetit. Mendoj se iniciativa të tilla duhet të kemi edhe në të ardhmen dhe të trajtohen me prioritet të lartë, prindërit dhe gjyshërit tanë kanë vend të veçantë në familje dhe shoqëri, njësoj duhet trajtuar edhe nga vetë shteti me pensione të larta e të mjaftueshme për plotësimin e nevojave bazike jetësore.

Është koha t'u sigurojmë dinjitet dhe mirëqenie të mirë të gjithë qytetarëve pa dallime, sepse për atë edhe e kemi marrë besimin e tyre. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Ariana Musliu-Shoshi.

ARIANA MUSLIU-SHOSHI: E nderuar nënkryetare!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Faleminderit për prezantimin tuaj, tema për të cilën po diskutojmë sot është shumë e rëndësishme, sepse bëhet fjalë për shumë pensionistë të Kosovës, të cilët nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit, meqenëse ata nuk i kanë 15 vjet përvojë të punës.

Për këtë kategori kemi përgjegjësi morale që të tregojmë mirënjohje ndaj kontributit të tyre të dhënë. Nuk ka në asnjë vend të botës, ku kategorizimi për të përfituar pension bëhet paushall dhe me vite. E drejta në pension është universale dhe e patjetërsueshme. Po sikurse një qytetar yni të kishte të drejtë adresimin e kësaj çështje në ndonjë nga gjykatat ndërkombëtare, pa dyshim që do ta fitonte, sepse një kufizim i tillë është diskriminues, joligjor dhe jokushtetues. Mendoj që deputetja Haxhiu e ka bërë një nismë shumë të mirë, mirëpo mendoj që një gjë e tillë do të bëhet edhe më mirë sikur të kemi të bëjmë me ligj dhe jo me procedura, andaj mendoj se ky mocion duhet të plotësohet me propozim konkret që të formohet grupi punues dhe të bëhet ndryshim plotësimi i Ligjit/L- 131 për skemat pensionale të financuara nga shteti, konkretisht neni 8 i këtij ligji.

Sidoqoftë, ne do të votojmë këtë propozim, sepse e kemi detyrë që të kujdesemi për të moshuarit që ata të kalojnë një pleqëri të dinjitetshme dhe të lumtur. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Musliu! Fjalën e ka deputetja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Autoritetet serbe tash e shumë vjet po vazhdojnë ta mbajnë të bllokuar kthimin e Fondit Pensional të Kosovës. Shteti i Serbisë kishte ndalur kontributet e pensionistëve të Kosovës nga qershori i vitit 1999, pas përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, më saktësisht në momentin që miratohet Rezoluta 1244 dhe vendoset misioni i UNMIK-ut në Kosovë.

Serbia ndërpret çdo pagesë për pensionistët kontributdhënës të Kosovës të nacionalitetit shqiptar. Që nga atëherë, pensionistët e periudhës para vitit 1999 nuk kanë arritur të marrin paratë e tyre

nga ky fond, ndërkohë që sipas Shoqatës së Pensionistëve, tash një numër i konsiderueshëm i tyre kanë ndërruar jetë dhe mbetet diskutabile edhe çështja e trashëgimit të pensionit.

Kërkojmë që në marrëveshje përveç çështjes së kthimit të fondeve pensionale, të iniciohet që edhe nëse pensionisti është gjallë, mjetet i merr vetë, nëse ka vdekur, pensionin e merr bashkëshortja, por nëse ka vdekur edhe bashkëshortja, paratë i merr anëtari i familjes së ngushtë që është përkujdesur për të. Në çdo takim me shtetin serb kemi të drejtë të kërkojmë llogari pse Serbia ndërpreu pensionet vetëm për shqiptarët, duke e grabitur Fondin Pensional në kundërshtim edhe me Kushtetutën e vet si shtet, konventat ndërkombëtare, si dhe në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

Sipas vlerësimeve të përafërta që prezantohen nga shoqatat e pensionistëve, thuhet se shuma e Fondit Pensional të Kosovës, i cili është marrë jashtëligjshëm nga Serbia, arrin vlerën e 2 miliardë eurove. Sipas Shoqatës së Pensionistëve në periudhën kur në mënyrë joligjore Serbia ka marrë Fondin Pensional, është llogaritur të jenë mbi 89 mijë pensionistë. Kemi raste të panumërta nga një numër i madh i pensionistëve, të cilët vazhdimisht kanë kërkuar kthimin e pensioneve të tyre nga ana e Serbisë, si institucione duhet të angazhohemi maksimalisht në çdo formë dhe në çdo takim me Serbinë që zëri i këtyre pensionistëve të dëgjohej. Ata nuk po kërkojnë asgjë më shumë, asgjë më pak se sa të drejtën e tyre të pamohueshëm.

Shteti i Serbisë duhet t'i kthejë pensionet e kontributdhënësve, sepse tek e fundit, kjo e drejtë e këtyre pensionistëve u garantohet me të gjitha konventat ndërkombëtare. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Kadrijaj! Fjalën e ka deputetja Saranda Musliu.

SARANDA MUSLIU: E nderuar nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Debati për pensionistët kontributdhënës është i nevojshëm kurdoherë, pasi që bëhet fjalë për një kategori që ka derdhur shumë mund e djersë në mënyrë që shteti i Kosovës t'i ketë themelet sa më të forta.

Janë këta njerëz që sakrifikuan shumë edhe në rrethana okupimi, por nuk e lanë popullatën keq e pa i marrë shërbimet në shumë sfera të jetës. Veçanërisht, nuk duhet harruar kurrë kontributi i punonjësve të arsimit të viteve '90-ta, të cilët me shumë përpjekje arritën t'i mbajnë gjallë shkollat në gjuhën shqipe edhe nëpër bodrume e në shtëpi private. Po ku janë këta njerëz sot dhe si jetojnë? Cili është kujdesi i shtetit për ta? Secilin prej nesh duhet ta brejë ndërgjegjja se nuk kemi bërë as nuk po bëjmë sa duhet për këtë kategori të popullatës, e cila nuk e ka jetesën që e meriton. Kontributet e tyre gjatë kohës sa ishin të punësuar nuk mund të matet me vlerën e

pensioneve që i marrin ata sot, sepse rrethanat e veprimtarisë së pensionistëve kontributdhënës në okupime ishin të vështira.

Prandaj, kujdesi shtetëror për ta duhet të ndryshojë për të mirë. Pensionet që marrin nuk u mjafton as për barna, e as për një pleqëri të dinjitetshme, ndërsa ne përmes formave ligjore kemi mundësi t'ua lehtësojmë jetën, por edhe qasjen në shërbime shëndetësore. E di që nuk paguajnë për disa shërbime shëndetësore, por shpesh nuk arrijnë t'i marrin ashtu siç u nevojiten. Madje, është një realitet i hidhur në mesin e pensionistëve kontributdhënës kosovarë për faktin se disa prej tyre nuk mund të marrin pensionin e plotë. Disa prej këtyre pensionistëve për pak ditë nuk kanë arritur të dëshmojnë në dokumente se kanë paguar kontributet gjatë periudhës 15-vjeçare para luftës, sa kanë qenë duke punuar dhe sot nuk u takon pensioni kontributdhënës. Kjo mangësi nuk ka ndodhur për fajin e tyre, prandaj brenda ligjeve duhet bërë ndryshimet e nevojshme, në mënyrë që këta pensionistë t'i marrin pensionet e merituar.

Kjo padrejtësi duhet të rregullohet përmes ndryshimeve ligjore, të cilat duhet t'i bëjmë në Kuvend. Këta njerëz me shëndet të rrënuar dhe tani kur na ka kapluar infeksioni COVID-19, janë më të rrezikuarit, ndërsa u duhet patjetër ndihma jonë. Edhe pensionistët me kontribut nuk janë të kënaqshëm dhe nuk plotësojnë nevojat e pensionistëve, por në rastet kur kontributi i paguar nuk njihet, ky është një dekujarim, diskriminim, sepse kështu ata barazohen me njerëz që nuk kanë punuar dhe marrin pensionin e njëjtë. Rregullimet ligjore në fushën e pensionistëve janë të domosdoshme, sepse shteti duhet të zgjasë dorën tek ata që kanë më së shumti nevojë dhe për këtë fushë duhet të ndjekin praktikatat e vendeve të rajonit dhe atyre perëndimore.

Ne e dimë se çfarë jete bëjnë pensionistët kosovarë që kanë punuar këtu, dhe ata që kanë punuar në vendet perëndimore, por që pleqërinë e kalojnë në Kosovë dhe ky dallim duhet të na shërbejë për të ndërmarrë hapa sa më konkretë. Një ditë të gjithë do të arrijmë moshën e pensionimit, dhe kujdesi me të cilin do ta trajtojmë këtë fushë do të na prekë secilin prej nesh, ndërkaq më shumë se me kujdes ndaj të moshuarve në këtë rast, kemi të bëjmë edhe me motivim. Nëse do t'u siguroheshin pensionet e dinjitetshme dhe meritore në të ardhmen, sigurisht se të rinjtë e sotëm do të kenë një motivim shtesë për shkollim e kërkime shkencore. Ndërsa, edhe ne nuk do të dëgjojmë frazën e dhimbshme të atyre që pensionohen se nuk po u dhemb ndarja me procesin e punës më shumë se sa jetesa me pak para që do t'ua japë shteti pasi të pensionohen. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Musliu! Fjalën e ka deputeti Sejdi Hoxha.

SEJDI HOXHA: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar deputetë,

Shumë të respektuar pensionistë të Republikës së Kosovës,

E nderuar deputete, kolege Teuta Haxhiu, përgëzime për këtë iniciativë,

Faleminderit, zoti ministër, për propozimin tuaj që familjet e dëshmorëve përveç pensionit t'i gëzojnë edhe të drejtat e tjera të garantuara me ligj.

Kjo nismë ligjore do ta llogarisë dhe do ta çmojë djersën e punonjësve të viteve të paraluftës. Të mos harrojmë edhe faktin tjetër që ata kanë punuar në kushte shumë të rënda psikologjike edhe nga pushtuesi serb. Ne kemi obligim ligjor dhe moral si të zgjedhur të popullit që përmes iniciative ligjore ta rregullojmë çështjen e pensionit kontributdhënës të viteve të paraluftës. Njohja e kontributit pensional është e drejtë ligjore e të gjithë punonjësve që shumica nga ata janë dëbuar me dhunë nga puna në vitet e '90-ta. Shumë nga këta punonjës të viteve të '90-ta janë edhe çlirimtarët e popullit të Kosovës, sepse ata braktisën punën e tyre në vitet e '90-ta dhe iu bashkuan radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ky përbën edhe një fakt tjetër që ne kemi obligim moral, përveç obligimit ligjor që t'i ndihmojmë dhe t'i përkrahim pensionistët në realizimin e të drejtave të tyre ligjore. Pra, si deputet e mbështes fuqishëm një nismë të tillë ligjore, e cila do t'u mundësojë punonjësve të viteve të '90-ta të përfitojnë stazhin e tyre të punës, e drejtë kjo e cila është e garantuar me çdo ligj.

Unë mendoj që në rastet e tilla nuk do të kemi dallime politike dhe partiake, por nismat që kanë të bëjnë me çështje të tilla duhet t'i përkrahim të gjithë, në mënyrë që pensionistët tanë të ndihen edhe komod, të ndershëm, të ndjejnë përkujdesje nga institucionet e Republikës së Kosovës dhe nga të zgjedhurit e popullit siç jemi ne deputetët në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Lirije Kajtazi.

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit, e nderuar kryesuese e Kuvendit!

Natyrisht se secili deputet do ta fillonte sot fjalën me kërkesën që pensionet e vjedhura nga Serbia të jenë gjithnjë dhe është dashur që nga dialogu bisedat e para të jenë sigurisht edhe për kthimin e fondit të vjedhur, në mënyrë që të shihej edhe serioziteti a kemi dhe çfarë mund të bisedojmë më tutje. Ajo çfarë është rekomanduar nga institucionet, konkretisht nga Avokati i Popullit, të cilën e ka pranuar edhe ministri, më lejoni ta shpreh bindjen time për angazhimet e vazhdueshme të mëhershme, por tani të ministrit Reçica në mandatin e kaluar raportimet e tij para Komisionit për të Drejtat e Njeriut na ka njoftuar për të gjithë hapat, të cilët ai po i ndërmerr dhe kjo na bën të jemi më optimistë se çështjet janë në rrugë të duhur dhe rekomandimet nga Institucioni i Avokatit të Popullit kanë qenë që në përgjithësi të bëhet një reformë, e cila harmonizon legjislacionin vendor me atë ndërkombëtar, kjo edhe për shkak të standardeve që ai legjislacion ndërkombëtar i përmban, por edhe për obligimet që ka Republika e Kosovës, ngase i ka pjesë të Kushtetutës së vendit.

Prandaj, në këtë aspekt gjithsesi që duhet të shkohet me këtë harmonizim, të rregullohet edhe gjithë ajo shpërndarje kaotike thuajse në shumë ligje dhe në shumë skema, në mënyrë që të

precizohet saktë e drejta e secilit që ta gëzojë këtë mundësi. Ne si shoqëri vijmë nga një shtet më herët diskriminues që ka qenë dhe fundja, edhe pensionimet në shtetin diskriminues më herët, ish-Jugosllavisë, kanë qenë diskriminuuese, do të thotë edhe vetë punësimet. Por, sidoqoftë ata që kanë pasur të drejtën dhe mundësinë të pensionohen duhet ta marrin atë të drejtë tani, ta gëzojnë dhe natyrisht krejt ajo që është artikuluar sot këtu te stazhi 15-vjeçar, ngase natyrisht që u ngrit tension atyre të cilët kanë refuzuar një regjim represiv atëherë dhe të detyruar kanë lënë vendin e punës të mos e gëzojnë këtë të drejtë dhe ta gëzojë ai që në forma të ndryshme ka vazhduar punën.

Prandaj, gjithsesi duhet të merret për bazë kjo, duhet të rregullohen edhe ligje të tjera, Ligji për veteranë edhe invalidë. E dimë që është shumë i kufizuar në pjesën kohore, prandaj ka mbetur një pjesë e aktivistëve, të cilët edhe janë lënduar dhe sot janë invalidë nga protesta të shumta në fillim të viteve të '90-ta, do të thotë flas për dekadën '90-2000 dhe ata sot kanë një jetë mjaft të kufizuar nga lëndimet që kanë marrë gjatë refuzimit të atij regjimi dhe sot nuk gëzojnë kurrfarë të drejte. Do të thotë, duhet të përfshihen edhe këta në skemat pensionale, si dhe duhet të rregullohet po ashtu Ligji për të pagjeturit, duke e saktësuar edhe numrin e të humburve dhe, sikurse që thamë, edhe për pjesën e dëshmorëve sa anëtarë kanë humbur, por edhe skemat e tjera, të cilat rregullojnë kategoritë e diskriminuara apo kategoritë hendikep, thjesht që i diskriminon ligji, ngase kemi pasur ankesa si Komision i të Drejtave të Njeriut që është angazhuar dikush në proces zgjedhor në fazën e zbatimit të zgjedhjeve për pak muaj dhe menjëherë automatikisht ka dalë nga skema e gëzimit të së drejtës invalidore.

Do të thotë, në përgjithësi këto skema kanë nevojë të shikohen sikurse që duhet të mendojë ky shtet edhe për familjet me më shumë fëmijë, siç i kemi edhe modelet kur përmenda edhe standardet evropiane, duhet t'i shohim edhe modelet te shtetet e tjera, nënat që kanë rritur 5-6 fëmijë sigurisht se mund ta gëzojnë një të drejtë më të theksuar se sa ato që ndoshta nuk e kanë pasur përkushtimin e mjaftueshëm ose kanë përzgjedhur që të përkushtohen më shumë në karrierë apo në forma të tjera. Do të thotë, krejt këto na bëjnë që kur flasim për një kategori, ne të mendojmë, të jemi gjithëpërfshirës që të mos diskriminojmë dikë, ngase gjithnjë e drejtojmë gishtin e diskriminimeve të mëhershme, duke e mos e parë veten që ne po diskriminojmë edhe sot. Pra, përveç atyre që përmendi në emër të Grupit Parlamentar deputeti Shkëmb Manaj, që ne e kemi njohur stazhin e kontributdhënësve në arsim edhe në shëndetësi, kemi edhe kontribut...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESJA: Edhe 30 sekonda ju lutem, fjalën deputetes!

LIRIJE KAJTAZI: Faleminderit! Do të thotë, të njihet edhe e drejta, kanë qenë këshillat e financimit, të cilat kanë pasur grumbullimin e gjithë atij 3% që janë rrezikuar, e tjera. Do të thotë, kemi kontribuues të shumtë, të cilët në mënyrë të detajuar, ashtu siç shprehët gatishmërinë,

zoti ministër, të analizohen saktësisht dhe me reformë të përgjithshme të shkohet në skemat, të cilat nuk e diskriminojnë asnjë qytetar. Faleminderit, kryesuese!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Kajtazi! Fjalën e ka deputetja Ganimete Musliu!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar ministër,

Të nderuara kolege dhe ju kolegë deputetë,

Si deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës e mirëpres këtë debat për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës, si kategori tashmë për një kohë të gjatë e diskriminuar e shoqërisë tonë. Edhe pse nuk është bërë mjaftueshëm, duhet të theksohet se pensionistët në përgjithësi të gjitha kategoritë falë qeverisjes së Partisë Demokratike të Kosovës kanë gëzuar mbështetje të madhe për sa i përket rritjes së pensioneve dhe trajtimit të dinjitetshëm që meritojnë. Kjo kategori që ka dhënë kaq shumë kontribut për ndërtimin e shtetit dhe shoqërisë demokratike.

Nga periudha 2008 deri në vitin 2014, në fakt të gjitha kategoritë e pensionistëve kanë gëzuar rritje të pensioneve prej 200 deri në 300%. Megjithatë, për sa u përket pensionistëve kontributdhënës, Ligji për skemat pensionale në mënyrë krejt të padrejtë ka përcaktuar që për të qenë përfitues i pensionit kontributpagues të moshës e gëzojnë të gjithë personat, të cilët i kanë 15 vjet stazh para datës 1 janar të vitit 1999. Ndërkohë që kategorizimi i shfrytëzuesve të pensionit kontributdhënës është bërë sipas kohëzgjatjes së pagesës apo kontributit, si dhe kualifikimit arsimor dhe kriterëve të tjera mbetet absurde se si në mënyrë të padrejtë është vendosur kriteri i stazhit 15-vjeçar si kusht i përfitimit të këtij pensioni.

Si deputete e Kuvendit kam takuar dhjetëra pensionistë, të cilët nuk i kanë 15 vjet stazh dhe për këtë kriter ata përkundër kontributit dhe kualifikimit të tyre, nuk e gëzojnë një pension të merituar. Është mirë që së fundmi ministri Reçica ka marrë iniciativë për të reformuar sistemin pensional dhe për ta adresuar një herë e përgjithmonë çështjen e pensionistëve kontributdhënës. Natyrisht që ky debat do të rezultojë me disa rekomandime të vlefshme, të cilat do t'i japin ndihmesë dhe orientim të duhur edhe qeverisë në zgjedhjen e këtij problemi.

Propozojmë që të shqyrtohet mundësia e përfitimit të pensionit kontributdhënës mbi bazën e përshkallëzimit të viteve të stazhit, në mënyrë që për secilin vit stazh nën 15 vjet, secili pensionist të përfitojë në mënyrë proporcionale pensionimin kontributdhënës. Sigurisht që në këtë Kuvend do të japim edhe kontributin tonë me rastin e pranimit të Ligjit nga ana e qeverisë dhe do të analizojmë gjerësisht edhe praktikatat e vendeve të rajonit dhe pensioni kontributdhënës në Republikën e Kosovës të ofrohet si një e drejtë e patjetërsueshme e secilit person që ka dhënë kontribut dhe ka stazhin e caktuar. Përndryshe, tani kur në ligj kemi njohur stazhin e mësimdhënësve që kanë kontribuar në mbajtjen dhe organizimin e arsimit shqip në Kosovë në

vitet e '90-'99, do të ishte më se e domosdoshme që edhe kategoritë e tjera të pensionistëve që kanë stazh para vitit 1999 t'u njihet e drejta e një pensioni të merituar. Për fund, si deputete e shpreh zotimin tim që do të japim kontributin tonë që kategoria e pensionistëve kontributdhënës të rregullohet me ligj mbi bazën e meritave për secilin vit të kontributit të stazhit të tyre dhe kjo temë pas këtij mandati legjislativ t'i mbetet të kaluarës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Musliu! Fjalën e ka deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: E nderuar nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Ministër,

Pensionistët kontributdhënës kanë të drejtën e tyre që t'u njihet ligjërisht dhe moralisht kontributi i dhënë. Ata kanë punuar që të kenë një jetë më të dinjitetshme të pensionimit. Kanë të drejta për jetë më të rehatshme, për kujdes të veçantë shëndetësor, për njohje të kontributeve të dhëna dhe të mund të mbulojnë shpenzimet e tyre të përditshme me një pension të përputhshëm me koston e jetesës në Kosovë.

Edhe me vetë Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, neni 14, parashihet harmonizimi i pensioneve me koston e jetesës, ku thuhet "harmonizimi i pensioneve me koston e jetesës do të bëhet një herë në vit duke rritur shumën e pensionimit që duhet paguar në të njëjtën përqindje bazuar në indeksin e koston së jetesës të vitit paraprak". Pasi të jetë aplikuar rritja me përqindje rezultuese, shuma e pensionimit që del do të rrumbullakohet me numrin më të afërt të plotë. Indeksi i koston së jetesës do të përcaktohet nga Ministria e Financave dhe do të reflektojë ndryshimet në mesataren e shpenzimeve të jetesës të pensionistëve. Si personat me pension bazë të pleqërisë pa kontribute, si pensionistët kontributdhënës i kanë të drejtat e tyre të kenë pensionet më të larta në përputhje me koston e jetesës në Kosovë. Me nenin 8, kushtet dhe kriteret për njohjen e të drejtë në pension kontributpagues të moshës parashihet të drejtën në pension në kontributpagues, pensionistët të cilët kanë mbushur 65 vjet dhe kjo e fundit për moshën 65-vjeçare duhet të ndryshohet pasi që ka persona që do të duhej të kenë të drejtën për pensionim kontributpagues edhe para moshës 65-vjeçare nëse kanë ndonjë sëmundje të rëndë.

Duhet të bëhet gjithqysh edhe pensionimi i parakohshëm i mësimdhënësve para moshës 65-vjeçare, në rast të vlerësimit nga komisioni mjekësor se ata kanë sëmundje të rënda apo të pashërueshme, pasi që kemi raste kur mësimdhënësit kanë pësuar sulm në tru para moshës së pensionimit dhe janë detyruar të shkojnë në shkollë. Kjo çështje kërkon veprim të shpejtë dhe urgjentisht të ndryshohet Ligji i lartpërmendur. Po ashtu, paragrafi 6 i nenit 8, thuhet "me këtë ligj u njihet stazhi i punës për pensionistët kontributdhënës për vitet 1989 dhe 1999 punëtorëve të arsimit, të shëndetësisë dhe të tjerëve që kanë punuar në sistemin e Republikës së Kosovës". Përvoja e punës apo stazhi nga 15-vjeçar duhet të zbrësë në 10, nëse buxheti i Kosovës është i

varfër, mund të bie edhe në 8. Duhet të ndryshohet edhe Ligji për pensionet e aftësisë së kufizuar, ku kemi raste në Kosovë që personat që kanë pasur sulm kanë humbur aftësinë e tyre mendore, gjuhësore dhe bëjnë jetë tërësisht të varur nga kujdestarët e ata marrin vetëm një pension, por familjarët e tyre që përkujdesen për ta, edhe pse kanë punuar 30 vjet, e kanë braktisur punën në moshën 55-vjeçare për t'u kujdesur për anëtarin e tyre të familjes dhe nuk marrin pension para moshës 65-vjeçare.

Si kujdestar i familjarit me humbje të përhershme të aftësisë mendore, urgjentisht kujdestarët e familjarëve me humbje të përhershme të aftësisë fizike e mendore edhe para moshës 65-vjeçare duhet të marrin pensionin mujor dhe t'u njihet madje edhe përvoja e punës. Unë mendoj që Qeveria shpejt do të na sjellë këtë ligj dhe ne do ta japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Rexhepi! Fjalën e ka deputeti Bedri Hamza.

BEDRI HAMZA: Faleminderit, zonja nënkryetare!

I nderuar zoti kryeministër,

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Po flasim për një temë dhe për një sektor që realisht detyrimisht na imponon të gjithë neve që të marrim veprime të caktuara dhe konkrete. Është jashtëzakonisht pozitive inicimi i këtij debati, është pozitive që ne si deputetë kërkojmë, por realisht edhe të përkrahim qeverinë në adresimin e kësaj çështjeje.

Kur flasim për pensionistët kontributdhënës dhe në përgjithësi për pensionistët, jam i bindur që janë kategoria, e cila ka paguar koston më të madhe socio-ekonomike në 30 vjetët e fundit, jo vetëm pas luftës, por edhe gjatë viteve të '90-ta për shkak të inflacionit shumë prej pensionistëve as që kanë mundur të shkojnë t'i marrin pensionet. Kurrë s'e kam pasur të qartë, as sot s'e kam të qartë pse është caktuar kriteri 15 vjet?! Pse jo 10, pse jo 16?! Nuk ka ndonjë standard, por është caktuar një kriter. Dhe ne si Parti Demokratike edhe gjatë fushatës zgjedhore, në programin tonë zgjedhor e kemi pasur një propozim konkret që një pjesë të tij e dha edhe deputetja Musliu dhe e kemi të shkruar dhe besoj që do ta japim këtë kontribut në të ardhmen gjatë trajtimit të kësaj çështjeje që të jetë një përkallëzim. Nëse me një stazh prej 15 vjetëve e fiton të drejtën e pensionit 100% të jesh kontributdhënës, pse s'i bëjmë disa kategori dhe të themi: prej 1 deri 3 vjet është kjo përqindje, prej 3 deri 5 një përqindje tjetër, prej 5 deri 10 një tjetër dhe ai pensionisti me 14 vjet, se ne e dimë që ka shumë njerëz në Kosovë që për disa muaj nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e këtij pensioni dhe ai me 14 vjet t'i ketë 90% dhe të pensionit kontributdhënës.

Kjo fushë duhet të rregullohet, e tha edhe ministri, e dimë edhe tjerët që ka shumë ligje që e rregullojnë këtë fushë dhe duhet të harmonizohet kjo dhe duhet të mos eliminohen kolizionet prej

një ligji te ligji tjetër, përveç problemeve që i kanë pensionistët kontributdhënës dhe unë jam i sigurt që ka mundësi të adresohet në mënyrë korrekte dhe kurrkujt të mos i humbet kjo e drejtë për 2 muaj, 3 muaj apo 6 muaj. Në mënyrë të përshkallëzuar ne kemi edhe situatën ku realisht nënat e dëshmorëve vijnë në një situatë kur duhet zgjedhur mes njërit pension, a ta marrin pensionin e pleqërisë a pensionin e dëshmorit. Po e them, është numri i kufizuar, por është çështje e padrejtë. Te asistenca sociale, janë vendosur kriteret që duhet të përmirësohen, ka kriter ku thotë familjet, apo nënat, prindërit që i kanë fëmijët deri në moshën 5-vjeçare e gëzojnë këtë të drejtë, si t'i kalojë fëmija moshën 5-vjeçare, e humb atë të drejtë, por fëmija si i bëri 6, 7 vjet nuk ta përmirëson ty gjendjen ekonomike, përkundrazi, veç vijnë duke u rritur shpenzimet.

Prandaj, ne si Grup Parlamentar sigurisht i kemi propozimet tona shumë konkrete, të qarta, gjithmonë duke pasur kujdes edhe në mundësitë reale për financim, gjithmonë duke pasur kujdes edhe ruajtjen e stabilitetit makrofiskal, mirëpo kjo mund të akomodohet pa e cenuar stabilitetin makrofiskal, në përputhje me mundësitë tona për financim dhe besoj që edhe brenda kësaj rezolute, por edhe brenda procesit të përgatitjes, draftimit dhe finalizimit të ligjeve do ta japim kontributin tonë. Po, zoti ministër, ju lutemi që sa më shpejt ta adresoni këtë çështje, edhe pse nëse i kthehemi historikut dhe e marrim gjatë kohës kur Partia Demokratike ka qenë në pushtet, pavarësisht me cilët partner të koalicionit, nga vitit 2008 ka pasur një rritje sinjifikante të kësaj, pjesë e madhe është kryer, por këto duhet eliminuar dhe të hiqen, sepse pensionet në vitin 2008 kanë qenë dikur rreth 40 euro, ndërsa sot një pensionist kontributdhënës i merr mbi 240 euro, nuk është mjaftueshëm, nuk është boll, por këta të tjerët që për dy javë, tri javë, gjashtë muaj e humbin këtë të drejtë, ne duhet t'ua njohim këtë të drejtë, se nëse dikush e merr me 15, pse të mos e fitojë dikush 90% me 14 vjet. Ne sigurisht që do ta japim kontributin tonë dhe është çështje që ne si Parti Demokratike e përkrahim sa më shpejt të eliminohen këto probleme, të cilat janë në legjislacionin tonë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Hamza! Fjalën e ka deputeti Arbër Tolaj. Zoti Haradinaj, kërkoj falje, unë po e shoh emrin këtu dhe nuk e di saktë ku e ka vendin, pra flet deputeti Daut Haradinaj, me kartelë të deputetit Arbër Tolaj.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Po shihet një dakordim i përgjithshëm si të gjendet një zgjidhje për këtë temë dhe, sa për informacion të opinionit publik, janë rreth 2 mijë persona, të cilët mund të përfitojnë në rast se do të përmirësohet ligji, por një fakt i pamohueshëm është se ky ligj bazament e ka ish Ligjin e Jugosllavisë dhe ky ligj ka hyrë në fuqi në vitin 2014 dhe është ligj diskriminues për shumë kategori dhe në rast se qeveria nuk e sjell, ne si deputetë mund të marrim iniciativë, pra unë kërkoj edhe prej thirrësit të kësaj seance, të këtij debati, që t'i japë afatet se deri ku do të shkojë diskutimi. Unë i kam parë edhe zotimet publike të qeverisë që do ta trajtojnë këtë temë, por t'ju them sinqerisht, kjo është duke marrë një kohë bukur të gjatë, jemi duke dhënë deklarata publike, ndërsa veprimet nuk po ndodhin.

Në rast se 2 mijë persona në Kosovë kanë nevojë për një plotësim-ndryshim të amendamentit të këtij ligji, por unë mendoj që ky ligj duhet trajtuar seriozisht nga ekspertët, të cilët e njohin më mirë këtë fushë, ne do të jemi këtu për t'u ndihmuar që sa më shpejt ky ligj të hyjë në fuqi dhe t'u kthehet e drejta atyre njerëzve. Kërkesa eksplicite është të ulet stazhi i punës nga 15 në 10 vjet dhe ata qytetarë, rreth 2 mijë persona, mund të mos jem i saktë në shifra, nuk janë ndonjë dëm i madh për buxhetin e Republikës së Kosovës. Por, në vitin 2020 të ketë një ligj të bazuar nga ligjet e ish-Jugosllavisë është e pandershme për Qeverinë e Kosovës dhe për ne si deputetë. Në atë kohë ndoshta ka qenë emergjent, është votuar, por sot asnjë arsye nuk e kemi të kemi një ligj të përkthyer nga gjuha serbe në gjuhën shqipe dhe të votuar në Parlamentin e Kosovës. Kaq kisha, zoti ministër!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Haradinaj! Fjalën e ka deputeti Shpejtim Bulliqi.

SHPEJTIM BULLIQI: Faleminderit, nënkryetare!

Të respektuar kolegë deputetë,

Të respektuar qytetarë,

Unë i dëgjova me vëmendje të gjitha ato që u thanë nga kolegët rreth kësaj problematike, vërtet është për t'u brengosur që kjo problematikë e punëtorisë kosovare duhet të diskutohet në këtë fazë, me këto probleme pas 21 vjetëve të funksionimit të shtetit të Kosovës ose nga pas çlirimi dhe, fatkeqësisht ngrihet prej atyre të cilët për këto 20 vjet në një formë, me periudha të ndryshme kohore kanë qeverisur me vendin dhe njëkohësisht kanë qenë sponsorizues të po atyre ligjeve, të cilat sot janë në fuqi dhe të cilat zbatohen për këto kategori.

Unë desha të ndalem te një problematikë tjetër, për këtë kategori të punësuarve, për arsye se në bazë të informacioneve që i kemi, në disa organizata të asaj kohe punëtorja, pavarësisht faktit që ka punuar, dhe ka periudhë të gjatë kohore diku mbi 20 vjet përvojë të punës, kur kanë ardhur në fund, domethënë ka dalë që ajo përvojë e punës në vite të caktuara nuk është bërë pagesa nga udhëheqjet e atyre organizatave të asaj kohe, ndërsa ka pasur vite të tëra që ndoshta, pavarësisht faktit se punëtorëve tanë iu kanë ndaluar ato shuma të mjeteve për të paguar kontributdhënësit të këtij pensioni, prapëseprapë nuk janë derdhur në fondet adekuate dhe kësisoj, në momentin kur kjo klasë punëtoresë i kërkon ato kontribute, të cilat i ka paguar, del që ka shpëputje dhe ka diskrepancë në ato vite. Ta zëmë, ka shembull që dikush mund t'i ketë 20 vjet përvojë pune, domethënë në periudhën '90-'99 edhe më herët, ndërsa kur shkohet dhe merren dokumentacionet shihet që mund të ketë paguar përvojën e punës vetëm për 8 vjet, domethënë, mjetet u janë ndaluar atyre punëtorëve, ndërsa në realitet ato kontribute janë keqpërdorur dhe nuk kanë shkuar në destinacionin e duhur.

Kësisoj unë besoj që në bazë të informacioneve që kemi, për shembull, një numër i madh i punëtorëve të KEK-ut janë ballafaquar me këto probleme, por unë besoj që një numër i madh i punëtorëve të organizatave të tjera në atë kohë janë ballafaquar po me këtë problem. Prandaj,

mendoj që në rast se do të vijë deri te amendamenti i këtij ligji, unë besoj që duhet të kihet parasysh edhe kjo kategori e të punësuarve, sepse nuk është faji i tyre në qoftë se nga paga e tyre janë bërë ndalesa të atyre shumave të mjeteve për të paguar kontributin dhe nuk është paguar kontributi, kështu që pa fajin e tyre ata do të jenë të sanksionuar dhe nuk do të kenë mundësi të realizojnë të drejtën e tyre në pensionin kontributdhënës. Prandaj, unë mendoj që në momentin që fillohet amendamenti i këtij ligji, duhet pasur parasysh këtë kategori, në mënyrë që edhe kjo kategori të mos sanksionohet për shkak të asaj që janë keqpërdorur mjete të tillë të atyre punëtorëve të asaj kohe. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Bulliqi! Folësi i fundit i lajmëruar për këtë pikë është deputeti Shkëlzen Hajdini.

SHKËLZEN HAJDINI: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, ministra,

Të dashur deputetë,

Ne jemi duke debatuar sot për një kategori shumë të rëndësishme, e cila ka dhënë kontribut të veçantë në shtetndërtimin e vendit tonë. Legjislacioni në fuqi nuk trajton në mënyrë të drejtë dhe të dinjitetshme këtë kategori të kontributdhënësve, pensionistëve, të cilët kanë dhënë një kontribut shumë të rëndësishëm për të cilin jemi shumë mirënjohës.

Legjislacioni në fuqi, u përmend edhe më herët që referohet në Ligjin e ish- Jugosllavisë, me ligjin në fuqi dhe rregulloret në fuqi specifikohet që pensionistët duhet t'i kenë 65 vjet dhe 15 vjet përvojë. Bazuar edhe në diskutimet që u bënë nga deputetët e tjerë, me qëllim që të kursejmë dhe kohën dhe të mos përsëritem, unë kërkoj dhe nga Ministria relevante, në këtë rast ministri dhe nga ne deputetët të iniciojmë ndryshimin e ligjit në fuqi dhe të merren parasysh kontributi i secilit kontributdhënës për periudhën për të cilën jemi duke folur, të ulet stazhi së paku në 10 vjet ose, nëse keni mundësi të merret në konsideratë kontributi për secilin vit, për secilin kontributdhënës të dhënë në këtë periudhë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Ministri Reçica ka kërkuar fjalën edhe një herë në fund.

MINISTRI SKENDER REÇICA: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Me shumë vëmendje e dëgjova secilin fjalim që u diskutua këtu për këtë temë kaq të rëndësishme, më lejoni t'ju falënderoj të gjithëve edhe për komentet, edhe për sugjerimet, edhe për përkrahjet, se në esencë edhe kundërshtitë, diskutimet dhe vërejtjet e kanë një qëllim që të adresojmë një çështje që ka zënë vend tash e 20 vjet në vendin tonë, dhe nuk po flasim për një çështje, e cila ka ndodhur dje dhe po e diskutojmë sot.

Madje, këtë çështje edhe mandatin e kaluar më shumë se një herë e kam ngritur dhe nga kjo foltore, edhe në komisionet parlamentare, madje edhe me dokumente konkrete kemi tentuar të adresojmë këtë çështje, por fatkeqësisht kemi përshtypjen nganjëherë se diskutimet për çështje të cilat janë të interesit nacional po mbeten vetëm diskutime të foltoreve dhe të takimeve, por nuk po veprohet konkretisht, e them këtë me kompetencë, sepse sikur të kishim pasur përkrahjen në 2018-ën, sot ne nuk do të diskutonim për mënyrën se si t'i zgjidhim problemet e pensionistëve kontributpagues. U fol këtu që Ligji për skemat pensionale duhet të ndryshohet dhe të përcaktojë stazhin e punës nga 15 në 10, ose në 5. Atëherë unë ju pyes, çfarë bëjmë ne nëse e bëjmë nga 15 në 10? Do të diskriminojmë prapë një kategori e cila për dy-tri ditë nuk arrin t'i mbushë dhjetë vjet. U tha këtu, që ka pensionistë që nuk e kanë arritur stazhin 15 për muaj. Jo, ka për 3 ditë. Unë i kam në zyrë pensionistë që për 3 ditë nuk kanë arritur të përmbushin këtë kriter.

Problemi i çështjes së stazhit nuk zgjidhet kështu. Ne në reformën pensionale në koncept-dokumentin të cilin e kemi hartuar në vitin 2018, është një dokument që ka përmbledhur të gjitha problemet, me të cilat ballafaqohen qytetarët tanë, respektivisht pensionistët tanë të të gjitha kategorive. E thash në fjalimin e parë, nuk kemi sistem të mirëfilltë pensional. Kemi një sistem që është i ndërtuar prej 23 skemave dhe kemi 8 ligje që rregullojnë ato fusha të beneficioneve dhe pensioneve e të cilat në shumë raste krijojnë kundërshti me njëra tjetrën.

Do të thotë, problemi i pensionistëve në përgjithësi zgjidhet me reformë. Por, duke parë se kjo reformë, uroj që të kemi këtë mbështetje politike, siç e pamë sot në këto diskutime dhe uroj të mos mbeteten vetëm deklarative këtu në Kuvend, por edhe kur të vijë ligji të përkrahet, duke parë se reforma kërkon. Po, ne kemi filluar me urgjencë të intervenojmë në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti në tri çështje, që konsiderojmë se janë jetike për pensionistët tanë. E thash më herët, ky ligj ka diskriminuar, ose privuar, shtatëmbëdhjetëmijë pensionistë në vitin 2014 nga e drejta e tyre themelore për pension në kontribute. Tani kemi rreth njëmbëdhjetëmijë. Dhe, nëse ne vazhdojmë kështu ky numër do të zbrësë akoma më shumë dhe nuk do të arrijnë ata pensionistë tanë, të cilët kanë derdhur djersë e mund që t'i kemi edhe këto institucione sot, nuk arrijnë të gëzojnë një të drejtë themelore të tyre.

Prandaj, me urgjencë ne kemi nisur plotësim-ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti në tri çështje:

1. Njohja e stazhit për të gjithë ata që i dëboi Serbia me dhunë nga puna në vitet '90 - '99;
2. Pensionistët kontributpagues njëherësh familjarë të dëshmorëve apo invalidë të luftës të kenë të drejtë të gëzojnë edhe pensionin e tyre, edhe pensionin meritator që rregullohet nga Ligji për kategoritë e dala nga lufta; dhe

3. Intervenimin e tretë synojmë ta bëjmë në lajmërimin e pensionistëve tanë, që të mos u krijojmë vështirësi që çdo gjashtë muaj të paraqiten para sporteleve të zyrave të pensioneve.

Unë dua të ju siguroj që jo vetëm për këtë diskutim, po në agjendën legjislative të cilën ne e kemi miratuar në Qeveri dhe në programin qeverisës ky plotësim-ndryshim tashmë është i miratuar dhe është data 30 korrik datë që duhet të miratohet në Qeveri dhe të përcillet për këtë Kuvend. Unë besoj, duke parë edhe diskutimin këtu edhe gatishmërinë të partnerit të koalicionit qeverisës, që këtë plotësim-ndryshim do ta keni më 30 korrik në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për këtë pikë. E lus administratën të më tregojë a kemi kuorum për të votuar?

Në ndërkohë e ftoj propozuesen për fjalën përfundimtare, zonjën Teuta Haxhiu, që ta marrë fjalën. Lus regjinë që ta përdor zilen, po qe se ka deputetë të tjerë afër, sepse vetëm 59 janë në sallë për momentin.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetare e Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Ministra,

Zëvendëskryeministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Faleminderit shumë, sidomos prej deputetëve kolegë, që participuan për të dhënë mendimet e tyre në një problem afatgjatë të pazgjidhur. Mendoj që prapë ky është vendi ku ne e kemi obligim, para së gjithash qytetar, për të ngritur shqetësimet që na vijnë nga grupe njerëzish e mbi të gjitha nga shoqatat e pensionistëve, duke përmendur edhe shumë probleme të tjera që ne i kemi ngritur edhe në çdo mandat pothuajse, sidomos pensionet e dyfishta të familjeve të dëshmorëve dhe personave me aftësi të kufizuara apo ata që kanë qenë persona të verbër 100%, që nuk kanë gëzuar pensionin që kanë pasur si pension i personit të verbër dhe pension i familjes së dëshmorit.

Kjo, ministër, për mua, kërkon atë reformën që ju e keni përmendur edhe në mandatin e kaluar, por më e pakta që kam kërkuar dhe po kërkojmë ne si deputetë është një problem, vetëm një problem, i pensionistëve. Domethënë, problemet që u përmenden nga kolegët deputetë janë të shumta dhe është realitet, mirëpo vetëm një problem që është diskriminim, shkelje e të drejtave më elementare, është pikërisht ky stazh. Prandaj, duke ditur edhe disponimin e kolegëve të mi deputetë, unë që në fillim në fjalën time e thash që pensionistët kontributdhënës të marrin pensionet e tyre për aq vite sa kanë punuar. Prapa kësaj jam, mirëpo duke parë edhe fjalën e ministrit jemi të gatshëm, ministër, që të të mbështesim, të të përkrahim, duke ditur që ke qenë ministër edhe në mandatin e kaluar shkoi pak si gjatë histori se çfarë keni menduar, mirëpo konkretisht se çka do të bëni tash?

Ne do ta kemi një rezolutë, që unë po e lexoj. Megjithatë pres edhe nga grupet tjera parlamentare, sugjerimet e tyre, me dashamirësi që ta kemi një rezolutë, edhe pse e kam thënë vazhdimisht, fatkeqësisht nuk janë obligative. Nga një vend ku do të duhej të jenë obligative për Qeverinë, nga se ky është vendi që monitoron Qeverinë dhe askush tjetër. Prandaj, krejt çfarë kërkoj është që Qeveria e Kosovës të sjellë me urgjencë Ligjin o4/L-131 për plotësim-ndryshim, në mënyrë që të hiqet ai neni 8 dhe pika 1.2, që është diskriminuose, e përmendëm më herët, pra mënyrën se si i trajton pensionistët kontributdhënës.

Edhe për problemet tjera, do ta keni përkrahjen edhe në reformat që ju i keni iniciuar, mirëpo deri sa nuk kemi diçka ne si deputetë, ne nuk mund të themi, ministër, se thjesht nuk kemi bërë atë që po kërkojmë për ta bërë. Unë pres që në mbledhjen e parë të Qeverisë, ministër, ta kaloni këtë projektligj. Pra, unë besoj shumë, që kryeministri është këtu, dhe do ta ketë në mbledhjen e parë të Qeverisë, në mbledhjen e ardhshme pra këtë projektligj për plotësim-ndryshim dhe të na e sjellë neve si deputetë. Pra, unë pres pas debatit që edhe grupet tjera, nëse kanë, të ma përcjellin me shkrim ndonjë koment tjetër, që mund ta plotësojmë rezolutën tonë. Faleminderit!

KRYETARJA: Faleminderit! Me kaq përfundon debati për këtë temë. Tani do t'i vendos në votim të dy rezolutat, edhe ajo paraprakja që kishte të bënte me Telekomin, pra situatën financiare të Telekomit të Kosovës pas lejimit të përmbartimit të vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, për të vazhduar më pastaj me rezolutën që ka të bëjë me pensionistët kontributdhënës.

I lus deputetët, a dëshironi që sërish ta lexoni tekstin e rezolutës për Telekomin? Urdhëro, zonja nënkryetare!

ARBËRIE NAGAVCI: Të nderuar kolegë, ju falënderoj fillimisht për diskutimet në ditën e djeshme lidhur me këtë temë!

Propozimi ynë për rezolutën është si vijon:

Kuvendi i Kosovës në seancë plenare konstaton, se kontrata Telekom – Dardafon.net LLC e vitit 2009 ka të evidentuara nga hetimi parlamentar i zhvilluar nga Kuvendi i Kosovës në Legjislaturën VI elemente të mjaftueshme për t'u hetuar penalisht dhe për të kërkuar dëmshpërblim financiar ndaj palëve, që me veprimet e tyre kanë dëmtuar Telekomin e Kosovës, Shoqëri Aksionare, si dhe parimet kushtetuese, rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralin e shoqërisë.

Po ashtu, ka evidencë të mjaftueshme për të konkluduar që në procesin e Arbitrazhit Ndërkombëtar të përfunduar në vitin 2016 interesat e aksionarit, pra Qeveria e Kosovës dhe Korporatës Telekomit i Kosovës sh.a. nuk janë mbrojtur në proces.

Si pasojë, borxhi i krijuar nga ky proces duhet të mos pranohet. Një proces i ri gjyqësor, ku sigurohet mbrojtje e plotë e palës së dëmtuar, pra Telekomit të Kosovës, duhet të ndodhë. Andaj, në mbështetje të nenit 65, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, pas debatit parlamentar lidhur me diskutimin e situatës financiare të Telekomit të Kosovës, pas lejit të përmbartimit të vendimit përfundimtar OE1 nr.20990MHM të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pranë Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Paris, të mbajtur më datë 23 korrik 2020, Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i propozon Kuvendit të Republikës së Kosovës të miratojë këtë:

R e z o l u t ë

1. Qeveria të zbatojë në përpikëri vendimin nr. 02/39 të datës 2 qershor 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi masat për parandalimin e keqpërdorimeve në ndërmarrjet publike. Qeveria të mbikëqyrë vazhdimin, zbatimin dhe përshtatshmërinë e masave, si dhe të shqyrtojë mundësinë e plotësisimit të tyre.
2. Aksionari, ndërmarrjet dhe organet kompetente shtetërore të kërkojnë vërtetimin e nulitetit të marrëveshjes, që cenon rendin publik, dispozitat urdhëruese dhe moralin e shoqërisë. Nuliteti të kërkohet edhe në procedurë civile, pa marrë parasysh epilogun e rasteve penale.
3. Të nisen procedurat për ndryshimin e Ligjit 04/L-220 për investime të huaja, për të tërhequr pajtimin e pakufizuar të Republikës së Kosovës për Arbitrazh Ndërkombëtar, me cilëndo palë që pretendon se është investitor i huaj dhe që nuk i ka të deklaruar aksionarët e vërtetë.
4. Qeveria të ndërmarrë masa konkrete për të mbrojtur Telekomin nga kreditorët e pandërgjegjshëm me qëllim të stabilitetit financiar të Telekomit dhe të punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje.
5. Qeveria brenda 60 ditësh të hartojë një plan strategjik për rimëkëmbjen financiare të Telekomit. Gjithashtu, Qeveria brenda këtij plani të ketë prioritet rritjen e kapitalit, me qëllim të rritjes së vlerës së ndërmarrjes.
6. Aksionari nëpërmes të të zgjedhurve në Bordin e Drejtorëve të shqyrtojë të gjitha kontratat komerciale, që janë lidhur paraprakisht në kundërshtim me masat e përcaktuara të vendimit nr. 02/39.

Ju ftoj që ta mbështetni me votë këtë rezolutë dhe ju falënderoj!

KRYETARJA: Faleminderit! Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për Propozim-rezolutën. Lus deputetët që të përgatiten për votim! Po e shoh se edhe deputetët tjerë po na bashkohen në

ndërkohë. Në sallë janë 74 deputetë. Jemi duke votuar për Propozim-rezolutën nga debati parlamentar për situatën financiare në Telekomin e Kosovës, pra propozim-rezolutën që sapo e lexoi nënkryetarja e Kuvendit, zonja Nagavci.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarojnë për Propozim-rezolutën!

Kush është për? Faleminderit!

Kush është kundër? Nuk ka kundër.

Kush abstenon? Nuk ka as abstenime.

Lus administratën që ta sjellë rezultatin!

Kemi vetëm 29 deputetë, 29 vota për. Pra, nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm të deputetëve që kanë marrë pjesë në votim.

Po vazhdojmë me votimin e Propozim-rezolutës nga debati për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës, pra teksti i rezolutës u lexua tashmë nga deputetja Teuta Haxhiu.

Lus deputetët, që të përgatiten për votim!

Kush është për? Faleminderit!

Kush është kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenime? Nuk ka. Faleminderit!

48 vota për. Nuk ka kundër dhe as abstenim. Rrjedhimisht, edhe për këtë rezolutë nuk kishte kuorum të mjaftueshëm të deputetëve që morën pjesë.

- Propozimet e grupeve parlamentare për plotësime dhe zëvendësime të deputetëve në komisionet ad hoc dhe në komisionet parlamentare

Dhe në fund, të nderuar deputetë, siç e dini, i kemi disa propozime të grupeve parlamentare për plotësime dhe zëvendësime të deputetëve në komisionet ad hoc dhe në komisionet parlamentare.

1. Grupi Parlamentar i LDK-së ka propozuar plotësimin e dy komisioneve ad hoc me nga një anëtar shtesë nga ky grup parlamentar, pas shpërbërjes së Grupit Parlamentar Nisma. Deputetja Lirie Kajtazi propozohet anëtare në Komisionin ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Pavarur të Mediave, ndërkaq deputeti Ilir Ferati propozohet për anëtar në Komisionin ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të RTK-së.

2. Grupi parlamentar i AAK-së ka propozuar deputetin Haxhi Shala anëtar në Komisionin për Integrim Evropian, në vend të deputetit Bekë Berisha dhe deputetin Arbër Tolaj anëtar në

Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Infrastrukturë dhe Mjedis në vend të deputetit Rasim Selmanaj.

Në ndërkohë, sot ka ardhur edhe një kërkesë nga Lista serbe, me të cilën Lista serbe kërkon që në dy komisionet ad hoc, atë për RTK-në dhe atë për KPM-në, që deputeti Igor Simiq të zëvendësohet me deputetin Slavko Simiq.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për këto propozime.

Kush është për? Faleminderit!

A ka kundër? Nuk ka.

A ka abstenime? Nuk ka.

Me shumicë votash miratohet propozimi i grupeve parlamentare të LDK-së, AAK-së dhe Listës serbe për plotësimet dhe zëvendësimet e deputetëve në komisionet ad hoc dhe në komisionet parlamentare.

Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance.

* * *

E premte, më 7 gusht 2020

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 korrik 2020

Mbledhjen e drejton kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me:

- Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për financiare në Telekomin e Kosovës

Pra, diskutimet lidhur me këtë debat sa i përket situatës financiare në Telekom kanë përfunduar dhe propozim-rezoluta e Grupit të Lëvizjes Vetëvendosje u është shpërndarë deputetëve.

I lus deputetë që me ngritje dore të deklarohen. Jemi duke votuar për rezolutën për situatën financiare në Telekomin e Kosovës.

Kush është për? Faleminderit! A ka kundër? Nuk ka! A ka abstenime? Nuk ka!

Atëherë 27 deputetë kanë votuar pro rezolutës lidhur me situatën financiare në Telekomin e Kosovës. Nuk ka kundër dhe nuk ka abstenime.

Rrjedhimisht nuk ka kuorum të mjaftueshëm as për këtë rezolutë.

- Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për të drejtat e pensionistëve

Kjo rezolutë po ashtu është lexuar në seancën e kaluar dhe nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje dhe u është shpërndarë deputetëve për njoftim.

I lus deputetët që me ngritje dore të deklarohet lidhur me propozim-rezolutën për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës.

Kush është për? Kush është kundër? Nuk ka kundër. A ka abstenime?

44 deputetë kanë votuar për, 11 kanë abstenuar.

Totali është 55, rrjedhimisht as për këtë rezolutë nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

Nuk kanë ardhur deputetë të tjerë në ndërkohë. Kështu që në qoftë se vijnë, janë numëruar të gjithë ata që e ngritën dorën.

Nuk ka propozime nga grupet parlamentare, kështu që po vazhdojmë.

Të nderuar deputetë,

Këto seanca të papërfunduara me pikat për të cilat nuk kishte kuorum do të vazhdojmë kurdo që Kuvendi mblidhet herën tjetër dhe me vendim të Kryesisë.

* * *

KRYETARJA: Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdojmë, sapo u njoftova nga Administrata që numërimin që ma kanë sjellë më herët për rezolutën për të drejtat e pensionistëve kontributdhënës nuk i kanë numëruar 10 deputetë që kanë qenë mbrapa, tashmë erdhi numërimi i ri nga ana e Administratës. Ju lus edhe një herë t'i sillni numrat që ta lexoj totalin, sepse është numër tjetër i votave nga ajo që ma kanë sjellë me shkrim më herët.

Derisa të presim që t'i sjellë Administrata numrat pa gabim në numërim.

* * *

KRYETARJA: Atëherë, sa i përket rezultatit për votimin e rezolutës që ka të bëjë me të drejtat e pensionistëve kontributdhënës, 53 deputetë kanë votuar për, asnjë kundër dhe 11 deputetë kanë abstenuar. Rrjedhimisht, 64 kanë marrë pjesë në votim, pra rezoluta ka kaluar dhe kam kërkuar nga Administrata që ta sjellë të nënshkruar rezultatit, në mënyrë që të kemi prova të mjaftueshme për këtë që e lexova.

* * *

E enjte, më 17 shtator 2020

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 23 korrik 2020

Mbledhjen e drejton kryetarja e Kuvendit, znj. Vjosa Osmani.

KRYETARJA: Procedojmë me votimin e një pike të papërfunduar nga seanca e mbajtur më 23, 24 korrik dhe 7 gusht:

- Votimi i propozim-rezolutës nga debati parlamentar për situatën financiare në Telekomin e Kosovës, pas përmbarimit të vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit

Siç e dini, diskutimet nga debati kanë përfunduar. Prandaj, shkojmë drejtpërdrejt me votim.

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për propozim-rezolutën.

Kush është për? Faleminderit! Kush është kundër? Faleminderit!

A ka abstenime? A mund ta sillni rezultatin, ju lutem!

Me 28 vota për, 52 kundër dhe 1 abstenim, nuk kalon rezoluta nga debati parlamentar për situatën financiare në Telekomin e Kosovës.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*